**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**KUVENDI I KOMUNËS**

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe nenit 25.1 të Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës,

## THËRRAS

Mbledhjen e XLII-të (dyzetedy - mandati VII)-*e rregullt*, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më **31 korrik 2024, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunën e Podujevës**, në orën **10:00**, me këtë;

## REND TË DITËS

1. **Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: *29 mars 2024*; *23 maj 2024*; *19 qershor 2024* dhe *27 qershor 2024***

2. **Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti "*Furnizim me mekanizëm bujqësor*"**

3. **Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti "*Furnizim me mëshqerra*"**

4. **Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti "*Furnizim me sera*"**

5. **Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik pronat e paluajtshme shoqërore - "Mekanizmi" nën menaxhimin e AKP-së, dhe atë: Njësitë kadastrale 00244-2 dhe 00244-3 në Zonën Kadastrale Podujevë, për realizmin e projektit "*Ndërtimi i objektit për Banim të Përballueshëm*".**

6. **Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko-Llapi" Sh.A. në Podujevë**

7. **Raporti Financiar për periudhën janar - qershor 2024**

8. **Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për vitin 2023**
   8.1. **Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit**

9. **Propozim vendimi për shfuqizimin e vendimit nr.prot.01-016/01-0045377/23 për miratimin e Planit të Integritetit 2023-2027 në Komunën e Podujevës**

10. **Propozim vendimi për inicimin e procedurave për hartimin e planit rregullues të hollësishëm në pjesën e poshtme të qendrës 2 lindje - blloku 1**

11. **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - *Njësia kadastrale P-163-0, ZK Siboc i Epërm***
    11.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

12. **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës -** ***Njësia kadastrale P-297-0, ZK Dobratin***

12.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

13. **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës -** ***Njësia kadastrale P-337-1, ZK Dobratin***

13.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

14. **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës -** ***Njësia kadastrale P-337-2, ZK Dobratin***

14.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

15. **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës -** ***Njësia kadastrale P-336-0, ZK Dobratin***

15.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

16. **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës -** ***Njësia kadastrale P-640-0, ZK Lupç i Poshtëm***

16.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

17. **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës -** ***Njësia kadastrale P-1392-0, ZK Dobërdol***

17.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

18. **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës -** ***Njësia kadastrale P-1378-0, ZK Dobërdol***

18.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

19. **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës -** ***Njësia kadastrale P-1381-1, ZK Dobërdol***

19.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

20. **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës -** ***Njësia kadastrale P-1381-2, ZK Dobërdol***

20.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

21. **Të Ndryshme**

**Nr.Prot.01-01-060/03-0047244/24**
**Podujevë, datë; 19 korrik 2024**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Ilmi Hoxha**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - KOMUNA E PODUJEVËS - OPSTINA PODUJEVO - PODUJEVË/O

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KUVENDI I KOMUNËS

**Procesverbal nga mbledhja e XXXVII-të (tridhjeteshtatë)-*e rregullt*, mandati VII-të, e mbajtur më 29 mars 2024.**

Mbledhja filloi në orën 10:20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.
Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.
Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:
(Nga LDK *Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Adnan Zymeri; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Ilir Koprani; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani;* Fahri Hasani; kurse munguan; *Demokrat Hodolli dhe Tringa Sfishta*
Nga LVV, *Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota*; *Sebastina Vokrri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi.*
Nga PDK, *Bashkim Syla; Mimoza Abdullahu; Endritë Murati.*
Nga AAK, *Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.*
Nga OBKD, *Gazmend Islami i cili mungoi me arsyetim shëndetësor me shkrim dërguar Kryesuesit të Kuvendit.*

Gjithashtu të pranishëm mbledhje ishin, z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;
*(Xhevrie Beqiri-Drejtoria e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Leutrim Krasniqi-Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Pajtim Balaj-Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH; Alban Zeka-Drejtoria e Inspeksionit DI; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE).*

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të KFOR, përfaqësues të mediave lokale (TV Llapi), një qytetar dhe disa zyrtar komunal.

## Rendi i Ditës

**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe i'u dëshiroj mirëseardhje dhe punë të mbarë, theksoi, kuorumi ekziston për momentin prezent janë 27 anëtar/e të Kuvendit, kurse mungojnë 8 e prej tyre 2 dy janë me arsyeje (Demokrat Hodolli dhe Xhevdet Maloku) të cilët më kanë njoftuar për mungesën e tyre, në fakt mungesat e këshilltarëve janë bërë të shpeshta për çka edhe shoqëria civile ka dal me një raport për mungesat e anëtarëve të Kuvendit në seancat e mbajtura, por unë nuk dëshiroj që të merrem me këtë problem tani.

Sa i përket rendit të ditës besoj që materialin e keni pranuar me kohë, po ashtu rekomandimet e Komitetit për Politik dhe Financa, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron të marr fjalën, nëse jo atëherë e hedhim në votim rendin e ditës së bashku me rekomandimet e Komitetit për Politik dhe Financa nga mbledhja e mbajtur më 28.03.2024.

*Njëzëri me 27 vota Për, nga anëtarët që ishin prezent në sallë, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar, përfshirë edhe pikën shtesë të rekomanduar nga KPF në mbledhjen e mbajtur më 28.03.2024, dhe atë:*

- ***Plotësim ndryshimi i përbërjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB,*** *përkatësisht z.Bashkim Bajrami Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë, të jetë anëtar në kuadër të përbërjes së KKSB në vend të ish Komandantit z.Nijazi Jashari i cili është pensionuar.*

1. **Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: *28.12.2023*; *30.01.2024* dhe *17.02.2024***

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, kemi 3 procesverbale nga mbledhjet e kaluara të Kuvendit, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për ndonjë plotësim ndryshim apo ndonjë korrigjim eventual, nëse jo atëherë i hedh në votim këto tri procesverbale sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

*Njëzëri, pa plotësim ndryshime, korrigjime apo vërejtje eventuale, miratohen procesverbalet sipas materialeve përkatëse të dërguara për këtë pikë të rendit të ditës.*

2. **Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00594-0, ZK Turuçicë**

   ***2.1.*** *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**znj.Saranda Stublla**, drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, pikë e rendit të ditës e kemi propozim vendimin për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në Zonën kadastrale Turuçicë si dhe propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësueses për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, ku për këtë komision nga ana Ekzekutivit me propozim të Kryetarit të Komunës propozojmë z.Avni Fetahu dhe znj.Adelina Stublla, kurse nga shoqëria civile propozojmë Alejna Hamiti.
**z.Valon Demolli**, theksoi, ne Grup i LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim për dhënie në shfrytëzim dhe për anëtar në komisionin përkatës nga Lidhja Demokratike e Kosovës e propozoj znj.Arnisa Sylejmani.
**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim këtë propozim vendim dhe për anëtar në komisionin në fjalë e propozojmë znj.Qëndresa Hajrizi.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ka ndonjë propozim tjetër, nëse nuk kemi atëherë e hedh në votim propozim vendimin për miratim për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës me njësi kadastrale P-00594-0, ZK Turuçicë së bashku me propozim vendimin për formim të komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të kësaj prone, sipas propozimeve të paraqitura nga parafolësit.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 28 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00594-0, ZK Turuçicë, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, në këtë përbërje:*
*z.Avni Fetahu, nga Ekzekutivi i Komunës*
*znj.Adelina Stublla, nga Ekzekutivi i Komunës*
*znj.Arnisa Sylejmani, nga Kuvendi i Komunës*
*z.Ardi Hasani, nga Kuvendi i Komunës*
*znj.Alejna Hamiti, nga sektori joqeveritar lokal*

3. **Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00596-0, ZK Turuçicë**
   ***3.1***. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**znj.Saranda Stublla**, drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, kemi propozim vendimin për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës në Zonën kadastrale Turuçicë me numër të parcelës P-00596-0, si dhe propozim vendimin për formimin e komisionit përkatës nga Ekzekutivit i Komunës propozojmë z.Bahri Selimi dhe znj.Xhevrie Beqiri, ndërsa nga shoqëria civile propozojmë z.Rilind Konushevci.
**z.Valon Demolli**, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim, ndërsa për anëtarë të komisionit e propozojmë z.Ilir Koprani.
**z.Fitim Muçolli**, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës dhe për anëtar të komisionit propozojmë z.Ardi Hasani.
**z.Haki Rudari**, theksoi, vetëm një sqarim sa i përket Grupit ton të LVV-së, ne mund të bëjmë zëvendësim te pika paraprake dhe znj.Qëndresë Hajrizi të jetë në këtë komision kurse z.Ardi Hasani të jetë anëtar i komisionit sipas pikës paraprake, pra nuk paraqet ndonjë problem.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, e hedhim në votim propozim vendimin për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër sipas kësaj pike të rendit të ditës së bashku me propozim vendimin për formim të komisionit vlerësueses duke theksuar që në vend të znj.Qëndresa Hajrizit në pikën dytë të rendit të ditës kalon z.Ardi Hasani kurse në këtë pikë të rendit të ditës anëtare e komisionit propozohet znj.Qëndresë Hajrizi, pra kjo për shkak të përmbushjes së kushtit të përfaqësimit gjinor.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 28 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në*

*<u>shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00596-0, ZK Turuçicë</u>, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe <u>propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim</u>, në këtë përbërje:*
*z.Bahri Selimi, nga Ekzekutivi i Komunës*
*znj.Xhevrie Beqiri, nga Ekzekutivi i Komunës*
*z.Ilir Koprani, nga Kuvendi i Komunës*
*znj.Qëndresë Hajrizi, nga Kuvendi i Komunës*
*z.Rilind Konushevci, nga sektori joqeveritar lokal*

4. **Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00597-0, ZK Turuçicë**
   ***4.1***. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, kërkoj të jemi të kujdesshëm sa i përket formimit të komisionit sepse duhet të kemi parasysh barazinë gjinore.
**znj.Saranda Stublla**, drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, si pikë të rendit të ditës e kemi edhe propozim vendimin për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme së komunës me njësi kadastrale P-00597-0 Zona kadastrale Turuçicë, ndërsa sa i përket anëtarit të komisionit nga ana e Ekzekutivit të Komunës e propozojmë z.Vigan Salihu dhe z.Leutrim Krasniq, ndërsa nga shoqëria civile propozojmë znj.Fahrie Rashiti.
**z.Valon Demolli**, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së i përkrahim këto propozim vendime dhe anëtare të komisioni vlerësues e propozojmë znj.Edona Shabani.
**z.Bahri Blakqori**, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim këtë propozim vendim dhe anëtar të komisionit e propozojmë z.Fitim Muqolli.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 28 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet <u>propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00597-0, ZK Turuçicë</u>, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe <u>propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim</u>, në këtë përbërje:*
*z.Vigan Salihu, nga Ekzekutivi i Komunës*
*z.Leutrim Krasniqi, nga Ekzekutivi i Komunës*
*znj.Edona Shabani, nga Kuvendi i Komunës*
*z.Fitim Muçolli, nga Kuvendi i Komunës*
*znj.Fahrie Rashiti, nga sektori joqeveritar lokal*

5. **Nisma për bashkëpunim ndër-komunal mes Komunës së Podujevës me Komunave:** Komuna e Vushtrrisë; Komuna e Prishtinës; Komuna e Mitrovicës së Jugut dhe Komuna e Obiliqit
   ***5.1.*** *Propozim vendimi për miratimin e kërkesës – nismës për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal*
   ***5.2.*** *Propozim vendim për autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për themelimin e bashkëpunimit ndër - komunal*

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, theksoi, kjo nisëm e bashkëpunimit ka të bëjë me ndërtimin e rrugës lidhëse që parashikohet të shtrihet për afërsisht në kufij të komunave që do të shërbej si rrugë lidhëse e që do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e turizmit rural po ashtu edhe në funksionalizimin e plotë të kësaj zone. Komuna të cilat kanë planifikohen të jenë pjesë e këtij bashkëpunimi janë, Komuna e Podujevës, Komuna e Prishtinës, Komuna e Vushtrrisë, Komuna e Obiliqit dhe Komuna e Mitrovicës së Jugut. Hapi fillestar i këtij bashkëpunimi do të jetë studimi i fizibilitetit e më pastaj edhe hartimi i projektit, në varësi të përcaktimit në kuadër të këtij bashkëpunimi edhe Komuna Podujevës do të participoj në ndërtimin e kësaj rruge.
Funksioni i kësaj rruge do të jetë mjaft i madh duke e marr për bazë që do të jetë si pjesë e një rëndësie mjaft të madhe për zonën kufitare në mes këtyre komunave.
Sa i përket trasesë së rrugës ende nuk ka diçka të përcaktuar përveç që parashihet të filloj te pjesa e Barilevës e duke ndjekur pjesën veriore dhe të përfundoj deri në Bjagorë, pak a shumë të ndjek pjesën e kreshtës malore apo malet e Kopavnikut që fillojë te pjesa e Barilevës dhe të përfundojë te pjesa e Bajgorës, mirëpo pas raportit apo studimit të fizibilitetit do të jetë e përcaktuar edhe traseja e rrugës se ka do të jetë, kjo është pjesa për këtë bashkëpunim ndër komunal.
**z.Ardi Hasani**, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim nismën për bashkëpunim ndër komunal në mes Komunës së Podujevës, Komunës së Prishtinës, Komunës së Vushtrrisë, Mitrovicës së Jugut dhe Obiliqit.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, sot e kemi një nismë për bashkëpunim ndër komunal për ndërtimin e rrugës mes këtyre komunave dhe sigurisht që e ka mbështetjen e Grupit të LDK-së, për bashkëfinancim të komunës tonë me komunat e cekura.
Edhe në mbledhjen e KPF-së por edhe sot këtu dua të shfaqë rreth çështjes së trasesë, drejtori parafolës e dha mendimin se nga do shkojë traseja mirëpo krejt çka sqaroj është që do të bëhet studimi i fizibilitetit dhe përmendi disa kreshta se ku mendohet se do të shkojë, vërtetë duke e pasur parasysh këtë segment nuk jam autoritet në kuptimin profesional si gjeograf mirëpo çka dua të theksoj është se dje në një komunë tjetër e cila është bashkëpunim me Komunën e Podujevës më ra rasti të shoh që kjo trase apo rrugë kah ka do të kaloj dhe në një formë ne në Kuvend të Komunës në Podujevës sot nuk e kemi, kurse në një komunë tjetër e kemi të vendosur saktë vendet se kah do të shkojë traseja e kësaj rruge, për të qartësuar këtë në komunën e Obiliqit është vendosur si pikë e rendit të ditës për këtë rrugë e cila do të kaloj nëpër Barilevë, Kozaricë, Dumnicë e Epërme, Kunovik, Vesekofc, Kurillovë dhe Bajgorë, dhe nga kjo nuk besojë dhe nuk po e shoh që po e preket territori i Komunës së Podujevës.
Fare nuk zbret nga vlera një rrugë qoftë edhe e komunave tjera si motra sepse i afrohet territorit të Komunës së Podujevës dhe sigurisht ajo do të ketë të mirat e veta qoftë për turizëm apo për segmente lidhëse që do t’i kemi më afër. Edhe dje në KPF por edhe sot e theksoj që një segment i një rëndësie të veçantë për shkarkimin dhe gjegjësisht hyrjen në funksion të qarkullimit të lirë të Komunës sonë do të ishte rruga Llapashticë – Popovë, pra të lidhet kjo rrugë, ndërsa dje është përmendur disa herë në KPF që kalon në fshatrat Lupç, Majac, Barilevë që në një formë më duket e pakuptueshme, por si do që të jetë po e përmbylli me këtë, se ne e mbështesim si projekt si çdo projekt tjetër i cili është në funksion të një rruge e cila në veçanti mund të ketë impakt në turizëm.

**z.Bashkim Syla**, theksoi, ne e diskutuam edhe dje në KPF, kështu që si Grup i PDK-së e mbështesim këtë projekt, përkatësisht këtë pikë të rendit të ditës.
**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, theksoi, është e vërtetë që janë përmendur disa fshatra sa i përket trasesë së kësaj rruge, Komuna e Vushtrrisë ka qenë iniciatore fillestare rreth kësaj rruge ku unë kam kontaktuar me inxhinieret përkatës të cilit e kanë punuar këtë planifikim, kanë vendos që kah të kaloj rruga dhe sigurisht që të jem më konkret edhe para jush nuk kam pas ndonjë hartë se kah do të kaloj rruga. Me vet faktin që nuk ka ende studim të fizibilitetit nuk ka të përcaktuar se nga do të kaloj traseja e rrugës, mund të supozojmë në fshatrat të cilat janë në kufij në mes të komunave, mirëpo zyrtarisht të përcaktuar në detaje nuk kemi ende, mund të ketë një pjesë të shtrirjes më pak ose më shumë në mes Komunës së Vushtrrisë dhe Komunës së Podujevës që janë në afërsi të kufirit por ndonjë përcaktim në detaje nuk kemi.
Në këtë rast po fillojmë nga pjesa e Barilevës mund të jetë Kozaricë ose mund të jetë pjesa e Lupçit të Poshtëm pastaj Majac, Dumnicë e Epërme, Vesekofc apo pjesa e Lupçit të Epërm, Popovë deri te pjesa e Bajgorës,  pra pak a shumë është kjo çështje edhe për Komunën e Obiliqit por edhe për komunat e tjera nuk ka diçka të përcaktuara si iniciativë për përcaktimin e trasesë së rrugës. Ndërsa për rrugën e Llapashticës që u cek ne kemi bërë kërkesë në kuadër të thirrjes publike prej 17,000,000.00€ që ka qenë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duke e marr për bazë që territori i Komunës tonë është mjaft i madh dhe ka një numër të madh të kërkesave dhe siç janë deklaruar po shpresojmë që të gjen përkrahje për ndërtimin e kësaj rruge e cila po ashtu është në funksion të lidhjes së fshatit Llapashticë me pjesën tjetër rurale që është fshati Popovë.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, edhe dje edhe sot ne e shfaqëm mendimin se ne e mbështesim këtë projekt sepse është një lehtësim për jetën dhe zhvillimin ekonomik të këtyre vendeve, qoftë nëse atakohem drejtpërdrejtë si Komunë apo jo.
Ajo që dëshiroj një sqarim është se nëse në një Kuvend tjetër komunal është vendosur dhe caktuar me emër kah do të shkoj kjo rrugë, pra dje është vendos dhe i përmenda emrat Barilevë, Kozaricë, Dumnicë, Kunovik, Kurillovë, Bajgorë pra që është vendos në një Kuvend të Komunës tjetër dhe nëse është vendosur në një kuvend tjetër, andaj nëse bashkëpunimi ndër komunal dhe ata akter të bashkëpunimit çka do që shohin të arsyeshme për bashkëpunim do ta kenë mbështetjen apo përkrahjen, mirëpo derisa në një Kuvend Komunal të një Komune tjetër jepen emrat si projekt ideor, atëherë çfarë do të studioj ai fizibilitet që u cekë, pra duhet të ketë një orientim sepse nuk bëhet fizibiliteti për kreshta por duhet të jetë një projekt ideor i cili pastaj kalon në fazën e dytë.
Sa për sqarim, nëse Komuna e Obiliqit e dinë trasenë dhe e ka vendos si Kuvend i Komunës, ka qenë e rrugës që edhe Podujeva të jetë aty sepse ne nuk po e kundërshtojmë.
**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, traseja sipas të gjitha gjasave do të kaloj përmes malit të ashtuquajtur Gerdec, besoj se një pjesë e juaja e din se ku është, dhe në atë sektor në pjesë të caktuara kalon brenda kufirit administrativ të Podujevës, kurse masa më e madhe e rrugës sigurisht se do të kaloj përmes komunave fqinje, por do të preken edhe pjesë të territorit të Komunës tonë dhe atë diku afërsisht mes fshatrave Lupç i Epërm dhe Popovë.
Edhe një çështje, traseja që na është dërguar nuk dëshiruam t'jua përcëllim juve sepse t'ju them të drejtën ishte shumë qesharake, pra kemi një hartë të vjetër e që nuk e di se cila nga këto Komuna e ka bërë andaj kjo ishte arsyeja përse ne nuk e kemi paraqitur para juve trasenë saktë sepse as ata nuk e kanë definuar saktë. Fizibiliteti pak a shumë ideor aty është, por në fizibilitet do të caktohet traseja e saktë, nëse futet më thellë në territorin e Komunës së Podujevës jemi në rregull edhe vetëm nëse pak e prek territorin ton prapë jemi në rregull.

Ajo që është shumë e rëndësishme është fakti që ne tashmë e kemi të asfaltuar rrugën e fshatit Majac deri në fshatin Popovë dhe i kemi edhe disa degëzime të tjera që i kemi bërë dhe në çfarë do rrethane neve dhe qytetarëve tan po ju afrojmë një mundësi kyçe në atë arterie rrugore që do të bëhet, e që besojë që do të ketë efekt pozitiv, kurse sa do të jetë gjatësia e rrugës që kalon në kufirin administrativ të Komunës së Podujevës nuk e dimë saktë, por këtë do ta përcaktoj fizibiliteti, ndoshta mund të jetë 100, 300, 500 metra apo edhe 1 km, por nuk e dim saktë sepse në hartën që neve na është dërguar vetëm e kanë skanuar ashtu thjesht e që ndoshta po ta kishte drejtori i DPUMM z.Leutrim Krasniqi sigurisht që do ta rregullonte më mirë, por neve na e kanë dërguar atë hartë në atë formë.
Është një kërkesë që është nisur iniciativë edhe me Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pra nuk e financojmë ne këtë projekt por do të investoj Ministria, por si kërkesë do të shkojë në emër të këtyre 5 komunave në mënyrë që pastaj të hapen mundësitë për financim nga ana e Ministrisë. Kështu që sa e vërejta në atë hartë një pjesë të territorit të Komunës së Podujevës do të përfshihet në atë rrugë, konkretisht mes fshatit Lupç i Epërm dhe fshati Popovë, mirëpo tani kemi të bëjmë me Marrëveshje të bashkëpunimit ndër komunal mes këtyre komunave në mënyrë që t'i japim dritën e jeshile këtij procesi për të vazhduar tutje si projekt, ndërsa pas studimit të fizibilitetit do ta kemi trasenë e saktë dhe se në atë trase të saktë unë do të kërkoj që nëse kërkohet të bëhen pagesa për studim të fizibilitetit, unë do ta paguaj vetëm gjatësinë apo pjesën që kalon më territorin e Komunës së Podujevës, por a është e mirëseardhur për Komunën ton besoj që po sepse e lidh atë pjesë bukur mirë.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo e hedhim në votim Nismën për bashkëpunim ndër-komunal mes Komunës së Podujevës me Komunave: Komuna e Vushtrrisë; Komuna e Prishtinës; Komuna e Mitrovicës së Jugut dhe Komuna e Obiliqit së bashku me dy propozim vendimet përkatëse, Propozim vendimi për miratimin e kërkesës - nismës për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal si dhe Propozim vendim për autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 28 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet Nisma për bashkëpunim ndër-komunal mes Komunës së Podujevës me Komunave: Komuna e Vushtrrisë; Komuna e Prishtinës; Komuna e Mitrovicës së Jugut dhe Komuna e Obiliqit, përkatësisht:*

- *Propozim vendimi për miratimin e kërkesës – nismës për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal*
- *Propozim vendim për autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për themelimin e bashkëpunimit ndër – komunal,*

*sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.*

## 6. Raporti Vjetor Financiar i Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31.12.2023

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, e paraqiti Raportin në fjalë, ndër të tjera theksoi, po e hapim diskutimin për raportin financiar të Komunës së Podujevës për periudhën 1 janar deri me 31 dhjetor 2023, raport i cili pasqyron aktivitetet financiare që janë kryer gjatë periudhës së cekur.
Komuna e Podujevës si një organizatë buxhetore sikurse të gjitha komunat tjera apo organizatat tjera buxhetore e ka për obligim ligjor raportin vjetor financiar të përpiloj në kudër të udhëzimeve dhe rregulloreve të Ministrisë së Financave dhe në kuadër të formatit të cilin e përcakton Ministria e Financave dhe kjo është një pasqyrë financiare e cila në fund të vitit dërgohet në Thesarin e Republikës së Kosovës ku verifikohen të dhënat të cilat i paraqet kjo pasqyrë financiare.
Gjithashtu kjo pasqyrë financiare është pjesë e auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës ku edhe mbi bazën e këtyre të dhënave jepet opinioni nga kjo Zyrë, normalisht jo vetëm mbi bazën e pasqyrës financiare por Zyra Kombëtare e Auditorit jep opinione edhe për çështjet e tjera të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë financiare dhe jo vetëm, të cilën Komuna e Podujevës e ka përbrenda një viti fiskal.
Në bazë të buxhetit i cili është i miratuar në Kuvendin e Komunës për vitin 2023 ku sipas strukturës ka qenë; për paga dhe mëditje 13,041.474.00€, për mallra dhe shërbime 3,088.899.00€, për shpenzime komunale 468.000.00€, për subvencione 1,650.000.00€, dhe për shpenzimet kapitale 9,208,144.00€, pra qe ka qenë një buxhet në total prej 27,406.567.00€.
Gjatë vitit ka pasur ndryshime të buxhetit në raport me buxhetin fillestar dhe kjo ka ardhur në disa kategori siç është rasti për kategorinë e pagave e cila ka një rritje të buxhetit nga 13,000.000.00€ në 16,147,349.00€ si rezultat i fillimi të zbatimit të Ligjit të ri për paga, e që kur është planifikuar buxheti i vitit 2023 në bazë të Qarkores së Ministrisë së Financave janë marr parasysh pagat që kanë qenë aktuale, pra ka qenë para hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për paga, dhe ndërkohë Ministria e Financave e ka pasur një klauzolë ku me hyrjen në fuqi të Ligjit për paga mjetet i ka shpërndarë në organizatën buxhetore me qëllim të mbulimit të pagave për vitin 2023.
Në mallra dhe shërbime kemi një buxhet 3,357,402.00€, pra është një diferencë në bazë të buxhetit fillestar të miratuar ku kjo ka ardhur si rezultat se këtu në Kuvend të Komunës afër 222.000.00€ me vendim i kemi bartur nga kategoria kapitale në kategorinë e mallrave për arsyeje të disa nevojave dhe pamundësisë së mbulimeve në kategorinë e mallrave me mjetet të cilat kanë qenë në buxhetin fillestar dhe krejt kjo për shkak të rritjes të çmimeve në disa kategori.
Në kategorinë e komunalive nuk ka pasur ndonjë ndryshim, kurse në kategorinë e subvencioneve ka qenë një ndryshim dhe arsyeja se ka qenë si bazë e bartjeve buxhetore që kanë ndodh nga viti 2022 në vitin 2023. Po ashtu te investimet kapitale ka pasur një ndryshim nga 9,208.000.00€ në 9, 794.000.00€ e që edhe kjo ka ardhur si rezultat i bartjes së të hyrave nga viti 2022 në vitin 2023.
Shpenzimet e buxhetit në vitin 2023 sipas kategorive janë, në kategorinë e pagave 16,110.000.00€, në kategorinë mallra dhe shërbime 3,142.000.00€, në kategorinë e shpenzimeve komunale 465.000.00€, për subvencione dhe transfere 1,554.000.00€ dhe për investime kapitale 8,468,073.00€. Në qoftë se e marrim me përqindje realizimi i shpenzimeve në raport me buxhetin i cili është buxhet përfundimtar, në kategorinë e pagave kemi shpenzim 99.78%, na kategorinë e mallrave 93.59%, në kategorinë e shpenzimeve komunale kemi 99.39%, në subvencione dhe transfere 85.06% dhe në investime kapitale 86.46% që është një rekord i investimeve kapitale në këto vitet e fundit, dhe fundja nëse e marrim parasysh sigurisht është një informatë që ju intereson vetëm lidhur me shpenzimet të cilat janë nga granti qeveritar, pagat dhe mëditjet kanë qenë 99.77%, për mallra dhe shërbime nga fondi dhjetë janë shpenzuar 94%, për shpenzimet komunale 99.39%, për subvencione dhe transfere që kanë qenë të planifikuara nga granti qeveritar janë

shpenzuar 98.66%, ndërsa për investime kapitale mjetet të cilat kanë qenë të planifikuara nga graniti qeveritar janë shpenzuar 91.71%, pra kemi një rekord të investimeve kapitale qoftë si përqindje e realizimit apo qoftë nëse e marrim si vlerë totale të investimeve kapitale.
Tek të hyrat vetanake në bazë të planifikimit të buxhetit kanë qenë 1,806,493.00€, mirëpo gjatë periudhës janar-dhjetor 2023 janë realizuar të hyra 2,150,706.00€ që kemi një tejkalim të të hyrave vetanake e që besojmë që është një tregues i mirë për arsyeje se këto mjete financiare të cilat janë tejkalim nga ato të planifikuara do të bartën për investime varësisht nga politikat të cilat do të jenë dhe nga projektet ku konsiderohen me prioritet për investim.
Në pasqyrat financiare i keni edhe shpenzimet të cilat janë në bazë të kodeve ekonomike qoftë si kategori e mallrave qoftë te kategoria kapitale, do të thotë mallrat të gjitha të specifikuara qoftë për shpenzimet për mirëmbajtje të ndërtesave dhe për mirëmbajtje të shkollave si dhe mirëmbajtën e objekteve shëndetësore, shpenzimet të cilat kanë të bëjnë me furnizime mjekësore, furnizim me ushqim siç janë ushqimi për Çerdhen dhe për Institucione shkollore për nxënësit nga klasa I deri V.
Tek komunalit siç e ceka janë shpenzuar 465.000.00€ në total, ku për rrym janë shpenzuar 356.000.00€, për ujë janë shpenzuar 56.000.00€, për mbeturina 44.000.00€, ndërsa te kodi shpenzimet telefonike që është 10.000.00€ normalisht që ka të bëjë edhe me shpenzimet telefonike të komplet institucioneve duke përfshirë shkollat, objektet shëndetësore dhe përfshihen shpenzimet e internetit qoftë për objekte komunale arsimore shëndetësore.
Shpenzimet për subvencione janë gjithsej 1,554.000.00€, dhe shpenzimet kapitale të cilat totalin e kemi cekur, pra te investimet kapitale janë në bazë të kodeve ekonomike për ndërtesa të banimit 127.000.00€ sigurisht që e kemi një sqarim ku bëhet fjalë për shpenzimet të cilit kanë të bëjnë për ndërtimin e Qendrës Rezidenciale për të Moshuarit që është në bashkëfinancim me Organizatën humanitare “Jetimat e Ballkanit”, pastaj shpenzimet për ndërtesa administrative afariste 255.000.00€ kjo ka të bëjë me shpenzimet të cilat janë për ndërtimin e Stacionit të Autobusëve, mandej për objekte arsimore siç është ndërtimi i shkollave në fshatin Dumosh dhe në fshatin Obrançë, pastaj kemi edhe renovimin e objekteve shëndetësore ku janë investuar 1,273.000.00€, për objekte shëndetësore 224.000.00€ që ka të bëjë edhe participimi me Organizatën Qatar Charity si dhe për investime në renovimet e objekteve shëndetësore tjera. Tek objektet kulturore kemi 19.000.00€ siç është për objekte memorialë ku bëhet fjalë për ndërtimin e Shtatores së Adem Demaçit 60.000.00€. Mandej po ashtu kemi shpenzime për pajisje mjekësore 101.000.00€.
Te kodi ekonomik - toka që është 954.000.00€ ka të bëjë me çështjet e shpronësimit të cilat janë 250.000.00€ për Zonën Industriale ndërsa pjesa tjetër ka të bëjë me çështjen e shpronësimit për ndërtimin e rrugës së re nga rruga “Vëllezërit Frashëri” deri në magjistrale Podujevë-Prishtinë, si dhe shpenzime për kanalizim, për rregullim të lumenjve e të tjera.
Bëra përpjekje që në formë të shkurtë të jep disa sqarime dhe të bëjmë një prezantim të Raportit financiar për vitin fiskal 2023.
**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, para vetës kemi një dokument shumë të rëndësishëm siç është Raporti financiar për vitin kalendarik 2023, dhe nuk po e di kah të filloj. E para dhe shumë e rëndësishme që duhet të potencoj para juve dhe qytetarëve është që Ekzekutivi na sjellë një raport financiar të kamufluar ku përmes tij tenton të na mashtroj edhe neve si dhe qytetarët e që mendoj që është shkelje flagrante, andaj në vazhdim do ti paraqesë të gjitha mashtrimet që tentuan ti bëjnë përmes këtij raporti dhe nëse është e vërtetë që jeni duke kamufluar do t’ju pagëzojmë me emrin mashtrues.
Po e filloj me buxhetin ku në fund të vitit na mbetet suficit rreth 2,000.000.00€, një shumë aq e madhe të mbetet suficit është treguesi më i mirë se ju jeni të dobët dhe të pa afet të menaxhoni paranë publike, kurse qytetarët po i mashtroni me realizim perfekt të parashikimeve buxhetore.

A jap përgjegjësi ndokush nga ju për këtë dështim, nuk jam duke folur për shuma 500,000.00€ euro dhe as për 1,000,000.00€ por për plot 2,000,000.00€ të mbetura suficit.
Drejtori parafolës u krenua me tejkalimin e të hyrave vetanake por nuk u bë i sinqertë që aty bëjnë pjesë edhe të hyrat indirekte e të cilat janë gjobat në trafik, gjobat e gjykatës dhe pagesat tek Agjencioni i Pyjeve që janë mbi 400,000.00€ dhe ju nuk keni dorë në ato pagesa.
Në këtë Raport tek drekat zyrtare i keni paraqitur vetëm 3,000.00€ që është një pjesë e mashtrimit të cilin e potencova më herët. A e dini sa ka shpenzuar Ekzekutivi i Komunës për dreka zyrtare, janë 10,000.00€ - 20,000.00€ por i kamuflojnë si ushqim dhe pije dhe shërbime. Të gjitha pagesat janë të deklaruara në sistemin e free balance për të cilat janë dhënë restoranteve dhe lokaleve të gastronomisë.
Tek udhëtimet zyrtare dhe shpenzimet tjera përcjellëse po ashtu kemi një mashtrim në raport, ku sipas sistemit free balance janë paguar rreth 17,000,00€ - 18,000.00€, pastaj 6.000.00€ janë paguar nga buxheti i QKMF-së për udhëtim zyrtar për asistenten e kryetarit, merre me mend se çka shpenzohet. Kemi pagesë 330,000.00€ për shtimin hapësirave publike të gjelbëruara dhe kopshte për fëmijë kurse në realitet nuk është bërë asgjë, përndryshe më jepni shembull se ku është bërë ky investim. Te Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM janë shpenzuar milionat në 2-3 kode, asfaltimi i rrugicave në qytet nga rr.”Zahir Pajaziti” janë paguar 465,000.00€ ku më e sa e di unë në atë pjesë gati qe 20 vite kanë përfunduar ato rrugë, nëse del të jetë e saktë.
Ngritja e infrastrukturës për turizëm dhe kamping janë paguar 200,000.00€ por nuk e di në cilin pjesë më saktë është bërë ky investim. Diçka e dyshuar janë pagesat e shumta si shërbime kontraktuese dhe shërbime këshillëdhënëse, nëse ka mundësi drejtori të na shpjegoj saktë se për çfarë shërbime bëhet fjalë. Pastaj nga DPUMM bëhet pagesë për transportin e nxënësve edhe kjo është një gabim. Te Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, të gjitha punët i kryen vetëm një kompani që drejtori e ka për qejfi, kurse qeverisjes së kaluar i thërriste konferencë të jashtëzakonshme po për të njëjtën kompani, a nuk ka të tjera kompani për të kryer këto punë a është vetëm kjo. Ndërtimi i kanalizimeve prej 528,000.00€ gjithë këtë investim si mos të kishte rrjet të kanalizimit në Podujevë, pra po i bie që të fillojmë nga fillimi. Zgjerimi dhe rregullimi i shtratit të lumit Llap në qytet ku u paguan 350,000.00€, në qytet nuk është punuar asgjë.
Ndërtimi i trotuareve në rr.“Zahir Pajaziti” është një vlerë 443,000.00€, shtrohet pyetja ku janë shtruar të gjitha këto trotuare sepse shumica prej tyre janë të përfunduara. Mandej kemi 130,000.00€ pagesa për intervenim emergjent në kohën e vërshimeve e që dyshoj që ka pasur edhe keqpërdorime pasi është dhe me negocim direkt dhe dihet se kush ka përfituar dhe është kompania e preferuar e drejtorit e që nëse e llogaritim dalim mbi 2,000,000.00€ vlerë që merr tenderë nga Komuna e Podujevës vetëm një kompani. Mbi 8.000.00€ janë paguar për mirëmbajtjen e 2-3 fontanave në qytet, po ashtu në emër të mirëmbajtjes së ndriçimit publik u paguan mbi 80,000.00€ ku me gjithë këto mjete do të ishte bërë krejt një rrejt i ri.
Nga kodi i shkollës “Aleksandër Xhuvani” drejtori i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sport merr mjete për udhëtime jashtë vendi, mandej nga kodet e shkollës “Isa Boletini” dhe “Naim Frashëri” janë bërë pagesa për karburant të veturave, kurse sa e di unë shkollat nuk kanë vetura në pronësi për të shpenzuar karburant. Kemi pagesën 9,483.00€ që janë paguar po ashtu nga kodi buxhetor i Gjimnazit për mirëmbajtje të ndriçimit të objekteve. Po ashtu 20,00.00€ janë shpenzuar për kulmin e shkollës “Zahir Pajaziti” në Orllan. Shuma 25,000.00€ është shpenzuar nga kodi buxhetor i shkollës “Kongresi i Manastirit” për rregullimin e nyejve sanitare.
147,000.00€ janë paguar për furnizim me dru nga kodi buxhetore shkolla “Ali Ajeti” ku në kuadër të kësaj shkolle përfshihen shkollat e fshatrave Lladoc, Sfeqël, Balloc dhe sa kam njohuri unë shkolla e fshatit Ballocit e ka ngrohjen me pelet ku nëse i kthejmë në metra kub këto bëjnë rreth

3000 metra kub dru që janë paguar për dy shkolla, kurse në total janë rreth 600,000.00€ pagesa për dru, pastaj po me të njëjtin kod janë paguar 50,000.00€ për rregullimin e kulmit dhe nuk është punuar asgjë, çfarë kanë ndodhur me ato mjete pres një përgjigje nga drejtori. Po ashtu 25,000.00€o janë paguar për nyje sanitare.
Kaq kisha unë për fillim dhe pres përgjigje nga drejtorët e Drejtorive, pastaj vazhdojmë me replika.
**z.Haki Rudari**, theksoi, Raport financiar është një nga mekanizmat kryesor i monitorimit dhe mbikëqyrjes së buxhetit komunal ku ka për qëllim në radhë të parë mjetet sipas burimeve apo inkasimeve dhe ka për qëllim investimet, për ata është ky buxhet nuk është buxhet për ta ruajtur dhe hequr por është buxhet që duhet investuar në sektor të ndryshëm dhe është mirë që është ky buxhet. Të nderuar koleg monitorimi dhe mbikëqyrja e buxhetit komunal realizohet përmes tri shtyllave kryesore, Kuvendit që aktualisht jemi duke e bërë, pastaj auditimi brendshëm dhe auditimi i jashtëm, pra këto janë tri shtyllat të cilat në një mënyrë e monitorojnë kuvendin komunal dhe jo vetëm kuvendin tonë por të gjithë kuvendet komunale në nivel vendi.
Unë jam për një buxhet të mirë dhe transparent, më lejoni ti lexoj parimet të cilat e bëjnë një buxhet të mirë dhe transparent, duke filluar nga respektimi i kornizës ligjore, investimet kapitale, transparenca, pjesëmarrja e qytetarëve në planifikim që mendoj se është një element shumë pozitiv, llogaridhënia, zbatimi i suksesshëm i buxhetit, implementimi apo zbatimi i buxhetit në teren, auditimi i rregullt, qëndrueshmëria fiskale buxhetore, e theksojë këtë sepse nëse një komunë ka shumë projekte dhe nuk ka mjete pra ajo del shumë negative.
Të nderuar qytetarë dhe koleg, më lejoni të lexoj fillimisht burimet që e bëjnë këtë buxhet, granti qeveritar, të hyrat vetanake, të hyrat e dedikuara, të hyrat nga AKP, grantet e përcaktuara të donatorëve, financat nga huamarrjet dhe tani kur jemi te shuma është 29,739,731.00€ buxheti dhe nga këto kemi një investim 8,468,073.00€ pra investime kapitale që janë bërë në fshatra dhe lagje të tjera dhe duke ja shtuar 1,554,054.00€ subvencione që nënkupton se më shumë se 9,000,000.00€ në vitin 2023 janë bërë investime, dhe atë me këto investime janë prekur sektor të ndryshëm si infrastrukturën, shërbimet publike, shëndetësia, arsimi, kultura rinia dhe sporti dhe është mirë që janë bërë këto investime, andaj Grupi i LVV e përkrahim dhe e konsiderojmë që duhet të vazhdohet me investime në territorin e Komunës së Podujevës ngase për këtë është edhe Komuna si dhe buxheti për investime në teren pa dallime.
**z.Bashkim Syla**, theksoi, Raporti financiar për vitin 2023 për nga struktura përmbajtja është i mangët dhe nuk paraqet transparencë dhe llogaridhënie përveç që është obligim ligjor i qeverisjes komunale. Të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2023 nga tatimi pronë janë paraparë 758,000.00€ kurse janë realizuar 666,000.00€, pra 92,000.00€ janë më pak.
Ndryshimi i buxhetit nga ai fillestar në atë përfundimtar ka ndodhur te kategoritë e pagave ku mbi 3,000,000.00€ janë mjete shtesë që janë evidentuar te kategoria e pagave. Pastaj te mallrat dhe shërbimet ka pasur ndryshim buxheti nga ai fillestar në atë përfundimtar, 235,621.00€ janë marr nga investimet kapitale janë bartur në mallra dhe shërbime. Te investimet kapitale kemi ndryshim të buxhetit prej buxheti fillestar 9,208,144.00€ në buxhetin përfundimtar 9,795,000.00€ duke përfshirë edhe shumën 935,000.00€ nga të hyrat vetanake ku 8,468,000.00€ janë investuar në investime kapitale. Tek mallrat dhe shërbimet janë ndarë 3,357,000.00€.
Shërbime të ndryshime intelektuale dhe këshillëdhënëse janë 53,000.00€, mobile dhe pajisje nën 1.000.00€ janë shpenzuar 165,000.00€, furnizim me ushqim dhe dreka zyrtare kemi 262,000.00€, shërbime kontraktuese të tjera 621,000.00€ që nuk janë cekur në raport se çfarë raportesh kanë qenë dhe është mirë që drejtori të na shpjegoj këtë.
Kemi 222,000.00€ që janë shpenzuar vetëm për vendime gjyqësore për vitin 2023. Në tabelë janë evidentuar shumë shifra të paqarta, shembull te furnizimi mjekësor e kemi numrin 248 me siguri

bëhet fjalë për 248,000.00€, te drutë e kemi 597 dhe kemi shumë shifra të tjera që janë të paqarta. Te investimet kapitale nga granti qeveritar janë planifikuar 9,208,144.00€ ndërsa janë realizuar 7,533.000.00€ nga granti qeveritar, kurse suficit për vitin 2023 kësaj qeverisje i kanë mbetur 1,675,144.00€ dhe është mirë të na tregoni cilat projekte nuk janë realizuar që ka mbetur ky suficit aq i lartë.

**z.Arjant Topanica**, theksoi, parafolësi nga partia në pushtet na tregoj që buxheti është për të shpenzuar dhe ne këtë pjesë nuk e kemi ditur dhe e falënderojë për këtë pjesë, po ashtu e tha se mirë që është i lartë sepse sa më lartë buxheti kemi para për të bërë punë edhe këtë e dimë sa më i madh kazani i parave aq ma lehtë është keqpërdorimi dhe kamuflimi i tyre.

Kur jemi te raporti financiar u tha më herët me të drejtë që është njëri nga dokumentet më të rëndësishëm që miratohet apo kalon nga ky Kuvend për të mos thënë më i rëndësishmi për arsyeje se tregon menaxhimin rrjedhjen dhe shpenzimin e parasë publike apo parasë së qytetarëve tanë.

Kam analizuar me kujdes këtë raport dhe e kam krahasuar me raportet tjera ndër vite të Komunës së Podujevës por edhe me raportet e tjera të komunave tjera nga viti përkatës dhe me shumë keqardhje mund të them se është raporti më i dobët në kontekstin e shkrimit, strukturës dhe përmbajtjes së tij që ka. Një dokument shumë i rëndësishëm të merret me kaq seriozitet jo profesionalizëm dhe neglizhencë mund të them lirshëm që nëse pushteti ju ka zhveshur nga çdo ndjenjë tjetër së paku ndjenja e turpit do të duhet të ju kaplonte.

Gjetjet faktike që ishin në këtë dokument kryesisht u theksuan nga kolegu jon paraprakisht, mirëpo unë do ti përmendi sipërfaqësisht disa nga ato, keq menaxhimi i parasë publike mund të them lirshëm që është kryefjala e këtij raporti ku në të kemi edhe keq planifikim dhe raportim të rrejshëm, ku si keq planifikim mund të përmendi realizueshmërinë e investimeve kapitale ku në 9 muajt e parë ka qenë realizueshmëria vetëm 55% ose më saktësisht nga 9,968,000.00€ deri në atë periudhë kanë qenë të realizuara afërsisht 5,500,000.00€, ndërsa pjesa tjetër është mbetur që të realizohet edhe për 20 ditë, pra edhe 4,500,000.00€ për tu realizuar vetëm për 20 ditë dhe kjo nuk ka tjetër, merr - jep ku do që teket.

Pagesat që dalin nga vendimet e Gjykatës janë 1,124,000.00€ e për që këto detyrime është dashtë të merren parat nga kategoritë si në vijim: 766,000.00€ janë marr nga kategoria e pagave, 222,000.00€ nga kategoria e kapitaleve, 75,000.00€ nga kategoria e subvencioneve dhe 61,000.00€ nga kategoria e mallrave, dhe nga kjo del se 358,000.00€ janë keq klasifikim që automatikisht i jep të drejtë auditorit që opinionin mbi këtë pasqyrë financiare të jep si të kualifikuar. Drejtori thirret shumë në standardet e kontabilitetit e mund të them që ato nuk përputhen as për së afër me këtë pasqyrë apo raport financiar ku këto standarde nuk e lejojnë asesi që paraja publike të shpenzohet gjithqysh, pa kritere të bëhen pagesa nga kodi në kod, pa asnjë kriter të keq klasifikimeve të kodeve të caktuara, dhe keq planifikime në këtë buxhet.

Si përfundim këtu mund të nxjerrim dy çështje, ose kemi të bëjmë me një jo profesionalizëm total ose kemi të bëjmë me një tendencë për të keqpërdorë këtë buxhet duke u fshehur pas jo profesionalizimit, andaj presim përgjegjësi dhe llogaridhënie për këtë në emër të Grupit tonë dhe të qytetarëve të Komunës së Podujevës.

**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, edhe unë i kam disa vërejtje për raport financiar, së pari ne e dimë krejt këtu që raporti nëntëmujor nuk ka ardhur në Kuvend edhe pse është obligim ligjor dhe ky që ka ardhur edhe është i ndërlikuar dhe shumë i rrejshëm. Janë këtu edhe disa fakte që nuk përputhen me raportin e free balance, por i kam edhe disa pyetje sepse edhe te raporti i free balance janë disa të mangëta, po përmendi disa këtu: shërbime këshillëdhënëse 11,210.00€, shërbime auditimi ne e dimë që Komuna i ka auditorit e certifikuar që janë për atë punë ndërsa paguhen të tjerë e që janë tri pagesa për auditorët dhe një pagesë është për shkollën e mesme

teknike “Fan S Noli” ku në këtë shkollë është paguar në vlerë prej 700.00€ dhe në komunë 700.00€, se kush është ky auditor nuk e di.
Për shenjëzimet vertikale dhe horizontale 120,000.00€ janë paguar në komunën ton për vitin 2023, shfrytëzimi i hapësirave me qira paguan Infrakosit apo Hekurudhave pra te pagesat është shfrytëzimi i hapësirave me qira 12,330.00€ dhe nuk e di pse na duhet ti paguajmë hekurudhës ne.
Pastaj kemi pagesë Telekomit të Kosovës-Vala 10,000.00€. Mandej është një pagesë punimi dhe montimi i reklamave “I love Podujeva” në shumë 9,615.00€ që janë paguar për atë reklamë, për sigurimin fizik 6,624.00€ kjo nuk ka qenë kurrë në Komunën ton dhe nuk e di pse këto punësime sepse këtu ka të punësuar persona si roje objekti dhe nuk e di pse paguhet kompani tjetër.
Pagesa në kafe nga përkrahësit e Lëvizjes Vetëvendosje, drejtori e din që te një kafe pagesë brenda vitit mund të bëhet deri 100 €, pra njëherë pa kontratë, kurse kemi rast ku drejtori z.Pajtim Balaj ka bërë shpenzime në kafen “Clips” 382 € , pra ka pirë kafe me para të Komunës dhe një diçka tjetër që unë nuk e kamë ditë është se ajo kafiteri përveç kafes që shërben ajo po përgatitke edhe ushqim, pra këto i kam parë në raportin free balance.
Te raporti që e cilësova si të rrejshëm, shembull orë jashtë orari shkruan aty zero, por drejtori e din për disa qasje në dokumente zyrtare që unë i kam marr para 3 muaj ku veç për një punëtor ku këtu i kam edhe dokumentet dhe vendimet, pra vetëm për një punëtor 7 muajit e fundi të vitit 2023 i ka marr 660 € jashtë orarit të punës.
Është një kod ndërtimi i trotuareve në qytet rrugën “Zahir Pajaziti” në shumë 443,668.00€ e që unë mendoj se vetëm nëse i ka heq kockat natën drejtori dhe i ka vendos në mëngjes sepse unë në rrugën “Zahir Pajaziti” nuk kam parë duke u ndërtuar trotuar. Pastaj kemi për ndërtimin e kanalizimit fekal dhe atmosferik shumën 526,220.00€, po ashtu është një pagesë ndërtimi i fushave të hapura sportive në qendër të qytetit pagesa është 153,206.00€, unë fushë në qendër të qytetit e di që është duke punuar një, por për aq para nuk e di se çka të them.
**znj.Arnisa Sylejmani**, theksoi, në mbledhjen e djeshme të Komitetit për Politik dhe Financa shpreha shqetësimet e mija lidhur me raportin financiar të cilin e konsideroj si vështirë të kuptueshëm për personat të cilët nuk janë specialist të fushës së ekonomisë apo nuk kanë njohuri të përgjithshme në këtë drejtim. Është shumë sfiduese të zbulohet se çfarë po ndodh me financat e Komunës tonë në këtë raport që na është paraqitur neve, e që të bëhen krahasime me raporte financiare të komunave tjera, madje vetëm përveç prezantimit e vëren se ky raport shumë qartë është në disavantazh, shembull, nëse e bëjmë krahasimin e këtij raporti financiar me raportin financiar të Komunës së Prishtinës e vërejmë shumë mirë dhe lehtë se sa ndryshime të këtyre raporteve ka mes vete, prandaj konsideroj se kemi nevojë për përmirësim jo vetëm në prezantim por edhe në mënyrën se si po i shpreheni informacionet tek qytetarët në mënyrë që të jetë më e lehtë që ata të kuptojnë këtë raport.
Një observim tjetër që dëshiroj ta theksoj është në faqen 16 të këtij raporti ku i keni paraqitur disa shkurtesa siç janë (VH GQ AK LGP), shtrohet pyetja çka janë këto shkurtesa i nderuar drejtor sepse për një person që nuk është specialist i fushës së ekonomisë është shumë vështirë të kuptoj se çka keni paraqitur me anën e këtyre shkurtesave, siç jam unë në këtë rast, andaj a mund të na shpjegosh kuptimin e këtyre shkurtesave në mënyrë që të gjithë qytetarët ta kuptojnë se çka po ndodh në këtë raport, nëse është e mundur këto dhe nëse i konsideron si kritika ose këshilla t’i zbatosh në raportet e ardhshme që të jenë më të kuptueshëm dhe të qartë për të gjithë.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, po flasim për raportin financiar për vitin 2023 dhe shpesh kur po dëgjoj diskutimet këtu më kujtohen filmat në mes luftës së parë dhe dytë botore ku aty janë disa vetura prodhim i vjetër që kanë rrota shumë të holla edhe duken më tepër filma satirik që kur vozitë

shoferi momentin që mbetet në baltë i kthen rrotat majtas dhe djathtas dhe hyn edhe më thellë dhe mbetet krejt.
Të respektuar të pranishëm, në vitin 2023 ne jemi dëshmitar të shumë investimeve kapitale që janë bërë në Komunën tonë, si asnjëherë më parë kemi fillimin e investimeve në çerdhe publike pastaj në shkolla të ndryshme të Komunës ton, pastaj investime të ndryshime në infrastrukturë, kanalizim trotuare, rrugë, pra investime të cilat janë të dukshme dhe të prekshme si dhe investime të cilat qytetarët i shohin në mënyrë direkte. Raporti financiar është një pasqyrë që është një mostër për të gjitha institucionet lokale dhe është një mostër e njëjtë ku të gjitha komunat e paraqesin në mënyrë të njëjtë raportin. Sa e vërejta aty çdo tabelë ka të shkruar edhe sqarimin prej drejtorit, dhe për mua personalisht nuk ka diçka të pa qartë edhe pse nuk jam i kësaj fushe por nuk pash diçka të pa qartë të paraqitur në këtë raport, mirëpo diskutimet tjera që ne mund t'i bëjmë për këtë çështje janë më tepër të natyrës politike se sa të asaj që përkojnë me realitetin dhe me gjendjen në teren, realitet i cili është që e prekin të gjithë qytetarët e Komunës ton në çdo ditë duke u bazuar në investimet e përditshme që bëhen dhe që e prekin direkt jetën e tyre.
**znj.Arjeta Salihu**, theksoi, edhe unë i kam disa pyetje dhe kërkoj disa sqarime nga ana e drejtorit, te kolona e pagave neto për punë jashtë orarit në raport i keni deklaruar zero pagesa, kurse ne e dimë të gjithë që jashtë orarit të punës gjithmonë janë bërë pagesa, andaj a ka mundësi që të na sqaroni i nderuar drejtor pse nuk është deklaruar asnjë euro tek kjo kategori.
Te pasuria jo financiare mbi 1,000.00€, kemi një rritje prej 5,000,000.00€ tek pronat, pra te pasuritë kapitale është një ndryshim goxha i madh nga viti paraprak. Mandej te stoqet në administratë dhe arsim kemi një rritje prej 15,000.00€ kurse në QKMF janë ulë për 40,000.00€.
Raporti te pasuritë financiar në vlerë nën 1,000.00€ te administrata është një rritje prej 200,000.00€, kurse te shëndetësia kemi 100,000.00€ më pak.
Përndryshe ne e dimë që është kjo rritje, por duam të dimë pse është kjo rritje.
**z.Adnan Zymeri**, theksoi, dua që të ndalem pak dhe të vlerësoj paraqitjet që i benën raportit financiar kolegët nga Lëvizja Vetëvendosje, rasti i deklarimit të fundit që ishte nga ana e kolegut të LVV ishte i atij llojit të djeshëm të deputetit në nivel nacional që i tha dikush dil e fol blej pak kohë dhe mos thuaj diçka që rrit tensione por realisht ishte e njëjta pasqyrë në atë kuptimin se çka tha kolegu. Ndërsa sa i përket shefit të Grupit të LVV ishte një deklarim i tij si gjeneralizuar, shembull, buxheti është i madh dhe i mirë, por unë mendoj që ma mirë se të bëhen këso klasifikime është të tregohet se ku janë 600,000.00€ dhe përse po negociohet drejtpërdrejtë, e që po besojë që duhet të jenë shqetësime konkrete të çdo secilit prej neve.
Ne jemi pro dhe e mbështesim çdo investim dhe punë të mirë që është bërë sepse nuk është që nuk janë duke bërë punë të mira por në të njëjtën kohë duhet të jetë fokusi edhe te elementet e tilla që janë shqetësuese, pra 600,000.00€ janë shumë, pastaj situatat emergjente duhet të trajtohen ndryshe dhe këto janë shqetësime që secilit prej neve besoj duhet të na shqetësojnë.
Çështja tjetër, unë nuk jam njeri që bëjë cilësime cili dinë e cili nuk dinë ngase shefi i Grupit mos me ditë nuk do të ishte shef i Grupit, prandaj e kanë vlerësuar por të bëhen përgjithësime të tilla nuk mendoj që është mirë.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, nuk është mirë ne si anëtarë të Kuvendit të Komunës të merremi me njëri tjetrin, janë drejtorët / Ekzekutivi dhe pyetjet jua drejtojmë atyre dhe normal partia në pushtet ka nevojë të tregoj punët veta që i ka bërë.
**z.Haki Rudari**, theksoi, kjo qasja e juaj ndaj një buxhetit vërtetë është e një niveli që nuk është në interes të qytetarëve për arsyeje se thash që kemi buxhet për herë të parë mbi 9.000.000.00€ për investime kapitale, çfarë i thua këtij i buxheti, i vogël, i mangët, por është një dallim në mes neve dhe juve si LDK për këtë arsyeje populli ju ka ndëshkuar me "karton të kuq" dhe sot jeni në

opozitë, ndërsa ne sot e kemi besimin e qytetarëve dhe duhet të ecim me këtë, ne kemi një program po në atë program nuk e zbatojmë se si na thotë LDK-ja, programin qeverisës e udhëheqim ne qoftë Kryetari me Ekzekutiv qoftë unë me Grup të këshilltarëve në këtë Kuvend, dhe ne jemi të pavarur këtu. Nëse e ke përcjell diskutimin tim z.Adnan Zymeri, më trego një pikë që unë kam thënë që nuk është ashtu, vetëm një pikë më trego, jo lojëra por më trego një pikë që e kam thanë që nuk është ashtu, e nëse dëshiron t'i përsërisë sërish por një po e përsëris që për mua është kryesorja, ky buxhet është respektues dhe e respekton kornizën ligjore, kjo përfundon për mu, do të thotë aspekti ligjor e përfundon gjithçka, mirëpo këto çka ju po i boni janë realisht më shumë veç të them diçka dhe për të marrë kohë. Unë jam këtu deri të përfundon seanca pa marr parasysh kritikave të juaja, jam në gjendje deri në ora 8 të mbrëmjes të qëndroj këtu dhe pa i ndërhyrë asnjërit dhe nuk dua ti ndërhyj askujt në diskutim, por në të njëjtin kohë jam për një debat intelektual e jo vetëm të them apo të manipuloj diçka.
Unë e kam këtë raport këtu me vete sikurse ju, por nuk kemi nevojë të na vijnë raporte "shminkatës" sepse sallonet e ondulimit janë për atë punë, për mua është me rëndësi që raporti financiar të jetë në vij ligjore dhe nëse ka keqpërdorime që tha dikush nga grupi i LDK-së mund t'i theksoni ato mos u fshihni. Unë kur kam qenë në opozitë kur ka pasur keqpërdorim i kam shpreh ato, prandaj duhet me qenë tolerant i arsyeshëm kur e etiketon ndonjërin.
Jam shumë ithtarë ta dijë që ka keqpërdorime, edhe më shumë se ju jam ithtarë të dijë nëse ka por nuk them sepse kur kam qenë në opozitë shumë qytetar më kërkonin t'i them për njerëzit që po vjedhin e po keqpërdorin, por jo sepse duhet të verifikohet ngase në momentin që e flas në foltore i qëndroj pas deri në fund asaj, prandaj është mirë që të verifikohen gjërat dhe gjithherë po bëjë debat në bazë raportit që na ka ardhur dhe prapë po ju lus urdhëroni në raport që unë e thash thuaje diçka që e kam thanë e nuk është e vërtetë në raport.
**z.Adnan Zymeri**, theksoi, fillimisht që Kryesuesi e theksoj se nuk është mirë që këshilltarët të diskutojnë mes veti, ne këtu nuk po diskutojmë për çështje personale dhe nuk jam duke diskutuar me z.Haki Rudarin si Haki, nuk jam duke e marr personale unë këtë, por unë jam duke diskutuar shumë seriozisht dhe nuk jam duke bërë humor zotëri Kryesues, ne jemi duke diskutuar për çështje të raportit financiar dhe nuk kam asgjë personale me z.Haki Rudarin.
Sa i përket çështjeve që i theksoi z.Haki Rudari po është ë vërtetë që është brenda ligjit por çka po kërkoj unë është që të diskutohet pak më thellë, ndërsa ky po e thekson që nuk ka keqpërdorime dhe theksoi që është i interesuar që të paraqiten keqpërdorimet, siç e thekson zotëri Përparimi në debate, veç me ta vizatuar është kjo farë pune, kur thotë dikush që 600,000.00€ janë blerë dru çka të them tjetër, pastaj kur thotë dikush tjetër që 450,000.00€ janë shtruar trotuare pra krejt këto janë elemente që ty të qojnë nga ajo, dhe vendimin e jep gjykata sepse na nuk jemi këtu për me gjykuar që ka pasur apo nuk ka pasur keqpërdorime.
**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, ti koleg z.Haki Rudari e tregove këtë raport por këtë raport e kemi edhe ne edhe ti, nëse e ke kryer ti ndonjë punë nuk ka nevojë të na tregosh neve a duhet t'i tregojmë të metat a jo, unë asnjë fjalë që nuk është këtu dhe që nuk është paguar ndonjë faturë nuk e flas, këtu me veti i kam 162 faqe të printuara pra është raport i free balance ku çdo pagesë që është bërë në Komunë qoftë se është edhe 1€ që nga 1 janar 2023, deri me 31 dhjetor 2023 i kam këtu të gjitha faturat me emër dhe mbiemër, si për bursa, për subvencione. Nëse e ke dëgjuar fjalimin mirë unë nuk dal ti them as gënjeshtar as hajn sepse kur te quaj hajn dikë duhet të jem në cilësinë e prokurorit por unë thash që në këtë raport që na keni sjell keni dashtë me na mbyll sytë, këtu shkruan 3,000.oo€ dreka zyrtare kurse janë 21,000.oo€ të paguara, nëse je i interesuar t'i tregoj edhe restorantet, ka drekë 4,800.oo€ të paguar dhe përkthe me një shujtë 12€, llogariti sa persona duhet me qenë në restorant për me arrit atë shumë, krejt i kam faturat dhe asnjë gënjeshtër

nuk po ta tregoj, krejt çka flas këtu sot dhe 100 vjet le të vjen kush të donë unë i qëndroj mbrapa asaj që e them.  Nuk po them që të vjen ty mirë njëherë me thanë buxheti më i madh e më i mirë, ajo është tjetër gjë, unë po ta shpjegoj se si bëhen pagesat dhe të gjitha janë të vërteta, asnjë nuk është gënjeshtër, të gjitha këto mundesh me i marr në Ministri të Financave ose unë t'i dërgoj në e-mail ku mund ti shohësh të gjitha dhe bindesh sepse ti është dashtë t'i thuash drejtorit përse nuk ke ardhur në Kuvend me raportin 9 mujor të vitit 2023, a e din se si kemi mbetur ne anëtarët e kuvendit këtu, tregomë kujt duhet t'i raportohet për 9 mujorin apo përse nuk i ke thënë Kryetarit sepse ai është përgjegjës për këtë punë. Pra a i ke thënë ndonjëherë pse nuk ke raportuar sepse duhet t'i thuash Kryetarit që duhet të raportoj për 3 mujorin e fundit.
Pastaj i nderuar Rudari, a e din ti se çka ka bërë nga 6 mujori në 9 mujor, shikoj pagesat të gjitha i ke me 21, 22 dhjetor, a e din se është bërë pagesa me Shoqatën "Jetimat e Ballkanit" 126,500.oo€ dhe a e din kur është bërë ajo pagesë pa u nisë punët atje dhe pa u bërë Marrëveshja, andaj lidhur me këtë parat tua po ti kesh në shtëpi, kur shkon në shtëpi gjysma e fëmijëve të kërkojnë lloagari se ku i ke lën, e lëre më të bëhen pagesa pa raport të punës, pa filluar objekti dhe pa asgjë.
Nuk e them asnjëherë të mos filloj Shtëpia Rezidenciale por duhet të jetë raporti i punës dhe atëherë të bëhen pagesat e jo kështu vetëm të bëhet një buxhet dhe pastaj të bëhen pagesat sepse tani auditori e vlerëson raportin e kualifikuar.
**z.Haki Rudari**, theksoi, z.Adnan Zymeri edhe drutë edhe trotuaret dhe kushdo qoftë ato para duhet të paguhen, ato para askush tjetër nuk i jep dhe ka kaluar koha e "Nënës Terezë" si ndihma humanitare, kurse tash a është shuma 500.000.oo€, 400.000.oo€ nuk ka asgjë të keqe, e nëse është keqpërdorim është diçka tjetër, a nëse është kërkesë dhe nevojë unë nuk shoh asgjë të keqe këtu.
Tani z.Ekrem Rrahmani, krejt ato që i potencove ti këtu janë 29,000.oo€ pagesa, mirë që i ke ato pagesa por çdo pagesë që bëhet është normale që të jenë në Ministri dhe Komunë, por krejt ato që ju po i thoni nuk po e shoh që ka keqpërdorim në kuptimin që ka blerë dru kaq, ka bërë këtë trotuar apo atë tjetrin, pra nuk i thuhet keqpërdorim asaj sepse asnjë investim nuk bëhet pa para, pra çdo investim kushton si në arsim, shëndetësi, kulturë dhe për këtë arsye është buxheti për të investuar.
Njeri nga kolegët e përmendi Komunën e Prishtinës, ku nuk kam dëshirë të merrem me këtë sepse Prishtina njehet me menaxhim të dobët, me mbetje të madhe të buxhetit, por megjithatë jemi fqinjë dhe e kemi Kryeqytet andaj respekt për Komunën e Prishtinës, por të njëjtën kohë buxheti i Prishtinës dhe komunave të tjera që ka mbetur pa realizuar normalisht që nuk është mirë.
Nëse kanë mbetur këtu investimet pa u realizuar edhe unë isha pajtuar me juve sepse nuk është në rregull të teproj dhe të mbeten mjete të pashpenzuara dhe në të njëjtën kohë të ketë kërkesa të ndryshme për investime e të tjera.  Natyrisht ato mbi 1,000,000.oo€ që kanë mbetur do të doja edhe ato të investoheshin sepse për këtë arsyeje janë buxhetet, për të investuar dhe për të pasur kërkesa të qytetarëve, grupeve dhe shoqatave të ndryshime, dhe kur ke buxhet del në teren dhe bënë implementim në teren.  Unë e kuptoj opozitën sepse edhe ne kemi qenë opozitë dhe nuk është fundi i botës, por të njëjtën kohë t'i thuhen gjërat seriozisht me fakte dhe jo të flasim me kuturu.
**znj.Edona Shabani**, theksoi, dëshiroj të përgëzoj drejtorin e DBF-së edhe Kryetarin e Komunës që e kanë një njeri si z.Haki Rudarin sepse me mish e shpirt po mundohet t'ju mbroj, mirëpo z.Haki Rudari kur ekzistojnë dokumentet vetëm kot fol, por mos u bë servil sepse nuk ta dinë askush, besomë sot e 100 vjet në këtë foltore po të tregoj se nuk ta dinë, këto gjëra që i bisedojmë ne janë gjëra që i kanë bërë në Prishtinë dhe nuk ke nevojë të flasësh për këtë temë sepse ne kemi kërkuar sqarime nga drejtori përkatës e jo nga ti sepse ne të gjithë këtu jem njëjtë, ndoshta ti ke diçka më shumë që je profesor.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, vërtetë u debatua dhe pas miratimit të buxhetit sigurisht që pika më kryesore e një Kuvendi është që ta shikojmë se si është shpenzuar ai buxhet. Po mundohem të jem më i qartë por kur shefi i Grupit të LVV-së e mori fjalën dhe që në fillim, fillojë të shpjegoj shtyllat se cilët mekanizma e kontrollojnë buxhetin dhe me fjalët e tij pastaj ra në kundërshtim me gjithë atë ose pjesërisht me atë që e tha. Është për keqardhje kur një shembull i mirë që e thekson ndokush dhe tenton atë praktikë sepse shoqëria nuk zhvillohet gjithë nga zero por është zhvillim zingjiror por t'i lëmë fjalët e të jem më konkret.
E kam thënë dje dhe po e them edhe sot, një qeverisje e mirë pavarësisht shkronjave që i ka e karakterizojnë transparenca, llogaridhënia dhe pjesëmarrja e qytetareve në vendimmarrje, këto i potencoj shefi i Grupit, si dhe qëndrueshmëria e investimeve kapitale, mirëpo i ka thanë eksperti këto e që është më i mençur se unë dhe ti i nderuar Rudari, dhe ashtu është, por kur kemi të bëjmë me buxhetin duhet të pyes se një raport kur t'i paraqitet ndokujt në këtë rast neve si Kuvend nga organi ku ligji e obligon për të paraqitur raportin, ai raport duhet të jetë i kuptueshëm, sqarues dhe transparent nga ata që e paraqesin.
Nga shumë kolegë u atakua me të drejtë ky raport ashtu siç e theksoi znj.Arnisa Sylejmani ku ky raport është me akronime me dy-tri shkronja dhe nuk e sheh të arsyeshme një shpjegim që në çdo dokument zyrtar kur ki akronime duhet të kesh një faqe t'i shpjegosh se çka janë ato akronime, pra nuk e ka. Një raport financiar duhet të ketë në komponentën e vet vitet krahasuese, pyes ku i kemi këtu vitet krahasuese në këtë raport që e kemi, nuk e kemi askund, prandaj të thuash që është shpenzuar në kufijtë që e ka përcaktuar korniza ligjore, me të drejtë e tha kolegu ne nuk i kemi mantilat e zeza që ishte fjala tek gjyqësori dhe prokuroria, sepse ato e japin fjalën se a janë shpenzuar në harmoni me ligjin apo jo, ne këtu ngritim shqetësime lidhur me paqartësitë që na janë paraqitur në këtë raport e që ka shumë dhe shumë investime të pasqyruara.
Po nisem nga një element ku të gjithë tani jemi këtu, dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e pyetem drejtorin e DBF-së se a është shuma e suficitit 1,300,000.00€ dhe u përgjigj me po, kjo është e sakta, ndërsa sot një tjetër anëtar i Kuvendit thekson se është suficiti 1,600,000.oo€, kurse tjetri thekson se suficiti është 2,000,000.oo€, andaj a jemi të orientuar ne diçka këtu.
Sa i përket raporteve periodike, po të ishin të panevojshme sigurisht që hartuesi i Ligjit për Financat Publike nuk do t'i parashihte fare, andaj sigurisht që janë të rëndësishme raportet periodike për arsye se të paktën na shpjegojnë dinamiken e realizimeve të projekteve që i kemi miratuar në shtator të vitit të kaluar.
E përmendi dikush këtu dhe mua tani po më dalin dy shifra në bazë këtij raporti që e kam unë si dokument zyrtar dhe raportit 9 mujor se çka ka ndodh, Komuna jonë në web faqe e ka publikuar këtë raport, arsyeje pse, sigurisht për të bërë një mashtrim për performancë apo transparencë komunale dhe nuk e ka sjell në Kuvend ku është i obliguar me ligj ta sjell dhe në atë raport z.Haki Rudari investimet kapitale për periudhën janar-shtator i kemi 3,217,966.oo€ prej buxhetit 9,000,000.oo€, do të thotë për një periudhë kohore 9 mujore i kemi shpenzuar 3,000,000.oo€, ndërsa 3 mujorin e fundit me një dinamik tjetër nëse mund të them me një panik 6,000,000.oo€, edhe sot e kemi një buxhet që theksojmë u shpenzuar që nuk e dimë as unë sot, besoj që drejtori i DBF do të na jap një shifër dhe nuk e di sa është e besueshme ajo shifër sepse shifra që më dha dje në KPF ka qenë 1,300,000.oo€ kurse sot nuk e di çfarë shifre do të më jap, sepse në bazë të kolegut z.Qendrim Softoli janë 2,000,000.oo€ suficit edhe atë dokumente e ka në dorë edhe ndokush tjetër.
Çështja tjetër, z.Haki Rudari në aspektin që unë e realizoj programin e partisë që ka fituar zgjedhjet në këtë rast Lëvizja Vetëvendosje, shumë në rregull jemi, por të thash edhe para disa ditëve që qytetari i Komunës së Podujevës për shumicë në këtë Kuvend e ka votuar Lidhjen

Demokratike të Kosovës e jo LVV-në, dhe Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ka si të del jashtë rolit të saj qoftë ligjor qoftë si obligim qytetar dhe moral për të bërë opozitën dhe të hulumtoj defektet e pozitës, e që hulumtimi i defekteve mendoj që e ndihmojmë pozitën dhe në aspektin partiakë dhe për këtë e di që ti mundohesh ta dërgosh përpara programin e LVV-së, dhe shumë mirë që dallojmë, për ata jemi edhe të rreshtuar sepse nuk mund të jemi në të njëjtën vijë.
Për fund, ky raport buxhetor vërtetë është dhe pasqyron atë që e tha znj.Arnisa Sylejmani, i pakuptimtë, jo sqarues dhe jo raport i drejtë për të mos e thënë mashtrim, pra mashtrimi dhe raportimi jo i drejtë ku auditori në herën e parë ka konstatuar të gjetura besoj që auditori si organ i autorizuar për atë do ta jep fjalën meritore dhe ne do të jemi këtu, vetëm ju kisha lutur me mbajt në mend të gjithë atë që e ka thënë.
**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, theksoi, faleminderit të gjithëve për sugjerimet dhe vërejtjet e bëra, gjatë diskutimit pati shumë çështje të cilat u diskutuan ku janë me dhjetëra por do të bëjë përpjekje maksimale që të kthej përgjigje për këtë pyetje. Disa çështje u përsëriten nga anëtarët e ndryshëm të Kuvendit ku është normale sepse mund ta ndajnë një çështje të njëjtë lidhur me raportin financiar, formën dhe vërtetësinë. Unë e ceka në fillim në fjalën hyrëse se ky është raporti financiar që është standard, forma ku e kemi praktikuar edhe për vitin e kaluar për raportin vjetor i cili është i miratuar nga ana Ministrisë së Financave, pra ky është standardi i pasqyrës financiare vjetore të cilën Komuna e Podujevës ashtu si çdo organizatë tjetër buxhetore e ka për obligim të përpiloj dhe përveç asaj që e kemi para asamblesë komunale ta dorëzojë edhe në Thesarin e Republikës së Kosovës ku i ka komplet këto dokumentacione si çdo pagesë që e bënë Komuna e Podujevës e ka Thesari në raportin e tyre që e vërteton dhe pranon këtë pasqyrë financiare.
Jashtë kësaj, Komuna e Podujevës vetëm e ka kaluar apo e kemi kryer fazën e auditimit nga ana e Zyrës Kombëtare së Auditimit, e ka audituar këtë pasqyrë financiare e cila është e paraqitur para juve. Zyra Kombëtare e auditimit e cila ka qenë në muajin shkurt në proces të auditimit i ka gjetur disa mangësi te pasqyra financiare ku i ka jep vërejtjet e saj dhe ne e kemi mundësinë ligjore që deri në fund të muajit shkurt ta dërgojmë sërish në Ministrinë e Financave raportin financiar të përmirësuar në bazë të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit, dhe ky raport që është para jush është edhe në bazë të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit, pra kjo është sa i përket çështjes së raportit financiar për vërtetësi. Prandaj tani ne edhe përkundër që e kemi marr verdiktin e Ministrisë së Financave dhe për kundër faktit ku Zyra Kombëtare e Auditimit ka theksuar se kjo pasqyrë paraqet të dhëna të sakta dhe të vërteta, eventualisht mund të ketë ndonjë mangësi ose lëshim të vogël.
Lidhur me suficitin e mjeteve buxhetore, unë e paraqita çështjen e shpenzimeve të cilat i kemi, Komuna e Podujevës në vitin 2023 i ka shpenzuar 8, 468,073.oo€ investime kapitale e që në total si përqindje e investime kapitale është 86.46%, mirëpo nga granti qeveritar i kemi 91.71% që nënkupton se edhe në dekadën e fundit jemi rekord i investimeve kapitale, qoftë si vlerë totale qoftë si përqindje e realizimit të investimeve kapitale, kjo ishte çështja që ka të bëjë me suficitin.
Te tejkalimi i të hyrave vetanake, u cek se edhe të hyrat të cilat kanë të bëjnë me çështjen e tatimit pronë dhe të hyrat vetanake, e vërteta është se gjatë këtyre viteve Komuna e Podujevës në vazhdimësi ka tejkalime të të hyrave vetanke në raport me ato të planifikuara, e kemi diskutuar edhe më herët që të hyrat e planifikuara vijnë në bazë të Qarkores Buxhetore të lëshuar nga ana e Ministrisë së Financave ku janë limitet që ne duhet t'i përmbahemi sa i përket çështjes së planifikimit buxhetor dhe ata e marrin si planifikim mesataren e tri viteve të fundit dhe ne vazhdimisht jemi mbi mesataren e tri viteve të fundit e që për këtë vit i kemi të tejkaluara ku janë afër 2,100,000.oo€ të hyrave vetanake për dallim nga shuma 1,800,000.oo€ të cilat kanë qenë të planifikuara.

Te çështjet e tatimit pronë është e vërtetë që ka të hyra më pak se që kanë qenë të planifikuara, pa marr parasysh si total i kemi tejkaluar të hyrat vetanake, por arsyeje te çështja e tatimit pronë është se qytetarët gjatë vitit 2023 kur filloj të diskutohet çështja e faljes së borxhit nga tatimi në pronë dhe shumë qytetarë duke pritur çështjen e faljes së borxhit nuk e kanë paguar tatimin pronë, faktikisht në fund është marr vendim për faljen e borxhit të tatimit pronë gjegjësisht fatura e vitit 2023 ku shumë qytetarë e kanë paguar dhe ata do të rimbursohen, pra në vitin 2024 nuk kanë nevojë që të paguajnë faturën e vitit 2024, e që kjo është arsyeja rreth çështjes së tatimit pronë.
Te ndërtimi i rrugëve në qytet, u cek këtu vlera financiare e cila është paguar për ndërtimin e rrugëve në qytet dhe kufizimet të cilat e cilësojnë. Tani po fillojmë me sqarimin sepse kështu e kam renditjen si dhe për vërtetësinë të cilën u cek, edhe për çështjen e respektimit ligjor të gjithave pagesave të cilat janë kryer në DBF, po ju informoj edhe pse ende nuk e kemi raportin zyrtar nga ana e Zyrës Kombëtare të Auditimit, sigurisht që ka ndonjë gjetje nga zyra kombëtare, mirëpo duhet të ceket një gjë që Zyra Kombëtare e Auditimit me auditim që ka bërë mbi një muaj ditë në Komunën e Podujevës nuk e ka asnjë të gjetur, asnjë pagesë të cilën e ka kryer Komuna e Podujevës e cila ka shkaktuar një dëm financiar për Komunën e Podujevës, do të thotë do ta shihni raportin e ZKA dhe nuk e ka asnjë të gjetur e cila ka të bëjë me këtë çështje.
Sigurisht i keni raportet të cilat i keni marr në Ministri të Financave, por keni pasur mundësi që t'i merrni edhe në DBF për çka ju ftoj në mënyrë të hapur si zyrtarisht po edhe miqësisht vetëm e bëni një kërkesë zyrtare në Drejtori duke kërkuar të gjitha pagesat të cilat janë bërë në vitin 2023, nga 1 janar deri me 31 dhjetor dhe deri sa t'i bartë të gjithë lëndët komplet lënda e pagesës me zyrtar të cilët i kanë nënshkruar me raporte të pranimit me procedurat të cilat i kemi ndjek si dhe kontratat, pra vetëm deri sa t'i bartë nga follderi në USB të cilat janë skanuar të gjitha pagesat dhe i merrni të gjitha, si dhe kjo vlen edhe për sqarime në DBF, pra po flas në emër të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe për kompetencat e Drejtorisë që ka të bëjë me procedimin e pagesave dhe do t'ju sqaroj çdo pagesë ashtu qysh i kemi sqaruar para Zyrës Kombëtare të Auditimit e sqarojmë edhe para juve, prandaj me sinqeritetin tim më të madh e them se mundeni me ardhë me i marr të gjitha të skanuara, dhe nuk po e marr si çështje të cilën po ju ofroj juve se është e drejtë ligjore e juaja, mirëpo që t'jua jap me data-bazë dhe me gjitha tjerat ashtu siç janë, edhe pse e sheh ligji mund të mos jua ofroj.
**z.Ekrem Rrahmani**, duke ndërhyrë nga vendi i drejtohet drejtorit të DBF-së se nga ata dy drejtorë që ke përpara vetës asnjëherë nuk më kanë kthyer përgjigje për kërkesa të tilla, ndërsa ti sa herë kam kërkuar dokumentet më ke ofruar gjithmonë.
**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, vazhdoi, u përmend çështja e ngritjes së infrastrukturës të turizmit që janë bërë pagesë 200,000.oo€, bëhet fjalë për investimet te pishat e Kërpimehut dhe Shakovicës është pagesë 200,000€ ashtu siç kanë qenë të planifikuara.
**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, kërkoj falje për ndërhyrjen, kjo që thua jo të merret në bazë të punës, por duhet të shkosh e të shikosh se çfarë punë është bërë atje ku thua.
**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, vazhdoi, sërish, sa i përket shërbimeve kontraktuese, këtu lidhet çështja e raportit financiar me çështjen e planit kontabël, pra plani kontabël pas çdo pagese që bëhet ku fillon nga çështja e zotimit duhet të bazohet në një kod ekonomik, e vërteta është që ai plan kontabël është nga Ministria e Financave dhe nuk ka mundësi asnjë shmangie sepse nuk mund të procedosh pagesë në free balance pa e respektuar planin kontabël, prandaj i ka disa mangësi dhe i ka disa veprimtari të cilat zhvillohen si dhe disa natyra të pagesave të cilat bëhen e ku të cilat nuk janë të specifikuara saktë në planin kontabël, shembull konkret e kemi te transporti i nxënësve pra nuk e kemi ndonjë kod ekonomik të saktë që e identifikon transportin e nxënësve, normalisht te përshkrimi i shpenzimit nëse merret komplet në përshkrim të shpenzimit e keni shërbimet

kontraktuese transporti i nxënësve, mirëpo këtu te shërbimet kontraktuese hyjnë transporti i nxënësve, dezinfektimi i hapësirave që kryhen nëpër Drejtori, disa kontrata të cilat i kemi pas te punësimi në bashkëpunim me Ministrin e Financave konkretisht me Qendrën e punësimit ku janë bashkëfinancime me Ministrinë edhe ato mjete shkojnë nga shërbimet kontraktuese.
Te shërbimet këshillëdhënëse, si kod ekonomik janë dy çështje të cilat kanë të bëjnë me shërbime këshillëdhënëse, hartimi i projekteve sa për sqarim z.Ekrem Rrahmani kur bëhet një pagesë për hartim të projekteve.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, i nderuar drejtor, tjetër kod e ke te shërbimet këshillëdhënëse dhe tjetër pagesë e ke te hartimi i projekteve, por për këtë nuk të bëra pyetje sepse e kam parë.
**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, vazhdoi, te shërbimet këshillëdhënëse janë hartimet e projekteve, ka disa analiza të fizibilitetit të cilat bëhen dhe ajo në kuadër të kategorisë këshillëdhënëse. Po ashtu Edhe është një çështje të cilën Komuna e Podujevës e ka pas një kontratë me një zyrtar i cili punon gjatë këtu i cili është i kontraktuar përmes ligjit të prokurimit për shërbime të veçanta që është quajtur përpara dhe normalisht që ai e ka kodin ekonomik shërbimet këshillëdhënëse.
Për ndërtimet e kanalizimeve që pati pyetje, normalisht që ajo është në bazë të kontratës e cila është e nënshkruar në Zyrën e prokurimit në bazë të planifikimit të buxhetit dhe janë kryer pagesat në bazë të raportit të punëve të kryera. Pastaj rregullimi i lumit në qytet dihet që është bërë rregullimi i lumit në pjesën e sipërme të qytetit nga "Ura e Fushalive" dhe pjesa tjetër që është nga magjistralja në pjesën e poshtme edhe kjo është një kontratë të cilat i keni parë investimet dhe normalisht në bazë të punëve të kryera janë bërë pagesat. Mandej te ndërtimet e trotuareve bëhet fjalë që tani Ministria e Financave na ka kufizuar të bëjmë një emërtim të projekteve ku në bazë të zonave duhet identifikuar qytetin, shembull konkret "ndërtimi i trotuarit nga kjo rrugë në atë rrugë" edhe është bërë ndërtimi i trotuareve, pra bëhet fjalë për rrugën "Hakif Zejnullahu" dhe disa trotuare tjera ku në bazë të kontratave është bërë pagesa e këtyre trotuareve.
Te çështjet të cilat u cekën për disa pagesa në fushën e arsimit, shembull mirëmbajta e rrjetit të ndriçimit nga Gjimnazi "Aleksandër Xhuvani", tani është pyetja për drutë edhe disa pyetje tjera që janë bërë për këtë shkollë, është një çështje te buxheti i arsimit që është si buxhet total për tu proceduar një pagesë duhet të bartën mjetet me një kod te një shkolle që nuk nënkupton që shpenzimet janë për atë shkollë, shembull shpenzimet e druve janë bërë nga një kod ekonomik i një shkolle por nuk kanë të bëjnë vetëm me atë shkollë por kanë të bëjnë me shpenzimet e pagesave të druve nëpër të gjitha institucionet arsimore dhe nuk bëhet fjalë shembull për kodin ekonomik që e keni marr për dru, pra aty bëhet fjalë për shpenzimet për dru dhe shpenzimet për pelet për arsye se nuk ka një kod të veçantë ekonomik për shpenzimet e peletit, drutë dhe peleti si produkte të drurit. Te vlera financiare që u përmend rreth pagesa e druve ne kemi qenë dëshmitar në vitin 2023, e kemi pas një rritje enorme të çmimit të peletit edhe të çmimit të druve që ka qenë në vitin 2022, dhe ka vazhduar në vitin 2023, disa obligime na kanë mbetur për arsyeje të rritjeve enorme të çmimeve që janë bërë te shpenzimet në fund të vitit 2022 ku këto është dashtë të paguhen në fillim të vitit 2023 për arsye se nuk kanë arritur të mbulohen për shkak të çmimeve që kanë dalë përtej planifikimit të buxhetit kur e kemi pasur në vitin 2023, kurse ne sërish në fillim kemi paguar për kontratat të cilat kanë qenë të lidhura dhe që ka qenë çmimi i lartë i peletit rreth 600€ për një ton, e që rrjedhimisht ne e kemi planifikuar në buxhet 220€ për një ton, ndërsa tani e dimë që çmimi i peletit ka rënë dhe tani pagesat dhe kontrata është me çmim shumë më të ulët afërsisht 230€ për një ton pelet nëse nuk gaboj.
Sa i përket mirëmbajtjes së ndriçimit publik, bëhet fjalë për mirëmbajtjen e elektrikes nëpër institucionet arsimore, jo vetëm në Gjimnaz mirëpo në të gjitha institucionet arsimore, normalisht

në bazë të atyre pagesave aty i keni specifikacionet, kërkesat e shkollave dhe të gjitha se ku ka shkuar ai investim për mirëmbajtën e elektrikes dhe e njëjta gjë vlen edhe për nyejt sanitare dhe për rregullimin e kulmeve të cilët kanë ndodh.
Asamblisti z..Bashkim Syla i shtroi disa çështje të cilat kanë të bëjnë me raportin financiar dhe rreth ndryshimeve të buxhetit të cilat kanë qenë përgjatë vitit mbi bazën e buxhetit fillestar dhe mbi bazën e buxhetit përfundimtar. Ne kemi miratuar një buxhet për vitin 2023 dhe bazë të Qarkores Buxhetore e cila është lëshuar nga ana e Ministrisë së Financave, te kategoria e pagave e marrim me mend që kanë qenë të planifikuara në bazë të limitit të Ministrisë së Financave 13,000,000.oo€ dhe me inkuadrimin e ligjit të pagave Ministria e Financave ka pasur një klauzolë për afër 80,000,000.oo€ për të gjitha organizatat buxhetore, pra për të gjitha komunat të cilat me atë shumë ka mbuluar tejkalimin e shpenzimeve të cilat janë si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjit të pagave dhe normalisht për çdo muaj ka alokuar mjete për mbulimin e shtesave që kanë rrjedh nga hyrja në fuqi e Ligjit të ri të pagave edhe normalisht edhe këtu në Kuvend të Komunës është miratuar një propozim ndryshim i buxhetit për bartjen e disa mjeteve nga kategoria kapitale në kategorinë e mallrave, pra edhe këtu ka qenë një ndryshim i buxhetit mirëpo te investimet kapitale një tërheqje të mjeteve në bazë të këtij vendimi, por këtu reflektohen edhe bartja buxhetore nga të ato të pa shpenzuara në vitin 2022 në vitin 2023, të cilën z.Bashkim Syla e ceku, kurse sa i përket shërbimeve intelektuale besojmë që e dhamë përgjigjen më herët.
Te furnizimet mjekësore normalisht që bëhet fjalë për pagesën e barnave dhe materialeve të tjera të cilat janë në fushën e shëndetësisë, kurse te furnizimi me ushqim u cek vlera 262,000.oo€, jo dreka zyrtare por normalisht ato janë shpenzuar për fëmijët të cilët shërbehen me ushqim në Çerdhe si dhe bëhet fjalë për shpenzimet për shujtat ditore të nxënësve nga klasa 1 deri në klasën e 5, ajo vlerë buxhetore është ashtu dhe janë të gjitha të skanuara dhe mund t'i merrni t'i shihni pagesat të cilat janë bërë.
Janë edhe disa çështje të cilat janë të përsëritura lidhur me çështjen e raportit financiar të cilat i ceku z.Arjant Topanica, besoj që i sqarova çështjet që kanë të bëjnë me raportimin financiar, pastaj te pagesat e vendimeve gjyqësore, është e vërtetë që është një breng e jona si Komunë dhe jo vetëm e jona por e të gjithë komunave, bëhet fjalë për një kontratë kolektive e cila është nënshkruar në vitet e mëhershme e cila është nënshkruar pa mbulesë financiare dhe ne kur e marrim këtë sërish e përsërisë Qarkoren Buxhetore sepse e marrim pa kontigjencën e vendimeve gjyqësore, dhe ne si Komunë e kemi të pamundur dhe nuk i kemi të drejtat që t'i paguajmë këto pa vendim gjyqësor, pra në momentin kur merr vendim gjykata pastaj është detyrim dhe nuk vjen pagesa te ne sepse mjetet të cilat janë për kategorinë e pagave nuk i ekzekutojmë ne, në kuptimin pra përmes Free Balance mund t'i shihni më qartë, mirëpo këto ekzekutohen përmes listës së pagave që shkojnë përmes Thesarit të Republikës së Kosovës e që janë mbi 1,100,000.oo€ dhe ajo është e vërteta të cilët janë vendimet gjyqësore në kategorinë e pagave si dhe kjo rritje te pagat e buxhetit është për shkak se Ministria e Financave i ka rimbursuar shpenzimet të cilat kanë rrjedh si rezultat i këtyre vendimeve gjyqësore, përndryshe në rast se nuk do t'i rimbursonte Ministria e Financave ne si Komunë në muajin e 12 nuk do të kishim pas mundësi me marr as paga për të gjithë ndonëse pak, por jo të gjithë.
Te shërbimet e auditimit u përmenden disa pagesa, bëhet fjalë që Komuna e Podujevës e ka obligim ligjor që ta bëjë Komitetin e Auditimit dhe në bazë të një Rregulloreje anëtarët e jashtëm të Komitetit të Auditimit duhet të paguhen në bazë të asaj rregulloreje të cilët janë të zgjedhur, ata paguhen dhe e kanë një mëditje tjetër. Te çështja e auditimit te shkolla e mesme "Fan S Noli" bëhet fjalë për një projekt me Zyrën Japoneze me të cilën ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëfinancimi Komuna e Podujevës me Ambasadën Japoneze dhe Komuna e ka pas për obligim

të angazhoj një auditor të jashtëm për të audituar projektin i cili është zbatuar në shkollën "Fan S Noli" dhe normalisht në bazë të kontratës së lidhur është dashtë që të paguhen këto shërbime të auditimit të cilat janë bërë në shkollën "Fan S Noli".

Çështja e shenjëzimit horizontal dhe vertikale është bërë në bazë të kontratës e cila është 2 vjeçare dhe e cila është paguar. Te telefonia që është në raport financiar, që është në vlerë 10,000.oo€ bëhet fjalë për telefon dhe internet në të gjitha institucionet të cilat janë në kompetencë të nivelit lokal dhe të gjitha shkollat sot pothuajse kanë qasje me internet dhe normalisht paguhet dhe bëhet fjalë për shpenzimet telefonike të cilët janë në komunë, shpenzimet e internetit, shpenzimet për objektet shëndetësore dhe normalisht besojë që është një vlerë dhe nuk besoj që sot dikush e keqpërdor telefonin.

Shpenzimet për sigurimin fizik të objektit të Komunës kanë qenë për dy roje të sigurimit fizik ku është kontraktuar një kompani private dhe kjo ka qenë e nevojshme, por tani ne nuk kemi kontratë me askënd dhe jemi në procedurë të lidhjes së kontratës dhe ju e dini shumë mirë që roli i rojës ka të bëjë me drejtimin e palëve të cilët vijnë në Komunën e Podujevës dhe për këtë arsye janë kontraktuar dy roje të sigurimit fizik dhe normalisht në bazë të kontratës janë bërë këto pagesa.

Pagesat e kafes që u diskutua, dihet që çështjet e furnizimit në fushën e gastronomisë siç janë ushqime për dreka zyrtare apo pije, nuk zhvillohet procedurë e prokurimit dhe janë të përjashtuara nga Ligji i prokurimit, ajo deri në shumën 100€ është e vërtetë por vlen për aktivitet e tjera sepse petty cash ke të drejtë të përdorësh deri 100€, mirëpo për dreka nuk ke të drejtë, pra nuk është në kuadër të Ligjit të prokurimit por janë të përjashtuara nga ky ligj, ndërsa te kjo kafja afër Komunës kodi ekonomik është ushqim dhe pije si kod ekonomik, mirëpo nuk bëhet fjalë për ushqim por bëhet fjalë për pije në takimet me delegacione që përdoret sepse është kafja më e afërt.

Te çështja e pasurisë që u përmend nga znj.Arjeta Salihu që bëhet fjalë për rritjen e pasurisë për 5.000.000€ dhe që kjo është goxha mirë, bëhet fjalë për Zonën Industriale, do të thotë kur është shpronësuar pjesa e Livadicës e që besoj se sivjet fillon ndërtimi i Zonës Industriale ku vlera e asaj prone është 4.500.000€, mirëpo ne e paguajmë vetëm 20% të vlerës por kur e regjistrojmë pasurinë regjistrohet si komplet vlera të cilën e ka pasur ajo pronë në bazë të Ministrisë së Financave dhe përveç kësaj Zone bëhet fjalë edhe për shpronësimet e rrugës afër Lumit Llap ku edhe ka filluar ndërtimi e që janë afër 776.000€ vlerë e asaj prone ku jemi të obliguar të paguajmë 100% të vlerës së vlerësuar sepse bëhet fjalë për persona privat e jo si në rastin e Zonës Industriale ku jemi të detyruar të paguajmë vetëm 20% dhe kjo normalisht ka ndikuar në rritjen e pasurisë tek Toka, pra te toka normalisht në planin kontabël nuk e ka emërtimin por vlerësohet me atë vlerë që është, andaj për këtë arsye e kemi një rritje të pasurisë.

Te pagat, në pasqyrë financiare të gjitha shpenzimet të cilët kanë mbetur pa paga janë paraqitur në të hyrat nga pagat neto, është e vërtetë që nuk janë të paraqitura si zë i veçantë pagesat për punë jashtë orarit mirëpo janë para të këtij zëri të pagave neto, por në rast se si informatë mund të më merr kohë paksa por ne për këtë punë jemi së bashku me zyrtarët tjerë në Drejtorinë e Financave, pra mund ta marrë dhe t'jua sjell informatën saktë për shpenzimet e pagave për punë jashtë orarit sepse është shpenzim që për çdo zyrtar që punon jashtë orarit duhet të identifikohet kur ka punuar dhe të nxjerrët ai shpenzim, mirëpo në pasqyrë është e marr nga lista pagave vetëm si total i pagës neto të cilën të gjithë të punësuarit të cilët janë të paguar nga buxheti i Komunës janë prezantuar.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar drejtor, të bëra një pyetje por nuk mora përgjigje, sa është suficiti i Komunës së Podujevës në vitin 2023, dëshirojë zyrtarisht që të di nga zyrtari kryesor financiar i komunës se sa është suficiti i komunës në vitin raportues.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, theksoi, unë kur e bëra prezantimin e përgjithshëm sepse dje në KPF e theksova që vlera është kaq dhe e mora si në raport me anë të suficitit të buxhetit i cili ka qenë nga granti 10, por edhe suficitin nga të hyrat vetanake, mirëpo ne kemi edhe një tejkalim të hyrave vetanake.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, sërish i nderuar drejtor edhe dje në KPF por edhe sot po të them që nuk kam nevojë për këto sepse i di, e di kush e bënë buxhetin etë tjera, por më intereson të di sa është suficiti i Komunës me një fjali dhe nuk ka nevojë sqarime të tjera.
**z.Fatlum Osmani,** drejtor i DBF, vazhdoi, shuma e mbetur për bartje e cila nuk ka qenë e shpenzuar nga të hyrat vetanake është 1,103,805€ do të thotë që të hyrat vetanke që nuk janë shpenzuar në vitin 2023, dhe ato barten, ndërsa nga granti qeveritar të cilën ua sqarova për çdo kategori të cilën nuk janë shpenzuar është afër 900.000€.
**z.Avni Fetahu**, drejtor i DKA, theksoi, ato çështje që nuk u potencuan në lidhje me fushën e arsimit po mundohem që shumë shkurtë të përgjigjem, znj.Arjeta Salihu e potencoj një ngritje të shumës së buxhetit prej 15.000.oo€ te fusha e arsimit, bëhet fjalë sikurse tek të gjitha komunat që për mësimdhënësit që janë me sëmundje kronike prandaj është ndarë një buxhet shtesë në mënyrë që t'iu mbulohen shpenzimet atyre mësimdhënësve që janë me sëmundje kronike.
Sa i përket pyetjes rreth auditimit, nuk e di z.Ekrem Rrahmani sa ishte i koncentruar kur drejtori i DBF-së e sqaroj projektin me ambasadën japoneze që ka qenë shumë i qartë pasi që ata e kanë bërë financimin dhe ne bashkëfinancimin, pra kanë dashtë që të jetë auditimi i pavarur dhe kjo shumë 700€ është tenderuar dhe është bërë auditimi i atij projekti që është realizuar, pra është shumë me rendësi të potencohet kjo sepse konsideroj se kur ekzistojnë dokumentet ato flasin dhe nuk ka tendencë askush të mashtroj askënd dhe as opinionin publik përmes raportit financiar, mirëpo edhe ju si anëtar të Kuvendit duhet të jeni të kujdesshëm në deklaratat e juaja për arsyeje se këto mbeten dhe janë edhe me video por edhe në procesverbale, andaj në rast që nuk i shikon askush tani, fëmijët tanë mund t'i shikojnë dhe mos të dalim para tyre qesharak pastaj.
Sa i përket vitit 2023, kontratës për dru, vlera e kontratës është e qartë në vitin 2023, pra janë 298,570.oo€ për 3600 kubik dru. Në vitin 2023 kemi qenë komuna që kemi marr çmimin më të lirë për dru, pra kemi qenë komuna që me çmimin më të volitshëm që kemi paguar për dru, kurse në vitin 2024 kontrata është 209,850.oo€, që i bie 58 euro e 29 cent për metër dru, pra nëse i bëjmë bashkë këto dy vitet 2023 dhe 2024 nuk arrijnë shumën 600,000.oo€ të shpenzuara për dru, kështu që mos u mundoni t'ia shitni popullit këtë kinse kemi blerë dru 600,000.oo€, por duhet bazuar në fakte ku edhe i potencoj drejtori i DBF-së që bëhet fjalë edhe për pelet por edhe për disa karburante ku disa shkolla dhe çerdhe ngrohjet i kanë me naftës, kështu që të jemi të qartë, në vitin 2023 kontrata është publike në shumë 298,570.oo€ dhe nuk janë shpenzuar dru në vlerë 600,000.oo€, këtë duhet ta din opinioni publik.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, para kësaj mbledhje i nderuar Kryesues vërejtje e juaj për mua ka qenë duke më thënë pse po i kritikon drejtorët, nëse pretendon që vërtetë të menaxhosh si duhet seancën, në bazë të Rregullores në replika nuk mund t'i thuash ndokujt prit, e them ngase drejtori i Drejtorisë në këtë sallë është llogaridhënës para kuvendarit dhe nuk mund t'i thuash anëtarit të kuvendit prit deri sa te përfundon ky tjetri, fundja drejtori i arsimit i bëri disa konstatime dhe duhet përgjigje që të sqarohen pyetjet e pastaj përfundon debati me drejtorin e arsimit dhe vazhdojmë me drejtorin tjetër.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, nuk po e bëjë këtë vetëm që kam të drejtë por dua që t'jua jap fjalën drejtorëve të Drejtorive që të përfundojnë me përgjigjet, dhe pastaj anëtarëve të Kuvendit.

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, theksoi, çështja e parë ishte për asfaltimin e rrugëve në qytet ndërsa për çështjet e emërtimeve të kodeve buxhetore veç se u përgjigj drejtori i DBF-së ku e përcaktoj çështjen e emërtimeve të kodeve buxhetore.
Ishte pyetje se cilat rrugë janë asfaltuar, kemi rrugët te Lagjja "Shqiptarët për Shqiptarët" në kuadër të bashkëpunimit që kemi pasur si me Shoqatën përkatëse po ashtu edhe me pronarin që e ka lëshuar tokën dhe është bërë e gjithë infrastruktura përcjellëse duke filluar nga asfaltimi, trotuari si dhe pjesën tjetër të nevojshme për funksionalizimin e plotë të kësaj lagje.
Pastaj kemi rrugën mbrapa komunës ku mund ta shohim nga këtu ku jemi pa dal fare jashtë, pra mund ta shihni investimin që është bërë në atë rrugë, pastaj kemi rrugën "Bedri Ahmeti" por edhe rrugët të tjera të cilat janë brenda qytetit.
Te zgjerimi i hapësirave publike, mund të shikoni djathtas dhe kemi hapësirën përpara komunës këtu, pra po i cekë zgjerimet e hapësirave publike dhe të gjelbëruara dhe nëse nuk është ashtu atëherë mund ta thoni, andaj sa i përket zgjerimit të hapësirave publike u keqkuptua paksa, mirëpo duhet të jemi më pragmatik edhe kur gjykohem unë. Te çështja e fontanave në qytet nuk është e vërtet që janë paguar 8.000€ por kontrata është 8,160€ dhe është kontratë dy vjeçare që do të thotë që për 1 vit është afërsisht 4.000€ ku në varësi të saj ka pasur nevojë për riparimin e disa pjesëve të cilat kanë qenë brenda për brenda instalimit të brendshëm të sistemit që ka pasur nevojë për funksionalizimin e plotë, unë po dua të përgjigjem, mirëpo me këto ndërhyrje nuk po na lejoni që t'ju kthejmë përgjigje në formën më të mirë, andaj t'i përfundojmë ne dhe tani ju pastaj keni fjalën.
**z.Ilir Koprani**, theksoi, konsideroj se i gjithë faji është te ju Kryesues i Kuvendit, nëse nuk je në gjendje të mbash seancën ashtu siç duhet dhe të zbatosh Rregulloren e punës së Kuvendit atëherë mos mbaj seancë fare.
**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, nëse janë përfunduar diskutimet e anëtarëve të Kuvendit radha është që të deklarohen drejtorët e Drejtorive dhe të japin përgjigje, nëse nuk jeni të kënaqur me përgjigjen e drejtorëve mund të pritni deri në përfundimin e përgjigjeve të tyre dhe pastaj merrni ju fjalën dhe diskutoni, mirëpo nuk diskutohet me dhjetë herë sepse ka një Rregullore të punës që duhet ta respektoni çdonjëri nga ju, pra nuk diskutohet sa herë t'ju teket juve për një pikë të rendit të ditës sepse ekzistojnë rregullat dhe ju bëjë thirrje ta respektoni Rregulloren e punës së Kuvendit, përndryshe mund ta shikoni Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe e vëreni se kur kryhen diskutimet për temën e caktuar nuk ka më diskutim nga ana e Deputetëve dhe të kthehen pikën zero, pra jep përgjigje Ministri dhe aty përfundon diskutimi.
Pra ju anëtarët e Kuvendit diskutoni temat e juaja dhe më pas kur kalon diskutimi te drejtorët e Drejtorive nuk ka më kthim mbrapa, drejtorët e Drejtorive e kanë për obligim t'ju japin përgjigje, nëse nuk përgjigjen atëherë mbetet përgjegjësi e tyre, e jo e juaja.
Besoj se të gjithë i dini rregullat, madje z.Naim Çunaku i din shumë mirë.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, ju lutem Rregulloren e dimë të gjithë, z.Ekrem Rrahmani dy herë e ke marr fjalën për të njëjtën pikë, unë mbaj shënime këtu për të gjithë diskutuesit, pra për secilën pikë ka drejtë secili të marr fjalën dhe ka drejtë në replikë, mirëpo në fund të gjithë diskutuat për raportin financiar dhe unë pyeta a ka ndokush që dëshiron të marr fjalën dhe nuk u lajmërua askush andaj fjalën i'a kaluam pastaj drejtorëve të Drejtorive, përfundojnë drejtorët dhe nëse nuk është i kënaqur me ndokush mund ta merr fjalën sërish, mirëpo në këtë pikë ende nuk e përfunduan diskutimin të gjithë drejtorët.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, i dimë apo nuk i dim rregullat, konsideroj se nuk është në rregull se si po e udhëheqë seancën i nderuar Kryesues, nuk dua të diskutoj më rreth Rregullores së punës së Kuvendit sepse është bërë e tepërt, dhe nuk po dua që të lexoj atë ngase për çdo pikë të rendit të

ditës i ke edhe dy diskutime, diskutimin primar dhe diskutimin sqarues, pra tri diskutime dhe sa herë që përmendet emri është e drejta e replikës.

**znj.Adelinë Stublla**, drejtoresh e DSHMS, theksoi, sa i përket pagesës për Qendrën Rezidenciale që u përmend më herët, pagesa është bërë pas lidhjes së Marrëveshjes dhe pas caktimit të lokacionit, objekti është duke u punuar dhe punët janë duke shkuar mirë, kështu që vetëm e gazofshim.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DSHPMSH, theksoi, dëshiroj të jap përgjigje në disa prej pyetjeve të parashtruara sa i përket drejtorisë që unë udhëheqë, mirëpo fillimisht dua që të potencoj se e kuptojmë që Kuvendi i Komunës është një arenë politike ku bëhet garë, por me fyerje dhe etiketime të ndryshme po bie edhe niveli i politikës shumë poshtë, vetëm pse është mundësia me fol para kamere duke bërë etiketime të ndryshme të pa bazuara dhe pa asnjë arsyeje, përtej etiketimeve personale që u benën këtu me të vërtet po ndjena keq kur po mendoj që jemi asamble në një vend ku merren vendime diskutohet dhe debatohet gjatë e të diskutohet në këtë formë nganjëherë njeriu edhe eskalon ku në këtë rast e bëra edhe unë, por seriozisht u ndjeva keq që nga fillimi dhe nuk ke hera e parë duke përdorur fjalë si “ ti nuk je askush, ty nuk pot shoh hiç”, pra nuk mendoj që është forma e duhur e komunikimit. Po e filloj me disa kompani për qejfi ku i përmendi z.Qendrim Softolli, duke theksuar që vetëm një kompani fiton tender në Drejtorinë e Shërbimeve Publike  kjo nuk qëndron dhe nuk është e vërtetë, unë nuk dëshiroj që të përmendi kompani me emra por e di që DSHPMSH i ka 23 projekte të ndryshme e që nuk ka mundësi vetëm një kompani me i krye të gjitha këto punë por edhe me dashtë nuk mundet prapë se ka fusha të natyrave të ndryshme, ndërsa se sa fiton kompania projekte është zyra e prokurimit që e bënë menaxhimin e këtyre punëve dhe nuk i menaxhon drejtoria këto, drejtoria pra e menaxhon projektin dhe këtë dua të ndërlidhi me disa fjalë që më herët u cekën lidhur me takime në vetura apo diçka të ngjashme, ne patjetër duhet të komunikojmë mes veti sepse ne e kontrollojmë punën e tyre dhe për të kontrolluar punën unë së bashku me operator me veturë komunës e kontrollojmë punën e tyre ose i ftoj që të vinë te vendi i punës, pra ne duhet t’i kontrollojmë këto punë në një mënyrë dhe nuk shkojmë në vend punishte mbasi të përfundoj puna pra shkojmë së bashku ku i japim vërejtët dhe sugjerimet tona dhe besoj që është diçka normale, ndërsa sa i përket fjalëve që për qejf e fjalë të tjera, për neve janë për qejfi ato që punojnë drejtë pa marr parasysh se cila kompani është pa përmendur emra të tyre. U përmend edhe rregullimi i shtratit të Lumit Llap duke thënë që nuk është bërë asgjë në këtë drejtim, këtu ja nuk dëshirojmë që t’i shikojmë ose nuk kemi sy fare, me thënë që nuk është bërë asgjë rrethe rregullimi të shtratit të Lumi Llap kur në qytet në ty dy anët e vendit të punës së z.Qendrim Softolli e sheh një problem 20 vjeçar që nuk ka mundur të zgjidhet asnjëherë dhe nga ai rrezik janë rrezikuar shtëpitë që të shembën nga devijimi i shtratit të Lumit, pra ne kemi shkuar dhe kemi rregulluar atë pjesë me një kosto që ka dal të jetë shumë e vogël në krahasim me punën që është bërë, pra është 100 metra larg punës ku ti qëndron çdo ditë dhe më poshtë i ki edhe 500 metra të tjera rregullim i shtratit të Lumit Llap në qytet dhe prapë e thekson që nuk është bërë asgjë, kjo me të vërtetë është absurde, ndërsa në anën tjetër nuk i përmendin rregullimin e shtretërve në fshatra por e përmendin vetëm qytetin, aty i ki dhe mund ta shohësh dhe të bësh një video ku është rregulluar edhe në pjesën e poshtme e jo vetëm aty ku është prishur për shkak të jo profesionalizmit të juaji që e keni pasur, ku e keni bërë rregullimin e shtratit të Lumit Llap pa asnjë lidhje të brigjeve me shtylla të betonit dhe ajo vjen më pas deri te dëmtimi, tash ne si drejtori duhet të bëjmë projekt të ri dhe duhet të ndahen edhe mjete të tjera 180.000 euro për të rregulluar këtë punë që ju e keni lënë keq dhe më pastaj ti më thua mua që u dëmtua shtrati i Lumit sepse keni vendosur kaskada, por jo nuk është ashtu por ajo me kohë është rregulluar keq, edhe në pjesën e poshtme të lumit jemi duke vendosur kaskada por nuk do të dëmtohet sepse jemi

duke i vendosur në mënyrë profesionale, pra rregullimi i shtratit të Lumit Llap nuk pa pasur lidhej të brigjeve me shtylla të betonit dhe nuk ka as sot por do të ketë në projektin që ne e kemi planifikuar ku për këtë projekt kontrata është lidhur por vetëm po pritet për kushtet atmosferike për të filluar punën. Sa i përket temës lidhur me trotuaret, ne kemi bërë trotuare me një kontratë që ka filluar në vitin 2022 dhe ka vazhduar në vitin 2023 ku janë përfunduar trotuare të reja afër 4,880 metra si dhe është ndërtuar rruga " Hakif Zejnullahu" ku është përfunduar 1 km trotuar dhe 1 km shteg të biçikletave pra me atë kod buxhetor edhe është trajtuar komplet rruga ku është bërë shtresimi i saj pastrimi i kanalizimit atmosferik mbjella e drunjëve ku ka pasur mundësi që ata të mbjellën përveç kësaj është për herë të parë shtegu për të verbër, ndërsa sa i përket pagesës te rruga "Zahir Pajaziti" ju informoi drejtori i buxhetit dhe i financave për atë kod buxhetor. Sa i përket mirëmbajtës së ndriçimit publik më duket mua që nuk e ke shikuar me vëmendje ose nuk e ke perceptuar ashtu si që është realisht sepse nuk janë 80,000.oo€ për mirëmbajtje të ndriçimit publik por janë 110,000.oo€ pra këto janë mirëmbajte të elektrikes në shkolla, mirëmbajte të ndriçimit publik janë 110,000.oo€ janë shpenzuar në vitin e fundit dhe duke pasur parasysh se sa është zgjeruar rrjeti i ndriçimit ku janë 300km në Komunën e Podujevës ndriçim publik dhe 10000 trupa ndriçues ndërsa juve ju duket që janë shumë e madhe 110,000.oo€ euro për mirëmbajte unë po ju tregojë që nuk janë shumë përkundrazi kanë qenë të pamjaftueshme sepse prapë ka dëmtime dhe dëme dhe është përfunduar kontrata, nëse për momentin kemi kërkesa ndokush nga qytetarët për rregullimin e ndriçimit publik nuk do të kemi mundësi të bëjmë për arsyeje se nuk kemi kontratë të lidhur sepse ka përfunduar kontrata e kaluara që ka qenë. Te intervenimet emergjente u cekën se në janar të vitit 2023 janë shpenzuar 130,000.oo€ ku janë keqpërdorur ato, si kanë mundur të keqpërdoren ato kur ne kemi dal këtu në Kuvend Komunal me raport ku ju jeni kërkuar raport për atë punë dhe e keni parë të gjithë dhe janë 78 vende ku është bërë intervenimi për rregullimin e ndriçimit publik dhe çdo se cilin e keni pas në raport me emër dhe mbiemrin dhe vendin ku është bërë intervenimi, ndërsa sa i përket lidhjes së kontratës pra lidhja e kontratës bëhet në mënyrë emergjente sepse nuk kemi kohë të presim 45 ditë procedurat e prokurimit sepse është emergjente, pra e kemi lidhë një kontratë e kemi shpenzuar dhe janë ende vendet e evidentuara kur është bërë intervenimi besojë që e keni në materiale të juaja dhe e keni parë se ku është bërë ky intervenim dhe mbas 1 vite e gjysmë më thua që është keqpërdor ky buxhet dhe më thuaj ku është keqpërdor ky buxhet sipas teje, në atë kohë kur ka qenë raporti para juve në Kuvend Komunal është dashtë të theksohet kjo ndërsa kjo që e theksove ti sot është fjalë publike para kamerave e theksuat ju po e them edhe unë, e për çka është intervenuar në këtë rast ju e dini shumë mirë pra në rregullimin e brigjeve të Lumit Llap, në rregullimin e urave dhe rrugëve të tjera si dhe dëmeve të tjera që janë të gjitha të evidentuara dhe disa nga ju keni dal në teren se a po përfundojnë dhe nuk keni hasur në asnjë vend që nuk është përfunduar dhe mos të harrojmë se ndokush këtu e ka përmendur që nuk ka përfunduar por mbas 2 ditëve ka dal kompania dhe është përfunduar edhe ajo punë. Kanalizimet fekale dhe atmosferike nuk e di pse po diskutohet për kanalizime sepse vetëm në këtë vite të fundit kanalizime fekale janë bërë 4 degë të kanalizimeve që kanë qenë jashtëzakonisht të rëndësishme për Komunën e Podujevës dhe kanë qenë degë me një trashësi të gypi F 500 për mi zgjedhur disa probleme që kanë qenë më herët ku në bazë të raportit që kam këtu me veti Bradash Bajçinë 1150 m, Letanc 515 m, Shajkoc-Batllavë 2214 m dhe rruga "Kongresi i Manastirit" mbi 200 m, pra këto janë të gjitha kanalizimet e reja gjatë vitit që lamë pas. Shenjëzimet vertikale dhe horizontale e theksuat që janë bërë 120,000.oo€ pagesë, po është e vërtetë që janë bërë por sa më kujtohet mua nuk kanë qenë të mjaftueshme që do të thotë që duhet të bëhen edhe pagesa të tjera, por sa i përket kësaj teme ju mund të kuptoni këtë nëse ju dilni dhe e shihni në qytet se çka është punuar në këtë drejtim por z.Ekrem Rrahmani rrinë më shumë te pjesa

e sheshit e ndoshta nuk e ka rastisë rasti t'i sheh këto punime. Dëshiroj që saktë me shifra t'ju tregojë sa i përket shenjëzimeve vertikale dhe horizontale pra shenjëzimi i vijave të bardha 8883m vendosja e shenjave vertikale 39 të reja dhe mirëmbajtja e të vjetrave, shenjëzimi i vendkalimeve për këmbësor 355m$^2$, shtigje të biçikletave për qarkullim me ngjyrë të kuqe 651m$^2$ pra të gjithë këto që i theksova e përbëjnë shumën e 120,000.oo€ e për të vërtetuar se a janë apo nuk janë të gjithë këto ju mund ti dilni dhe ti shihni vet edhe pse ka qenë një kritik sa i përket ngjyrës së kuqe mirëpo me atë ngjyrë është ka doket mirë. Sa i përket vendosjes së reklamës "I LOVE YOU PODUJEVA", që e theksuat që ka kushtuar 9,600.oo€, pra janë dy simbole të identifikimit të hyrjes në qytet që ti po e thekson që ka kushtuar 9,600.oo€, por unë të tregojë që nuk është që ka kushtuar shumë sepse janë të punuar me materialin nga më të mirin që ekziston sepse ne i kemi bërë para masat vet dhe e dimë ne se çka kemi kërkuar, pra materiali që është punuar me të është material që nuk ndryshket asnjëherë ku e bënë përçimin e dritës nga brenda dhe jashtë dhe është enkas për atë punë, po ajo zemra që e përmende ti, unë tash për momentin është jam duke menduar që t'i vendos edhe dy të tjera te rrethi i ri në magjistrale. Sa i përket çështjes që unë ju kam lodhur duke ju thënë qytetit të Podujevës me emrin Besiana, në atë kohë kur e kam quajtur qytetin e Podujevës me emrin Besianë ti nuk ke qenë duke u merr me politik fare në atë kohë sepse ti tash ke filluar të merresh me politik dhe në atë kohë ke pasur mundësi të më shohësh vetëm në televizor ose më ke dëgjuar këtu në Kuvend Komunal, unë po flas politikisht në atë kohë kur i kam thënë Besianë qytetit të Podujevës ti nuk je marr me politik fare por vetëm më ke dëgjuar në televizor.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, dëshiroj që t'i tregoj drejtorit të Drejtorisë së Arsimit që mund të marrësh raportin që e ka përgatit drejtori i Drejtorisë së Financave dhe aty mund ta konstatosh që është e shënuar kodi me shumën 597,000.oo€ për dru, ndërsa ti që u mundove ta kamuflosh duke e thënë që edhe nafta është pjesë e saj, dua të them që nafta për ngrohje ka kushtuar 61,000.oo€ që është e shkruar në raport dhe është kod i veçantë, ndërsa nafta për vetura zyrtare ka kushtuar 77,000.oo€, kurse ti e theksove që të gjitha drutë kanë kushtuar 247,000.oo€, pra u mundove që të thuash kontrata andej këndej, por vërtetë ka mundur të jetë kontrata e vitit 2023 ajo shumë që e theksove ti, mirëpo mua nuk më intereson se a të ka mbetur pagesa nga viti 2021 apo 2022, por ne e potencuam se sa janë bërë pagesa në emër të kodit të druve 600,000.oo€, prandaj mos u mundo të thuash ndryshe duke thënë që ne mos të flasim sepse ne i përmendëm pagesat për vitin 2023 dhe atë të gjitha pagesat e jo kontratat sepse t'i mund të bësh kontratë por mund të kesh kontratë kornizë nga vitet 2021 / 2022 në mënyrë që t'i bësh pagesat në vitin 2023.
Ndërsa sa i përket shenjëzimeve të bardha, drejtorit të DSHPMSH dua t'i them se ato vija nuk janë bërë në vitin 2023 e as nuk është bërë pagesa, por në vitin 2022 ajo vija e kuqe "e komunistëve" që e theksove ti, andaj për shenjëzimin vertikal dhe horizontal për mendimin tim 120,000.oo€ është shumë shtrenjtë, ndërsa simboli i zemrës me fjalën "I Love Podujeva" nuk e tha askush që është e keqe por 10,000.oo€ janë shumë për të sepse për rregullimin e saj kanë mund të shkojnë dy kolica beton një hekur 4x4 që bëjnë 16m, dhe kaq ka aty investim.
**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, u mblodhën goxha shumë disa çështje dhe po filloi prej kolegut z.Haki Rudari si një fanar i dijes që ngritet e i thotë koleges tonë servile e që mendoj se është një shembull i keq për të gjithë ata nxënës që mund të përcjellin direkt z.Haki Rudarin, dhe tani e tutje pyetjet dhe përgjigjet do t'i bëjmë ty zotëri Rudari e jo drejtorëve të Drejtorive sepse je bërë njëfarë avokati i pushtetit.
**z.Haki Rudari,** nga vendi i reagon parafolësit duke theksuar se për atë edhe i kam marrë votat.
**z.Qëndrim Softolli**, duke i reaguar theksoi, mirë që disa asamblistë u bënë drejtorë të Drejtorive sepse ti zotëri Rudari as asamblist nuk ishe sot. Si do qoftë po vazhdoj me temën.

**z.Haki Rudari,** sërish duke reaguar zotëri Softollit theksoi, ishe ardhë shef i Grupit të LVV-së ti por sigurisht që s'të kanë pranuar.
**z.Qëndrim Softolli**, vazhdoi, zotëri Rudari mund të dalësh në foltore dhe të flasësh e nga vendi.
Buxheti final për vitin 2023 ka qenë 31,500,000.oo€, realizimi ka qenë 29,731,000.oo€ edhe pse drejtori i DBF-së nuk qenka këtu besoj se na përcjell dhe na e kthen përgjigjen, pra nuk janë paraqitur te tejkalimi i planit të të hyrave rreth 581,000.oo€, nëse ia shtojmë krejt këtë shumë vlerës 1,854,000.oo€ atëherë del se kemi suficit mbi 2,400,000.oo€, do të thotë keni manipuluar me shifra në raportin financiar të paraqitur.
Te pagesa të cilën e ceku drejtori parafolës që kanë punuar te "Ura e Fushalive" dhe në afërsi të "Market Agnesa", ne e dimë që është edhe një pagesë tjetër 218,000.oo€ por nuk e ceka edhe pse e di që është pjesë e saj. Nuk është e vërtetë që e potencova se është vetëm një kompani, nuk është e vërtetë, mund ta dëgjosh fjalimin dhe e sheh që nuk e kam thënë, nuk është e vërtetë që thash është vetëm një kompani dhe nuk është e vërtetë që thash krejt tenderët i ka marrë veç një kompani, mundesh me përcjellë fjalimin por thash është kompania e preferuar e juaj të cilës i pate thirr konferencë të jashtëzakonshme në atë kohë të ish pushtetit, pra po të njëjtës kompani.
Tash e dimë gjendjen e Lumit Llap dhe nuk mund të më tregoni mua a dalë unë e fotografoi pjesën e dëmtuar apo jo, e juaja është t'i paraqitni ata "filmat e juaj" të mirë, e imja është që të paraqes dëmet që janë shkaktuar dhe rrënimi që është bërë përgjatë Lumit Llap. Mos u thirrni në atë duke na thënë ju, ju, ju sepse na keni lodh me këtë, kurrë asnjëherë nuk kam pasë pozitë ekzekutive në Komunë as askund, ata që kanë bërë më herët e kanë marrë vlerësimin dhe ku janë sot, prandaj dua të them lëreni më atë pjesë dhe nuk keni pse të na ngarkoni neve me atë pjesë sepse asnjëri prej neve këtu nuk ka pasë pozitë ekzekutive.
I keni vendos kaskadat në Lumin Llap në qendër, a kanë kushtuar rreth 8,000.oo€ a është bërë keq planifikim nëse janë rrënuar pas disa muajve dhe kanë kushtuar rreth 16,000.oo€, me kontratë direkte me të njëjtin operator, do të thotë është bërë dëm rreth 24,000.oo€ buxhetit të Komunës sa kam informatë unë në emër të atyre kaskadave e ato kaskada e kanë dëmtuar shtratin e Lumit Llap.
I nderuar Kryesues, e kam një vërejtje për ty rreth menaxhimit të seancës dhe për këtë të kemi dhënë vërejtje disa herë, nuk është hera e parë që po eskalon seanca ngase ngritet Kryetari i Komunës si polic nëpër sallë, pastaj merr fjalën kurdo që dëshiron, këto veprime ne nuk mund t'i tolerojmë, Kuvendi është i kuvendarëve, drejtorët e Drejtorive dhe Kryetari i Komunës vijnë dhe raportojnë në Kuvend nëse kanë ndonjë pyetje ose përgjigje, andaj i nderuar Kryesues menaxhimin e seancës duhet ta bësh ti si Kryesues dhe për këtë është vërejtja e fundit që po ta japë qoftë si asamblistë por edhe në emër të Grupit të LDK-së.
**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, duke i reaguar parafolësit theksoi, nëse ti nuk e din mësoje tani se Kryetari i Komunës sa herë që dëshiron e merr fjalën, në çdo moment, në çdo kohë kur do që e vlerëson të marrë fjalën, asnjëherë nuk të pyet ty e askënd tjetër, por e merr fjalën dhe përgjigjet.
**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, fjalën merre sa herë të duash ama të enësh si polic në sallë nuk të lejojmë.
**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, nuk është e drejtë e juaja të më caktoni vende mua dhe po ju tregoj se unë endem sa herë të dua.
**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, ti dil e shëtitu lirisht por nuk mund ta menaxhosh seancën, nuk e tolerojmë këtë ne, boll më se e keni tepruar sepse do e sillni një situatë ku në këtë Kuvend do të pamundësohet mbajtja e seancës pastaj.

**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, sërish duke reaguar theksoi, mbaje në mend ti (i drejtohet z.Qëndrim Softollit), duhet të jeni korrekt, të mos pengohen të tjerët kur janë duke diskutuar, sepse unë isha duke i'u përcjellë ty dhe kolegun tjetër tuaj.
Bëjeni rendin e diskutimeve dhe mbajeni atë rend ashtu siç duhet. Ndërsa sa i përket fjalës, unë e marrë fjalën në këtë Kuvend sa herë që dëshiroj.
**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, atëherë përse pse nuk iu dha fjala në këtë Kuvend kolegut z.Ekrem Rrahami. Ndërsa për rend, Kryesuesi është për atë punë, nuk je as ti e as unë por Kryesuesi i Kuvendit paguhet për atë punë.
Fjalën ti Kryetar merre sa herë duash askush s'po ta ndalon, por ta menaxhosh seancën dhe të enësh nëpër sallë, këtë se tolerojmë.
**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, e përsëris, kah do që dua unë endem s'më cakton ti kah endem unë.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, shiko z.Qendrim Softolli, problemi ishte te asambleja dhe disa asambleistë, jo te unë si Kryesues.
**znj.Arjeta Salihu,** theksoi, i nderuar Kryesues, problemi ishte te ju sa i përket menaxhimit të seancës.
**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, po e sqaroi edhe njëherë se unë fjalën ia dhashë drejtorëve të Drejtorive kurse ju në atë moment e kërkuat fjalën edhe pse drejtorët filluan të përgjigjen, ju e morët fjalën sërish, nuk mundemi tani që 100 herë një drejtor të debatoj me një anëtar të Kuvendit.
z.Ekrem Rrahmani dhe z.Qendrim Softolli e kanë marrë fjalën nga dy herë, edhe ti znj.Arnisa Sylejmani dhe shumë të tjerë, prandaj askujt nuk iu mohua dhe as nuk i'u ndalua fjala, dhe nuk e kam ndërmend t'ia ndalojmë fjalën askujt.
**znj.Arnisa Sylejmnai**, theksoi, me gjithë respektin i nderuar Kryesues, është hera e dytë që po e marr fjalën, pajtohem plotësisht me atë që e tha drejtori i DKA-së që duhet të kemi kujdes se si shprehemi nga ulëset tona sepse do të japim llogari për atë se çfarë shprehim, mirëpo kolegu z.Haki Rudari besoj që ka përvojë pune këtu aq sa kam unë vite, kush ka dashur ta kuptoj atë që e kam shprehë unë gjatë fjalimit tim e ka kuptuar sepse unë u shpreha vetëm në formën e paraqitjes se sa i pa kuptueshëm është ky raport që është paraqitur këtu, të paktën sipas mendimit tim i nderuar koleg zotëri Rudari, nuk fola për suficit të Prishtinës, ti mund të flasësh atje me kolegët tuaj për çfarë do shqetësimesh që keni, dhe në bazë të përgjigjes së drejtorit të DBF-së e vërtetova sërish fjalën time se ky raport është i pa trup dhe shumë i mbështjellur.
**z.Haki Rudari**, theksoi, po i përgjigjem koleges dhe parafolësit se çka diskutoj unë është e drejtë e imja, a diskutoj për Prishtinën, Gjilanin apo Shtimen ajo është e drejtë e imja.
**znj.Arnisa Sylejmnai**, theksoi, edhe e drejtë e imja është të të tregoj ty se jemi duke diskutuar për një çështje aktuale.
**z.Haki Rudari**, vazhdoi, unë po mundohem të jem korrekt, por megjithatë edhe parafolësit dua t'i them që po, unë jam këshilltar dhe shef i Grupit të këshilltarëve dhe natyrisht me përgjegjësi të plotë do t'i them se do t'i mbrojë veprimet e mia, investimet e mia që i bëjmë për qytetarët, sot e 10 vite dhe vazhdimisht do ta kenë përkrahjen time të fuqishme.
Unë ju thash paraprakisht që duhet me u kënaq me këto investime por nëse dikush është mësuar të jetë gjithë në pushtet, gjithë kungulli mbi ujë nuk shkon sepse vjen koha dhe bie poshtë.
**z.Arjant Topanica**, theksoi, po ndërlidhem me sjelljen e drejtorit të DSHPMSH kur ishte fjala se kush do ta marrë fjalën, nuk është ky që përcakton se kush e merr fjalën, a do të fol apo jo ndonjëri prej asmbleistëve, mirëpo këtë duhet ta di ai i cili duhet ta menaxhoj seancën.

Diskutimi ishte nga fillimi, pasi që i përfunduam gjitha diskutimet me drejtorin e DBF-së, njëherë u përgjigj ai njëherë diskutuam ne dhe përfundoj diskutimi i kësaj pjese, kaluam te arsimi dhe deshëm ta vazhdojmë të njëjtën, kurse na u ndalua fjala dhe e drejta e fjalës.
Pastaj i nderuar Kryesues ti e potencove se vetëm drejtorët e kanë të drejtën e fjalës e që mandej ngecëm sepse nuk mund ta marrë fjalën këtu vetëm kush dëshiron ngase nuk është Ekzekutivi ai që e përcakton se kush e merr fjalën këtu në Kuvend, andaj ju lus që të jetë hera e fundit kjo.
Sa i përket sjelljes së Kryetarit si dhe diskutimi i tij duke ardhur dhe duke shikuar se kush po i ndez mikrofonat, nuk është sjellje e hijshme, madje ajo u pa dhe te fjalimi i tij që tha le t'i ngrisin pyetjet dhe shqetësimet asamblistët, përgjigjen drejtorët dhe përmbyllet ajo temë, pra nuk është ai që na tregon se kur mbyllet tema sepse secili prej nesh kemi të drejtë dy herë ta marrim fjalën.
Nëse i ngrisim shqetësimet tona në fillim lidhur me raportin financiar dhe përgjigjet drejtori përkatës, ne sërish kemi të drejtën e ngritjes së shqetësimeve tona nëse nuk na është dhënë përgjigjja ose është tejkaluar pyetja, nuk na u mohua kjo e drejtë, por Kryetari ty të tha Kryesues që veç edhe njëherë kanë të drejtë fjale pastaj s'kanë me marrë fjalën, kështu që këto nuk janë sjellje të hijshme.
**znj.Arjeta Salihu**, theksoi, edhe unë po e paraqes një shqetësim si vërejtje përderisa drejtorët e Drejtorive janë të ndarë në profile të ndryshme atëherë secili e kryen pikën e vet, secili i përgjigjet pyetjeve të asamblistëve dhe mandej kalojmë te drejtori i Drejtorisë tjetër, mirëpo i nderuar Kryesues ashtu siç e menaxhove, keq menaxhove dhe udhëheqë atëherë le të rrinë vetëm një drejtor këtu dhe i bëjmë pyetje kurse ai drejtor përgjigjet edhe për të tjerët të cilët lirohen prej seancës, kështu e pashë unë, sa herë që ka dalë drejtori i DBF-së ka raportuar, i kemi parashtruar pyetje, është përgjigjur dhe madje ka kaluar te drejtori tjetër, prandaj kjo që po ndodh mendoj se është totalisht pa rregullsi.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, sa i përket kësaj, tema ishte te raporti financiar që u ndërlidh me drejtorin e DBF-së, mirëpo drejtorët për Drejtoritë e tyre përkatëse japin sqarime.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar Kryesues e ke menaxhuar shumë mirë seancën të përgëzoj veç vazhdo kështu, mirëpo me këtë qasje vërtetë po mundohem maksimalisht të të kursej, seancën tjetër prej asaj foltoreje ke keqpërdorë, bjeri herë Kryetarit herë Drejtorëve, tash mua jashtë foltores, hyn në diçka që nuk është kompetencë e juaja duke menduar dhe vepruar veç kujt t'ia lëshoj unë mikrofonin në një mënyrë.
**Kryesuesi i Kuvendit**, duke demantuar parafolësin theksoi, nuk ka qenë ashtu.
**z.Naim Çunaku**, vazhdoi, është incizimi për këtë dhe mos ndërhyj deri sa të përfundoj unë, kuptoje njëherë anën njerëzore, të përfundoj unë fjalimin pastaj folë ti sepse me këtë situatë një ditë do të "rrihemi", madje për pak sa kapërceu situata pak më parë, nuk bën kështu.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, nuk jemi aq trima që të rrehemi mes vete.
**z.Naim Çunaku**, vazhdoi, nuk rrahëm unë sepse trimat nuk ndërrojnë aso fjalësh ngase trimi kur i ndërron ato fjalë ndërron edhe diçka tjetër, po më shpërqendron dhe nuk e di synimin.
Më bëri të flas drejtori i DKA-së, vërtetë edhe mua më dolën shqetësuese ato shifra dhe ajo çka tha drejtori i DKA-së, e pranoj atë që e potencuam unë dhe kolegia znj.Arnisa Sylejmani dhe të gjithë ne, ky raport nuk është shpjegues, nuk është sqarues, ka krijuar konfunzitet te një këshilltar i Kuvendit rreth shumës 400,000.oo€ apo 600,000.oo€ sepse ka mund të jenë shkruar krejt në një vend për pelet, jo veç për dru, por pelet, dru dhe naftë, kaq do të ishte dhe nuk do të krijoheshin këto që u krijuan, pra mund të përshkruhet, andaj poenta ishte për ato shpenzime që janë të pa sqaruara, ndërsa ajo ana moralizuese që po provohet të bëhet këtu nga dikush, lëreni more atë gjë sepse del ndokush e hyn në cv-në tonë prej kur jemi në këtë Komunë, të gjithë i kemi disa cv,

dikujt i pëlqejnë, dikujt nuk i pëlqejnë, dikush i ka për qejfi, dikush irritohet prej tyre dhe nuk e kemi këtë të drejtë t'i kualifikojmë ne, nuk e kemi atë të drejtë se a më pëlqen mua diçka apo jo.
Drejtorin e DSHPMSH z.Bahri Selimi po e mirëkuptoj në bazë të asaj që e potencoi se vërtetë më shtytë të dalë nga vetja, dhe po e pranoj në mënyrë kolegiale atë ngase përndryshe t'i ulë mikrofonat dhe t'i thotë nuk ke me fol këtu këshilltarit të Kuvendit të Komunës është jashtë çdo normaleje të Ekzekutivit të Komunës, por Kryesuesi është ai që e kryeson seancën e që një ditë me këto veprime mund të vijmë në një situatë të pa lakmueshme.
**z.Bahri Selimi**, drejtor i DSHPMSH, theksoi, edhe njëherë po e filloj me këtë të fundit që u tha nga z.Naim Çunkau dhe nga z.Arjant Topanica të cilët i pyes se, çfarë jua merr mendja juve, a është më shqetësuese të ndalet ose të lëshohet mikrofoni apo të ofendohet në baza personale dikush, cila është shqetësuese më tregoni.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, përse i nderuar drejtor nuk reaguat atëherë kur ndërhyri z.Haki Rudari.
**z.Bahri Selimi**, drejtor i DSHPMSH, theksoi, cilën do formë unë nuk e arsyetoj në asnjë rast dhe asnjërin edhe pse ajo ndodhi pas ishte ajo ngritja e gjakrave nëse mund ta quaj kështu, si do që të jetë, të bëhen fyerje në baza personale dhe të thuhet pastaj ishte e rëndë ngase një drejtor e ndali mikrofonin, shumë është diskrepancë e madhe kjo. Unë e thash që dola nga vetja dhe është e vërtetë që dola nga vetvetja por me vetë faktin kur e dëgjoj një asamblistë duke e fyer kolegun tim dhe mua këtu afër pa qare dalë nga vetvetja, asnjëherë nuk e thash përse më bëtë pyetje për ndonjë projekt sepse është natyrë e punës ajo. Çka të doni thoni për punët dhe angazhimet e mia por personalisht s'keni të drejtë të më fyeni askush, kaq sa i përket kësaj teme.
I nderuar z.Qendrim Softolli edhe një herë të them dhe ta japë mundësinë edhe njëherë me fol, e potencove në fillim se nuk është bërë bash asgjë, e evidentova këtë fjalë tënde dhe mund ta shikosh në kamera, e the nuk është bërë bash asgjë në Lumin Llap në qytet kështu the decidivisht, unë të tregova çka është bërë, diçka që shihet dhe të kuptova që ti e the ndoshta këtë në mënyrë politike e që ato janë çështje politike. Pastaj e përmende një kallëzim penal e këtu më duhet të përgjigjem patjetër për një kompani të tenderuar, kam bërë kallëzime penale dhe sërish bëj kurdo që nuk e ka mirë, sërish e bëjë, dhe në atë konferencë e kam treguar për çka sepse ti nuk e din çka ka ndodh aty, ju nuk e dini sepse nuk keni qenë atëherë, madje mirë e tha dikush më përpara se po na sulmoni ju, ju, ju, por ne s'kemi qenë atëherë, mirëpo që ka ndodhë ajo atëherë po e din, do të thotë ka qenë, kurse tani nuk po bën t'ju themi ju, ju, ju, ndërsa që ka ndodh ajo konferencë në vitin 2012 ose 20213 po e din.
Si do që të jetë, zotëri Softolli mos u thirr në atë kam qenë ose s'kam qenë, unë kam qenë gjithë në LVV edhe jam dhe e përfaqësoj atë, nëse thua se s'ke qenë është gabim ose duhet me dalë i pavarur me thënë unë e përfaqësoj vetëm vetveten, por ne po përfaqësojmë subjekte politike këtu e aq më shumë ju që jeni kuvendar.
**z.Qëndrim Softolli**, theksoi, sa i përket kallëzimit penal, mund të jesh keqkuptuar, kallëzim penal nuk përmenda drejtor, por e përmenda konferencën e jashtëzakonshme, mirëpo për të njëjtën kompani edhe kallëzimin penal paske bërë ti, atëherë në emër të asaj që tani po del të jetë e preferuara e jote, mbi 2,000,000.oo€ vetëm brenda vitit 2023 i ka marrë po e njëjta kompani.
**U**në jam krenar edhe me të kaluarën time politike edhe me të bëmat e LDK-së, por nuk mund të më akuzosh për role Ekzekutive sepse e theksova që nuk kam pasë pozicion të tillë asnjëherë, jo që s'kam qenë në LDK, nuk kam pas pozicion Ekzekutiv e thash, dhe tani çfarë po mendoni, shkaku i të bëmave të atyre më herët t'ju amnistojmë juve tani a, ose t'ju themi bëjeni këtë sepse e kanë bërë edhe ata, këtë po dëshironi ta standardizoni ju, nuk bëhet kështu, nëse e kanë bërë ata e kanë marrë vlerësimin, s'janë më, ashtu ka me u ardhë puna edhe juve.

**z.Bahri Selimi**, drejtor i DSHPMSH, theksoi, ti i nderuar Softolli veç vazhdimësi je, s'ke ndryshuar, a je në LDK apo ke ndërruar parti, LDK-ja ka qenë.
**z.Qëndrim Softolli**, duke reaguar theksoi, më duket se nuk ke dëgjuar vëmendshëm ose nuk e din çka ishte, ose mund të shkosh për ushqim dhe pije ngase si duket nuk qenke vetvetja.
**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, theksoi, të gjithë ata që u drejtuan me fyerje ndaj meje edhe me tendencë, do të ishte edhe njerëzore të kërkohet falje.
**znj.Edona Shabani**, theksoi, dua t'i them drejtorëve të Drejtorive, fillimisht e them se unë nuk i thash atij je servil (fjala është për z.Haki Rudarin), por i thash mos u bë servil për çështjen e partisë. Po ashtu lidhur me temën që ishim duke diskutuar nuk kisha asgjë personale kurse kolegu në fjalë mu drejtua mua me fjalë ti je servile më shumë se unë, në rregull është faleminderit shumë që njëri jem më servil se tjetri, ai ose unë, fare nuk ka dert kjo, por kuptoje se kjo nuk është gjuhë e mirë ngase ne fillimisht duhet të diskutojmë dhe t'i sqarojmë gjërat e jo të shtyhemi njëri me tjetrin. Kolegu në fjalë kur u shpreh me fjalën servile, drejtoresha përballë meje këtu dhe ju të gjithë të tjerët, s'ka lidhje a më kërkon falje apo jo, vetëm dua t'ju them se keni nevojë të merreni me vetën e juaj dhe ju lutem të mos më ndalni mikrofonin sepse unë kam të drejtë të flas dhe askush nuk mund të më pengoj të flasë këtu, por kur e keni "mizën pas veshi" mos iu kapni askujt.
Edhe njëherë e përsërisë se nuk i thash askujt servil sepse së pari nuk e kam në gjak, në familje e as në fis këtë gjuhë, por i kam thënë mos u bë servil dhe atë për faktin se më është dhimbsur ngase pa u emëruar drejtorë disa ish asambleist dhe pa u liruar vendet, ky nuk do ishte sot këtu.
**z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës**, theksoi, lus të gjithë anëtarët e Kuvendit që të kalohet në pikat e rendit të ditës dhe të diskutoni për rendin e ditës, përndryshe nëse keni nevojë për sqarime të tilla mund ta kërkoni një seancë të jashtëzakonshme dhe t'i sqaroni të gjitha këto probleme, prandaj mosni ju lutem sepse jeni duke dalë shumë qesharak ku në një pikë shumë serioze të rendit të ditës ju jeni duke dalë në gjëra personale mes vete dhe kur po diskutoni për këto gjëra jeni duke treguar sjelljen dhe kulturën e juaj, andaj ju lutem mos diskutoni për këto gjëra sepse po dilni shumë keq dhe askush ju shikon.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, disi Kryetari më lexoj mendjen sepse e potencoj atë që deshta të them sepse vërtetë është mirë të jemi sa më përmbajtësor dhe sa më konkret në debatet tona ngase jemi pasqyrë e qytetarëve dhe kësaj shoqërie, dhe pa marrë parasysh këto veprime që po i paraqesim e që janë veprime jo të mira është një imazh i institucionit të cilin ne e përfaqësojmë, duhet të mundohemi që sinqerisht të jemi sa më konkret, sa më real dhe sa më të qetë, më të qartë dhe më argumentues për të gjitha çështjet të cilat jemi duke i trajtuar.
Po e shohë që njëherë janë ngritur gjakrat gjatë debatit (jo unë thash kështu e ai ashtu) por është mirë që ne si institucionalistë që jemi të vazhdojmë me debate konkrete sepse mosshfaqja e argumenteve sjell agresivitet dhe këtë po e shohë këtu, prandaj sinqerisht është mirë që ne këtu të tregojmë kulturë të lartë qytetare dhe këtë kulturë t'ia pasqyrojmë qytetarëve se përnjëmend në këtë vend ka kulturë, ka integritet, respektohen individët, respektohet institucioni dhe në asnjë mënyrë nuk bënë që me teke individuale të ketë qasje të tilla në publik ngase qasja në raport me publikun kur një person merr përgjegjësi publike është një qasje më ndryshe se sa kjo që po e shohë këtu.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, të gjithë po flasim për sjellje, për moral, edukatë por këtë nuk jemi duke e respektuar.
**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, kanë menduar që me atë raport financiar prej 3 faqesh e gjysmë të e sjellin ashtu duke menduar se ne nuk e marrin vesh. Pagesat që i cekëm janë bërë dhe i'u "ra kresë" kur i përmendëm sepse nuk ofendohen fare këta dhe nuk e kanë për kinse ofendim.

Pyetjen e bëra unë, përse ka bërë raport 3000.oo€ dreka dhe darka zyrtare kurse të paguara janë 21,500.oo€ veç dreka dhe darka zyrtare, nuk po hy te ushqimi i çerdheve sepse aty janë 250,000.oo€ të shpenzuara.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, i nderuar Rrahmani, tani mos i përsëritni dy-tri herë gjërat e njëjta.
**z.Ekrem Rrahmani**, vazhdoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, përse nuk i thua atij (drejtorit të Drejtorisë përkatëse) të përgjigjet por më drejtohesh mua duke më thënë mos i përsërit.
Të gjithë qytetarët duhet t'i dinë këto gjëra ngase këta me gjëra të tilla dhe duke gënjyer kanë ardhë në pushtet, duke thënë vetura, nafta, roja, etj. Asnjëherë Komuna e Podujevës rojtar s'ka paguar, pse nuk e bëni sikurse në QKMF që të qëndroj polici aty i cili paguhet nga MPB-ja, por ky e sjell shokun e tij këtu që ta ruaj objektin e Komunës e që unë pyes se kë ka për ta ruajtur këtu, kush të mbaj rend këtu, qytetarë të "tranuar" nuk ka këtu, kush do që vie në Komunë vie për të kryer shërbim, andaj për çfarë të vie ndokush këtu me uniformë dhe armë e të ruaj dhe të paguhet 12,000.oo€, kë ka për ta ruajtur brenda dhe për çka ka për tu paguar nga Komuna si sigurim kur Komuna ka punëtorët e vet që paguhen jashtë orarit për sigurim të objektit, përse me ardhë ata, mirëpo këtu askush nuk përgjigjet për këto gjëra.
**z.Arjant Topanica**, theksoi, po ndërlidhem me atë që e tha Kryetari dhe njëri prej asambleistëve paraprakisht duke shitë moral që po dalim prej teme, mirëpo unë nuk e dëgjova asnjë diskutim të kolegëve që ishte jashtë teme, në fakt jashtë teme u nxirr debati me shefin e Grupit ku cilësimet e tij e sollën diskutimin këtu ku jemi sepse të gjitha diskutimet tona ishin brenda grupit dhe brenda kornizës së temës për raportin financiar.
Kolegu që e potencoj se duhet të mbahet konteksti i debatit brenda pikës së diskutimit, është ai që në fillim ka dalë dhe ka treguar për disa qerre me rrota të holla, e që ishte diskutim jashtë teme, por jo diskutimi ynë rreth raportit financiar.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, për këtë pikë diskutuam mjaftueshëm, qytetarët janë ata që na vlerësojnë, kjo pjesa e fundit kur u ndalën mikrofonat nuk do të duhej të ndodhte por ky gjest shumë rrallë ka ndodh që t'i ndalet dikujt mikrofoni.

7. **Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri –** *Projekti "Furnizim me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve"*

**z.Vigan Salihu**, Drejtor i DPZHE, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, ky është një propozim vendim për bartjen e mjeteve buxhetore për pagesën e projekti "furnizim me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve", kjo është kërkesë e Ministrisë së Financave, andaj pres mbështetje nga ana e juaj.
**z.Arjant Topanica**, theksoi, ne Grupi i LDK-së normalisht se jemi për mbështetje të këtij propozim vendimi por vetëm dëshirojmë të ngrisim një shqetësim kur është në pyetje subvencionimi te pjesa e fermerëve që të jeni më real në vlerësimin e tyre dhe të mos jeni diskriminues. Po ashtu edhe te përqindja e participimit të fermerëve në vlerë 30%, e pjesëmarrjes edhe këtu kemi marrë ankesa nga fermerët që është një vlerë e pa përballueshme nga fermerët që kanë interes për t'i marrë këto pajisje bujqësore që jepen për këtë kategori si subvencione.
**znj.Qëndresa Hajrizi**, theksoi, ne në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim këtë propozim.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, pasi që s'ka diskutime tjera për këtë pikë të rendit të ditës atëherë e vë në votim propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Projekti "Furnizim me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve", sipas propozimit / materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 18 anëtar/e të Kuvendit që ishin prezent në sallë, me 17 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë e Përmbajtur (një anëtar nuk votoj), miratohet <u>propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri-Projekti "Furnizim me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve",</u> sipas propozimit / materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.*

8. **Plotësim ndryshimi përbërjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB, përkatësisht z.Bashkim Bajrami Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë, të jetë anëtar në kuadër të përbërjes së KKSB në vend të ish Komandantit z.Nijazi Jashari i cili është pensionuar.**

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, kjo pikë dihet që ka hy përmes KPF-së, për plotësim ndryshimi përbërjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB, përkatësisht z.Bashkim Bajrami Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë, të jetë anëtar në kuadër të përbërjes së KKSB në vend të ish Komandantit z.Nijazi Jashari i cili është pensionuar, tani ne duhet që ta votojmë këtë plotësim ndryshim të përbërjes së KKSB-së.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 18 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, me vendim miratohet Plotësim ndryshimi përbërjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB, përkatësisht z.Bashkim Bajrami Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë, të jetë anëtar në kuadër të përbërjes së KKSB në vend të ish Komandantit z.Nijazi Jashari i cili është pensionuar.*

9. **Të Ndryshme**

**z.Naim Çunaku**, theksoi, në mbledhjen e kaluar e kam bë një pyetje për drejtorin e DKA-së, e besoj se janë krijuar aso rrethanash sikur sot me tendencë dhe nuk kam marrë përgjigje.
**znj.Donjetë Sheqiri,** theksoi, i nderuar Kryesues mendoj se nuk kuorum për vazhdimin e seancën.
**z.Qendrim Softolli**, theksoi, nëse ju e lëshoni seancën atëherë është pa përgjegjësi.
**z.Haki Rudari,** duke i reaguar parafolësit theksoi, edhe ju keni përgjegjësi.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, i nderuari z.Haki Rudari nuk janë të obliguar këta për ta bërë kuorumin, andaj për shkak të mungesës së kuorumit pika të ndryshmet nuk mund të diskutohet, prandaj e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

*Meqë nuk pati kuorum për të vazhduar mbledhjen, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se pika Të Ndryshme nuk mund të shqyrtohet kështu që ndërprenë këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 13:35**

**Procesverbalin e mbajtën dhe hartuan;**
**Enis Sheholli**
**Osman Bajrami**

**Nr.Prot.01-060/04-0020989/24**
**Podujevë,** **Kryesuesi i Kuvendit**
**29 mars 2024** **Hilmi Hoxha**

# KUVENDI I KOMUNËS

**Procesverbal nga mbledhja e XXXIX-të (tridhjetenëntë)-*e rregullt*, mandati VII-të, e mbajtur më 23 maj 2024.**

Mbledhja filloi në orën 10:__ dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.
Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.
Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:
(Nga LDK *Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Adnan Zymeri; Arjant Topanica; Ilir Koprani; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani;* Fahri Hasani; *Demokrat Hodolli;* kurse munguan; *Donjetë Sheqiri; dhe Tringa Sfishta*
Nga LVV, *Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota*; *Sebastina Vokrri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi.*
Nga PDK, *Bashkim Syla; Mimoza Abdullahu;* kurse mungoi; *Endritë Murati.*
Nga AAK, *Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.*
Nga OBKD, *Gazmend Islami i cili mungoi me arsyetim shëndetësor me shkrim dërguar Kryesuesit të Kuvendit.*

Gjithashtu të pranishëm mbledhje ishin, z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;
*(Shuajb Blakçori-Drejtoria e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Leutrim Krasniqi-Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM;; Vlora Humolli Jashanica-Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH; Alban Zeka-Drejtoria e Inspeksionit DI; Lirie Hoti-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE; ndërsa mungoi Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ).*

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të KFOR, përfaqësues të mediave lokale (TV Llapi), një qytetar dhe disa zyrtar komunal.

## Rendi i Ditës

**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe i'u dëshiroj mirëseardhje dhe punë të mbarë, theksoi, para se të fillojmë me rendin e ditës konstatojmë se kuorumi ekziston për momentin mungojnë, Donjeta Sheqiri, Ilir Koprani, Tringa Sfishta, Endrita Murati dhe Gazmend Islami, që do të thotë prezent në sallë janë 30 anëtar/e të kuvendit dhe mund të vazhdojmë me mbledhjen.
**znj.Lirie Hoti,** Drejtoreshë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – DBPZHR, theksoi, para se të vazhdojmë me rendin e ditës unë kam një propozim që të vendoset si pikë e rendit të ditës, propozim vendimi për caktimin e kompensimit të anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike Eko Llapi – SH.A.
**z.Fatlum Osmani,** Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave - DBF, theksoi, arsyeja pse po e marrë fjalën është në lidhje me disa pika të rendit të ditës të cilat kanë të bëjnë me dhënien e pronave në shfrytëzim, dihet se është kriter ligjor që pjesë e komisionit të vlerësimit të jetë edhe

një përfaqësues nga shoqëria civile dhe ne në këtë rast kemi vetëm një aplikues nga shoqëria civile që të jetë pjesë e komisionit vlerësues, kurse kemi tri prona për dhënien në shfrytëzim dhe rrjedhimisht nga rendi i ditës duhet të largohen dy pika, andaj propozoj që nga rendi i ditës të hiqen pika e 12 dhe 13 për dhënien e pronave në shfrytëzim.
**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, theksoi, së pari e vë në votim propozimin e znj.Lirie Hoti, Drejtoreshë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – DBPZHR, që të vendoset si pikë e rendit të ditës, propozim vendimi për caktimin e kompensimit të anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike Eko Llapi – SH.A.
**z.Bashkim Syla, theksoi,** Kryesues së pari anëtarët e këtij komisioni duhet ta lirojnë sallë sepse pjesëmarrja e tyre në votim paraqet konflikt të interesit.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 17 vota për asnjë votë kundër, asnjë votë të përmbajtur miratohet vendimi për caktimin e kompensimit të anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike Eko Llapi – SH.A si pikë e rendit të ditës sipas renditjes.*

**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, theksoi, tani i vë në votim propozimet e drejtorit z.Fatlum Osmani që të largohen dy pika nga rendi i ditës për shkak të mungesës së anëtarëve të shoqërisë civile që duhet të jetë pjesë e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale dhe atë:
***12. Propozim vendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës – njësia kadastrale P-1207-0, ZK Llapashticë e Epërme,***
***12.1. Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim.***
***13. Propozim vendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës – 2 lokalet afariste 50 m2 dhe 55m2, të ndërtuara në rr. "Skenderbeu", në njësinë kadastrale P-00459-0, ZK Podujevë .***
***13.1. Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim.***

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 21 vota për asnjë votë kundër, asnjë votë të përmbajtur, largohen dy pika nga rendi i ditës për shkak të mungesës së anëtarëve të shoqërisë civile që duhet të jetë pjesë e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale dhe atë:*
*12. Propozim vendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës – njësia kadastrale P-1207-0, ZK Llapashticë e Epërme,*
*12.1. Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim.*
*13. Propozim vendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës – 2 lokalet afariste 50 m2 dhe 55m2, të ndërtuara në rr. "Skenderbeu", në njësinë kadastrale P-00459-0, ZK Podujevë .*
*13.1. Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim.*

**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, nga ana juaj kërkoj që pika e 14 e rendit të ditës të hiqet nga rendi i ditës, nuk ka të bëjë kjo asgjë me kuvend, nëse drejtoria ka bë komision, nuk ka nevojë neve komisioni të na raportoj, le t'i raportoj atij që e ka bë këtë komision dhe nuk e di pse e keni sjellë këtë raport këtu kur dihet se raporti nuk votohet dhe as dua ta di se çka ka bë ai atje se kurrfarë ekspertësh nuk janë ata për të vlerësuar për të rrënuar apo çka me bë nëpër prona private, kështu që unë kërkoj që të hiqet nga rendi i ditës kjo pikë dhe mos na vëni neve në lajthitje për të votuar këtu gjëra palidhje.
**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, theksoi, tani e vë në votim propozimin e z.Ekrem Rrahmani që të pika e 14 e rendit të ditës, Raporti i komisionit për vlerësimin e gjendjes dhe konstatimin e shkallës së rrezikshmërisë së objektit të ndërtuar në periudhën e viteve 1982-1985, për destinim "Shtëpi e Kulturës", të hiqet nga rendi i ditës.
**z,Xhevdet Maloku,** theksoi, i nderuari kryesues së pari merre fjalën e të gjithëve këtu që janë lajmëruar për fjalë e jo me i vë në votim këtu rend me rend propozimet se nuk shkon kështu pjesë pjesë, nuk është serioze kjo.
**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, theksoi, kjo është shumë serioze dhe e saktë i nderuar prandaj edhe njëherë pa humbur kohë rreth diskutimeve tani e vë në votim propozimin e z.Ekrem Rrahmani që të pika e 14 e rendit të ditës, Raporti i komisionit për vlerësimin e gjendjes dhe konstatimin e shkallës së rrezikshmërisë së objektit të ndërtuar në periudhën e viteve 1982-1985, për destinim "Shtëpi e Kulturës", të hiqet nga rendi i ditës.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 6 vota për, një votë kundër, asnjë votë të përmbajtur nuk kalon propozimi i z.Ekrem Rrahmani që të pika e 14 e rendit të ditës, Raporti i komisionit për vlerësimin e gjendjes dhe konstatimin e shkallës së rrezikshmërisë së objektit të ndërtuar në periudhën e viteve 1982-1985, për destinim "Shtëpi e Kulturës", të hiqet nga rendi i ditës.*

**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, këtë unë e dërgoj në ministri dhe nuk kalon kjo, është edhe vendimi i gjykatës kushtetuese dhe se di pse po bëni shaka, pse me na e sjellë neve atë, a ke formuar në kuvend ti atë komision, pse me na raportuar neve komisioni, a na ka pyet dikush kur ka rrënuar diçka, kanë rrënuar shumë objekte tjera si shkollën e Orllanit dhe nuk na ka pyet askush për asgjë, pse me ardhë me na pyet neve për sende private për çka je ti kryesues nuk ka nevojë me na sjellë këso sendesh dhe me na vë neve në lajthitje ku gjysma nuk e dinë se për ça po votojnë.
**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, theksoi, propozimi yt nuk kaloi se ishin vetëm 6 vota për.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, ne si kuvend nuk e kemi themeluar atë komision dhe nuk ka nevojë ai komision të na raportoj neve por duhet ti raportoj atij që e ka formuar atë komision, për çka e kemi miratuar ne hartën zonale, le te rrënojnë ata atë objekt apo te ndërtojnë tjetër por neve mos të na sjellin këtë këtu, pse me na sjellë neve sende të tilla me votu këtu, kjo është shumë e kot, ose ka me dalë me na spjegu me vendos në ekran dhe ta dimë se ça po votojmë e ça s'po votojmë. Kur s'guxojnë me marrë vendime vet atëherë i sjellin në kuvend se këta i ngrisin duart e votojnë dhe nuk dihet se ça bëhet atje, kjo është shumë e pa drejtë.
**z.Adnan Zymeri,** theksoi, I nderuari kryesues e nderuara nënkryetare, të nderuar koleg, shumë të dashur rugovistë, anëtar të Lidhjes Demokratike të Kosovës jam sot para jush për t'ju njoftuar me një vendim timin, vendim të cilin kurrë se kam menduar dhe për të cilin asnjëherë nuk kam punuar. Mirëpo kur në vend të meritokracisë promovohet padrejtësia, në vend të së vërtetës gënjeshtra, në vend të kontributit promovohet dy ftyrësia dhe në vend të progresit shkatërrimi, unë dorëzohem dhe refuzoj të jem pjesë e shkatërrimit të cilin sot e çdo ditë është duke ia bërë

Lidhjes Demokratike të Podujevës, kryetari i saj dhe ata pak njerëzit e tij. Deri sa po flas e di që secili kontribut i imi për LDK-në, do të shumëzohet me zero nga dikush me vlera nga po të njëjtit do të konsiderohem i pa vlerë në kafehanet ku bëjnë politikë vendim marrëse shkatërruesit e LDK-së, të Podujevës do të ekzaltohen duke përmendur emrin tim por gjithashtu e di që një LDK-je, të dobët në Llap i gëzohen vetëm ata që kurrë nuk kanë qenë në LDK, e sot udhëheqin me të. Por pavarësisht të gjithave dhe mbi të gjitha LDK-ja në Llap do të triumfoj, do të triumfoj atëherë kur do të udhëhiqet nga shpirti e mendja e njerëzve të mirë të saj si asamblist, deputet e ish deputet që unë kam njohur dhe punuar me ta e jo me politikan pa busull. Nga sot e deri atëherë unë do të jem i pavarur politikisht duke përfaqësuar dhe mbrojtur interesat denjësisht e atyre që më besuan dhe ri besuan dhe me të vetmin obligim kolegial e njerëzor ndaj atyre që më ftuan në angazhimin politik si kryetar Veliu, kryetar Rekaliu dhe Hoti, faleminderit shumë.
**z.Demokrat Hodolli,** theksoi, e nderuara nënkryetare e komunës i nderuari kryesues z.Hilmi Hoxha, të dashur asamblist dhe asambliste unë Demokrat Hodolli deri më sot si anëtar i kuvendit nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës dua që publikisht ta konfirmoj se tani e tutje do të jem asamblist i pavarur, ju faleminderit për mirëkuptim.
**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, theksoi, vetëm ju uroj suksese si grup i pavarur, vetëm të kishit edhe një anëtar e të bëheshit tre se tani grup nuk po mund të bëheni, tani meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën e hedh në votim rendin e ditës sipas thirrjes dhe materialit të kësaj mbledhje, rekomandimet e KPF-së, si dhe plotësim ndryshimeve të mbështetura në votimet paraprake:

**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit** pas votimit konstatoi se me 19 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të përmbajtur nga anëtarët e pranishëm, miratohet rendi i ditës për këtë mbledhje, me pikat si në vijim:

***1. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2023 në vitin 2024 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore.***
***2. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko-Llapi" Sh.A.***
***3. Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik pronat e Paluajtshme shoqërore nën menaxhimin e AKP-së, dhe atë; -në Zonën Kadastrale Dumnicë e Poshtme, për realizmin e projektit për ndërtimin e Tregut të Kafshëve, dhe - në Zonën Kadastrale Podujevë, për realizimin e projektit për ndërtimin e Tregut të Gjelbër.***
***4. Propozim vendimi për shpallje në interes të përgjithshëm publik - objektet e ndërtuara në Parcelën me nr.P-71712062-02153-1, Zona Kadastrale Podujevë.***
***5. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – mars 2024.***
***6. Draft Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 – 2026.***
***7. Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB për vitin 2023.***
***8. Propozim Plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB për vitin 2024.***
***9. Raport i punës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, periudha janar-mars 2024.***
***10. Informatë e Drejtorisë së Bujqërisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.***

***11.Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1274-0, ZK Llapashticë e Epërme.***
***11.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim***
***12. Raporti i komisionit për vlerësimin e gjendjes dhe konstatimin e shkallës së rrezikshmërisë së objektit të ndërtuar në periudhën e viteve 1982-1985 me destinim "Shtëpi të Kulturës".***
***13. Propozimi për plotësim ndryshimin e Vendimit të Kuvendit nr.prot.01-020/04-0101084/22 datë 09.12.2022 për formimin e komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës, përkatësisht në vend të ish anëtares znj.Antoneta Ejupi ish drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, anëtar në këtë komision të caktohet z.Shuajb Blakçori U.D. drejtor i Drejtorisë së Administratës në Komunën e Podujevës.***
***14. Propozim Vendimi për kompensimin e anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale "Eko-Llapi" SH.A***
***15. Të Ndryshme.***

**z.Hilimi Hoxha, Kryesues i kuvendit ,** theksoi, tani vazhdojmë me punë sipas rendit të miratuar të ditës.

1. **Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2023 në vitin 2024 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore.**

**z.Fatlum Osmani,** Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave –DBF, theksoi, Komuna e Podujevës si organizatë dhe si çdo komunë tjetër i ka të hyrat vetanake ku në bazë të ligjit për financat publike dhe në bazë të ligjit për buxhetin për vitin 2023, të hyrat vetanake i menaxhon në bazë të planifikimit të buxhetit të cilat i miraton nga ky kuvend. Në bazë të ligjit të buxhetit të vitit 2023 të hyrat vetanake të cilat nuk shpenzohen barten në mënyrë automatike në kodet dhe projektet të cilat nuk janë shpenzuar gjatë vitit 2023, me përjashtim të të hyrave vetanake të cilat e kanë tejkaluar planifikimin nga ana e vitit 2023, do të thotë se Komuna e Podujevës ka pas të planifikuar afërsisht 1,856,000.oo€, dhe ne si komunë është fat i mirë që kemi tejkalim të të hyrave vetanake në vlerë 344,213.05€, dhe këto mjete me vendim të kuvendit komunal duhet të barten në projektet dhe kategoritë të cilat propozohen dhe mendohet se duhet të shpenzohen gjatë vitit 2024. Ju e keni marrë materialin për bartjen e këtyre mjeteve të të hyrave vetanake mirëpo ndërkohë në komunikim me Ministrinë e Financave na është obliguar të themi kështu që disa të hyra të cilat janë tejkaluar në arsim dhe shëndetësi domosdoshmërisht t'ju takojnë këtyre dy programeve, kështu që këtu në bazë të propozimit që e kemi dërguar ka një ndryshim përpos programit të administratës komunale ku janë 253,904.54€, janë edhe në programin e arsimit 75,641.o1€ dhe 14,667.50€, në programin e shëndetësisë. Ndryshimi është në kodin e projektit të ndërtimit të Rr."Xhemajl Mustafa", janë larguar afër 25,000.oo€ ku janë vendos në komunali në fushën 25,641.00€ që janë vendos në komunali për arsim dhe në Drejtorinë e Shëndetësisë në kategorinë komunali janë 14,667.oo€, dhe për këtë vlerë buxhetore janë zvogëluar mjetet në projektin për

ndërtimin e stacionit të udhëtarëve. Këto janë ndryshimet të cilat janë nga propozimi të cilin e keni marrë përmes kryesuesit të asamblesë komunale përkatësisht prej zyrës ligjore.
**z.Arjant Topanica,** theksoi, para vetes kemi pikën e vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2023, në vitin 2024, në shumën e cekur nga ky raport 344,213.oo€, vendimi në parim përkrahet është ligjor dhe duhet detyrimisht t 'ishte në dobi të qytetarëve, mirëpo në ketë vendim janë paraqitur vetëm të hyrat që realizohen përtej planifikimit që është bërë. Shpërndarja do të ishte më e mirë sikur të ishte planifikuar në ndonjë projekt të ri që do ishte në dobi të qytetarëve dhe do të ishte në një formë si shpërblim për ta si rezultat i këtij tejkalimi se fundja e fundit në dobi të tyre do duhej të ishin projektet që udhëhiqen nga kjo qeverisje, mirëpo nuk ndodh kështu dhe nuk planifikohet mirë edhe kur ka mjete të mjaftueshme për qeverisje. Të nderuar e ceka më lartë se ky vendim është vetëm për mjete të pa shpenzuara të cilat e tejkalojnë planifikimin e të hyrave vetanake, mirëpo ne si kuvend nuk e dimë se ku janë 757,592.oo€, tjera që do duhej të ishin si pjesë e bartjes që kanë shkuar suficid nga viti 2023. Ku janë këto të dhëna, ku janë këto mjete në cilat projekte dhe kode janë alokuar, ne si kuvend jemi organ kompetent për bartjen e këtyre mjeteve e jo të jemi vetëm të informuar e fatkeqësisht në këtë rast po del që as informatën për këtë pjesë të mjeteve nuk e kemi. Tani do ta shpjegoj se nga rrjedh se nuk janë paraqitur këtu 757,592.oo€, që do të jenë si suficid për vitin 2024, të nderuar koleg në bazë të dhënave të mia të hyrat vetanake për bartje do të ishin 1,103,000.oo€, mirëpo ne kemi vendim vetëm për bartje të 344,000.oo€. Të hyrat vetanake të realizuara për vitin 2023, kanë qenë 2,150,000.oo€, nga të planifikuara që ishin 1,800,000.oo€, të shpenzuara kanë qenë 1,214,000.oo€, për vitin 2023, del se suficit mbesin 936,375.oo€, i shtojmë këtu edhe të hyrat suficit që janë bart nga viti 2022, në vitin 2023, që ishin 167,000.oo€, shto këtu edhe 936,375.oo€, të bartura nga viti 2023, në vitin 2024 dhe si total del se mjete të bartura nga mjetet vetanake nga viti 2023, në vitin 2024 janë 1,103,000.oo€. Tani duhet të marrim përgjigje ku janë këto mjete, ku janë alokuar, ku janë destinuar, çfarë është bë me këto mjete dhe pse kemi një raportim kaq të dobët, kaq të mangët dhe të cunguar ose kemi të bëjmë me fshehje të dhënave ose dikush nuk din si t'i raportoj këto të dhëna.
**z.Bashkim Syla,** theksoi, zakonisht edhe vitet e kaluara të hyrat vetanake të cilat nuk janë shfrytëzuar në vitet paraprake kanë kaluar me vendim të kuvendit komunal, pse s'ka ndodh këtë vit është sqaruar nga drejtori dhe është detyrë dhe përgjegjësi e tyre se a është vendim ligjor ose jo, në të ardhmen do të shihet. Sa i përket këtij propozim vendimi ne do të kemi propozim vendim me i kalu të hyrat 344,213.oo€, të cilat janë tejkaluar si të hyra vetanake të vitit 2023, këto janë të bartura në disa kode, unë e kam vetëm një pyetje për drejtorin se e sqaroj se prej 100,000.oo€ një pjesë e tyre janë marrë dhe janë mbet 86,000.ooo€ për ndërtimin e stacionit të udhëtarëve, a është punë shtesë apo është në kuadër të kontratës së stacionit të autobusëve.
**z.Artrit Mulliqi,** theksoi, i nderuari kryesues unë e mora fjalën për ta bërë një vërejtje për një shkelje procedurale që e bëre por kur ia dhe fjalën kolegut z.Bashkim Syla e bëre edhe shkeljen e dytë, fjala është se deri më tani procedura ka qenë që grupi më i madh në kuvend komunal e ka marrë çdo herë fjalën i pari, tani nga ky moment grupi më i madh është grupi i vetëvendosjes kështu që kërkoj nga ti kur të na japësh fjalën, së pari fjalën t'ia japësh kryetarit të grupit tonë pastaj grupeve më të vogla parlamentare në kuvend.
**z.Hilimi Hoxha, Kryesues i kuvendit ,** theksoi, më fal por unë nuk ju kam parë se keni ngritur dorën për të marrë fjalën.
**z.Artrit Mulliqi,** theksoi, nuk është problemi te unë, problemi është te procedurat do të thotë fjalën le te merr grupi më i madh njëherë, kështu ka qenë procedura deri më tani pastaj vazhdojnë grupet më të vogla, ne jemi grupi më i madh në këtë kuvend.

**z.Haki Rudari,** theksoi, më lejoni që të them edhe qëndrimin e grupit të këshilltarëve të LVV-së, lidhur me propozim vendimin për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2023, në vitin 2024, dhe destinimin në kategori dhe programe tjera buxhetore. Të nderuar qytetarë dhe të nderuar të gjithë të pranishëm të hyrat vetanake të Komunës së Podujevës 344,213.oo€, janë të hyra që janë tejkaluar nga të hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2023, tani për këto të hyra është propozimi që të barten në vitin 2024, dhe në programe të ndryshme, natyrisht se kolegët e kanë marrë materialin por për hir të qytetarëve unë po i lexoj programet të cilat parashihen që të kenë investime nga kjo shumë që e lexova më herët. Te kodi i projektit 49281 një investim që tash është më pak se 100,000.oo€ ashtu siç e tha edhe drejtori pastaj te kodi 40280 ndërtimi i stacionit të udhëtarëve, te kodi 519 po ashtu te ndërtimi i shkollës në Dumosh. Kemi dy kode të reja të cilat realisht mendoj se janë në interes siç është ndërtimi i tregut të ri të qytetit dhe ndërtimi i parkut industrial bujqësor, pra duke u nisur në të gjitha këto projekte ne si grup mendojmë se janë shumë të rëndësishme që të përkrahen dhe në emër të grupit sigurisht se do të votojmë për bartjen e këtyre mjeteve të të hyrave vetanake.
**z.Fatlum Osmani,** Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave –DBF, theksoi, faleminderit për diskutimin dhe çështjet që i shtruat, unë e bëra një sqarim edhe kur e mora fjalën lidhur me bartjen e këtyre mjeteve është e vërtetë se këtë vit për herë të parë bartet vetëm tejkalimi i të hyrave vetanake, është në ligjin e buxhetit të vitit 2023, i cili është miratuar nga Kuvendi i Republikë së Kosovës ku shkruhet specifikisht të hyrat vetanake të komunave të cilat janë të planifikuara në vitin 2023, ato të cilat nuk shpenzohen dhe të cilat kanë qenë të alokuara në SIMFK, barten në mënyrë automatike pas përfundimit të vitit fiskal në kodet dhe projektet, kategoritë ku kanë qenë të planifikuara dhe të aprovuara në Kuvendin Komunal. Një sqarim aty ku është miratuar ai buxhet i Kuvendit Komunal në vitin 2023, që e kemi miratuar buxhetin e komunës në projektet të cilat nuk janë shpenzuar aty janë bartë ato mjete ta zëmë një shembull disa mjete nuk janë shpenzuar në kategorinë e subvencioneve në DBPZHR, janë afër 75,000.oo€, janë bartë në kategorinë e subvencioneve. Janë afërsisht 350,00.oo€ të cilat kanë qenë të planifikuara të hyra vetanake për ndërtimin e rrugës në brezin e Lumit Llap që vazhdon deri te rruga magjistrale, nuk kanë qenë të shpenzuara vitin e kaluar për shkak se ka qenë i planifikuar shpronësimi, vlerësimi ka qenë më i ulët, procedurat e prokurimit kanë ngecë dhe rrjedhimisht këto mjete nuk janë shpenzuar dhe janë bartë në atë projekt 350,000.oo€, në atë projekt ku kanë qenë të planifikuara. Neni tjetër i buxhetit është që vetëm tejkalimi i të hyrave vetanake kalon përmes kuvendit komunal dhe them të drejtën është rregulluar për herë të parë këtë vit kështu mirëpo ka edhe një shpjegim logjik që besoj se është i drejtë se ti e ke pasë një buxhet që ke planifikuar në vitin 2023, dhe ato mjete ku nuk janë shpenzuar në ato projekte ato mjete janë bartë. Tejkalimi i të hyrave vetanake është në kompetencë të kuvendit komunal dhe të ekzekutivit që t'i propozoj bartjen e të hyrave vetanake se është normale për arsye se nuk kanë qenë të planifikuara në buxhetin e vitit 2023, këto mund të barten në projektet ekzistuese të cilat janë, mund të barten edhe në projekte të reja. Këtë ndryshimin të cilin e sqarova për arsye se disa të hyra vetanake të cilat janë në arsim dhe shëndetësi e kemi domosdoshmërisht t'i takojnëç këtyre dy programeve dhe janë bart edhe disa mjete në komunali që e sqarova më herët, ne tani kemi dy projekte të reja për të cilat na u ka mundësua ky tejkalim i të hyrave vetanake t'i financojmë. Bëhet fjalë për ndërtimin e tregut të ri të qytetit që do të ndodh në bashkëfinancim me Ministrin e Zhvillimit Rajonal ku këtë vit kemi ndarë 44,213.oo€, gjithashtu bëhet fjalë për ndërtimin e parkut industrial në Sfeçël në bashkëfinancim me Organizatën Katar ku besojmë se së shpejti do të nënshkruhet memorandumi dhe do të ndërtohet parku industrial bujqësor që do të jetë i pari i këtij lloji në Kosovë, unë së paku nuk jam i informuar që ka ndonjë park industrial bujqësor në Kosovë.

Normalisht kjo është praktikë e vendeve të zhvilluara që kanë zhvillim industrial dhe bujqësor, kryesisht të vendeve të perëndimit kuptohet dhe këto 50,000.oo€, janë për këtë projekt të ri i cili nuk ka qenë më herët i planifikuar në buxhetin e Komunës së Podujevës. Bashkim Syla bëri një pyetje lidhur me mjetet të cilat janë për stacionin e autobusëve, nuk bëhet fjalë për punë shtesë z.Bashkim Syla, bëhet fjalë për mjete financiare të cilat nevojiten për përmbylljen e projektit, ne e dimë se ai projekt ende është në ekzekutim e sipër dhe ai projekt është në bashkëfinancim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe këto mjete së bashku me mjetet që janë nda nga ana e Ministrisë së Zhvillimit rajonal nevojiten për përmbylljen financiare të këtij projekti.

**z.Hilimi Hoxha, Kryesues i kuvendit,** theksoi, nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën urdhëroni nëse jo atëherë e vë në votim propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2023 në vitin 2024 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore me ndryshimet e propozuara nga Drejtori i DBF-së.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 17 vota për, një votë kundër, asnjë votë të përmbajtur kalon propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2023 në vitin 2024 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore me ndryshimet e propozuara nga Drejtori i DBF-së, programi administratë komunale 253,904.54€, programin e arsimit 75,641.o1€ dhe në programin e shëndetësisë14,667.50€. Ndryshimi është në kodin e projektit të ndërtimit të Rr.”Xhemajl Mustafa”, janë larguar afër 25,000.oo€ ku janë vendos në komunali në fushën 25,641.00€ që janë vendos në komunali për arsim dhe në Drejtorinë e Shëndetësisë në kategorinë komunali janë 14,667.oo€, dhe për këtë vlerë buxhetore janë zvogëluar mjetet në projektin për ndërtimin e stacionit të udhëtarëve.*

2. **Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A**

**z.Fatlum Osmani,** Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave –DBF, theksoi, Ndërmarrja Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A, është një ndërmarrje e re dhe tani vetëm sa i ka zgjedhur organet e saj dhe ka marrë miratimin dhe është regjistruar në Ministrinë e Financave, është regjistruar në ARBK, i ka zgjedhë organet e saj drejtuese duke përfshi aksionarët, bordin dhe strukturat tjera, shefin ekzekutiv. Është në fazën e përgatitjes për fillimin e punëve si ndërmarrje publike mjete të cilat për punë do të kontraktohen nga ana e Komunës së Podujevës për kryerjen e punëve publike, kemi pasë kusht për themelimin e ndërmarrjes edhe një garancion fillestare financiare ku Komuna e Podujevës është e obliguar që të garantoj që do ta mbështes financiarisht për fillimin e veprimtarisë së kësaj ndërmarrje dhe në kuadër të kësaj ne propozojmë që për fillimin e punës së kësaj ndërmarrje të ndahen 30,000.oo€, subvencion dhe shpresojmë se do të jetë subvencioni i fundit për arsye se kjo ndërmarrje të hyrat dhe kapitalin e saj duhet ta sigurojë nga punët të cilat i kryen dhe të cilat do të paguhen nga ana e komunës së Podujevës apo edhe shërbimet tjera që mund t’i kryej edhe në sektorin privat.
**z.Artrit Mulliqi,** theksoi, në emër të grupit të këshilltarëve të LVV-së, e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës për subvencionimin e Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A në shumë 30,000.oo€.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë pikë por ndoshta do ishte e rrugës që këta aksionarët që i kemi zgjedh ne të na sjellin një raport për arsye se ne votuam

një propozim që këta aksionar të paguhen dhe dëshirojmë ta dimë se deri ku ka shkuar puna dhe me çfarë standardesh u vendos dhe me çfarë pagash. Nuk e kisha të qartë drejtor a ka qenë kusht me i nda këto 30,000.oo€, dhe a janë për paga këto mjete apo për diçka tjetër edhe pse unë e kam pa një tender që ka dal për blerjen e disa mjeteve të punës, këto mjete a janë për paga të atyre punëtorëve që janë pranuar a është si kusht me i pasë në llogari bankare.
**z.Bashkim Syla,** theksoi, edhe ne si grup e përkrahim propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko-Llapi" Sh.A.
**z.Burim Hasani,** theksoi, sa i përket pyetjes së kolegut z.Ekrem Rrahmani, ndërmarrja Eko Llapi është në fazën finale të punëve po ashtu edhe në bazë të çështjes së kompletimit të stafit jemi në fazën fillestare kurse sa i përket çështjes së dokumentimit ne së shpejti do të dalim me një raport përfundimtar lidhur me kërkesat kushtet, pajisjet dhe stafin që kanë qenë duke punuar deri më tani. Besoj se shumë shpejt do të dalim me një raport përfundimtar të cilin do ta prezantojmë këtu në kuvend, sa i përket mbështetjes me ndihmë financiare për ndërmarrjen Eko Llapi, unë do e kisha përkrahë por se di a duhet ta pyes zyrën ligjore se a kam të drejtë me përkrahë pasi që jemi aksionarë të ndërmarrjes dhe nuk e di a më lejohet ose jo.
**z.Naim Çunaku,** theksoi, kjo që e potencoi kolegu z.Ekrem Rrahmani po duket sikur është devijuar pak sa ne edhe dje në mbledhje të KPF-së, dhe shumë herë në këtë kuvend kemi shfaq shqetësimin tonë siç raportohet për të gjitha punët dhe raportet financiare periodike dhe raportet tjera ashtu është dashur të kemi raport nga të gjithë aksionarët në ndërmarrjet ku ne kemi aksionar dhe këtu ishte qëllimi i z.Ekrem Rrahmanit sa kuptova unë. Ne sot e kësaj dite nuk kemi pasë asnjëherë në këtë kuvend asnjë raport nga asnjë organizatë komunale dhe aty ku i kemi dërguar aksionarët dhe po kërkojmë marrjen e vendimeve për shpërblimin e tyre ata nuk e kanë pa të rrugës që të hartojnë një raport për të raportuar me ata që i kanë deleguar atje, në këtë rast kuvendin komunal.
**z.Fatlum Osmani,** Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave –DBF, theksoi, unë bëra përpjekje që në fillim t'i sqaroi disa çështje por z.Ekrem Rrahmani e ngriti një çështje lidhur me arsyen se ku do të përdoren këto mjete edhe se ndërmarrja ka një procedurë të prokurimit për furnizim me pajisje për fillimin e punës së ndërmarrjes, tash përpos pajisjeve për fillimin e punës së ndërmarrjes, ndërmarrja nga fillimi i aktiviteteve të saj bart me vete disa shpenzime operative që janë shpenzimet e naftës dhe shpenzimet tjera të cilat i bëjnë ato makineri, normalisht se këto mjete financiare në shumë 30,000.oo€ nuk kanë ndonjë destinim të caktuar për ça mund t'i përdor ndërmarrja por sigurisht se nevojiten për shpenzimet operative mirëpo edhe për pagat për stafin e saj por normalisht nuk mundet me gjeneru të hyra pa fillimin e punëve për punët të cilat kontraktohen nga ana e komunës dhe për fillimin e atyre punëve janë disa shpenzime operative që domosdoshmërisht nevojiten mjete financiare. Përtej kësaj edhe atë që e ceka në fillim ka qenë edhe garancion nga ana e komunës për themelimin e kësaj ndërmarrje që fillimisht ta mbështes me një kapital financiar për fillimin e veprimtarisë së saj.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, unë e potencova edhe në fillim që ne jemi për, por pasi që kolegu Burim Hasani tha se do të raportojmë por unë jam i interesuar ta di a ju ka nda ndonjë parcelë se ato mjete që kanë me i ble dikund duhet me i vendos, ne e dimë se kemi votuar këtu për një lokal që ata ta keni si zyre por për më shumë ne nuk dimë dhe për këtë aspekt unë thash që duhet të raportohet, ndoshta ky në seancën e radhës na jep më shumë sqarime. Ata është dashur ta kenë një vend se ka me qenë problem vendosja e atyre mjeteve që janë porositë dhe kur të vijnë ato mjete nuk them se nuk ka vend ku me i vendos ato mjete komuna por pse me marrë përgjegjësi kur ka mundësi me ua nda një vend ku është kjo kompania KRM Pastrimi, prandaj edhe kjo ndërmarrje është dashur ta ketë një garazh për pajisjet e saj sepse ato mjete janë të kushtueshme.

**z.Hilimi Hoxha, Kryesues i kuvendit,** theksoi, nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën urdhëroni nëse jo atëherë e vë në votim Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko-Llapi" Sh.A sipas propozimit të drejtorit të DBF-së.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 31 vota për, një votë kundër, asnjë votë të përmbajtur miratohet vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko-Llapi" Sh.A në shumë 30,000.oo€ për fillimin e e punës së kësaj ndërmarrje sipas propozimit të Drejtorit të DBF-së.*

**3. Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik pronat e Paluajtshme shoqërore nën menaxhimin e AKP-së, dhe atë; -në Zonën Kadastrale Dumnicë e Poshtme, për realizmin e projektit për ndërtimin e Tregut të Kafshëve, dhe - në Zonën Kadastrale Podujevë, për realizimin e projektit për ndërtimin e Tregut të Gjelbër.**

**z.Fatlum Osmani,** Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave –DBF, theksoi, bëhet fjalë për dy prona njëra është në zonën kadastrale Dumnicë e Poshtme ku momentalisht e ushtron aktivitetin tregu i kafshëve dhe në librat dhe regjistrat kadastral figuron se prona është e Agjencionit Kosovar të Privatizimit –AKP, rrjedhimisht tani ku është i vendosu stacioni i autobusëve planifikohet që të ndërtohet tregu i ri i gjelbër. Në mënyrë që të zhvillohen procedurat e shpronësimit nga ana e AKP-së, është obligim ligjor dhe procedural që këto prona nga ana e kuvendit komunal të shpallen në interes të përgjithshëm në emër të zbatimit të këtyre projekteve në mënyrë që pastaj të na hapë rrugë për fillimin e procedurave të shpronësimit nga ana e AKP-së, e kjo është shumë e dobishme për arsye se ne paguajmë vetëm 20% të vlerës së pronës e cila vlerësohet nga ana e Ministrisë së Financave.

**z.Ardi Hasani,** theksoi, LVV e mbështet Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik pronat e Paluajtshme shoqërore nën menaxhimin e AKP-së, dhe atë; në Zonën Kadastrale Dumnicë e Poshtme, për realizmin e projektit për ndërtimin e Tregut të Kafshëve, dhe në Zonën Kadastrale Podujevë, për realizimin e projektit për ndërtimin e Tregut të gjelbër.

**z.Valon Demolli,** theksoi, edhe ne grupi i këshilltarëve të LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim.

**z.Bashkim Syla,** theksoi, edhe ne grupi i këshilltarëve të PDK-së e përkrahim këtë propozim vendim.

**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, kam një lutje z. Kryesues nëse ka mundësi jo te prona sa i përket tregut të kafshëve por te prona te stacioni aktual i autobusëve pse nuk na e prezantoni në ekran pronën dhe të na jepni shpjegime se për cilën parcelë do të votohet e cilën jo se thuajse gjithë ne e dimë se është ajo parcelë aty e që dihet se ajo parcelë më parë ka pasë sipërfaqe më të madhe tash nuk e di a po votojmë ne për këtë ekzistuesen që është apo për atë parcelë që janë edhe dy shtëpi e për të cilat nuk e di a janë privatizuar a jo për këtë kisha dashur një shpjegim se çka po marrim e çka po shpallim në interes publik, këtë s'kemi mundur ose është e tjetër kujt, ose e ka fituar ose jo, sqarona pak.

**z.Hilimi Hoxha, Kryesues i kuvendit,** theksoi, nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni nëse jo atëherë e vë në votim Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik pronat e Paluajtshme shoqërore nën menaxhimin e AKP-së, dhe atë; -në Zonën Kadastrale Dumnicë e Poshtme, për realizmin e projektit për ndërtimin e Tregut të Kafshëve, dhe në Zonën Kadastrale Podujevë, për realizimin e projektit për ndërtimin e Tregut të Gjelbër.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 24 vota për, një votë kundër, asnjë votë të përmbajtur miratohet vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik pronat e Paluajtshme shoqërore nën menaxhimin e AKP-së, dhe atë; -në Zonën Kadastrale Dumnicë e Poshtme, për realizmin e projektit për ndërtimin e Tregut të Kafshëve, dhe në Zonën Kadastrale Podujevë, për realizimin e projektit për ndërtimin e Tregut të Gjelbër.*

**4. Propozim vendimi për shpallje në interes të përgjithshëm publik - objektet e ndërtuara në Parcelën me nr.P-71712062-02153-1, Zona Kadastrale Podujevë.**

**z.Avni Fetahu,** theksoi, para vetes keni një propozim vendimi për shpallje në interes të përgjithshëm publik - objektet e ndërtuara në Parcelën me nr.P-71712062-02153-1, Zona Kadastrale Podujevë, propozim ky që ka rrjedh nga DKA në koordinim me DPKGJ duke u mbështetur në planin zhvillimor të arsimit dhe politikat e Ministrisë së Arsimit për hapjen e çerdheve të reja si dhe mundësinë e ndërtimit të një çerdheje në parcelën nr.P-71712062-02153-1, Zona Kadastrale Podujevë, parcelë kjo përballë SHFMU “Xheladin Rekaliu”, e cila është pronë komunale por që objektet e ndërtuara në këtë parcelë janë pronë private. Të bashkëngjitur keni edhe fletën poseduese dhe kopjen e planit prandaj nga ju kërkoj që ta përkrahni këtë propozim vendim.
**znj.Qëndresa Hajrizi,** theksoi, duke pasur parasysh që qëllimi i shpalljes në interes të përgjithshëm publik i kësaj prone është për realizimin e projektit ndërtim i çerdhes ne si grup i LVV-së, e përkrahim këtë propozim vendim.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, drejtori e potencoi që janë dy objekte private, ne e dimë që ato janë privatizuar më herët në vitin 2017, dhe ky farë zakoni drejtori me vendos ku me u bë çerdhja po më duket pak si detyrë e rëndë, pse ky me vendos për çerdhe të fëmijëve tanë ku ka qejf ky, nuk jam kundër ndërtimit të çerdheve po nëse është në përfundim ndërtimi i çerdhes këtu te pishat, tjetra çerdhe “Armela”, dhe çerdhja te Shkolla teknike e ne në atë pjesën tjetër a nuk duhet me pasë çerdhe hiç as në Gllamnik, Lluzhan, Kryetar tërhiqi pak projektet në atë zonë. Pse nuk njoftohen ata njerëz që janë pronar të atyre objekteve aty, për njërin nuk e di sigurt a e din ose jo kurse tjetrin kam shkuar dhe e kam pyet dhe më ka thënë se nuk e din dhe më tha se në vitin 2017, e ka ble atë lokal dhe ka bë projekt për të ndërtuar aty dhe është më mirë me i njoftu më herët ata pronar ose me bë njoftimin për dëgjim publik e me i pyet qytetarët ku kemi nevojë për ndërtimin e një çerdheje. Të ndërtojmë çerdhe aty ku kemi nevojë se ai një shumë të parave e ka bllokuar për 5 ose 6 vite, e ka ble atë objekt, unë e di kur është në interes publik ai atë objekt duhet ta liroj dhe janë vlerësuesit që e vlerësojnë këtë dhe a është dëm për atë që i ka grumbulluar ato para për 7 vite aty, diqysh si në mënyrë arbitrare po veproni. Drejtori thotë unë e kam konstatuar se duhet të ndërtohet aty çerdhja dhe u krye kjo farë pune po duhet me qenë pak procesi më demokratik me mbajt ndonjë dëgjim publik dhe me i pyet qytetarët se ku kanë nevojë për ndërtimin e një çerdheje. Nëse doni të gjitha çerdhet po i bëjmë në qytet e neve që jetojmë në fshatra po rrimë e nuk po i dërgojmë fëmijët tanë në çerdhe hiç e po ju themi dilni nëpër lëndina luani.

**z.Mimoza Stublla,** theksoi edhe ne si grup i  këshilltarëve të PDK-së e përkrahim këtë propozim vendim.
**z.Artrit Mulliqi,** theksoi, sa i përket shqetësimit të kolegut z.Ekrem Rrahmani, unë vet vij nga ai lokalitet ku do të ndërtohet ajo çerdhe, në qoftë se ka një zonë më shumë banor që jetojnë më shumë se në atë zonë e këtë nuk e besoj se ka në rajon të Llapit. Në atë çerdhe përpos lagjeve të qytetit që përfshihen përfshihet edhe zona kah Surkishi se e shohë afër shkollës ku do të ndërtohet kjo çerdhe ka aq shumë nxënës ku edhe shkollave të qytetit mundet me ju bë rivalitet, prandaj mendoj se ajo është zonë adekuate për ndërtimin e një çerdheje që është shumë e nevojshme. Gjithashtu aty do të ndërtohet edhe rruga lidhëse kah market 'ETC-ja", kështu që ai është vend ideal për çerdhe.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, unë në fillim e thash e përkrahi këtë propozim dhe nuk thash që nuk duhet me u ndërtu çerdhja por nëse ai mendon se duhet aty me ndërtu ajo çerdhe unë mendoj se edhe kah ne duhet të ndërtohet një çerdhe sepse e drejta ime është e barabartë me të drejtën e tij. Në fillim e thash se përkrahim këtë dhe po e them prapë por mënyra se si vie deri këtu pa e pyet askënd nuk është në rregull sepse këtu nuk bëhet qysh them unë e Artriti, por jemi shumicë dhe duhet t'i pyesim pak edhe ata qytetarë të cilët na kanë votuar t'i ftojmë në një dëgjim publik e t'i marrim mendimet e tyre. Unë nuk them se nuk është e nevojshme ndërtimi i çerdhes aty se është afër shkolla dhe stacioni i autobusëve por duhet me pyet dikë se ku duhet ndërtohet ajo çerdhe sepse dyshoj se ka edhe interesa tjera por nuk po hy në atë temë.
**z.Avni Fetahu,** theksoi, sa i përket çështjes së vendosjes së çerdhes ajo dihet publikisht se drejtori nuk mundet të vendos për një parcelë të caktuar sa i për njoftimin e juaj në hartën zonale ajo pjesë është e përcaktuar për vendosjen e objekteve me qëllim arsimor të njëjtën kohë është kërkuar prej Ministrisë së Arsimit në lokalitetet ku ka dendësi të popullsisë e ju njoftoj që në procedurë të prokurimit është edhe çerdhja në Gllamnik prej çerdheve moderne që do të bëhet, po ashtu e potencuat edhe çerdhen në Lluzhan e ajo tashmë është funksionale. Është çerdhja në Kërpimeh që është në procedurë, në Zakut, do të shndërrohet  objekti që është shëndetësor, në të njëjtën kohë në Llaushë, Dumnicë dhe Bradash dhe në shumë lokalitete tjera që ndoshta për ju tjerët kanë qenë pak si ëndërr.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, e prita që do të filozofon por kjo do të, do të, do të..., i bie asgjë hiç, te ne i thonë asgjë, fol e asgjë hiç, ato do të, do të, do të, s'janë asgjë hiç,
**z.Avni Fetahu,** theksoi, për ty ato do të në "Tik Tok", funksionojnë mirë, besoj se po të funksionojnë mirë.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, kryesues unë e pata fjalën s'ka nevojë me ma ndërpre fjalën ai, unë e bëra edhe pyetjen tjetër që nuk u përgjigj ai kur e pyeta a ju ke treguar pronarëve që i kanë ble ato prona, a e meritojnë ata mos me ditë se për çfarë objekti të planifikuar bëhet fjalë aty, së paku ata duhet njoftuar që mos të investojnë më sepse kështu është planifikuar kaq.
**z.Naim Çunaku,** theksoi, vetëm desha ta përgëzoj drejtorin e DKA-së por më le pa e përgëzuar, aq mirë po na lexon dhe e ka zhvilluar telepatinë që po na i lexon edhe ëndrrat  dhe shumë mirë që po na i realizon ëndërrta, kjo më bëri të i them këto fjalë.
**z.Hilimi Hoxha, Kryesues i kuvendit,** theksoi, nëse dikush nga ju dëshiron ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni nëse jo atëherë e vë në votim Propozim vendimi për shpallje në interes të përgjithshëm publik - objektet e  ndërtuara në Parcelën me nr.P-71712062-02153-1, Zona Kadastrale Podujevë

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 26 vota për, një votë kundër, asnjë votë të përmbajtur miratohet vendimi për shpallje në interes të përgjithshëm publik - objektet e ndërtuara në Parcelën me nr.P-71712062-02153-1, Zona Kadastrale Podujevë.*

**5. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – mars 2024.**

**z.Fatlum Osmani,** Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave –DBF, theksoi, buxheti i planifikuar për vitin 2024, ka qenë 31,043,019.oo€, nga këto paga dhe mëditje 16,518,000.oo€, mallra 3,585,000.oo€, shpenzime komunale 513,000.oo€, subvencione 1,670,000.oo€, kapitale 8,756,000.oo€. Në tre mujorin e parë ka një progres të shpenzimeve në bazë të këtyre shumave, për paga dhe mëditje janë të shpenzuara 4,418,602.oo€, mallra dhe shërbime 438,896.oo€, për shpenzime komunale 118,233.oo€, për subvencione dhe transfere 220,813.oo€ dhe për investime kapitale 1,290,063.oo€. totali i shpenzimeve për periudhën janar- mars është 6,483,607.oo€, në raportin të cilin e keni marrë keni edhe shpenzimet sipas kodeve për periudhën janar – mars, kjo shuma totale është e shpërndarë edhe në kode të cilat janë shpenzuar gjithashtu janë të paraqitura edhe të hyrat të cilat janë realizuar për këtë periudhë në bazë të planifikimit të vitit 2024. Unë nuk po e zgjas më shumë në mënyrë që të kursejmë ndoshta edhe në kohë por çdo çështje e cila ju intereson në bazë të materialit të cilin e keni marrë jemi të gatshëm ta sqarojmë dhe diskutojmë.
**z.Xhevdet Maloku, t**heksoi, ne grupi i këshilltarëve të LVV-së në përgjithësi e vlerësojmë si pozitiv këtë raport megjithatë unë si asamblist kam disa paqartësi prandaj dua sqarime nga drejtori sa i përket shumës së kujdestarisë së punës gjatë natës dhe puna jashtë orarit që është një shumë më e madhe në krahasim me vitin e kaluar, gjithashtu kam një pyetje edhe për odat profesionale konkretisht në kod buxhetor çka përfshijnë po ashtu kam një lloj kritike për shpenzimet e udhëtimeve zyrtare brenda dhe jashtë vendit që janë më të larta në krahasim me vitin e kaluar. Një pyetja kam për kompensimin e përfaqësimit brenda vendit, pra dreka zyrtare pse është nda me një kod buxhetor në fund, a nuk është dashur të jetë edhe kjo bashkë me pjesën e parë.
**z.Qendrim Softolli,** theksoi, raportin financiar për muajit janar - mars 2024, po e diskutojmë në fund të muajit maj, kanë kaluar të gjitha afatet ligjore për këtë raport e kjo nuk është një gjë e re po mirë që e kemi tani se kanë mund mos me sjellë hiç. Një raport thuajse i njëjti me atë para tij me lëshimet apo manipulimet të njëjta me kode siç dinë këta me i paraqit, jemi në fillim të vitit dhe e dimë që te shpenzimet kapitale nuk kemi ndonjë shpenzim të buxhetit por edhe ato pagesa që janë bërë janë për projekte që janë përfunduar në vitin 2023, por ndoshta edhe të viti 2022. Po filloj me shpenzimet që lidhen me udhëtimet zyrtare, besoni kur e pash këtë raport thash mos ka ardhë gabim është i Ministrisë së Punëve të Jashtme, gjithë këto shpenzime për udhëtime jashtë vendit, është për ta analizuar mirë këtë raport, se çka jeni tu bë a jeni duke qit në dritë ndonjë gjë. Avans për udhëtime zyrtare 2,500.oo€, shpenzime zyrtare jashtë vendit 2,300.oo€, mëditje për udhëtime zyrtare jashtë vendit 660.oo€, akomodim për udhëtime zyrtare jashtë vendit 4,876.oo€, shpenzime tjera për udhëtime jashtë vendit 170.oo€, në total këto shpenzime arrijnë vlerën rreth 11,000.oo€. Zyrtarët e këtij ekzekutivi vetëm për tre muaj kanë arritur të shpenzojnë rreth 11,000.oo€, vetëm për udhëtime jashtë vendit, pastaj kemi një kod akomodim për udhëtime brenda vendit nuk po arrij të kuptoj se për ça bëhet fjalë është një vlerë 10,440.oo€. Manipulime me kode siç e ceka edhe më lartë po vazhdon të bëhet edhe me dreka zyrtare sipas raportit Free Balance, aty kemi rreth 11,600.oo€, që janë paguar në lokale të ndryshme të gastronomisë për dreka zyrtare, goxha të uritur s’ka që ju ngopë. Te të hyrat vetanake kemi një inkasim të dobët në krahasim me vitin paraprak por nëse e shikojmë planifikimin siç e kemi paraqitur në buxhet tatimi në pronë e pash një ulje rreth 60%, kurse tek tatimi në tokë edhe pse kemi të planifikuar një shumë

143,000.oo€, nuk e keni inkasuar asnjë cent. Te të hyrat vetanake kemi një inkasim më të dobët dhe besoj se drejtori do të na jap ndonjë sqarim rreth këtij trendi negativ, te kodi ndërtimi i rrugëve lokale kemi një shumë prej 500,000.oo€, për dallim nga viti 2023, ku në këtë periudhë i njëjti kod kishte vetëm 21,000.oo€, mendoj që janë pagesa të vitit paraprak. Mirëmbajtja e automjeteve po ashtu është një shumë prej 9,000.oo€, që është një shumë e lartë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, një kod interesant shtesa të veçanta për të zgjedhurit në një shumë më tepër se 10,000.oo€, për çfarë të zgjedhurish bëhet fjalë drejtor nëse mund të na sqarosh, shtesat për punën pa orar të paracaktuar 2,208.oo€, kurse tani është kodi tjetër 137,790.oo€, për pagesa për punë gjatë natës dhe jashtë orarit dhe kjo orari gjatë natës po e bënë diferencën. Ku është dallimi mes punës pa orar të paracaktuar dhe punës jashtë orarit s'po e kuptoj, tani është kodi tjetër ftesat tranzitore një kod që nuk po e kuptoj se për çka bëhet fjalë, për të gjitha këto besoj se drejtori do të na japë sqarime.

**z.Bashkim Syla,** theksoi, raporti financiar për tre muajt e parë të vitit 2024, është obligim ligjor i qeverisjes lokale, është ardhë me vonesë në kuvend dhe nuk është bë në mënyrën ma të mirë të mundshme, investimet kapitale nga 8,756,000.oo€, janë shpenzuar vetëm 1,290,000.oo€ që i bie afër 15% të shumës totale. Te renditja në tabelë kam menduar që në fillim drejtori i ka nda sa mjete kanë shkuar për paga dhe mëditje, për mallra dhe shërbime, për shpenzime komunale, për subvencione transfere dhe për investime kapitale, kam menduar që do t'i ndajë në rubrika të veçanta në mënyrë që me qenë sa më transparent mirëpo një gjë të tillë nuk e ka bë. Shpërndarja nëpër kode i ka marrë të gjitha bashkë dhe i ka nda ashtu siç tha parafolësi im në 3 ose 4 kode të njëjta dhe qëllimisht i ka nda shumat që mos me dal një shumë marramendëse dhe mendoj se ky është një gabim shumë i madh. Kemi pagat për vendimet gjyqësore 223,000.oo€ në një vend, ke shpenzimet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit në 3 ose 4 rubrika kështu që nuk e kam pritë se do të vije në këtë formë ky raport financiar, kam menduar se do të vij një raport më i mirë sepse është edhe në interesin e juaj, por a është bërë me qëllim për këtë Drejtori mund të na informoj. Avans për udhëtime zyrtare e ke marrë e ke vendos një në fillim e një në fund, shpenzime për vendime të gjykatave prapë një në fillim e një në fund, pastaj subvencione për etnitete jo publike 132,000.oo€ në një vend, 86,000.oo€ në një vend, kështu që realizmi i të hyrave nuk është në nivelin e planifikuara po edhe shpenzimi i investimeve kapitale është vetëm 15% sa i përket tre muajve të parë të vitit 2024.

**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, unë s'pajtohem me këtë raport pse me i fsheh gjërat këtu në raport shkruan dreka dhe darka zyrtare 1,160.oo€, në raport të Free Balance veç një darkë e fund vitit shkruan 7,800.oo€, pastaj disa iftare dhe dreka dhe kafe nëpër të gjitha kafiterit që janë pagesa 14,670.oo€, pse paguhen këto dreka, darka kafe dhe pije e shkojnë e ia ndërrojnë kodet herë shërbime e herë tjera dhe në fund janë darka e dreka zyrtare por për tre muaj të fillim vitit 14,670.oo€, restoranteve kjo është shumë. Këta ose s'po punojnë veç po rrinë nëpër restorante ose të shtunave dhe dielave po dalin në restorante dhe nuk po hanë bukë nëpër shtëpia kurrë ishit pas qenë të uritur me ardhë në pushtet me ndejtë nëpër restorante. Për tre muaj me i harxhuar 15,000.oo€ dreka dhe darka dhe në raport me t'i mbyllë sytë me 1,160.oo€, pse po i fshihni këto, janë raportet në Free Balance këto s'mund t'i fshihni edhe më është bë merak për këtë qiranë që kam bë pyetje edhe te raporti financiar i vitit 2023, por edhe tash pash shumë pagesa, qira Infrakos-it, le të del drejtori të na shpjegoi për çka me i pague ne hekurudhës qira a ka ndonjë objekt këtu që është duke e shfrytëzuar dikush e se di unë apo e paguajmë rrugën që është e shtruar në asfalt afër hekurudhës. Është mirë me na e shpjegua çfarë qiraje paguan Komuna e Podujevës për Infrakosin dhe a ka mundësi me ndal këtë pagesë për këtë qira nëse është e mundshme se treni nuk endet këndej dhe nuk është duke e shfrytëzuar askush atë hapësirë dhe nuk e kuptoj pse me

pagua ne qira për Infrakosin. Disa pagesa për subvencione që kanë qenë disa thirrje kah gjysma e vitit 2023, i pash se pagesat janë bë tani, këtu po na teprojnë para nuk po kemi ku t'i lëmë e këtu pse s'janë paguar këto subvencione kur kanë përfituar në atë kohe e mos me i lënë me i bë tash pagesat, pasi që kanë pasë para të mjaftueshme pse si kanë bë pagesat atëherë po tani.
**z.Fatlum Osmani,** Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave –DBF, theksoi, faleminderit për të gjitha diskutimet dhe çështjet që i shtruat do bëjë përpjekje maksimale se disa çështje prej asamblistëve të ndryshëm ndoshta u përsëriten e kjo është krejt normale mirëpo në formë të përmbledhur do të bëjmë përpjekje për t'i sqaruar. Pikë së pari raporti dhe kodet ekonomike i kemi diskutuar edhe herërave të kaluara se janë në bazë të planit kontabël të Ministrisë së Financave dhe shpenzimet bëhen në bazë të këtyre planeve kontabël dhe ka një ndryshim të planit kontabël nga viti 2023, në vitin 2024. Asamblisti z.Xhevdet Maloku i ceku disa çështje të cilat kanë të bëjnë me kujdestarinë dhe për punët jashtë orarit, dihet që kujdestaria kryesisht është kod ekonomik i cili është për punonjësit shëndetësor të cilët kanë kujdestarinë dhe për punën të cilën e kryejnë si kujdestari paguhen nga kodi ekonomik i cili është në kuadër të kategorisë së pagave për çështjen e kujdestarisë, njëkohësisht vlen edhe për punën jashtë orarit për stafin qoftë në sektorin e arsimit apo administratës. Sa i përket çështjes së odave shëndetësore që u cek do të thotë punonjësit shëndetësor e kanë për obligim që në kuadër të pagës së tyre e paguajnë një kuotë të cilët janë të anëtarësuar në odën shëndetësore dhe kjo merret nga paga e punonjësve të shëndetësisë. Te çështjet e udhëtimeve zyrtare dhe drekave zyrtare që u ceken këto lidhen edhe me planin kontabël, këtë vit që u fol edhe për fshehjen e shpenzimeve, Ministria e Financave nga plani kontabël e ka larguar kodin ekonomik dreka dhe darka zyrtare dhe të gjitha këto shpenzime buxhetore janë të paraqitura në akomoidim për udhëtime zyrtare brenda vendit. Kjo fatura të cilën edhe z.Ekrem Rrahmani e potencoi në lidhje me raportin e Free Balance dhe ne nuk fshehim asgjë dhe z.Ekrem Rrahmani është dëshmitarë i cili e ka kërkuar raportin dhe i është dërguar raporti me të gjitha shpenzimet për 3 muajt për të gjitha një nga një ashtu siç ia kemi përcjellë z.Ekrem Rrahmani pas kërkesës së tij për qasje në dokumentet publike prandaj po e përsërisë edhe njëherë ju mjafton një email dy rreshta ta dërgoni te zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente publike dhe të gjitha lëndët ne ua dërgojmë në mënyrë elektronike përmes emailit për dokumentet të cilat kërkohen nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe jo vetëm shpenzimet për këtë tre mujor por për çdo shpenzim dhe pagesë që ekzekutohet nga ana e DBF-së. Pjesë e kësaj është edhe pagesa e faturës ku ne të gjithë kemi qenë pjesë e darkës së fund vitit ajo pagesë normalisht është bë në fillim të vitit, kjo ka qenë një faturë që ka pasë një vlerë të madhe për arsye se jemi dëshmitarë që kanë qenë shumë persona në atë darkë të fund vitit. Free Balance për zotime financiare mbyllet në muajin nëntor, aktiviteti ka përfunduar në muajin dhjetor dhe rrjedhimisht ajo pagesë është dashur të kryhet në fillim të vitit 2024, kjo është arsyeja pse kjo vlerë financiare figuron kaq mirëpo edhe për çështjet e shpenzimeve të cilat ne besojmë se janë të gjitha të arsyeshme ju mundeni të kërkoni informacione se kush ka qenë pjesëmarrës në ato dreka zyrtare dhe sa është shpenzuar në ato dreka zyrtare dhe për shpenzimet e tjera. Te shpenzimet kapitale temë të cilën e ngritën disa asamblistë e në veçanti z.Qendrim Softolli dhe z.Bashkim Syla ku bëhet fjalë për shpenzime 1, 290,000.oo€, dihet që muajt janar, shkurt dhe mars nuk janë muaj ku ka shumë shpenzime të investimeve kapitale e kjo për shkak të kushteve atmosferike apo për arsye të procedurave të prokurimit që fillojnë në muajin janar dhe normalisht kontratat nuk janë të gatshme për ekzekutim në këtë periudhë. Bëhet fjalë për 650,000.oo€ që janë të shpenzuara për shpronësim përkatësisht bëhet fjalë për zonën industriale ku Komuna e Podujevës për 960,000.oo€ të cilat i kemi pasë obligim ndaj AKP-së, për shpronësimin e afër 30ha të cilët i kemi kryer për ndërtimin e zonës industriale, 250,000.oo€ i kemi paguar në vitin 2023, ndërsa 656,000.oo€, janë paguar në vitin 2024 në bazë të

marrëveshjes me AKP-në, dhe janë ekzekutuar në momentin kur është hapur sistemi i pagesave Free Balance, dhe janë disa çështje të tjera që kanë qenë disa kontrata dy vjeçare siç ka qenë ndërtimi i rrugës në fshatin Bellopojë, ka qenë kontratë dy vjeçare ku 30,000.oo€, kanë qenë të planifikuara në vitin 2023 dhe pjesa tjetër në vitin 2024. Operatori ekonomik e ka përfunduar punën në vitin 2023, dhe mjetet e disponuara në shumë 30,000.oo€, si shumë buxhetore është ekzekutuar dhe pjesa tjetër ka qenë e planifikuar në vitin 2024, në fillim të vitit fiskal 2024 ne e kemi kryer obligimin që ka rrjedhë si rezultat i rregullimit të rrugës në fshatin Bellopoj dhe kanë qenë disa mbetje tjera për shkak të këtyre kontratave dy vjeçare që operatorët e caktuar ekonomik kanë kryer punë përtej planifikimit financiar që ka qenë për vitin 2023 dhe ne s'kemi arrit ta mbulojmë financiarisht atë obligim dhe i kemi ekzekutuar në momentin kur është liruar buxheti i viti 2024. Një çështje të cilën e cekët në lidhje me të hyrat vetanake nga tatimi në pronë është e vërtetë që ka një rënje te programi i të hyrave vetanake te tatimi në pronë dhe kjo rezulton si rrjedhojë se ne si Kuvend Komunal dhe si ekzekutiv kemi propozuar që të falen 100€ të tatimit në pronë dhe kjo ka vlejte për të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës dhe ata që kanë kryer pagesën në vitin 2023, në mënyrë automatike iu ka fshi pagesa e vitit 2024, dhe normalisht kjo ka reflektuar se shumë qytetarë e kanë kryer obligimin dhe tani në vitin 2024 e kanë faturën e falur dhe normalisht nuk janë të obliguar ta paguajnë faturën dhe kjo është rrjedhojë e rënies së të hyrave të tatimit në pronë nga viti paraprak mirëpo kjo ka rezultuar te tremujori i parë. Në këtë periudhë ka një rritje të të hyrave vetanake është fjala tani për tre mujorin e dytë kjo për arsye se ne kemi shumë dallime që qytetarët kanë te tatimi në pronë do të thotë janë mbi 2,500,000.oo€, të cilat janë obligime të qytetarëve të faturave të tatimit në pronë dhe është mirë që është një vetëdijesim i qytetarëve që ato detyrime t'i përfundojnë, tani nga ana e Ministrisë së Financave kanë ardhë disa mekanizma për një mbledhje të detyrueshme por ne jemi të interesuar për një komunikim sa më të shëndoshë me qytetarët në mënyrë që me arrite marrëveshje me shkrim dhe nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes që ata t'i paguajnë me këste ju mundësohet edhe atyre që t'i ndalin ndalesat penale dhe interesat që janë si ndëshkues ndaj detyrimeve të tyre, do të thotë është në dobi të qytetareve që të vijnë e t'i nënshkruajnë ato marrëveshje dhe t'i bëjnë pagesat me këste. Shtesat tranzitore është përmend dhe bëhet fjalë për disa zyrtarë publik të cilët ligji i pagave ua ka zvogëluar pagat, faktikisht ata zyrtarë më të lartë e kanë pasë pagën para aprovimit të ligjit të pagave se sa që e kanë tani pagën në bazë të ligjit të pagave, për dy vite ata e kanë një shtesë tranzitore që nuk ua zvogëlon pagën në këto dy vite dhe kjo e ka një emërtim në listën e pagave si shtesë tranzitore që rrjedhon nga ligji i pagave. Asamblisti z.Ekrem Rrahmani shtroi pyetje për disa çështje dhe i kam mbete borxh t'i përgjigjem te raporti financiar i vitit 2023, për qiranë e Infa Kosit, të gjithë ne e dimë dhe qytetarët e Podujevës se ku gjindet "Parku i Mançesterit", ajo është pronë e Infra Kosit, dhe Infra Kosi ka marrë vendim që të gjitha pronat të cilat i ka t'i lëshoj me qira dhe për këtë ka bërë thirrje publike, në rasat se nuk ish marrë kjo pronë me qira nga Komuna e Podujevës ish krijuar rreziku që dikush do e kish privatizuar këtë pronë për të zhvilluar aktivitetet e tij dhe normalisht Komuna nuk ka kurrfarë kompetence që t'ia ndaloj këtë Infra Kosit dhe pastaj ai park nuk do ishte i Komunës së Podujevës dhe qytetarët kishin pas mundësi ta marrin në shfrytëzim atë hapësirë e ta zëmë të shesin në atë pjesë material ndërtimor dhe këtë s'do kishim mundësi t'ia ndalojmë pastaj. Besoj se është bërë një punë e mirë dhe ai park pa asnjë dyshim edhe në të ardhmen t'i takoj qytetarëve të Komunës së Podujevës dhe t'i shikojmë mundësitë që përmes procedurave të shpronësimit të bëhet kjo hapësirë pronë e Komunës së Podujevës, kemi pasë obligim edhe prej Organizatës së Mançesterit sepse aty janë duke u ndërtuar dy terrene sportive dhe pa marrëveshje me Infra Kosin nuk do kishte mundësi ndërtimi i tyre. Te pagesat për vendimet gjyqësore, këto pagesa fatkeqësisht po vazhdojnë sepse kanë të bëjnë me

kontratën kolektive dhe tani vazhdimisht po vijnë ë fatura në bazë të vendimeve të prera të gjykatave për ekzekutimin e tyre ku kryesisht mësimdhënësit i kanë fituar në gjykata të drejtat e tyre për çështjet e udhëtimit, drekave tash kanë filluar të vijnë edhe disa vendime që kanë të bëjnë edhe me kualifikimet dhe me disa punë shtesë të cilat i kanë bë që fatkeqësisht ne jemi para një situate ku ne si Komunë nuk mund të marrim asnjë veprim se ato janë vendime të gjykatave të cilat i ekzekuton thesari pa na pyet neve fare, vetëm na dërgon listën për kontrollim e cila është për ekzekutim, kaq kemi pyetjen prej thesarit. Bëra një përpjekje maksimale që të jem gjithëpërfshirës nëse ju kam mbet diçka borxh për sqarim jemi të gatshëm t'ju përgjigjem.

**z.Xhevdet Maloku,** theksoi, te kodi buxhetor 11431, nuk kërkova sqarime se çka nënkupton terminologjikisht kujdestaria e punës gjatë natës dhe punës jashtë orarit dhe nëse se kisha kuptuar këtë iu kisha drejtuar dikujt që e njeh gjuhën shqipe por fatmirësisht qëndroj mirë edhe vet, unë kërkova sqarime pse është kjo shumë kaq e lartë në krahasim me vitin e kaluar, a nuk ka pasë kujdestari gjatë natës vitin e kaluar apo si qëndron puna, apo s'ka pasë punë jashtë orarit këtë sqarim kërkova nga ju. Po ashtu kam edhe një pyetje te kodiu buxhetor 13480, shpenzime për anëtarësim që janë shtesë këtë vit në krahasim me vitin e kaluar pse janë këto, ku jemi anëtarësuar.

**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, drejtor më mbete borxh te një pyetje pse pagesat e subvencioneve të klubeve sportive që kanë fituar në gjysmën e vitit të kaluar janë vonuar dhe janë bë në këtë vit kur dihet se paratë po ju teprojnë.

**z.Qendrim Softolli,** theksoi, po ndalem edhe njëherë te kjo pjesa e drekave zyrtare, 10,440.oo€, janë paguar prej atij kodi akomodim brenda vendit për dreka zyrtare si dhe 11,000.oo€, për udhëtim jashtë vendit, kjo po na tregon se nuk jeni aq të kujdesshëm qysh na u keni paraqitur kur keni qenë në opozitë dhe qysh i keni mashtruar qytetarët se janë këtu një pjesë po nisem këtu prej shefit të grupit të këshilltarëve të LVV-së, z.Haki Rudari, sa kanë qenë në opozitë sytë dojshin me na i nxjerrë sa i përket këtyre shpenzimeve të pushteti të kaluar duke i quajtur të pa kujdesshëm e tani nuk i dëgjohet zëri, goxha parimor e kam njohur por nuk po del ashtu. Më fal vetëm te përfundoj pastaj je i lirë e merr fjalën, pra mos t'i mashtrojmë qytetarët po t'ju tregojmë direkt sa të uritur jeni për pushtet, për tre muaj rreth 21,000.oo€, ndoshta edhe më shumë janë shpenzuar veç për udhëtime e dreka zyrtare.

**z.Haki Rudari,** theksoi, fillimisht duhet të themi se kemi një raport financiar për muajt janar-mars 2024, dhe qëllimi i këtij raporti është të prezantohet një pasqyrë financiare e këtij tre mujori të vitit 2024, ne kemi një shumë mbi 6,483,607.oo€, të harxhuara në këtë tre mujor, pikërisht si shumë. Fillimisht unë do të them pse kaq pak nga investimet kapitale por sigurisht duke e kuptuar ndoshta edhe procedurat e prokurimit mund të ketë pengesa në atë drejtim, sa i përket shpenzimeve sipas kodeve janar-mars 2024, ka raste të rritjes së shpenzimeve por ka edhe raste të zvogëlimit të shpenzimeve në kode. Do të ndalem pak edhe te të hyrat vetanake për t'ju përgjigjur pyetjes së z.Qendrim Softollit, sa i përket të hyrave vetanake i kemi dy elemente ku kemi zvogëlim të të hyrave ashtu siç e ceku drejtori si pasojë e marrjes së vendimit nga ana e këtij kuvendi për faljen e borxheve të qytetarëve tanë deri në shumën 100€, po në të njëjtën kohë deri sa kemi zvogëlim të të hyrave vetanake mirëpo kemi rritje te të të hyrave te lejet e ndërtimit 18,998,oo€, kemi rritje 98,197.oo€, në njërën anë këtu kemi një rritje bukur të madhe kurse te të hyrat vetanake kemi zvogëlim por ky kuvend ka marrë një vendim që është në interes të qytetarëve. Sa i përket shefit të grupit të këshilltarëve të LVV-së, z.Qendrim Softolli, unë edhe kur isha në opozitë në vitin 2013, e tutje asnjëherë nuk i kam kundërshtuar shpenzimet që i ka bërë kuvendi i komunës, zyrtarët e LDK-së në atë kohë që ishin në pushtet kur ato mjete kanë shkuar për interesa të komunës, edhe ne kemi shkuar si grup në trajnime edhe si opozitë edhe kur kemi shkuar si grup në vizitë studimore kur ishim tash në pozitë dhe natyrisht çdo vizitë që bëhet jashtë vendit është e vetëdijshme që

kushton. Në parim nuk e kam kundërshtuar edhe atëherë, kemi koleg këtu që e dinë këtë por në të njëjtën kohë edhe tani kushdo që bënë vizita natyrisht se ato vizita bëhen në emër të komunës dhe ka shpenzime. Sa i përket aspekteve tjera unë mendoj që është detyrë e opozitës ta kryej rolin e vet konstruktiv por jo vetëm të thonë diçka por të njëjtën kohë edhe ne kemi qenë opozitë por kur ka qenë diçka e mirë për qytetarët natyrisht që e kemi përkrahë, për arsye se çdo investim që bëhet ai i mbetet qytetarëve partitë politike nuk i marrim me vete ato investime qoftë në objekte shkollore apo infrastrukturën rrugore, prandaj duhet gëzuar çdo investimi që bënë partia në pushtet dhe mbetet për të parë në zgjedhjet e ardhshme.
**z.Bashkim Syla,** theksoi, ne për këtë arsye po kritikojmë në mënyrën më të mirë të mundshme që me nxitë pushtetin me investue ma shumë, sa i përket raportimit është obligim ligjor të prezantohet raporti financiar çdo tre muaj, mirëpo edhe kur është ai raport i dobët duhet të themi se është i dobët, se investimet kapitale 1,290,000.oo€, me i zbrite 600,000.oo€ prej tyre në shpronësime po i bie dikund afër 7.5% , për tre muajt e vitit 2024, nëse i heqim edhe ato punët që i kanë kryer në vitin 2023, i bie 4% ose 5%, kështu që ky raport është i dobët sepse të mbesin 2,000,000.oo€ suficit. Ky diskutim po bëhet me qëllimin më të mirë me nxitë nivelin komunal që të punojë më mirë dhe të bëjë investime më të mira dhe kritika gjithmonë është e mirë.
**z.Qendrim Softolli,** theksoi, ne e dimë qysh ky raport financiar i ka kaluar gjitha afatet e parapara ligjore besoj se edhe drejtori e dinë këtë, sa i përket shpenzimeve për udhëtime jashtë vendit nuk e di qysh i arsyeton parafolësi 21,000.oo€ i kanë shpenzuar kurse 11,000.oo€ i ka shpenzuar kuvendi, nuk po bëjmë fjalë për shpenzime të kuvendit por për shpenzime të ekzekutivit, nëse don me emër e mbiemër t'i nxjerrë prej raportit të Free Balance, dhe t'i tregoj se ku kanë shkuar gjitha ato mjete edhe te lejet është normale te lejet pasi që harta zonale është miratuar dhe normalisht që tash realizohen projektet e ndërtimit.
**z.Fatlum Osmani,** Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave –DBF, theksoi, po bëj përpjekje edhe njëherë t'i jap disa sqarime sa i përket drekave dhe vizitave zyrtare dhe akomodimeve brenda vendit, ka një faturë që është afër 7,000.oo€, për drekën e fund vitit për të cilën jemi të informuar të gjithë dhe që është pjesë e figurimit të këtij raporti. Për drekat e kemi sqaruar edhe disa herë, për dreka zyrtare dhe akomodim ligji i prokurimit e përjashton nga procedura e tij, me ligjin e prokurimit publik ka disa aktivitete të cilat përjashtohen nga ligji i prokurimit, ka edhe disa shpenzime të udhëtimit zyrtarë që kanë ndodhë në fund të vitit 2023, e jo vetëm të këtij tre mujori. Zotimet e mjeteve financiare përmbyllen në muajin nëntor të vitit 2023, që janë në kategorinë e mallrave, çdo shpenzim që ndodh brenda nëntorit dhe iniciohet si shpenzim përjashtimisht kontratat kur i ke mjetet e zotuara dhe i ke të alokuara te X kontratat dhe X projektet pagesat duhet me i ekzekutu në fillim të vitit pasues i cili ekziston. Pyetje pat asamblisti z.Xhevdet Maloku te çështjet e punës së kujdestarisë, bëhet fjalë për kujdestaritë dhe punët jashtë orarit të stafit shëndetësor i cili punon edhe në kujdestari dhe këto bëhen në bazë të ligjit të pagave ku paguhen për orët shtesë. Te shpenzimet kapitale unë sot e potencova edhe më herët trendin si kanë rrjedhë këto 1,000,000.oo€, se dihet se tre muaj e parë të vitit nuk janë muaj që punohet për shkak të kushteve atmosferike qoftë për arsye procedurale një pjesë e madhe e këtyre shpenzimeve për hapësirat e brendshme janë për shpenzimet të cilat ua sqarova më herët.
**z.Hilmi Hoxha,** Kryesues i Kuvendit, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës debati përfundoj tani kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

## 6. Draft Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 – 2026

**Znj.Marigona Lahu,** Nënkryetare e Komunës, theksoi, të nderuar asamblistë para vetës keni Draft Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 – 2026, të Komunës së Podujevës, i cili mbështetet në një tërësi dokumentesh të rëndësishme ligjore dhe institucionale të cilat udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarë kombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejtë barazisë gjinore në Kosovë. Ky plan mbështetet në instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave kornizën ligjore dhe zhvillimore kombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizim e grave. Plani lokal i veprimit për barazi gjinore është një mjet praktik i legalizimit të dokumenteve të rëndësishme kombëtare por edhe ndërkombëtare në lidhje me barazinë gjinore, një dokument i hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, katër objektivat strategjike të këtij plani të barazisë gjinore janë; promovimi i të drejtave ekonomike, sociale të denjë si dhe fuqizimit të vajzave të reja dhe grave, zvogëlimi i pa barazive gjinore në arsim cilësor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës për të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë në gjithë diversitetin e tyre, promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në gjithë diversitetin e tyre si dhe promovimi i të drejtave seksuale dhe riprodhuese. Të dashur asamblistë unë ju ftoj që ta votoni këtë plan të barazisë gjinore.
**znj.Drita Pajaziti,** theksoi, rëndësia e Planit Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 – 2026, është shumë dimensionale dhe ndikon pozitivisht në shumë aspekte të jetës shoqërore, ekonomike dhe politike, një plan i veprimit për barazi gjinore është thelbësor për krijimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të barabartë, ai ndihmon në përmirësimin e jetës së gjithë banorëve duke siguruar që të gjithë zërat dhe nevojat të merren parasysh në zhvillimin dhe zbatimin e politikave lokale andaj në emër të grupit të këshilltarëve të LVV-së, e përkrahim këtë plan dhe apelojmë në drejtori që ky plan të zbatohet e mos të mbetet vetëm në letër.
**znj.Arnisa Sylejmani,** theksoi, në emër të grupit të këshilltarëve të LDK-së, e përkrahim Draft Planin Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 – 2026, nëse e shohim këtë plan e kuptojmë se reflekton kornizën kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe instrumentet ndërkombëtare për fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore. Në raport janë të përfshira edhe disa aktivitete të cilat shpresojmë se do realizohen dhe nuk do mbesin vetëm pjesë përbërëse e këtij raporti.
**znj.Mimoza Abdullahu,** theksoi, në emër të grupit të këshilltarëve të PDK-së, e përkrahim Draft Planin Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 – 2026.
**z.Ragip Fetahu,** theksoi, çdo draft plan që ndikon pozitivisht për jetën e përgjithshme të qytetarëve është i mirëseardhur dhe duhet të përkrahet mirëpo unë kam një vërejtje për këtë draft plan sepse nga akterët që e kanë shkruar këtë plan nuk është ftuar komiteti për barazi gjinore i themeluar nga Kuvendi Komunal i Podujevës dhe asnjë anëtar nuk ka marrë pjesë në hartimin e këtij draft plani që në një farë forme i bie anashkalim i kuvendarëve në hartimin e këtij draft plani të rëndësishëm të nivelit lokal.
**z.Hilmi Hoxha,** Kryesues i Kuvendit, theksoi, asamblisti z.Ragip Fetahu nuk paska qenë i informuar por këtë draft plan e ka bë një organizatë jo qeveritare së bashku me gjitha drejtoritë e komunës, por pse nuk e kanë ftuar z. Ragip Fetahun unë nuk e di por pa humbur kohë më shumë rreth diskutimit të kësaj pike e vë në votim Draft Planin Lokalt ë Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 – 2026.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 21 vota për, një votë kundër, asnjë votë të përmbajtur miratohet Draft Planin Lokalt ë Veprimit për Barazinë Gjinore 2024 – 2026.*

***Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 13:20__.***

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, i cili fillimisht konstatoi kuorumin ku prezent për momentin janë 22 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës.
Të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin anëtarët/et e Kuvendit, dhe atë:
Nga LDK, *Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; ndërsa munguan; Tringa Sfishta; Fahri Hasani.*
Nga LVV, *Florent Hasani; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokrri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori. Lirika Maliqi*
Nga PDK, *Bashkim Syla; Mimoza Abdullahu; ndërsa mungoi; Endritë Murati.*
Nga AAK, *Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.*
Nga OBKD, *Gazmend Islami i cili mungoi me arsyetim shëndetësor me shkrim dërguar Kryesuesit të Kuvendit.*
*Të pavarur; Adna Zymeri; Demokrat Hodolli munguan*

Të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës gjatë vazhdimit ishin drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;
*(Shuajb Blakçori-Drejtoria e Administratës DA;; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Leutrim Krasniqi-Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Vlora Humolli Jashanica-Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH; Alban Zeka-Drejtoria e Inspeksionit DI; Lirie Hoti-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE ndërsa mungoi Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ).;*

Gjithashtu të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin përfaqësues të mediave lokale (TV Llapi) dhe një numër i zyrtarëve komunal.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, vazhdojmë me mbledhjen aty ku kemi mbet në pikën e shtatë të rendit të ditës.

7. **Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB për vitin 2023**

**z.Avni Fetahu,** Drejtor i Drejtorisë së Arsimit –DKA, theksoi, para jush keni informatën për aktivitetet e KKSB-së për vitin 2023, është një përmbledhje e zgjeruar prej 83 faqesh, besoj se keni arritur ta shfletoni dhe jemi të hapur për çdo diskutim të mundshëm se çka ka ndodh në këtë periudhë kohore.
**z.Florent Hasani,** theksoi, në emër të grupit e përshëndesim informatën që është dërguar plani për siguri në bashkësi dhe inkurajojmë që të vazhdohet bashkëpunimi i organeve kompetente në këtë drejtim pasi që është në dobi të qytetarëve dhe është gjë primare.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, aty informatë nuk ka, këto janë procesverbalet ça ka ndodhë nëpër mbledhje e këto procesverbale janë të publikuara edhe në ueb faqe të komunës, unë informatë aty nuk pashë, jo 83 faqe por edhe 200 faqe me i bë aty informatë nuk ka. Këto që i keni sjellë në këtë material janë të publikuara, pra janë procesverbale nuk është informatë, madje asgjë s’kanë bë

vetëm kanë shkuar sa për të marrë një rrogë sepse asgjë s'ka funksionuar, nëse ka informatë unë s'di të lexoj sepse këtu unë informatë s'pashë.

**z.Avni Fetahu,** Drejtor i Drejtorisë së Arsimit –DKA, theksoi, informatat për KKSB-në, ndër vite janë ofruar në këtë formë po e shohë të arsyeshme t'ju tregoj që përveç anëtarëve që janë jashtë komunës që paguhen asnjëri prej anëtarëve që jemi ne nuk paguhet në këtë këshill të KKSB-së.

**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, është në rregull por këtu informatë nuk ka, këto janë procesverbale, këto procesverbale sa herë të publikohen në ueb faqe të komunës unë i përcjell përfshi edhe disa njoftime tjera në këtë ueb faqe, këtu vetëm i keni përmbledh ato procesverbale por informatë s'ka, nëse ka mundësi me na dhënë ndonjë informatë pasi që shkruan informatë kishe bë mirë, nëse jo vazhdo me procesverbale se po ec kështu dhe vazhdo.

**z.Hilimi Hoxha, Kryesues i kuvendit,** theksoi, nëse dëshiron dikush ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni nëse jo atëherë kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

**8. Propozim Plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB për vitin 2024.**

**z.Avni Fetahu,** Drejtor i Drejtorisë së Arsimit –DKA, theksoi, meqenëse jam emëruar si koordinator i këtij këshilli po e prezantoj në mungesë të kryetarit çështjen e këtij plani të mundshëm me aktivitete të cilat janë të planifikuara të realizohen për muajt e caktuar, kështu që pak a shumë ky plan, këtë kalendar të aktiviteteve të rregullta e keni secili para jush dhe uroj që ta votoni për të vazhduar edhe me aktivitetet që janë të planifikuara këtë vit.

**z.Fitim Muçolli,** theksoi, ne si grup e përkrahim këtë propozim plan të KKSB-së.

**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, nëse ka mundësi drejtori të na japë sqarime pse ka ndërruar ky plan në vitet 2022-2023, këtu e pashë tabelën dhe nuk pashë ndonjë plan përveç takimeve dhe asnjë pikë e planit s'ke, madje nuk ishin të planifikuara as aktivitetet brenda vitit edhe pse ky plan është shumë vonë, ky plan tash është dashur të miratohet për vitin 2025, e jo tani kur shkoj gjysma e vitit e ne po bëjmë plan për vitin 2024, deri tani nuk e di a kemi qenë fjetur ose çka ka ndodh prej muajit janar deri në fund të muajit maj.

**z.Hilimi Hoxha, Kryesues i kuvendit,** theksoi, nëse dëshiron dikush ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni nëse jo atëherë e vë në votim Planin e Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB për vitin 2024.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 16 vota për, dy vota kundër, asnjë votë të përmbajtur miratohet Planin e Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB për vitin 2024.*

**9. Raport i punës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, periudha janar-mars 2024**

**znj.Adelina Stublla,** Drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, theksoi, kjo pikë e rendit të ditës është sipas planit të punës së kuvendit në të cilën pikë është bërë një përmbledhje nga shërbimet që ofron QKMF-ja, projektet e iniciuara nga DSHMS-ja, shërbimet nga QPS-ja, shërbimet nga mirëqenia sociale, pra në QKMF kryhen shërbimet shëndetësore duke filluar nga emergjenca, shërbimi paliativ, stomatologjik, materniteti, specialistik, urologjik, ultrazë, mamografi, shërbimi shtëpiak apo paliativ shtëpiak për nëna dhe fëmijë, shërbimi nga

këshillimorja për diabet dhe hipertension, këshillimorja për planifikime familjare, shërbimet EKG-së, vaksinimit, mjekësisë familjare, infuzioneve, barnatorja tani punon me orar 12 orë në shërbim të pacienteve. Këtu vlen të theksohet puna që bëhet në terren përmes ambulantave të terrenit dhe 4 qendrave tjera përcjellëse, të gjitha këto të pajisura me aparatura dhe material të nevojshëm për shërbimet shëndetësore te qytetarët, duke i falënderuar gjithë punëtorët shëndetësor që bëjnë punën dhe angazhimin e tyre unë dua t'ju tregoj disa statistika të punëve të kryera gjatë këtij tre mujori, numri i vizitave të kryera në qendër dhe terren janë 38165 vizita që vlen të theksohet se janë 23669 vizita në qendër dhe 14496 vizita në terren. Numri i vizitave të shërbimeve të emergjencës janë 16718, numri i vizitave specialistike, pediatri, gjinekologji, epidemiologji 2176, pediatri 1401, gjinekologji 808 dhe epidemiologji 327 vizita pa dashur t'ju marrë khë rreth këtyre statistikave po kaloj te projektet të cilat janë iniciuar sipas kodeve buxhetore nëpërmes DSHMS-së, ku është realizuar projekti sistemi i menagjimit të radhës të pacientëve në QKMF i cili është mirëpritur shumë nga qytetarët, është realizuar projekti i furnizimit me pajisje mjekësore, është realizuar projekti i furnizimit me ID kartela të punëtorëve, është realizuar projekti i furnizimit me oksigjen me kontratë dy vjeçare, është realizuar projekti i mirëmbajtjes së laurës, furnizimi me kartela të hyrje daljeve të punëtorëve dhe furnizimet i tiketave për laurë. Kemi kontratë për furnizim me material për mirëmbajtje dhe kemi iniciuar procedura të reja për sigurimin e kontratës së re, është realizuar kontrata e realizmit dhe montimit të GPS për automjetet e QKMF-së, janë iniciuar procedurat për kontratë të re të servisimit të aparaturave laboratorike, radiologjike dhe stomatologjike. Janë iniciuar procedurat për kontratë të re për furnizim me barëra, material shpenzues, material stomatologjik, radiologjik dhe reagenca, janë iniciuar procedurat për projektin zgjerimi dhe izolimi i hapësirave të radiologjisë, janë iniciuar procedurat për projektin e renovimit në qendër dhe terren, është realizuar kontrata për furnizim me dokumentacione mjekësore, kontrata për material higjienik për nevoja të QKMF-së, që ndodhen ende në procedura të prokurimit. Kemi kontratë aktive të servisimit të automjeteve, larjen e automjeteve, mirëmbajtjen, nxemjen e klimave, mirëmbajtjen elektrike, furnizimin me çelës, furnizimin me derivate të automjeteve, DDD me kontratë tjetër pastaj me AQP-në dhe për të tjerat me kohë do të iniciohen procedurat e prokurimit në kontrata të reja. Sa i përket punës së sektorit të mirëqenies sociale për periudhën janar mars vlen të theksohet rasti me mjete financiare që janë ndihmuar 321 familje me probleme shëndetësore dhe me kushte të rënda ekonomike në vlerë prej 77,000.oo€, prej donacioneve janë ndihmuar 1050 familje me pako ushqimore dhe higjienike si dhe donator të ndrysh[m edhe organizata e shoqata humanitare, hapja e puseve me ujë të pijshëm nga shoqata e Katarit që është në shërbim të qytetarëve tanë për zgjedhjen e problemit me ujë të pijes ku kanë bë hapjen e 23 puseve për 23 familje. Sa i përket strehimit janë bërë 35 kërkesa për strehim ku këta janë strehuar dhe janë në proces të pritjes, sa i përket subvencioneve është bërë thirrja publike për OJQ-të në shumë 20,000.oo€, ndërsa për raportin e tre mujorit të parë të mirëqenies sociale në QPS, gjegjësisht në shërbimin social trajtohen raste të cilat ofrojnë shërbime sociale të drejtpërdrejta, dhuna në familje kemi trajtuar 26 raste të reja, fëmijë me aftësi të kufizuara kemi 9 raste të reja, gjithsej nën menaxhimin e rasteve sociale janë 135, shërbime me asistencë sociale kemi 641 përfitues të skemës sociale.

**z.Valon Demolli,** theksoi, raporti i fundit nga DSHMS-ja, nuk është asgjë më shumë se një mashtrim byrokratik që maskon dështimin tragjik në ofrimin e shërbimeve shëndetësore në Podujevë, përmendja e numrit të vizitave, statistika koti si tregues i suksesit është një tallje e hapur me gjithë ata qytetarët tanë që kanë nevojë për trajtime shëndetësore, e vërteta është se ky pushtet i mashtrimit nuk ka dele në terren për të inspektuar ambulantat në fshatra për muaj me radhë. Deri sa ne si opozitë kemi dalë dhe kemi pasqyruar gjendjen reale nga terreni, disa prej tyre janë

mbyllur përfundimisht duke lënë një peisazh shëndetësor të shkatërruar si pasojë e menaxhimit katastrofal. Për më tepër gjendja infrastrukturore në fshatra është alarmante dhe kërkon veprime të menjëhershme për përmirësim, është një dështim moral dhe profesional që banorët e fshatrave janë të privuar nga shërbimet bazike shëndetësore për shkak të keqqeverisjes dhe neglizhencës. Shërbimet e stomatologjisë janë një tjetër dështim i qartë me mungesë të vazhdueshme të shërbimeve bazike për qytetarët, laboratori i analizave është një shembull konkret i mos kujdesit ku mungon një biokimist dhe mostrat e analizave transferohen në AMF-në e Gllamnikut pa kushtet e përshtatshme duke rrezikuar jetën e pacientëve me rezultate të pa sakta. Ju keni infektuar çdo aspekt në QKMF, me nepotizëm dhe keq menaxhim duke e kthyer atë në një mjet për përfitime personale dhe propagandë politike ndërkohë qytetarët po vuajnë, qasja e juaj ndaj shëndetësisë është e tmerrshme. Podujeva po përjeton një eksod të rinisë së saj të zhgënjyer nga sistemi i cili i dënon ata nga një e ardhme e pa shpresë dhe meritokraci, kjo situatë është jo vetëm e pa pranueshme por edhe një dështim i qartë i detyrës suaj ndaj qytetarëve që ju kanë besuar të ardhmen e tyre. Raporti i juaj është një dëshmi e mos punës e një qeverisje të korruptuar nepotiste që ka braktisur përgjegjësitë e saj dhe duke vrapuar pas interesave personale.
**z.Ragip Fetahu,** theksoi, fjalimin tim po e filloj me një citat të librit politika si profesion të autorit Maks Veber, i cili thotë pjesa më e madhe e individëve të cilët merren me politikë e bëjnë për dy arsye, e para është për pushtet dhe e dyta për imazh. Më lejoni që të kthehem te informata e DSHMS-së, elementet e përmirësimit të kushteve siç janë ato në higjienë, infrastrukturë shëndetësore, shërbim, furnizim me barna dhe trajnime profesionale janë elemente që patjetër dëshmojnë një klimë pozitive në shëndetësi në komunën tonë. Përveç këtyre element shumë të rëndësishëm është edhe ndërtimi i emergjencës e cila do të ofroj kushte shumë më të mira si e stafit profesional dhe shërbime më të mira për qytetarët e komunës tonë dhe ajo që e bënë këtë punë mjaftë të suksesshme është edhe klinika të cilës i kemi jep dritën jeshile në seancën e fundit të kuvendit e cila u proklamua se kinse ne po e lëmë Podujevën pa spital mirëpo ne kemi bërë vetëm një klinikë të re për qytetarët e komunës tonë. Ndoshta aty ku ne duhet të punojmë më shumë është sektori i shërbimeve sociale, pra shërbimet sociale nënkuptojnë kujdesin ndaj çifteve të reja, kujdesi ndaj familjeve të reja të cilat për çiftet që kanë fëmijën e parë apo të dytin dhe atyre iu mungojnë informacionet se si ata të kujdesen për fëmijët e tyre, shtimi i punonjësve social, kujdesi më i theksuar për të moshuarit si dhe shtimi i psikologëve të cilët do të ndihmonin pozitivisht në trajtimin e fenomeneve negative në shoqërinë tonë e sidomos te gjeneratat e reja.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, shpenzimet të cilat i përmendi drejtoresha te raporti komplet përmendi shumë gjëra që janë në fazën e prokurimit, raporti ishte janar-mars, te raporti i Free Balance, këto shpenzime gjithkund janë zero te kodi mirëmbajtja e objekteve shëndetësore, shpenzimet janë zero, te kodi objektet shëndetësore shpenzimet janë zero, furnizimet mjekësore shpenzimet janë zero, pajisjet specialistike-mjekësore shpenzimet janë zero, furnizim me veshmbathje edhe këtu shpenzimet janë zero, këto janë në bazë të raporti Free Balance zero. Kam një pyetje për njërën prej auto ambulancave që është blerë vitin e kaluar pse ajo ende rrinë në garazh kurse operojnë me disa autoambulanca më të vjetra a ka ardhë ajo me ndonjë defekt apo jeni duke e ruajtur atë, pse nuk hyn në punë edhe ajo autoambulancë.
**z.Artrit Mulliqi,** theksoi, kur flasim për shëndetësinë sigurisht se ka vend çdo herë për më mirë, mirëpo për me ditë ku jemi është mirë të kthehemi pak mbrapa e të shikojmë ku jemi, unë i kam përgatitur dhjetë pika se ku kemi qenë, ka edhe më shumë por dhjetë i kam cekë si më kryesoret dhe ku jemi sot. Dallimin në kohën e qeverisjes së LDK-së dhe tani kur qeverisë LVV-ja, po filloj prej barnatores në QKMF, këto janë me fakte kush nuk beson mund të shkojmë së bashku t'i faktojmë këto që po i them, në kohën e LDK-së, barnatorja ka punuar nga dita e hënë deri të

premten me një ndërrim, 07;00-14;00, ndërrimi i paradites, kurse tani barnatorja punon me dy ndërrime edhe gjatë festave dhe vikendeve. Furnizimi me barna, ne e dimë shumë mirë që në kohën e LDK-së, nuk ka pasë as furnizim elementar me barna ku shpesh herë pacientët është dashur të dalin të blejnë sisteme, shiringa e kanila, kurse tani furnizimi është shumë më i mirë ku përpos gjërave elementare në barnatore ka edhe ceftriaksin, pantaprazol dhe furnizime tjera. Furnizimi me oksigjen në kohën e LDK-së ka pasë mungesë të theksuar të furnizimit me oksigjen, ku në dispozicion kanë qenë vetëm 7 boca e gjithashtu e dimë që gjatë kohës së pandemisë ka qenë nevoija shumë e madhe e oksigjenit, rezervat e QKMF-së, kanë qenë zero, tani kompania dhe operatorti i licencuar për furnizim me oksigjen përpos QKMF-së i furnizon edhe shërbimet në terren. Dhoma e infuzioneve, në kohën e LDK-së ka qenë një dhomë e infuzioneve me 4 shtretët ku në kohën e pandemisë covid-19, në të njëjtën dhomë kanë marrë infuzione pacientët e infektuar me covid-19 si dhe pacientët me sëmundje tjera. Një gjë shumë e rëndësishme është edhe shërbimi shtëpiak, në kohën e LDK-së nuk ka pasë shërbim shtëpiak, kurse tani kemi shërbim shtëpiak ku ky shërbim kryen rreth 1000 raste brenda një muaji ku me këtë rast edhe i falënderoj edhe ekipet e QKMF-së për punën që janë duke e bë, vizitat shtëpiake për nënat dhe fëmijët, në kohën e LDK-së, nuk ka pasë vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë kurse tani nga ky shërbim përfitojnë rreth 150 nëna dhe fëmijë në muaj. Mamografi në kohën e LDK-së, ka ekzistuar mirëpo ai ka qëndruar nëpër korridore të spitalit sepse nuk ka qenë i funksionalizuar asnjëherë përpos disa fotove që i kemi pa kur është pre shiriti, mirëpo mamografia aty nuk ka funksionuar dhe s'ka krye shërbim askush, kurse tani shërbimi i mamografisë bëhet falas dhe pa terminë. Radiologjia ose röntgeni, në kohën e LDK-së, shërbimi i radiologjisë ka punuar nga e hëna në të premten me një orar prej orës 07;00 – 14;00, kurse tani shërbimi i radiologjisë është në sispozicion nga ora 07;00 në mëngjes deri në ora 21;00, në mbrëmje edhe atë gjatë vikendit dhe festave. Laboratori në kohën e LDK-së, kemi pasur laborator vetëm brenda QKMF-së, dhe atë me një llojshmëri të vogël të analizave të punuara, kurse tani përpos rritjes së lloj llojshmërisë së analizave në QKMF, ka laborator edhe në Kërpimeh, Gllmanik e Orllan. Automjetet zyrtare, këtu te automjetet zyrtare është pak, në kohën e LDK-së ka qenë një veturë e kuqe që drejtori edhe specializimin e ka kryer me të, komplet specializimin gjatë njëfarë mandati e ka krye tash atë veturë nuk e shohë duke u shfrytëzuar as për nevoja të drejtorit e as të stafit por vetëm për pacientët, gjithashtu një fakt tjetër është emergjenca, në kohën e LDK-së, ka pas staf shumë më pak kurse tani në çdo ekip të emergjencës kemi nga dy mjek pesë infermier dhe dy vozitës plus dy infermier të infuzioneve. Ndryshimet vërehen dhe s'kam pse ta them po sa të hysh në oborr, oborri mbrapa ka qenë më shumë ka përngja në një otpad të mbeturinave kurse tash ka rregull, disiplinë dhe pastërti.
**z.Arjant Topanica,** theksoi, kjo fjala e kolegut posa e përfundoj nuk e di a është drejtori ky a drejtoresha që raportoi më herët sepse këtu tema është për raportin e një tre mujorshi të këti viti kalendarik e ky u kthye dhjetë ose pesëmbëdhjetë vite mbrapa duke fol dokrra këtu pa pikë rëndësie sepse ne po shohim tash e tutje çka po ndodh dhe po e analizojmë një raport tre mujor dhe jo të flasim këtu e të bëjmë krahasime me të kaluarën, ai foli diçka krejt jashtë temës dhe është pa sensë ti me fol e me u kthye e me krahasue me të kaluarën kur je i thirrur dhe mbanë përgjegjësi për pozitat dhe drejtorinë që udhëheq, jem duke folur për një raport tre mujor dhe diskutimi le të mbetet aty. Kjo është komplet pa sensë ça po folet dhe po shihet tendenca që gjithherë me sulmu LDK-në.
**z.Artrit Mulliqi,,** theksoi, vetëm desha t'i them kolegut që këto nuk janë dokrra por janë fakte të cilat mund t'i vërtetojmë kur të dëshiron, në qoftë se këtij i vjen turp prej të kaluarës së LDK-së, le të distancohet prej LDK-së, siç janë distancuar disa koleg tij në disa seanca më parë, gjithashtu edhe disa sot, kështu që atëherë nëse këtij i vjen turp le të dal i pavarur edhe ky dhe mos të lypë

vota për LDK-në, sepse ne e dimë që LDK-ja ka qeverisë 20 vite, mundet me pasë edhe tash ndonjë gabim mirëpo krahasuar me të kaluarën është jo mirë po super mirë.
**z.Arjant Topanica,** theksoi, mua nuk më vjen turp që jam pjesë e LDK-së, jam me shumë krenari edhe për të kaluarën dhe për të gjithë bëmat e LDK-së, se shteti nuk fillon prej 2020, por ka filluar shumë më herët dhe historia nuk fillon kurrë prej zeros por gjithherë ka shtylla baza dhe themele që i ndërtohen edhe shtetit,  komunës dhe vendit nuk ka pa gabime asnjë lloj qeverisje mirëpo unë jam krenar me të kaluarën dhe me atë se çfarë është bë deri më tani. Normalisht me kalimin e kohës gjërat vijnë duke u përmirësuar, rregullohen disa gjëra avancohen sistemet me ato mjete dhe buxhet e kjo është diçka tjetër dhe nuk do të thotë që gjithherë me investue në gjëra të njëjta por diçka u bë se nuk e kanë nisë këta prej zeros dhe nuk janë këta themelues të kësaj komune e as të institucioneve të saj e as të qeverisjes.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, respekt për kolegun që e përmendi 19 herë LDK-në, ai është rrit në LDK, ka punësuar familjar në LDK, por janë një dorë që cili pushtet vjen ata aty janë, tash i ka punësuar edhe të tjerët me këta këndej e i dhemb kjo, nuk e di unë pse del ky e kallëzon  LDK, LDK, LDK, kush ia përmendi këtij këto edhe s'ka nevojë dhe nuk e di pse hyri në atë temë, aty është rritë ky familjarët babain e ka pasë në LDK,  ka punësuar anëtar të familjes në LDK, tash ka punësuar tjerë në LVV edhe tjetri pushtet kur të vjen të garantoj me jetë se aty e ke me gjete se janë këta servilët gjithë në pushtet rrinë kurrë s'lëvizin, kurrë hiç, aty rrinë sa të është jeta kush të fiton aty i gjen në rend të parë madje çuditesh  kur i dëgjon duke thënë moti kam qenë po s'kam guxuar të kallëzoj.
**z.Artrit Mulliqi,** theksoi, i nderuari koleg z.Arjant Topanica në fjalimin tuaj patë kontradikta kështu s'po lëshohem më shumë hiç, s'po e komentoj edhe me qenë krenarë dhe mos me dashtë me ta përmend të kaluarën se di çka i thonë kësaj, kurse sa i përket fjalimit të kolegut Ekrem Rrahmani, i ka informatat komplet të gabuara po ia huq shpesh herë edhe sot ia huqi disa herë sa i përket punësimeve, në qoftë se flasim me emra për punësime është e vërtetë që e kam pas babain dhe nënën të punësuar prej viteve të 80 ta, tash do dalim edhe te punësimi i motrës e të gjithë me radhë, po dua vetëm një sqarim me bë kështu që vetëm të pa vërteta mos fol. Jam shumë i vetëdijshëm çka fola, në kohën e LDK-së, nëse babai dhe nëna ime kanë punuar ata nuk kanë mund ta lëshojnë punën në kohën e LDK-së, është e vërtetë se motra ime është punësuar në vitin 2019, gjithashtu është e vërtetë që e keni larguar një MSC prej pune për ta punësuar një me shkollë të mesme e këtë e keni zyrtare edhe nëpër portale dhe gazeta gjithkund kur janë bërë hulumtimet, kështu që kam me vazhdu me punësue por çdo herë sipas meritave e jo siç keni punësuar ju pa konkurse e pa shkollim adekuat.
**znj.Edona Shabani,** theksoi, drejtoreshë i përmende gjitha realizimet dhe desha të them që në QKMF, të realizohet edhe sjellja ndaj pacientëve, jo gjithmonë ballafaqohemi me atë që presim të shohim në QKMF, fatkeqësisht këtë e kisha edhe unë para disa javësh kur kisha nevojë për trajtim. Në QKMF unë u sprovova nga një sjellje arrogante të një të ashtuquajture doktoreshë duke pasë parasysh edhe shqetësimin tim mjekësor aq më pak e prisja një sjellje të tillë nga ajo, e cila më bëri me dije se çdo pacient që futet në spital po sjell sëmundje të ndryshme, duke e pa sjelljen e saj arrogante dhe shqetësimin tim mjekësor u detyrova të kërkoj dikën nga personeli të kujdeset për mua.  Në këtë moment situata u acarua deri në një pikë ku zonja në fjalë më lëshoj nga dhoma dhe më kërcënoi me thirrjen e policisë si duket ajo u ndie e nënvlerësuar dhe u soll siç nuk i ka hije një doktoreshe sidomos në QKMF, për një moment e pash që betimi i Hipokratit te disa individ nuk luan rol fare. Unë dhe të gjithë të pranishmit këtu e kemi dhënë një betim dhe kemi përgjegjësi më së shumti morale ndaj qytetarëve, drejtoreshë për këtë rast dikush duhet të japë përgjegjësi sepse besoj se unë jam një rast nga rastet e shumta që ballafaqohet me situatat e njëjta, uroj që unë të jem

rasti i fundit i kësaj pa përgjegjësie dhe sjelljes së pa hijshme kisha dashur që këto raste mos të ndodhin kurrë. Unë të gjitha i kuptoj ato që ndodhin por logjikisht drejtoresha ka për detyrë me rrit stafin dhe përgjegjësinë në QKMF dhe duhet me ju tregu se kushdo që punësohet me ju treguar se kryesorja është sjellja se mantila është fisnike.

**z.Ragip Fetahu,** theksoi, unë së pari po çuditem për këtë insistimin e juaj z. Kryesues që t'ju jepet sa më pak fjala anëtarëve të kuvendit e dihet se ky vend është i anëtarëve të kuvendit e nuk është ekzekutivit, ekzekutivi është këtu vetëm në rolin e llogaridhënësit në raport me neve, ajo që desha të shtoj është një plotësim të fjalimit tim të më hershëm duke pasë parasysh që kjo drejtori ka një volum shumë të madh të punëve që janë dy digastere të ndryshme si Drejtori e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale, pra kemi dy profile të ndryshme të bëra bashkë, është mirë që ne në një të ardhme të afërt si anëtar të Kuvendit të të gjitha subjekteve politike të shqyrtojmë statutin e komunës me mundësi që këto dy digastere të ndahen pra të themelohet edhe Drejtoria e Mirëqenies Sociale, me qëllim që qytetarëve tonë t'ju ofrohen kushte dhe shërbime më të mira nga ne.

**znj.Adelina Stublla,** Drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, theksoi, faleminderit për secilin nga ju, thuhet një fjalë se aty ku punohet edhe kritikohet kështu që më vjen mirë prej secilit që i dha vërejtjet, sugjerimet, kritikat, lëvdatat e të gjitha, mbi të gjitha i kam parasysh e besoj që në të ardhmen e afërt do t'i rregullojmë. Nga asamblisti z.Valon Demolli u përmend statistika koti, më vjen shumë keq që u shprehe kështu për shkak se në mesin e atyre punëtorëve që i kanë kryer gjitha ato shërbime shëndetësore janë edhe shokët dhe shoqet tuaja dhe qytetarët e këtij vendi dhe njëkohësisht edhe disa familjar tanë. Sa i përket punës së ambulantave në terren dhe mbylljen e tyre më vjen mirë që ju si opozitë jeni interesuar dhe keni dalë në terren dhe e keni vlerësuar gjendjen e tyre por vlen të theksohet rasti se shërbimi paliativ po i mbulon të gjitha zonat në terren dhe kështu nuk e shohim të arsyeshme për t'i mbajtur ambulantat hapur kur brenda një viti janë 5 shërbime shëndetësore ku dihet se me ata 5 pacientë ka kosto buxhetore për ta mbajtur hapur një ambulantë duke pasë parasysh mungesën e resurseve humane. U flit për punën e stomatologjisë, për shërbimet stomatologjike ku vlen të theksohet rasti se stomatologjia punon edhe në qendër edhe në Lluzhan, Orllan dhe Gllamnik, kurse sa i përket punës së shërbimeve stomatologjike të Kërpimehut ajo ka punuar edhe më herët. Sa i përket çështjes së laboratorit që veç se e ceke punën e bio kimistit të kam thënë edhe më herët edhe po ta them prapë se ne kemi hapur konkurs por nuk ka pasur të interesuar gjë që ne proceduralisht jemi në rregull por që nuk ka pasë të interesuar atëherë ne nuk kemi çka me bë. Sa i përket punës së analizave laboratorike që i theksove që i kemi bartë pa kushte kjo faktikisht nuk është e vërtetë ne kemi veturën e Ministrisë së Shëndetësisë, donacion që faktikisht është me frigoriferin e posaçëm që ne i kemi bartë mostrat e analizave për shkak të një defekti që faktikisht atij aparatit i ka munguar një pjesë që me intervenim të operatorit ekonomik është rregulluar, sa i përket nepotizmit nuk kisha dashur ta ceku por po më vjen keq që po e ceku prapë se kam respekt shumë për atë grua punëtore për nënën e asamblistes tuaj që faktikisht është pjesë e procesit të punës, kështu që i uroj fat dhe shumë suksese në punë. Kurse sa i përket çështjes që ceku asamblisti z.Ragip Fetahu ofrim të shërbimeve sociale ndaj familjeve të reja ne në QKMF, kemi këshillimoren që faktikisht aty jepen këshilla për parandalimin e shtatzënive të pa dëshirueshme, kurse te shërbimet sociale që veç i ceke atëherë për shërbimet sociale janë punëtorët socilal që atje punojnë kurse sa i përket punës së psikologut veç se jemi duke u marrë me këtë çështje për ta hapur një konkurs, kush do ta ketë tash fatin për të punuar si psikolog meqenëse ka nevojë jashtëzakonisht të madhe për punën e psikologut në QPS, ku tani po dihet puna e divorceve e mos ta them se tani është bërë trend. Sa i përket punës së shërbimeve për të moshuarit ne kemi shërbimin në kuadër të shërbimit paliativ që është shërbimi geriatrik që merret edhe me të moshuarit dhe ata që janë të vetmuar, kurse sa i

përket punës së kodit Free Balance që e ceku asamblisti z.Ekrem Rrahman i cili nuk qenka prezent këtu nuk po i përgjigjem hiç, sa i përket punës së autoambulancës që rrinë në garazh nuk është e vërtetë, të gjitha ambulancat janë në terren aty ku janë kërkesat dhe nevojat e qytetarëve, vlen të theksohet se janë 7 copë. Sa i përket punës punës së raportit tre mujor ky veç e bëri një krahasim se si ka qenë dhe si është tani kështu që unë s'kisha dashtë me zgjatë debatin më tepër e për t'ju marrë kohë më shumë, çka do që keni tjetër ju mirëpres.
**z.Valon Demolli,** theksoi, fillimisht e falënderoj drejtoreshën që i ceku gjitha ato që i thash unë që janë të sakta si transportin, mostrat dhe gjithçka tjetër që thash unë është e saktë, drejtoreshë e kam edhe një pyetje për ty para dy viteve në ligjin e ri e ke cituar këtu në kuvend nuk lejohet me qenë ushtrues detyre pas asaj drejtori i jashtëligjshëm i QKMF-së, është emëruar në atë pozitë sepse ju e keni pritur më shumë se dy vite për ta arritur stazhin e mjaftueshëm për ta vendosur në pozitën e drejtorit, tash ju pyes a jeni duke vepruar njësoi edhe për pozitën e kryeinfermierit, a jeni duke e pritur edhe atë për ta bërë stazhin e duhur për ta emëruar kryeinfermier apo ku qëndron problemi, drejtoreshë mendoj se duhet me pasë përgjegjësi për ligjin që është shkelur qe dy vite. Sa i përket punësimit të nënës së koleges po mundoheni pas saj t'i fshihni të gjitha ato punësimet e juaja, jeni duke u munduar vazhdimisht ta përmendi emrin e nënës së koleges dhe ju themi se ajo ka shumë vite që ka përvojë pune në atë institucion, pas nënës së koleges po fshehin kunata, reja të motrave dhe gjithë familjarët e juaj, nëse nëna e koleges nuk e ka merituar atë vend të punës pse e keni pranuar, pse s'po i përmendni punësimet e juaja, familjaret e juaja, përmendi të gjithë e mos e përmend nënën e koleges sonë edhe kjo nuk është hera e parë që përmendet nëna e koleges sonë në këtë kuvend. Ju po flisni për sjellje në QKMF po ju së pari e dini që Kryetari i juaj çfarë sjellje ka pasë në QKMF, kjo nuk është çështje tjetër, Kryetari i Komunës me ardhë me goditë një të moshuar në urgjencë nuk e di a donë koment kjo punë.
**znj.Adelina Stublla,** Drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, theksoi, më falë znj.Edonë Shabani se të mbeta borxh sa i përket sjelljes më vjen mirë që t'i faktikisht e ceke si problematikë për shkak se duhet me u marrë me këtë çështje më vjen keq që të ka ndodh kjo çështje që ka ardhë puna deri te policia, me keq ardhje për punën e doktoreshës ju them se do të merrem me këtë çështje meqenëse janë edhe kamerat dhe mundemi me zbulu si çështje. Sa i përket punës së çështjeve që the janë të vërteta dhe të sakta dhe ju përgëzoj për punën si opozitë dhe ju përgëzova edhe më herët se opozita këto punë i ka dhe vetë kam qenë opozitë dhe gjithherë kam dal në terren dhe kështu terreni flet e nuk mund t'i verifikosh punët nga zyra ashtu siç pasqyrohen nga puna e terrenit. Sa i përket punës së ushtruesit të detyrës që faktikisht veç po e cek ti nuk është puna që po e presim atë kryeinfermierin për me krye punën e stazhit kanë mbete këto gjana jo faktikisht që kemi harruar por është çështja që po merremi me çështje të tjera për rritjen e shërbimeve ndaj qytetarëve që faktikisht janë jashtëzakonisht të kënaqur me shërbimet që po iu ofrohen në QKMF dhe terren. Kurse për punën e çështjes së nepotizmit unë veç e ceka dhe i kërkoj falje koleges tuaj për punën që faktikisht e kam cek me gjithë respektin për punën që ajo e ka bë kaq kisha për të thënë.
**z.Hilimi Hoxha, Kryesues i kuvendit,** theksoi, nëse dëshiron dikush ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni nëse jo atëherë kalojmë në pikën e radhës së rendit të ditës.

## 10. Informatë e Drejtorisë së Bujqërisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

**znj.Lirie Hoti,** Drejtoreshë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural –DBPZHR, theksoi, kam kënaqësinë që sot para jush të kem rastin të japë informatën për DBPZHR, për punët dhe aktivitetet të cilat ne si drejtori jemi duke zhvilluar bashkarisht me ekipin me të cilën punojmë në këtë drejtori për vitin 2024. Sigurisht që gjatë kësaj informate sot unë do të mundohem t'i jap disa shpjegime në disa pika, qëllimet kryesore të politikave të cilat ne si drejtori i kemi për vitin 2024, pastaj objektivat e përgjithshme, fokuset e aktiviteteve të drejtorisë si dhe aktivitetet të cilat i kemi në proces ose i kemi realizuar deri në periudhën për të cilën ne po flasim e gjithashtu edhe për projektet të cilat i kemi në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – MBPZHR, deri në periudhën të cilën jemi sot. Unë po filloj me qëllimet kryesore të cilat ne kemi për këtë vit ku një ndër qëllimet kryesore është kalimi nga prodhimtaria në ferma të cilat plotësojnë nevojat e ekonomisë familjare në fermë gjysmë komerciale dhe atë komerciale, pastaj zbutja e papunësisë, varfërisë dhe përmirësimi i cilësisë së jetës për banorët e zonave rurale e kjo ne synojmë që të arrihet përmes projekteve të cilat ne i planifikojmë t'i zbatojmë si DBPZHR, për vitin 2024. Ndër objektivat më të rëndësishme për këtë vit është edukimi i vazhdueshëm dhe përcjellja e inovacioneve në sektorin e bujqësisë dhe atë të zhvillimit rural, forcimi i zinxhirit ushqimor, mbrojtja e kafshëve dhe menaxhimi i rrezikut në bujqësi, përfshirja sociale, zvogëlimi i varfërisë dhe zhvillimi ekonomik në viset rurale, mbështetja në riaktivizimin e fermerëve, plantacioneve bujqësore si dhe kapaciteteve përpunuese ushqimore në Komunën e Podujevës. Si fokuse kryesore që ne si drejtori i kemi për vitin 2024, janë këto fusha, fusha e pemëtarisë dhe pemët e imëta ku ne synojmë që në këtë fushë kemi sjellë edhe projekte që tani janë duke u implementuar si mjedër, dredhëz, manaferra, boronicë dhe aronia, ku në disa nga këto pemë të imëta ne veç se kemi sjellur projektet tani. Pastaj fushë tjetër e rëndësishme në të cilën ne do të fokusohemi është edhe e perimtarisë, blegtorisë, bletarisë, tani do të vazhdoj në pika të shkurtra t'ju njoftoj me disa prej projekteve që ne tashmë i kemi iniciuar ose janë në realizim deri në këtë periudhë. Siç e përmenda një prej fushave të rëndësishme që ne i kemi kushtuar vëmendje këtë vit është ajo e pemëtarisë ku ne veç kemi iniciuar procedurat për realizimin e këtyre projekteve, si projekt e kemi përkrahjen e fermerëve me fidanë të mjedrës ku ne kemi pasur një thirrje të hapur për aplikim të fermerëve me nga 1,100.oo€, me fidanë të mjedrës, në ketë thirrje që ka qenë e hapur deri më datë 29.03.2024, është bërë përzgjedhja, kanë aplikuar gjithsej 4 fermerë ku pas vlerësimit është publikuar edhe lista për fermerët përfitues që do të përkrahen me nga 1,100.oo€ për mbjelljen e fidanëve të mjedrës. Qëllimi kryesor i këtij projekti është ngritja e pemishteve moderne me mjedër e po ashtu edhe rritja e kapaciteteve prodhuese në sektorin e pemëve të imëta të cilat janë strategjike për komunën tonë. Projekt tjetër i rëndësishëm është ai për përkrahje të fermerëve me fidanë të feferonave, sigurisht që ky projekt tashmë është në fazën finale të përmbylljes pasi që është publikuar lista e fermerëve përfitues të këtij projekti, kjo thirrje ka qenë e hapur për 10 fermerë të cilët do të përkrahen me nga 500€, për mbjelljen e fidanëve të feferonave. Vlera maksimale e përkrahjes është me nga 500€, për një fermer përfitues dhe qëllimi kryesor është mbështetja e fermerëve në rritjen e sipërfaqeve të mbjellura me perimekulturë. Projekt tjetër në këtë fushë kemi edhe përkrahjen e fermerëve me fidanë të dredhëzës, sistem të ujitjes dhe foli, ky është një projekt i ri të cilin ne e kemi sjellë këtë vit me qëllim që t'i përkrahim fermerët në fushën e pemëve të imëta dhe ngritjen e kapaciteteve në këtë fushë, ka qenë një projekt i mirëpritur prej fermerëve. Thirrja ka qenë publike për përkrahje të 22 fermerëve me nga 1,500.oo€, vlerë monetare për mbjellje të fidanëve të dredhëzës me sistem të ujitjes dhe foli, qëllimi kryesor ka qenë ngritja e pemishteve moderne me dredhëz si dhe rritja e kapaciteteve prodhuese në sektorin e

pemëve të imëta, siç e ceka më parë janë një strategji për drejtorinë tonë për vitin 2024. Projekt tjetër të cilin ne e kemi iniciuar për të cilin ka qenë e hapur ftesa publike e cila tani është mbyllur dhe jemi në proces të vlerësimit është ai furnizimit dhe montimit të serave për fermerë, këtë vit DBPZHR, ka sjellë një risi sa i përket këtij projekti për shkak se kemi sjellë dy grupe të serave pas takimet me fermerë pra kemi sera me $50m^2$ dhe sera $500m^2$, me qëllimin e vetëm që t'ju ofrojmë mundësi të gjithë fermerëve të interesuar varësisht nga qëllimi dhe interesi i tyre në zhvillimin e kësaj fushe të aplikojnë dhe të përfshihen në projekt. Sa i përket serave $50m^2$, këtë vit kemi pasur thirrjen për 85 fermer , pra kemi 85 fermer përfitues për serat $50m^2$, po ashtu do të kemi edhe 35 fermerë përfitues me serat $500m^2$, ftesa publike ka qenë e hapur deri më datë 15.05.2024, ku veç është mbyllë ftesa publike dhe tani komisioni është në vlerësim të kërkesave ku pas vlerësimit të kërkesave nga ana e komisionit do të bëhet shpallja e listave përfituese. Qëllimi kryesor i këtij projekti është ngritja e kapaciteteve të kultivimit të perimeve në ambiente të mbyllura apo sera, projekt tjetër të cilin ne e kemi në plan ta realizojmë e për të cilin kemi filluar procedurat dhe jemi në fazën e procedurave të prokurimit është ai i përkrahjes së fermerëve me mekanizëm bujqësor. Ne si drejtori lidhur me këtë projekt kemi iniciuar tashmë procedurat dhe ky projekt është në faza të prokurimit, qëllimi i realizimit të këtij projekti është rritja e kapaciteteve prodhuese të kulturave bujqësore përmes përgatitjes më cilësore të tokës. Projekt tjetër deri në këta muaj ku po flasim e të cilin e kemi në fazat përfundimtare të realizmit është ai në fushën e blegtorisë ashtu siç e përmenda edhe kjo është një ndër fushat me interes të drejtorisë të cilën e përfaqësoj dhe është projekti i furnizimit me mëshqerra ku për këtë vit ne kemi paraparë në bazë të buxhetit të cilin e kemi pas të ndarë për këtë fushë të bëjmë përkrahjen e 154 fermerëve me mëshqerra bartëse. Për këtë projekt tashmë është mbyllë thirrja për aplikim, afati i aplikimit ka qenë deri më datë 24.04.2024, ku të gjithë fermerët që kanë plotësuar kushtet sipas thirrjes publike kanë pasë të drejtën e aplikimit, në këtë projekt tashmë jemi në fazat e vlerësimit, sot u njoftova nga komisioni që kanë filluar edhe punën e tyre në terren. Qëllimi kryesor i këtij projekti është mbështetja e fermerëve me avancimin dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese si dhe numrin e rritjes së gjedheve, sigurisht ne si DBPZHR, kemi edhe projekte tjera të planifikuara për t'i realizuar këtë vit, mirëpo këto janë faza të tjera do të thotë muajt në vijim do të fillojnë fazat e inicimit të tyre dhe nuk po ndalem të flas për këto projekte sepse do të flas në informatën e radhës që do ta kemi për drejtorinë tonë. Siç e përmenda edhe në fillim ne si drejtori kemi edhe bashkëpunimin tonë të ngushtë me MBPZHR-në, andaj edhe për periudhën për të cilën ne po flasim janë realizuara dy projekte të cilat kanë qenë të iniciuara nga MBPZHR-ja, siç është projekti për aplikim për pagesa direkte, për subvencionim për litër të qumështit, pra bëhet fjalë për periudhën e dytë të vitit 2023, ku ka qenë thirrja e hapur nga data 15.01.2024 deri më datë 13.02.2024, ku të gjithë fermerët kanë pasë të drejtën e aplikimit për subvencionim për litër të qumështit në bazë të cilësisë dhe klasit të përcaktuar me rregullore. Në Komunën e Podujevës sa kam informacion lidhur me këtë projekt kanë aplikuar 82 fermerë për subvencionim për pagesa direkte në ketë fushë dhe jam e informuar se këto aplikacione janë dorëzuar në ministri për shqyrtim dhe janë në procedura të shqyrtimit dhe miratimit. Projekt tjetër të cilin e patëm së voni është thirrja për aplikim për subvencionim me pagesa direkte për kulturat dhe aktivitetet bujqësore për vitin 2024, kjo mund të konsiderohet si një përkrahje e rëndësishme dhe veç se konsiderohet për të gjithë fermerët e të gjitha komunave sigurisht se ka qenë një intensitet i madh i punës në këtë periudhë, kjo thirrje ka qenë e hapur prej datës 13.03.2024, realisht deri më datë 24.05.2024, me zgjatjen e cila është bërë prej MBPZHR-së, me kërkesë të fermerëve ku gjatë kësaj periudhe gjithë fermerët kanë pasë të drejtën e tyre që të dorëzojnë aplikimet e tyre lidhur me subvencionimin e kultura të ndryshme bujqësore që ata i kultivojnë. Gjatë periudhës për të cilën ne po flasim i gjithë stafi i DBPZHR-së ka qenë duke punuar me

kapacitet të plotë duke përfshirë edhe punën e tyre jashtë orarit si dhe punën e tyre gjatë vikendeve për punën e bërë unë i përgëzoj publikisht gjithë zyrtarët e drejtorisë që unë e drejtoj dhe i falënderoj për korrektësinë të cilën e kanë treguar dhe vullnetin e tyre në punë. Aktivitete tjera që ne kemi realizuar deri në periudhën që po flasim janë edhe kërkesat për regjistrim të fermerëve pra pajisja me dokumente NIF, kërkesa për shndërrimin apo destinimin e tokave nga ajo bujqësore në tokë ndërtimore me ç ‘rast gjatë kësaj periudhe janë lëshuar 5 vendime për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, flas për periudhën deri në fund të muajit prill, pastaj kemi pasur kërkesa të ndryshme për subvencionim, vizita tek fermerët dhe kërkesa tjera për këshilla për fushat të cilat ne i përfaqësojmë. Po ashtu një informatë tjetër sa i përket sektorit të pylltarisë, sektori i pylltarisë që nga muaji janar i këtij viti përmes një memorandumi të bashkëpunimi në mes të MBPZHR dhe MAPL-së, si dhe Komunës së Podujevës, ka kaluar në kompetencat e Agjencionit Pyjor, edhe njëherë unë ju falënderoj juve për vëmendjen e juaj, në qoftë se unë kam harruar të përmend diçka në këtë raport ju ftoj që të shtroni pyetjet e juaja dhe do të jem e gatshëm që t’ju përgjigjem dhe sigurisht i përshëndes edhe njëherë të gjithë fermerët e Komunës së Podujevës dhe njëherit ju uroj një vit të begatshëm.
**znj.Sebastina Vokrri,** theksoi, parimisht ne e përkrahim këtë informatë, vetëm një pyetje shtesë kisha dashur t’ia bëj drejtoreshës, nëse ka informatë për procesin e ndarjes së mjeteve për bujqit ose fermerët Llapjan të dëmtuar nga vërshimet dhe fatkeqësitë tjera natyrore të vitit 2022, kur do të ekzekutohen mjetet.
**z.Arjant Topanica,** theksoi, është e vërtetë që fokusi im ka qenë i orientuar goxha shumë kah sektori i ekonomisë jo se vij nga ajo anë por në përgjithësi Podujeva me territorin që ka dhe kulturat bujqësore që prodhon ndër vite mendoj se këtij sektori duhet me i dhënë vëmendje edhe qeverisja lokale dhe ajo qendrore për zhvillim të bujqësisë për ta pasë një përkushtim të veçantë për këtë regjion për arsye se kemi shumë fermerë të zotë që mbjellin sipërfaqe të mëdha me kultura të ndryshme që japin rendimente të larta e për këtë arsye këtij sektori duhet kushtuar vëmendje e veçantë e me theks subvencioneve. Të gjithë e dimë çka mundet të bëjë DBPZHR për zhvillimin ekonomik të sektorit të bujqësisë e këtë mund ta bëjë përmes subvencionimit e për këtë arsye subvencionimit duhet t’i kushtohet një vëmendje shumë e lartë, së pari nga pikëpamja se ku po shkojnë këto subvencione a ka parregullsi, favorizime, keqpërdorime të këtyre subvencioneve dhe ku po shkojnë ato mjete me saktësi. Pastaj mendoj se duhet të krijohet një komision i cili vlerëson përdorimin e këtyre subvencioneve se e dimë që edhe në të kaluarën dhe tani që këto subvencione po keqpërdoren prandaj duhet të jetë një komision vlerësues për përdorimin e këtyre subvencioneve se a kanë shkuar ato subvencione te personat e duhur, po ashtu duhet të ketë një analizë të veçantë dhe të detajuar se çfarë efekti po gjenerojnë këto subvencione. Dihet qëllimi i subvencioneve është me i ndihmu bujkut, rrjedhimisht të stimuloj zhvillimin ekonomik në këtë rast përmes bujqësisë dhe nëse nuk e kemi një analizë sa bujq janë ndihmuar sa është zhvilluar sektori i bujqësisë dhe a duhet ta ngrisim nivelin e zhvillimit dhe në cilët sektor duhet të investojmë pa e pasë një analizë të veçantë mendoj se ia ulim vlerën dhe nuk i dërgojmë në vendin e duhur subvencionet dhe nuk arrijmë të nxjerrim më të mirën nga këto subvencione. Po ndërlidhem edhe te serat se kemi pasë shqetësime nga bujqit, për serat $50m^2$, ankesat e bujqve vazhdimisht janë se kujt i hyn në punë një serë $50m^2$, nuk e di çfarë kulture bujqësore duhet me kultivu në atë hapësirë për me pasë rendiment për këtë arsye kisha dashur që ta rishqyrtoj edhe njëherë ketë DBPZHR-ja, për efektin që krijojnë këto dhe a kanë efekt, sa kanë efekt, sa kanë interes qytetarët apo bujqit për këto lloj serash këtu ndërlidhet me atë me pa se çfarë efekti po krijojnë këto subvencione dhe a do e ndryshojmë politiken e tyre se si do të vazhdojmë e kështu me radhë. Dëmet i përmendi edhe kolegeje paraprakisht kemi pasë shumë interesim , kërkesa dhe ankesa nga bujqit për dëmet e vitit

2023, që nuk janë paguar edhe të janarit të vitit 2023, dhe qershorit të vitit 2023, në muajin qershor i kemi edhe ekonomitë familjare dhe bujqësore kurse në janar ekonomitë familjare janë paguar ndërsa ato bujqësore nuk janë paguar prandaj fermerët kanë kërkesa dhe dëshirojnë ta dinë për kohën e ekzekutimit të tyre për arsye se tani është fillimi sezones dhe investimeve në fushën e bujqësisë, ju duhen mjete dhe ju duhet mbështetje, kanë interes dhe kanë shpreh vazhdimisht kërkesat e tyre për kompensimin e dëmeve.

**z.Burim Hasani,** theksoi, sa i përket çështjes së koleges që i potencoi dëmtimet të cilat janë shkaktuar gjatë vitit 2023, në raport nga MBPZHR-ja, dhe një kërkese që ka ardhë për Komunën e Podujevës, DBPZHR e ka angazhuar dhe ka formuar një ekip vlerësues i cili ka bë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në kulturat bujqësore të vitit 2023, nga të reshurat që kanë ndodh gjatë kësaj periudhe, në dy periudha të ndryshme kohore në janar si dhe në muajt maj-qershor. Sa i përket të reshurave dhe dëmtimeve vlerësimet kanë qenë në bazë të ekonomive familjare po ashtu edhe në vlerësimet e dëmeve bujqësore te fermerët. Sa i përket çështjes së vlerësimit DBPZHR, në pik mëri me pikat të cilat i takojnë DBPZHR-së, e ka formuar komisionin i cili ka bërë vlerësimin e dëmeve dhe ju ka shkuar lista e gjithë fermerëve, po ashtu edhe e ekonomive familjare, sa i përket kësaj çështje kërkesa ka qenë edhe nga drejtorët më herët dhe nga drejtoresha e DBPZHR-së, lidhur me kërkesën sepse bujqit çdo herë kanë kërkesa në lidhje me kompensimin e dëmeve por ende nuk është kthyer ndonjë përgjigje zyrtare nga MBPZHR-ja, edhe pse DBPZHR-ja çdo herë ka qenë e angazhuar lidhur me kërkesat e fermerëve por kjo nuk është pjesë e DBPZHR-së, sepse kjo vetëm ka aprovuar kërkesat e fermerëve dhe ato lista i ka dërguar në MBPZHR, sa i përket pagesave DBPZHR-ja, se besoj se ka mundësi t'i bëjë këto kompensime sepse vlera e tyre është aq e madhe. Pyetja tjetër që desha t'i ndërhyj kolegut në lidhje me serat se a kanë efekt ose jo, efekti vërehet te kërkesa e fermerit e ajo a është e dëshirueshme për fermer ose jo tregon vetë fakti i kërkesave nga bujqit të cilët i parashtrojnë. Vitin e kaluar e kemi pasë edhe një projekt të DPZHE, por kemi pasë edhe projekte tjera nga DBPZHR, kemi pasë projekte të serave 300m$^2$, ku është dashur me përsëritë dy herë thirrjen publike për aplikim se nuk ka pasë interes të mjaftueshëm për sera të mëdha. Sa i përket serave të vogla 50m$^2$, në shumicën e rasteve kjo kërkesë vije nga ekonomitë familjare ku numri i kërkesave për serat 50m$^2$, është thuajse tejet i lartë.

**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, edhe unë kisha të njëjtën pyetje si kolegët e mi parafolës, ne normalisht se kërkojmë sqarime nga drejtoresha se neve na kanë sjellë këtu tërë dokumentacionin dhe listën e dëmeve të janarit dhe qershorit dhe duhet ta ketë një komunikim zyrtar DBPZHR-ja me MBPZHR-në, nuk është pyetja jo legjitime. Kurse që nuk ka inspektim të ndarjes së subvencioneve është e vërtetë, unë isha në vizitë te një fermer i cili disa herë më ka thënë pse s'po intervenon se po kam dëshirë ta marrë subvencion një lopë kur shkova në vizitë pashë se kishte dy copa lopë dhe i thash po ti i paske marrë dy copa lopë subvencion, ai më tregoj se ato dy lopë i kishte blerë prej përfituesve të projektit me mështqerra nga ana e Komunës së Podujevës e ai nuk ka përfituar por i ka blerë prej përfituesve të atij subvencioni, do të thotë po ndodh në Komunën e Podujevës kjo, jo prej të gjithëve se disa me të vërtetë kanë nevojë për këto subvencione por ka edhe asi matrapazësh që janë përfitues të mështqerrave e pastaj ato i shesin për përfitime të tyre.

**znj.Donjetë Sheqiri,** theksoi, kam një pyetje për drejtoreshën sa është rritur për këto vite përqindja e përfituesve të subvencioneve nga ana e gjinisë femërore dhe a jeni duke i vëzhguar për shkak se është shfaqur një praktikë jo e rrallë që në listat e përfituesve figurojnë gratë kurse faktikisht përfitues të atyre subvencioneve janë meshkuj. A jeni duke e bërë një lloj monitorimi për shkak se ne e dimë që i japim përparësi përfitueseve të gjinisë femërore mundësisht të na përgjigjeni në këtë pyetje.

**z.Valon Demolli,** theksoi, desha ta pyes drejtoreshën e DBPZHR-së, a ekziston te specifikat e shpërndarjes së mëshqerrave një term kur thotë kolegu z.Ragip Fetahu, një term që po e përdorin shoferët e Kryetarit të Komunës te shpërndarja e mëshqerrave, po e citoj si e thonë ata nëse dëshiron ta përfitosh mëshqerrën ma jep të voglin e saj, mirëpo shoferët e Kryetarit të Komunës, po ju thonë qytetarëve se ta nxjerrim lopën a ma jep viçin, nuk e di nuk e kam pa dikund në specifika të aplikimit, nuk e di a është e vërtetë drejtoreshë apo jo.
**z.Arjant Topanica,** theksoi, po kthehem te kolegu që foli pas meje unë nuk po e di a është zyrtar i DBPZHR-së, a jo se unë pyetjet i drejtova te drejtoresha e DBPZHR-së, e ai u mundua të përgjigjet dhe te serat tha a ka nevojë ose jo ne e shohim te aplikimet, normalisht kur komuna hap thirrje publike edhe 0.1ha me qenë sera dikush dëshiron ta marrë atë serë por efektet që krijohen pasi të jepet kjo serë dhe të futet në shfrytëzim se vetë bujqit po thonë nuk kemi çka të mbjellim në to dhe çfarë efekti krijojmë se janë të vogla, më mirë me pasë numër më të vogël të serave me sipërfaqe më të madhe këtë e thonë fermerët nuk e them unë se nuk jam kultivues, por përgjigjen desha ta marr nga drejtoresha dhe të shikoj ajo në të ardhme në këtë drejtim.
**z.Ragip Fetahu,** theksoi, e falënderoj drejtoreshën për informatën mirëpo unë dua që të bëjë edhe një plotësim nëse më lejohet ne e dimë faktin që mbi 70% e popullsisë e komunës tonë jeton në zonat rurale, po i referohem statistikave zyrtare të komunës dhe duke u bazuar në këtë kemi një numër të madh të banorëve të komunës tonë të cilët merren me blegtori dhe siç e dimë blegtoria është një sferë shumë e zhvilluar ose ka qenë një sferë shumë e zhvilluar tradicionalisht tek ne sepse vitalizohet dhe materializohet shumë lehtë dhe mbahet shumë lehtë dhe kisha sugjeruar drejtorinë që të fokusohet në këtë drejtim më tepër sepse është mirë që bujqit po furnizohen me mëshqerra dhe lopë, mirëpo po preken bujqit të cilët kanë të tilla dhe nuk po preken ato shtresat sociale të cilat nuk kanë mundësi ta blejnë një lopë, viç ose mëshqerrë dhe kjo nuk ndihmon shumë në zbutjen e këtyre pa barazive sociale tek ne. Çështja tjetër është bletaria e cila është një sferë shumë e zhvilluar viteve të fundit në komunën tonë pra kemi një numër jo të vogël të bletarëve të cilët merren me këtë aktivitet dhe në vazhdimësi dëgjoj ankesa nga ana e tyre sepse bletaria si sferë ka filluar pak të lihet anash nga DBPZHR, janë disa projekte që janë zhvilluar për t'i ndihmuar bletarët mirëpo ato projekte nuk janë kapitalizuar, nuk kanë përfunduar ose kanë dështuar, është mirë që drejtoresha të punoj më tepër në këtë drejtim dhe së bashku me bletarët të gjejë mënyrat më të mira që ata të ndihmohen.
**z.Xhevdet maloku,** theksoi, faleminderit drejtoreshë për informatën, duke parë këtu në informatë njërin nga qëllimet kryesore të politikave bujqësore që është kalimi nga prodhimtaria në ferma që plotësojnë nevojat e ekonomisë familjare, në ferma gjysmë komerciale dhe komerciale, pak më habiti fakti se si është hapur aplikimi për sera 500m$^2$ dhe 50m$^2$, kështu që nëse jemi duke dashur të kalojmë në ferma më të mëdha që plotësojnë nevoja më të mëdha se sa ekonomitë familjare nuk e di pse prapë është fokusi kryesor te këto fermat e vogla. Po ashtu po e shohë te objektivat e përgjithshme edukimi i vazhdueshëm dhe përcjellja e inovacioneve në sektorin e bujqësisë çfarë inovacionesh është duke përcjellë për momentin DBPZHR-ja dhe zyrtarët e saj në sektorin e bujqësisë duke pasë parasysh që si trend global mungesën e ujit të pijshëm është inovacioni i drejtuar kah efikasiteti i ujit të pijshëm a është duke u marrë ndonjë inovacion i tillë në Komunën e Podujevës nga ana e DBPZHR-së.
**znj.Lirie Hoti,** Drejtoreshë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural –DBPZHR, theksoi, sigurisht kjo që po paraqitni ju sot është interes i gjithë qytetarëve e në veçanti i fermerëve dhe po mundohem t'i përgjigjem secilit në pyetjet të cilat ju i ngritët, në qoftë se do ju mbetem borxh ndonjë gjë do t'ju dërgoj edhe informacione tjera shtesë lidhur me shqetësimet që keni ngritë edhe përmes emailit. Fillimisht po filloj nga pyetja e znj.Sebastina Vokrri, për shqetësimin të cilin

e ngriti lidhur me dëmet e shkaktuara nga vërshimet e vitit 2022, siç e dimë kjo temë është stërfolur e diskutuar edhe në këtë sallë ku jemi ne sot dhe nga të njëjtit persona që ndodhemi ne sot, unë jam personi i fundit që mund të flas ndoshta ose më kompetent lidhur me çështjen për shkak se unë e kam gjetur si çështje të përfunduar këtë e kam thënë dhe përmendur edhe herave tjera në një seancë të tillë të kuvendit është diskutuar edhe raporti me të gjeturat e komisionit të formuar nga ky kuvend dhe si rrjedhojë e saj kanë ardhë edhe konstatimet e tyre. Andaj konsideroji se ndaj një vendimi të cilin e ka refuzuar disa herë një organ më i lartë siç është MBPZHR, ndaj të cilit janë gjetur shkelje edhe nga ana e komisionit të krijuar nga ky kuvend komunal atëherë konsideroj që DBPZHR, nuk është më organ kompetent që të vendos se a duhet të bëhet pagesa e këtyre dëmeve a po jo, kështu që krejt ajo që unë mundem me shpreh ndaj fermerëve është keqardhje për rastin që ju ka ndodh edhe pse ne e dimë që ka pasë fermerë të involvuar të cilët kanë bërë shkelje po në këtë proces e këtë po e them në bazë të raporteve dhe arsyetimeve që kanë ardhë nga MBPZHR, më shumë lidhur me këtë çështje nuk konsideroj se jam kompetent të flas për shkak se nuk dua t'i hyjë në hak askujt, kaq kam unë informacion dhe kaq e konsideroj se jam kompetent të flas lidhur me këtë çështje. Lidhur me shqetësimet të cilat ngriti z.Arjant Topanica, e falënderoj për shkak se një prej këtyre pikave unë veç e ceka kur thash ne paraprakisht kemi pasë konsultime me fermer kur kemi vendosur për projektet të cilat do t'i realizojmë për vitin 2024, z.Arjant Topanica e ngriti çështjen se ku po shkojnë subvencionet dhe me i kushtu vëmendje se ku po ndahen subvencionet e pastaj se si po shfrytëzohen e çka po përfiton të them shoqëria, po në ketë kuptim ishte pyetje. Kjo është një pyetje shumë e mirë sepse lidhur me këtë çështje bashkarisht me kryetarin vitin e kaluar e kemi ngritur një komision i cili do të dalë në terren dhe do të verifikoj të gjitha rastet që ne ju kemi japë subvencione. Unë nuk jam kompetent të flasë për periudhën për të cilën unë nuk kam qenë, kështu që atë periudhë fare nuk po e diskutojmë, nuk mund të them ose ta mohoj që nuk ka pasë të tilla keqpërdorime sepse s'kam qenë në atë periudhë, unë uroj mos të ketë pasë por prapë nuk është faji i zyrtarëve, kjo duhet të mbetet në ndërgjegjen e fermerëve dhe gjithsesi si shoqëri duhet të vetëdijesohemi që ky subvencion po jepet me qëllim të kontribimit te familjet përfituese njëherit e pastaj në shoqëri, Pas ngritjes së komisionit janë iniciuar dy raste në gjykatë për ata përfitues që kanë bërë keqpërdorim me subvencione, kjo periudhë e punës së komisionit në terren për verifikimin e rasteve është pauzuar për periudhën që kishim të ngarkuar me pagesa direkte pasi që i gjithë stafi ka qenë i angazhuar për pagesat direkte kurse tani nga java e ardhme ne do të dalim në terren dhe do i verifikojmë sërish këto raste deri të arrijmë në një shkallë të kënaqshme të vetëdijesimit të qytetarëve që subvencionet që i marrin nuk duhet t'i keqpërdorin por të përdoren për nevojat që ju jepen. Shfrytëzoj rastin nga ky vend që t'ju bëj thirrje të gjithë fermerëve nëse dinë një rast të tillë të vijnë e ta lajmërojnë në DBPZHR, po edhe njëherit gjithë fermerëve përfitues subvencionet të cilat i marrin t'i përdorin për qëllimet që ato po jepen, lidhur me analizën që u përmend se çfarë efekti po gjenerojnë këto subvencione, sigurisht që edhe kjo ka qenë një pikë të cilën e kam vendosur në listën e projekteve të cilat do t'i bëj gjatë këtij viti. Këtë kemi qenë duke e diskutuar edhe me zyrtarët e drejtorisë, madje propozova që këto vizitat që po i bëjmë po i përdorim edhe në aspektin që të shohim se si kanë kontribuar në të ardhurat e asaj familje por edhe efektin që kanë pasë. Sa i përket serave $50m^2$, pse janë ndarë dhe cili është interesi unë e përmenda që paraprakisht ne kemi pasur një ftesë publike në takim me fermerët për të diskutuar këtu në sallën e kuvendit komunal për të diskutuar për kërkesat e tyre dhe sigurisht se pa qenë një kërkesë prej fermerëve ne nuk do të kishim vendos këtë si projekt, ka qenë një interesim i madh e sidomos i fermerëve gra dhe qëllimi i ndarjes së serave $50m^2$, është përkrahja e ekonomive familjare apo i ndihmës për nevojat e asaj familje, pastaj përkrahjen siç e përmendi edhe z.Xhevdet Maloku, kemi serat 5 ari me të cilat ne synojmë që të bëhet kalimi në

ferma komerciale dhe gjysmë komerciale. Kaq konsideroj se ishte përgjigjja për z.Arjant Topanica, nëse u përgjigja në të gjitha pyetjet, znj.Donjetë Sheqiri pyeti se sa është rritur përqindja e përfitueseve gra në tri vitet e fundit me një shifër të saktë Donjetë do t'ju përgjigjem në ditët në vijim, mirëpo mund të them nga këto që kam pa deri në periudhën e sotit konsideroj se ka një rritje të interesit për gratë fermerë dhe kjo na gëzon bashkarisht të gjithëve, tash pse dikush po përfiton në emër të grave nuk është diçka që kemi ne në kompetencë ne konsiderojmë se një subvencion po i dedikohet atij personi që ka aplikuar dhe i ka plotësuar kushtet dhe kriteret sipas thirrjes së publikuar dhe nuk kemi ndonjë mekanizëm që mundemi ta kontrollojmë por konsiderojmë se nuk ka keqpërdorime të tilla. Asamblisti z.Ekrem Rrahmani pyeti se a kemi komunikim me zyrtarët e MBPZHR-së, sigurisht se ne kemi komunikim për çështje të cilat ne kemi pyetje apo paqartësitë tona dhe kemi një komunikim të shëndosh të themi apo raport me institucionin për të cilin po flasim siç e dimë është edhe një organ më i lartë se drejtoria jonë. Unë veç se e ceka më herët se përfituesit e fermerëve janë duke u monitoruar dhe po përgjigjem edhe njëherë në këtë pyetje që është e njëjtë të cilën e parashtruan z.Arjant Topanica dhe z.Ekrem Rrahmani, nuk e di për periudhën që nuk isha drejtoreshë e drejtorisë mirëpo për këtë periudhë ju njoftoj se është duke u bërë monitorimi i tyre. Sa i përket pyetjes së z.Valon Demollit për specifikat i them se ato janë publike dhe nuk kisha hasur një specifikë të tillë në ftesën publike, kjo është bë sipas kritereve dhe specifikave të përcaktuara sipas rregullores në fuqi sigurisht që edhe ky projekt është bë në konsultim me fermerët dhe pasi ne kemi analizuar se ky projekt i ndihmon fermerët dhe të gjitha projektet që i ngrisim ne si DBPZHR, ajo nuk bëhet për ta dëmtuar fermerin por për ta ndihmuar atë. Sa i përket bletarisë që u cek se ka filluar të lihet anash nuk është e konsideroj se kemi diçka të tillë madje për vitin 2024, kam theksuar edhe në takimin me bletar që kemi po thuajse projektin më me prioritet për DBPZHR-në dhe jemi duke punuar në këtë aspekt mirëpo projektet do të vijnë gjatë vitit dhe do të flasim pastaj edhe informatën tjetër. Asamblisti z.Xhevdet Maloku, pyeti sërish pse janë serrat e vogla 50m$^2$, unë më doket se për këtë pyetje u përgjigja edhe më heret kur u bë pyetja nga kolegët paraprak, kështu që përgjigjja është e njëjtë dhe inovacionet patjetër jemi duke i përcjell inovacionet dhe sigurisht këto janë vetëm projekte të realizuara për tre mujorin e parë të vitit e ne do të vazhdojmë me projekte deri në dhjetor.
**z.Ragip Fetahu,** theksoi, veç një sqarim të vogël unë nuk ju pyeta drejtoreshë për kushtet e ndarjes së mëshqerrave mirëpo thjeshtë unë kërkova nga ju dhe e bëra një krahasim me blegtorinë që duhet investim më pak dhe e zbutë më shumë kohezionin social, kurse mëshqerrat kushtojnë shumë më shumë dhe janë ato kriteret të cilat për fat të keq nuk po shkojnë te ajo kategori sociale që përnjëmend ka nevojë dhe nuk ka asnjë lopë ose diçka të tillë për këtë arsye unë ndërhyra dhe sugjerova që është mirë që ju t'i fokusoni politikat më tepër te blegtoria se kushton më pak dhe ka impakt më të madh social.
**znj.Lirie Hoti,** Drejtoreshë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural –DBPZHR, theksoi, ju kërkoj ndjesë që paskam keqkuptuar pyetjen tuaj jo me qëllim atëherë sa i përket pyetjes që ju prapë e ngritët ne nuk mund të bëjmë diskriminime të themi të tilla unë e thashë edhe njëherë dhe po e ri përsërisë çdo projekt i iniciuar i cili zhvillohet në DBPZHR, është paraprakisht në konsultim publik me fermerët, vazhdimisht mbajmë konsultime dhe takime me ta e sigurisht edhe analiza nga ekspertë e zyrtarë të cilët janë të angazhuar në këtë drejtori dhe gjithçka që ne sjellim e sjellim në bazë të nevojave të fermerëve por prapë sërish të falënderoj për këshillën.
**z.Shpejtim Bulliqi,** Kryetar i Komunës, theksoi, unë vetëm një lutje kam publike për asamblistin e respektuar z.Valon Demolli, sepse e dëgjova që shoferët e mi po kërkojnë favore për mëshqerra, dëgjoni asamblistë të respektuar nëse keni më të voglën dëshmi kjo është edhe në interesin e juaj por edhe në interesin tim si Kryetar Komune por edhe në interes të të gjithë neve, nëse keni më të

voglin fakt për manipulim tillë ose kërkesa tilla ju lutem shumë më depononi një dëshmi. Dëgjomëni mua jemi shumë transparent nëse keni më të voglën dëshmi për keqpërdorim të këtyre subvencioneve ju lutem shumë ejani se jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me ju dhe ta marrim barrën e përgjegjësisë që t'i zhdukim këto dukuri nëse ka, unë nuk dyshoj që ka e nëse bëhet pyetja a ka shkuar ndonjë prej subvencioneve në adresë të gabuar atë mund ta pranojmë sepse kemi filluar procedura gjyqësore për keqpërdoruesit eventual të mëshqerrave sepse kemi shembuj që i kanë shit për të arrit për t'i zbuluar këta unë kam kërkuar nga DBPZHR-ja, prej drejtoreshës që të formohet një komision për verifikimin e tyre dhe a kemi rast të keqpërdorimit të subvencionimit me mëshqerra, nëse dëgjojmë rast se ka keqpërdorim dhe nuk janë në destinacionin ku janë marrë ne prapë për ta do bëjmë kallëzim penal dhe le të merret gjykata me ta.
Kjo ka ndodh do të ndodh sepse nuk jemi të interesuar të shkojnë huç mundi dhe puna që po e bëjmë për t'i ndihmuar njerëzit meritor që dëshirojnë të punojnë dhe të rrisin produktivitetin e tyre.
**z.Hilimi Hoxha, Kryesues i kuvendit,** theksoi, besoj se për këtë pikë të rendit të ditës përfundoj debati, u dhanë shumë përgjigje nga ana e drejtoreshës dhe besoj se edhe drejtoresha dhe të gjithë ne jemi të interesuar që të punohet edhe më mirë dhe pa humbur kohë më shumë kalojmë në pikën e radhës së rendit të ditës.

**11.Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1274-0, ZK Llapashticë e Epërme.**

**11.1.** ***Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim***

**z.Avni Fetahu,** Drejtor i Drejtorisë së Arsimit –DKA, theksoi, në mungesë të drejtorit të DBF-së po e propozoj vendimin për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1274-0, ZK Llapashticë e Epërme, bashkangjitur e keni materialin dhe kopjen e planit dhe në të njëjtën kohë kërkohet edhe propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim ku prej ekzekutivi propozojmë z.Shuajb Blakçori, dhe znj.Lirie Hoti, kurse prej shoqërisë civile kemi vetëm një aplikues ku bëhet fjalë për z.Shqipdon Rushiti, ndërsa mbetet nga grupet e asamblesë komunale të propozojnë anëtarët e kuvendit për ta kompletuar komisionin.
**z.Bahri Blakçori,** theksoi, në emër të grupit të këshilltarëve të LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim ndërsa për anëtar të komisionit vlerësues nga radhët e LVV-së, propozojmë z.Florent Hasani.
**z.Valon Demolli,** theksoi, edhe ne si grup e përkrahim këtë propozim vendim dhe nga LDK-ja, anëtar të komisionit vlerësues e propozojmë z.Arjant Topanica.
**z.Hilimi Hoxha, Kryesues i kuvendit,** theksoi, tani kemi të propozuar 5 emra që të jenë anëtar të komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1274-0, ZK Llapashticë e Epërme dhe atë; Shuajb Blakçori, Lirie Hoti, Florent Hasani, Arjant Topanica, Shqipdon Rushiti, së pari e vë në votim propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1274-0, ZK Llapashticë e Epërme.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 26 vota për, asnjë votë kundër, asnjë votë të përmbajtur miratohet Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1274-0, ZK Llapashticë e Epërme.*

**z.Hilimi Hoxha, Kryesues i kuvendit,** theksoi, sa i përket propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim kemi të propozuar 5 emra që të jenë anëtar të komisionit vlerësues dhe atë Shuajb Blakçori anëtar nga ekzekutivi, Lirie Hoti, anëtare nga ekzekutivi, Florent Hasani, anëtar nga kuvendi, Arjant Topanica, anëtar nga kuvendi, Shqipdon Rushiti, anëtar nga sektori jo qeveritar lokal, pa humbur kohë më shumë edhe këtë pikë të rendit të ditës sipas propozimeve të lartcekura e vë në votim.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 25 vota për, asnjë votë kundër, asnjë votë të përmbajtur miratohet Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim në këtë përbërje;*
*Shuajb Blakçori, anëtar nga ekzekutivi i komunës*
*Lirie Hoti, anëtare nga ekzekutivi i komunës*
*Florent Hasani, anëtar nga kuvendi i komunës*
*Arjant Topanica anëtar nga kuvendi i komunës*
*Shqipdon Rushiti, anëtar nga sektori jo qeveritar lokal.*

**12. Raporti i komisionit për vlerësimin e gjendjes dhe konstatimin e shkallës së rrezikshmërisë së objektit të ndërtuar në periudhën e viteve 1982-1985 me destinim "Shtëpi të Kulturës".**

**z.Leutrim Krasniqi,** Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes së Mjedisit – DPUMM, theksoi, para jush keni raportin e komisionit për vlerësimin e gjendjes dhe konstatimin e shkallës së rrezikshmërisë së objektit të ndërtuar në periudhën e viteve 1982-1985 me destinim "Shtëpi të Kulturës", në thelb ky raport nënkupton nxjerrje e një vendimi nga ana e juaj për hapat e më tejshëm që duhet ndërmarr bazuar në atë që objekti pronësi publike dhe si i tillë kuvendi i komunës ka përgjegjësi dhe kompetencë për këtë gjë. Arsyeja pse kemi sjellë një raport të tillë para jush është lirimi i hapësirës – parcelës dhe hapja e rrugës për investime tjera në interes publik, parcela ka hapësirë më të madhe afërsisht mbi 52 ari mirëpo sipërfaqja mbi 20 ari është e lirë dhe si e tillë sipas HZK-së, mund të shërbej për investime të projekteve publike arsimore, shëndetësore, kulturore. Nga raporti i komisionit kuptojmë që objekti nuk ka përfunduar asnjëherë dhe komisioni rekomandon që objekti të rrënohet për shkak të dëmtimit përgjatë kohës i cili edhe nuk mund të rinovohet, bazuar në të gjitha këto që ceka vendimi mbetet te ju dhe si i tillë i definuar vetëm për pronën publike.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, nuk e di ça lexoj drejtori por këtu por këtu vendim s'ka, nëse ka dikush në dokumenta vendim, këtu ka veç raport të komisionit dhe normalisht nëse e ke ngritë ti komisionin ai komision të raporton ty si drejtori pse të na raportoj neve e këtu që thua vendimin e keni për obligim këtu në këto dokumente s'po shohë, është vetëm raport që kanë dalë disa që s'kanë ide për atë punë, vetëm e kanë prek me gisht objektin dhe ia ka bë röntgenin dhe e ka sjellë raportin këtu, unë vendim për rrënim të objektit këtu s'po shohë, ti po thua por unë s'po shohë, nëse e sheh dikush jemi në rregull vazhdo.

**z.Shpejtim Bulliqi,** Kryetar i Komunës, theksoi, arsyeja pse dola ta marrë fjalën është fakti i një çështje që të gjithë ne e dimë lidhur me ecurinë e situatës së një objekti i cili për afërsisht ka filluar së ndërtuari dikund para 50 viteve dhe i cili fatkeqësisht tash e 24 vite pas luftës askush nuk është marrë për t'i dhënë kahje procesit të atij objekti i cili ka mbete si gërmadhë në sheshin e qytetit të Podujevës. Unë e di që shumë nga ju asamblistë që jeni këtu pak ose shumë e dini ecurinë e këtij procesi që lidhet me objektin në fjalë por mund të ketë edhe të tillë që se dinë por jam shumë i bindur që qytetarët e Llapit edhe sot e kësaj dite nuk e dinë problemin pse ky objekt ka ngecë tash e 50 vite dhe nuk ka ecë ky proces përpara, nuk po flas për kohën e para luftës, po flasë për periudhën 24 vjeçare të pasë luftës. Për hir të opinionit publik qytetarëve të Llapit që nuk e dinë këtë çështje sepse një pjesë e asamblistëve këtu e dinë ecurinë e kësaj çështje po i bëjë disa të dhëna publike të cilat besoj se për herë të parë po diskutohen në këtë kuvend sepse në njëfarë forme janë mbajte mbyllur tani e 24 vite si kutia e Pnadorës dhe ne tani më e kemi guximin të ballafaqohemi edhe me probleme të tilla dhe nëse më pyesni pse e keni guximin e kemi guximin se nuk jemi pjesë e gjitha atyre proceseve nëpër të cilat ka kaluar historiku i këtij objekti. Për opinionin publik por edhe për ata që nuk e dinë unë kam kërkuar një historik të kësaj prone nga zyra e avokatit të komunës e cila më ka sjellë një raport dhe unë pata dëshirë që ai vet të vij e të prezantoj këtë para jush por më than që nuk është mirë avokati të bëjë kronologjinë e kësaj çështje dhe e detyrova zyrtarisht ta përgatisë këtë raport me shkrim të të gjitha problemeve që kanë ndodh me këtë objekt që ta prezantoj para jush. Më datë 30.06.2006, në ish Gjykatën Komunale në Podujevë, tani Gjykata Themelore Dega në Podujevë, paditësit XXX, kanë parashtruar padi për vërtetim pronësie për ngastrën 554, 555, 556 fleta poseduese nr.203, ZK Podujevë, bëhet fjalë për pronësinë në të cilën një pjesë e këtij objekti është ndërtuar. Çka ka ndodh me këtë pronësi nëpër cilat etapa të më hershme ka kaluar në vitet e 80-ta kur është marrë vendimi për ndërtimin e këtij objekti unë nuk e di dhe nuk jam kompetent ta di së fundi, është administrata komunale që është dashur këto gjëra t'i përcjell, se a i ka përcjellë nuk e di. Me aktgjykimin nr122/2006, të datës 01.07.2007, gjykata refuzon padinë e paditësit si të pa bazuar që do të thotë përkundër që kanë bë padi gjykata në vitin 2007, ia refuzon padinë, kundër këtij aktgjykimi paditësi paraqet ankesë në ish Gjykatën e Qarkut, tani Gjykata e Apelit e cila aktvendimin Ac. Nr. 821/2007, të datës 22.10.2008 e aprovon ankesën e paditësve dhe lënda kthehet në rigjykim për ato parcela. Në rigjykim Gjykata Komunale në Podujevë me aktgjykim cnr.879/2008 të datës 24.02.2010, e aprovon padinë e paditësve si të bazuar duke ua njohur të drejtën e pronësisë, që do të thotë gjykata jonë këtyre paditësve që nuk po ua ceku emrat e të gjithë e dimë se kush janë po për hir të opinionit nuk po i cekim, gjykata ua ka aprovuar të drejtën e pronësisë dhe u ka njohur të drejtën e pronësisë me një sipërfaqe përafërsisht 13 ari. Kundër këtij aktgjykimi ish përfaqësuesja e komunës ka parashtrua ankesë në ish Gjykatën e Qarkut në Prishtinë e cila me aktgjykimin AC.490/2010, të datës, 31.01.2011, e aprovon ankesën e komunës dhe e ndryshon aktgjykimin cnr. 879/2008 dhe e refuzon si të pa bazuar padinë e paditësve. Tani paditësit prapë kthehen kundër aktgjykimit Ac.nr. 490/2010, parashtrojnë revizion në Gjykatën Supreme e cila me aktgjykim revizionin nr 50/2001, të datës 21.11.2012, e pranon revizionin e paditësve duke e ndryshuar aktgjykimin Ac.490/2010 ashtu që mbetet në fuqi aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Podujevë cnr.879/2008 i datës 24.02.2010, që ua njeh të drejtën këtyre pronarëve aktual të cilët pronën e kanë në dokumentacionin e tyre, me të cilin është pranuar si i bazuar kërkesë padia e paditësve dhe i cili është bërë i plotfuqishëm më datë 22.11.2012. Kjo është për mua por nëse ju duhet një kopje si asamblistë ua japë për ta ditur kronologjinë e këtij procesi, ça ka ndodhë, më datën 05.02.2013, kemi parashtrua kërkesë për mbrojtje të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë kundër aktgjykimit revizion nr.50/2011, të datës 22.11.2012, në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, e cila me

aktvendim për pranueshmëri KAL/13 të datës 13.03.2013, e ka hedhur poshtë kërkesën si të pa pranueshme dhe pjesa tjetër paditësit, kreditorët kanë parashtruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë dega në Podujevë, datë 01.10.2013, propozim për përmbarim për lirimin dhe dorëzimin e paluajtshmërisë nga njerëzit dhe sendet mirëpo Gjykata Themelore Prishtinë dega Podujevë me aktvendim cp.nr.440/2013 e ka refuzuar propozimin e kreditorit si të pa bazuar kundër aktvendimit të lartcekur kreditorët kanë bërë ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës e cila me aktvendim AC.3239/2014, e refuzon ankesën e kreditorit dhe e vërteton aktvendimin cp.nr.440/2013. Tash këto janë vendime të proceseve gjyqësore nëpër të cilat ka kaluar ecuria e asaj pronësie të atyre parcelave ku ato tri parcelat kanë sipërfaqe afër 13 ari, në atë parcelë ku është objekti i ndërtuar i shtëpisë së kulturës janë 17 ari përkundër se edhe për këtë ka pasë padi të cilat nuk janë realizuar do të thotë janë refuzuar ndërsa këta 13 ari paditësit i kanë kthyer në pronësi të tyre madje ecuria e procesit ka kaluar nëpër të gjitha nivelet e Gjykatave të Kosovës deri te Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata Kushtetuese ia ka njohur të drejtën e pronësisë paditësve.
Objekti ka mbete në gjendje në të cilën është, nëse vlerësoni që ai objekt është pasqyrë e mirë për qytetin e Podujevës e lëmë sa të doni as nuk jemi pjesë e këtij procesi e as nuk e kemi bë këtë proces e as nuk e kemi filluar dhe as nuk e kemi pasë mundësinë atëherë me mbrojte se nuk kemi qenë në pushtet, ça kemi mundësi, si Kryetar Komune duke e parë atë gjendje aty kam kërkuar dhe kam formuar komision vlerësues për gjendjen e atij objekti, çka me bë dhe ai komision vlerësues na e ka sjellë një rekomandim në këtë rast z.Ekrem Rrahmani ke të drejtë se nuk ka vendim po rekomandim që ai objekt nuk i plotëson kushtet të qëndroj më tutje ose të rinovohet ose të vazhdohet të investohet në atë objekt plus këtu shto faktin që ke 13 ari ku objekti është i ndërtuar në pronësi të tyre përkundër faktit që paditësit kanë bë kërkesë për ta rrënuar objektin tonë, por këtë të drejtë paditësve nuk ia ka njoftë gjykata. Nëse e vlerësojmë dhe ka dilema çka me bë unë e kam kryer një pjesë të përgjegjësisë time si ekzekutiv dhe e kam sjellë në kuvend për të na dhanë dritë jeshile me shty këtë projekt përpara ose me thënë stop ndaleni sepse ne do të luftojmë kundër vendimit të Gjykatës Kushtetuese që ia ka njoftë të drejtën e pronësisë atyre njerëzve, tash Shpejtim Bulliqi si Kryetar i Komunës por as si Shpejtim por edhe këta asamblistë e LVV-së, ju garantoj që asnjëri kurrfarë interesi në këtë punë nuk ka përveç faktit që është mirë ta heqim atë varrezë ndërtimore dhe ta lirojmë atë hapësirë, po e ka ai përpara pronën e tij, ne e kemi sipërfaqen tonë ai zotëria e ka sipërfaqen e tij, kjo është rruga e parë, rruga e dytë është nëse e kemi gatishmërinë si kuvend komunal mund të marrim vendim dhe të shkojmë në shpronësim le te paguajmë dy herë të njëjtën pronë. Sa kushton shpronësimi i asaj prone unë nuk e di sepse janë të tjerët që e vlerësojnë peshën e atyre 13 ari në atë pozicion ku është, nëse e vlerësojmë si komunë që mundemi unë prapë e them se nuk e di se sa është çmimi real i 1 ari tokë në atë pjesë dhe a na duhet shumë ajo pjesë them se tepër shumë na duhet sepse është në pozitën më të mirë të qytetit, nëse më pyetni mua a duhet të vazhdohet më tutje me atë gërmadhë aty besoj se nuk duhet dhe pyetjen tjetër që mund të ma bëni pse ata kanë qenë më të mençur se ti që se kanë bë këtë punë deri sot e ta kanë lënë ty apo çka, unë po ju tregoj se ne jemi të pastërt në këtë punë pse s'jemi të fëlliqur në këtë punë, nëse dikush është i fëlliqur në këtë punë ndoshta edhe se kanë pas guximin të merren me këtë punë dhe unë e kam ndërgjegjen e pastër sot dhe me ndërgjegje të pastër e kemi sjellë këtë vendim para jush, ju jeni asambleja komunale, ju jeni kuvendi i Podujevës ju rekomandoni pozitivisht ecim pozitivisht, ju rekomandoni negativisht vazhdojmë dhe jemi në rregull. Më jepni rekomandim që të fillojmë me procedurat e shpronësimit, unë nesër i filloj procedurat e shpronësimit të asaj pjesës tjetër dhe e ruajmë komplet tërësinë, se ça ka ndodhë derisa është ndërtuar ai objekt aty besoj që disa prej nesh që janë më të vjetër këtu e dinë por edhe disa që janë më të ri besoj se kanë dëgjuar për të por nuk jemi pjesë e këtij procesi dhe unë nga ju

kërkoj që të na jepni kahje se si të veprojmë tutje me këtë pjesë, nëse mendoni se dikush ka interes në këtë punë gishtat janë tuaj ndaleni këtë proces kurrfarë telashe nuk ka por unë e kam ndie obligim moral edhe zyrtar me sjellë para jush për t'i dhënë kahje këtij procesi, të tjerët pse s'kanë guxuar të hyjnë në këtë proces nuk e di mund ta diskutojmë këtë çështje.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, është e vërtetë që procedurat janë zhvilluar ashtu se të gjithë dokumentacioni e kam edhe unë aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2021, dhe ne e dimë se kur vendos Gjykata Kushtetuese më ajo është e përfunduar. Të më pyesësh mua a je për ta rrënuar atë objekt kur kisha dal prej kuvendi se kisha pa atë gërmadhë aty por këtu diqysh ose po na cilësoni neve kuvendarëve si makinë votuese ose neve nuk na ke pyet kur e ke formuar komisionin dhe nuk keni sjellë vendim por raport i komisionit dhe rekomandim i komisionit të cilin e keni formuar ju komisioni normalisht se është dashur të dalë me rekomandim dhe ai komision ka bërë mirë që ka dalë me atë rekomandim. Komisioni është dashur t'ju rekomandoj juve që e keni ngritë atë komision dhe te çështja që e përmende Kryetar se tjerët s'kanë pasë guxim, ne e dimë që tash harta zonale është miratuar vonë dhe tani ke të drejtë ti, megjithatë edhe pse kur ia bëre pyetjen drejtorit sa ari janë, unë e di se komuna i ka 17 ari në pronësi aty kurse pjesa tjetër është 13 ari por objekti sa metra katror ka në pronësi të komunës dhe sa metra katror të objektit janë në pronë private këtë nuk e di ose nuk diti drejtori të na tregoj. Unë mendoj se këtë pa e sjellë në kuvend ti me këtë rekomandim të komisionit ti mundesh ta rrënosh atë objekt, ti e din që është tenderi për rrënime, por neve s'është dashur të na rëndosh me atë punë se unë s'jam për mos rrënim se e kam edhe aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe kur e kam pa se procedurat kanë shkuar deri në Gjykatën Kushtetuese jam çuditë që merret me këto çështje Gjykata Kushtetuese unë se kam ditë këtë. Kur e kam marrë vendimin e Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës Kushtetuese e kam ditë se kjo punë ka përfunduar por është dashur ta përfundosh ti këtë punë pa na bë telash neve, këtë desha ta them ose është dashur ta sjellësh këtë si vendim e jo si raport se komisioni raport të jep vetëm ty që e ke ngritë atë komision.
**z.Shpejtim Bulliqi,** Kryetar i Komunës, theksoi, i nderuari asamblist me gjithë respektin që kam duke i marrë parasysh të gjitha këto rrethana nëpër të cilat ka kaluar dhe historikun e kësaj pune Shpejtim Bulliqi si Kryetar Komune nuk ka të drejtë me marrë një vendim të tillë pa e pyet këtë kuvend sepse jeni organi më i lartë i kësaj komune e keni parasysh dhe kjo është respekt për këtë kuvend, nuk është vendim i Shpejtim Bulliqit, Shpejtim Bulliqi i ka hapë rrugë procesit dhe ua ka sjellë raportin me rekomandim përpara, a e rrënoni a jo, a i jepni leje Shpejtim Bulliqit si Kryetar Komune me këtë ekzekutiv ju e thoni fjalën e juaj prandaj nëse doni refuzone, nëse doni shtyne përpara mendoni thjeshtë lirisht, nëse mendoni se ky proces rikthehet mos e votoni sepse humbim shumë, nëse vlerësoni se mund ta paguajmë atë tokë më jepni një vendim sot që të shpronësohet ajo pronë Shpejtim Bulliqi i fillon procedurat dhe e shpronëson atë pronë dhe e kthen të gjithën në atë sipërfaqe që është dashur të jetë por që fatkeqësisht në rrugë ka devijuar. Vitet 2010, 20211, 2012, 2013, as ne LVV-ja e as Shpejtim Bulliqi nuk ka qenë në pozitë udhëheqëse sepse deri në vitin 2007 kam qenë Drejtor i Drejtorisë së Arsimit por kjo nuk ka tanguar me Drejtorinë e Drejtorisë së Arsimit prandaj nuk kam asnjë informacion se çfarë ka ndodh në atë proces por informatën e kam zyrtare që gjendja e pronësisë është kjo, nëse e vlerësoni se kemi nevojë me këqyr sa herë dalim pamjen e vrazhdë të Podujevës së pari duke filluar nga ajo shtëpi aty vazhdojmë tutje, Shpejtim Bulliqi është dakord me ju, por nëse pritni që unë marrë vendim me rrënua atë objekt mos e pritni sepse jeni institucioni më i lartë legjislativ.
**z.Bashkim Syla,** theksoi, mua më vjen mirë që Kryetari doli dhe na e shpjegoi gjendjen qysh ka filluar procedura dhe si është gjendja e tanishme faktike për atë objekt ne në mbledhjen e KPF-së, kemi pas një pyetje nga kolegu z.Qendrim Softolli, drejtuar drejtorit se a është ajo pronë publike ai

ka thënë tri herë se pronë publike është. Kryetari i bërë sqarimet se ajo lënë ka kaluar në Gjykatën Kushtetuese dhe ajo pronësi iu ka njohur paditësve ajo punë ka përfunduar dhe e vetmja mënyrë është kjo që e tha Kryetari ose me shpronësim të asaj prone ose me marrë pjesën tonë të tokës dhe me ndërtue diçka për të mirë të qytetarëve kështu që nëse ne nuk e marrim këtë vendim dikush duhet ta marrë këtë vendim prandaj unë mendoj se është më mirë të përfundoj kjo punë dhe nëse është mundësia për shpronësim mundemi edhe pse ajo kushton shumë shtrenjtë por mendoj se ajo pjesë mund të shpronësohet dhe të ndërtohet diçka për të mirën e qytetarëve do të ishte edhe më mirë, mirëpo ka kosto të lartë. Nëse Gjykata Kushtetuese ka vendosur në favor të atyre personave ajo punë është e kryer e definuar të cilën unë se kam ditë.
**z.Ragip Fetahu,** theksoi, duke u bazuar në argumentet të cilat u than këtu në kuvend nga kryetari mirëpo në të njëjtën kohë edhe kjo amullia ose paqartësia në mes anëtarëve të kuvendit se ça duhet bërë me këtë pronë, unë propozoj që të kemi një pauzë 5 minuta që të diskutojnë shefat e gjitha grupeve të të gjitha subjekteve politike dhe ta marrim një vendim siç është më së miri për këtë çështje.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, Kryetar njëherë the se s'kanë guxuar ata që kanë qenë më herët, tash the unë s'po guxoi, këtë mos na e thuaj, ndoshta edhe ata e kanë sjellë në kuvend dhe është kthyer, nëse ata s'kanë guxuar edhe ti s'po guxon, njëjtë i bjen kjo punë, a e din çka kërkova në fillim unë që drejtori të bëhet më korrekt e të thotë kaq metra katror janë në pronë komunale e kaq metra katror të atij objekti janë në pronë private dhe do e rrënojmë atë objekt dhe me sjellë në dokumente propozim vendimin e jo rekomandim e pastaj kishim votuar ose jo.
**z.Shpejtim Bulliqi,** Kryetar i Komunës, theksoi, z.Ekrem Rrahmani, nëse shihni emrat e komisionit, kam bë komision prej të gjitha drejtorive ku janë edhe inxhinierët të përfaqësuar si dhe zyra e kadastrit, zyrtarët e emergjencave dhe dua t'ju them që kam dashur që ky raport të jetë sa më profesional dhe sa është profesional nuk jam unë kompetent ta di se nuk e di dhe pyetjen që e bëre ti sa metra katror të objektit janë në pronë të komunës e sa metra katror të objektit janë në pronë private unë nuk e di, gjeodetët tanë kanë bë matje ata e dinë, këtë informatë mund ta marrësh te zyra e kadastrës përndryshe vetëm një element të vogël dyshimi ka në këtë punë e kemi shumë të lehtë të gjithë unanimisht mund të votoni e ta kthejmë mbrapa dhe e lëmë ashtu të vazhdoj, nëse e vlerësoni që kemi buxhet të mjaftueshëm dhe kemi kapacitet si komunë për shpronësimin e asaj prone edhe atë procedurë e fillojmë. Çdo rekomandim që më jep ky kuvend sot unë kam me përfill dhe do e shtyjë përpara, kurse është mirë është t'i japim zgjidhje atij procesi sepse e kemi në mes të komunës e kemi në qendër të komunës dhe nëse asgjë tjetër po ju tregoj si kuvend së bashku me mua ose do lëvdohemi të gjithë ose do të fyhemi të gjithë, ky është vendim i kuvendit unë e zbatoj mos ma leni hiç mua këtë, as meritat e as dëmin, merreni vendimin si kuvend unë e zbatoj.

*Nga anëtarët/et e Kuvendit të Komunës, mbështetet propozimi për pauzë 20 minuta, dhe atë duke filluar nga ora 15;40*

***Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 15:40.***

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, i cili fillimisht konstatoi kuorumin ku prezent për momentin janë 23 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës.

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, vazhdojmë me mbledhjen aty ku kemi mbet në pikën e rendit të ditës Raporti i komisionit për vlerësimin e gjendjes dhe konstatimin e shkallës së rrezikshmërisë së objektit të ndërtuar në periudhën e viteve 1982-1985 me destinim "Shtëpi të Kulturës". Për këtë pikë u diskutua gjerë e gjatë për gjetjen e një gjuhe të përbashkët dhe pas konsultimit me shefat e grupeve të këshilltarëve erdhëm në përfundim që kuvendi të merr vendim për rrënim të objektit ish shtëpia e kulturës sipas rekomandimeve të komisionit të datës 05.04.2024. Autorizohet Drejtoria përkatëse sidomos Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit të ndërmerr masa dhe veprime për zbatimin e këtij vendimi. Pa humbur kohë propozimin në fjalë e vë në votim.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 23 vota për, asnjë votë kundër, një votë të përmbajtur merret vendim për rrënimin e objektit ish –shtëpi e kulturës, dhe atë si në vijim;*

*- Kuvendi i Komunës miraton rekomandimin për rrënimin e objektit ish-Shtëpi e Kulturës, sipas Raportit të datës 05.04.2024 të komisionit për vlerësimin e gjendjes dhe konstatimin e shkallës së rrezikshmërisë së objektit të ndërtuar në periudhën rreth viteve 1982-1985 me destinim për "Shtëpi të Kulturës" i cili gjendet në udhëkryqin që lidhë rrugët "19 Qershori" dhe "Zahir Pajaziti", në qytetin e Podujevës.*
*- Kuvendi i Komunës autorizon Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, dhe Drejtoritë tjera relevante të Komunës së Podujevës, që të ndërmarrin gjitha masat dhe veprimet e nevojshme në funksion të zbatimit të këtij vendimi.*
*- Këtij vendimi i bashkëngjitet Raporti i datës 05.04.2024 i komisionit për vlerësimin e gjendjes dhe konstatimin e shkallës së rrezikshmërisë së objektit të ndërtuar në periudhën rreth viteve 1982-1985 me destinim për "Shtëpi të Kulturës" i cili gjendet në udhëkryqin që lidhë rrugët "19 Qershori" dhe "Zahir Pajaziti" në qytetin e Podujevës.*

**13. Propozimi për plotësim ndryshimin e Vendimit të Kuvendit nr.prot.01-020/04-0101084/22 datë 09.12.2022 për formimin e komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës, përkatësisht në vend të ish anëtares znj.Antoneta Ejupi ish drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, anëtar në këtë komision të caktohet z.Shuajb Blakçori U.D. drejtor i Drejtorisë së Administratës në Komunën e Podujevës.**

**z.Hilimi Hoxha, Kryesues i kuvendit,** theksoi, për këtë pikët të rendit të ditës s'kemi ça të diskutojmë kur dihet se do bëhet vetëm një plotësim ndryshim i këtij vendimi kur dihet se në vend të znj.Antoneta Ejupi Drejtor i Drejtorisë së Administratës është zgjedhë z.Shuajb Blakçori andaj pa humbur kohë më shumë e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 23 vota për, asnjë votë kundër, një votë të përmbajtur merret vendim përpër plotësim ndryshimin e Vendimit të Kuvendit nr.prot.01-020/04-0101084/22 datë 09.12.2022 për formimin e komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës, përkatësisht në vend të ish anëtares znj.Antoneta Ejupi ish drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, anëtar në këtë komision të caktohet z.Shuajb Blakçori U.D. drejtor i Drejtorisë së Administratës në Komunën e Podujevës.*

**14. Propozim Vendimi për kompensimin e anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale "Eko-Llapi" SH.A**

**z.Hilimi Hoxha, Kryesues i kuvendit,** theksoi, pikë e rendit të ditës që u shtua është edhe propozim vendimi për kompensimin e anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale "Eko-Llapi" sh.a. Miratohet propozim vendimi për caktimin e kompensimit të anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale "Eko-Llapi" sh.a. të caktuar sipas vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-016/01-0079532/23, të datës 31.10.2023, për formimin e komisionit të aksionarëve.
Anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale "Eko-Llapi" sh.a, do të kompensohen për çdo muaj sipas pagës së përcaktuar minimale të të ndërmarrjes publike lokale "Eko-Llapi" sh.a, ku të njëjtit shërbejnë. Mjetet Financiare për kompensimin e anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve do të merren nga ndërmarrjes publike lokale "Eko-Llapi" sh.a, ku të njëjtit shërbejnë. Ky vendim vlen për anëtarët e komisionit të zgjedhur nga radhët e kuvendit të komunës përderisa anëtarët e deleguar nga Kryetari i Komunës, këtij të fundit i rekomandohet ta rregulloj kompensimin e anëtarëve të komisionit me vendim të veçantë. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen ndërmarrja publike lokale "Eko-Llapi" sh.a.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, ne e përkrahim këtë propozim vendim dhe ndoshta bëhen pak më korrekt dhe na raportojnë ndonjëherë.
**z.Ragip Fetahu,** theksoi, ky propozim është për ta ndihmuar punën e komisioneve mirëpo çka desha unë të them, është që të përkrahen sikurse ky komision që është bë për anëtar të komisionit, të përkrahen edhe anëtarët e komisioneve tjera që janë në ndërmarrjet tjera publike, unë nuk e di si shkon proceduralisht kjo punë. Është mirë që të gjithë anëtarët e komisioneve të ndërmarrjeve publike në Podujevë të hyjnë një një pako si tërësi dhe të merret një vendim nga kuvendi si tërësi që mos të kemi në në çdo seancë nga një pikë e cila mund të kryhet si pako.
**z.Bashkim Syla,** theksoi, edhe ne si grup e përkrahim këtë propozim vendim.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, vjet është votuar ngjashëm kompensimi i anëtarëve të komisionit për përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, ndoshta s'është dashur ta përmendi se edhe unë kam qenë anëtar i atij komisioni dhe ministria ka kthyer përgjigje se nuk bëhet pagesa, tash edhe për këtë komision se di a e kthen ministria të njëjtën përgjigje, ose ka bërë ndonjë gabim drejtori e ka dërguar vendimin me ndonjë kod tjetër për vlerësim për të na e kthyer vlerësimin kështu.
**z.Hilimi Hoxha, Kryesues i kuvendit,** theksoi, i nderuar z.Ekrem Rrahmani, ai vendim nuk është kthyer që s'kemi të drejtë të bëjmë pagesën por është dashtë me pasë mbulesë se prej kujt po i merr mjetet dhe për atë arsye ai kompensim nuk është bë, besoj se këtë çështje drejtori i DBF-së e zgjedhë andaj pa humbur kohë më shumë e vë në votim Propozim Vendimi për kompensimin e anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale "Eko-Llapi" sh.a

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 22 vota për, asnjë votë kundër, një votë të përmbajtur merret vendim për kompensimin e anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale "Eko-Llapi" sh.a, dhe atë si në vijim;*
*- Miratohet propozim vendimi për caktimin e kompensimit të anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale "Eko-Llapi" sh.a. të caktuar sipas vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-016/01-0079532/23, të datës 31.10.2023, për formimin e komisionit të aksionarëve.*

*- Anëtarët e komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale "Eko-Llapi" sh.a, do të kompensohen për çdo muaj sipas pagës së përcaktuar minimale të të ndërmarrjes publike lokale "Eko-Llapi" sh.a, ku të njëjtit shërbejnë.*
*- Mjetet Financiare për kompensimin e anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve do të merren nga ndërmarrjes publike lokale "Eko-Llapi" sh.a, ku të njëjtit shërbejnë.*
*- Ky vendim vlen për anëtarët e komisionit të zgjedhur nga radhët e kuvendit të komunës përderisa anëtarët e deleguar nga Kryetari i Komunës, këtij të fundit i rekomandohet ta rregulloj kompensimin e anëtarëve të komisionit me vendim të veçantë. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen ndërmarrja publike lokale "Eko-Llapi" sh.a.*

**15. Të ndryshme.**

**z.Florent Hasani,** theksoi, paraqes një shqetësim të lagjeve rreth parkut të pishave, lagjes "Hasan Prishtina", lagjes "Ilir Konushefci", i cili shqetësim është çështja e ujit të pijshëm, tash e një kohë gypi furnizues i vjetruar si pasojë e dëmtimit shkakton mungesën e ujit të pijshëm në shumicën e kohës po ashtu edhe ndotjen e ujit. Duke e ditur se komuna nuk është përgjegjëse për sistemin e ujësjellësit, kërkojmë që komuna të ndërmjetësoj te ujësjellësi duke e paraqitur këtë shqetësim real të banorëve të atyre lagjeve dhe të bëhet urgjentisht rregullimi i atij gypi.
**z.Ekrem Rrahmani,** theksoi, unë i kam dy blic pyetje për drejtorin, kjo rruga te stacioni i policisë pse është gërryer dhe a ka kontratë për të, mendoj që prej rrugëve e asfaltuara më e mira ka qenë kjo, pse është gërryer dhe pse janë ndal punimet në Rr."Xhemajl Mustafa", prej urës e këndej, çka ka ngecë aty, a është duke penguar posta a ça është problemi, a nuk ka mbikëqyrje pse ata njëherë e rrafshojnë rrugën pastaj kthehen edhe harrojnë vendosjen e gypave dhe herë e gërmojnë rrugën e herrë herë i mbyllin ato kanale të gërmimit, akanë ata kontratë ata apo nuk i dinë këto punë dhe harrojnë dhe pse ndodhin këto.
**z.Ragip Fetahu,** theksoi, dua ta paraqes një shqetësim të bizneseve të cilat veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në Rr."Skenderbeu", sepse të gjitha kyçjet e rrugëve për shkak të asaj prerjes së asfaltit janë bërë shumë të vështirësuara dhe po ka shumë prishje në automjete dhe një dëmtim të automjetit e kam pasë edhe vet personalisht. Kur pritet të përfundojnë punimet në atë prerje të asfaltit edhe pse kompania nuk është pak më e përgjegjshme kur i sheh gropimet që janë bë e kur bien në ato gropa veturat dëmtohen jashtëzakonisht shumë, pse nuk i mbyllë ato përkohësisht deri në përmbylljen e projektit.

*Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 15:55**

**Procesverbalin e hartoi/mbajti;**
**Osman Bajrami**

**Nr.Prot.01-060/04-0033711/24**
**Podujevë,** **Kryesuesi i Kuvendit**
**23 maj 2024** **Hilmi Hoxha**

# KUVENDI I KOMUNËS

**Procesverbal i mbajtur më 19 qershor 2024, në mbledhjen Solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VII, e mbajtur për nderë të 19 qershorit - Ditës së Çlirimit të Podujevës**

Mbledhja filloi në orën 10;15, dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.
Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.
Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin të gjithë anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:
Nga LVV*; Fitim Muçolli; Artirit Mulliqi;; Sebastina Vokrri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori;* ndërsa munguan *Florent Hasani; Kasib Bashota dhe Lirika Maliqi.*
(Nga LDK *Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Arjant Topanica; Ilir Koprani; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani;* Fahri Hasani ndërsa munguan, *Donjetë Sheqiri dhe Tringa Sfishta.*
Nga PDK, *Bashkim Syla; Mimoza Abdullahu, ndërsa mungoi Endritë Murati*
Nga AAK, *Mrika Thaqi; Burim Hasani ndërsa mungo Arbnor Fazliu,*
Nga OBKD, *Gazmend Islami i cili mungoi me arsyetim shëndetësor me shkrim dërguar Kryesuesit të Kuvendit. Demokrat Hodolli dhe Adnan Zymeri anëtarë të pavarur në Kuvendin e Komunës.*

Gjithashtu të pranishëm ishin z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës së Podujevës, znj.Marigona Lahu Nënkryetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;
*(Shujab Blakçori DA; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Leutrim Krasniqi-Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Vlora Humolli Jashanica-Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS, Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH; Alban Zekai-Drejtoria e Inspeksionit DI, Lirie Hoti-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR, Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE,)*

Të pranishëm tjerë ishin përfaqësues dhe kryetarë të Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së.
Ish komandant dhe luftëtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; z.Rrustem Mustafa, z.Latif Gashi, z.Kadri Kastrati dhe të tjerë.
Përfaqësuesi Forcës së Sigurisë së Kosovës z.Shaip Haziri.
Përfaqësues të Policisë së Kosovës.
Përfaqësues të Familjeve të Dëshmorëve dhe Heronjve të Kosovës.
Përfaqësues të Bashkësisë Islame në Podujevë, z.Mensur Hoti, z.Idriz Bilalli, z.Bekim Jashari.
Deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës z.Vendenis Lahu dhe z.Fitim Haziri.
Kryetari i Komunës së Leposaviqit z.Lulzim Hetemi.
Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë z.Petrit Malaj.
Përfaqësues të KFOR

Me ftesë të veçantë prezent ishte ish Deputetja e Parlamentit Europian Doris Pack, e shpallur Qytetare Nderi e Komunës së Podujevës dhe e ftuar për pranimin e Dekoratës, dhe Ertan Xhihiq me qëllim të pranimit të Mirënjohjes për kontributin e dhënë në sportin Llapjan.

Pjesëmarrës tjerë në këtë mbledhje ishin edhe përfaqësues të mediave lokale-TV Llapi, si dhe një numër i qytetarëve- rreth 25-30, dhe zyrtarëve komunale (bashkëngjitur linku i video seancës youtube: https://www.youtube.com/watch?v=ee1lxBVMONM

## 1. Hapja e mbledhjes nga Kryesuesi i Kuvendit

- **Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

***Mbledhja u hap me Intonimin e Himnit të Republikës së Kosovës dhe Himnit të Republikës së Shqipërisë – Himni Kombëtar***

**Kryesuesi i Kuvendit z.Hilmi Hoxha**, ftoj për 1 minutë heshtje në shenjë respekti për të gjithë të rënët për liri

*Mbahet 1 minutë heshtje në nderim të të gjithë të rënëve për liri.*

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, mysafirë të nderuar, kam kënaqësinë dhe ndihem shumë i nderuar që me një fjalë rasti të hap këtë mbledhje solemne për të shënuar 25 vjetorin e Çlirimit të Podujevës.
Kam nderin të përshëndes Kryetarin e Komunës z.Shpejtim Bulliqi, Nënkryetaren e Komunës znj.Marigona Lahu, shumë të respektuara familje të Dëshmorëve, Invalidëve dhe Veteranëve të UÇK-së, përfaqësues të Shoqatave të dala nga Lufta, të nderuare anëtar/e të Kuvendit të Komunës, drejtor të Drejtorive të Komunës, të nderuar Deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
Të nderuar dhe shumë të respektuar Gjeneral Rrustem Mustafa, Gjeneral Kadri Kastrati, Gjeneral Latif Gashi, Gjeneral Naim Haziri, ju faleminderit shumë që keni gjet kohë të jeni prezent në këtë mbledhje solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës.
E nderuara dhe shumë e respektuara ish Deputete e Parlamentit Europian zonja Doris Pack, i nderuari Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Kosovë z.Petrit Malaj, i nderuar Kryetar i Komunës së Leposaviqit z.Lulëzim Hetemi, i nderuar z.Ertan Xhihiq, përfaqësues të Policisë së Kosovës, përfaqësues të Forcës së Sigurisë së Kosovës, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të Këshillit të Bashkësisë Islame, përfaqësues të Shoqërisë Civile, Media dhe të nderuar dhe respektuar qytetarë të Komunës së Podujevës, mirë se keni ardh në seancën solemne me rastin e 25 vjetorit të Çlirimit të Podujevës.
Siç e dim 19 Qershori i vitit 1999 është ditë historike për Komunën tonë.
Sot të gjithë festojmë duke kujtuar të kaluarën tonë të lavdishme sepse 25 vite më parë në këtë ditë që po e shënojmë i'u dha fund një epoke të gjatë të luftës për liri dhe pavarësi.
Kjo datë mbanë një histori me ndjenja të përziera, krenari e dhimbje të cilat janë pjesë të pandashme të përditshmërisë tonë ngase lufta e fundit la gjurmë të pashlyera në kujtesën tonë përmes vrasjeve, djegieve dhe shkatërrimeve të shumta.
Për këto 25 vite janë bërë ndryshime shumë të mëdha në gjithë Kosovën, pra edhe në Komunën e Podujevës dhe atë në të gjitha segmentet, si në ekonomi, arsim, shëndetësi, infrastrukturë, sport e kulturë, por natyrisht që na mbetet ende të punojmë.
Derisa sot festojmë 25 vjetorin e Çlirimit të Podujevës, kurorëzimit të përpjekjeve shekullore, me përulje kujtojmë Dëshmorët, Martirët, heronjtë e gjallë dhe miqtë ndërkombëtar që ndihmuan luftën e shenjtë të UÇK-së e cila solli lirinë pas shumë shekujsh robërie.
Nderim të përjetshëm për të gjithë ata që sakrifikuan, luftuan dhe dhanë jetën për këtë ditë.
Urime Dita e Çlirimit të Komunës tonë.
Ju faleminderit.

**Kryesuesi i Kuvendit** në vazhdim theksoi, tani për nderë të shënimit të kësaj date, fjalën i'a jap Kryetarit të Komunës z.Shpejtim Bulliqi

## 2. Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës

**z.Shpejtim Bulliqi**, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit z.Hilmi Hoxha, e nderuara Nënkryetare e Komunës znj.Marigona Lahu, të nderuar Ministra, Zëvendësministra të Qeverisë dhe Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, shumë të respektuara familje të Dëshmorëve, të nderuar invalidë dhe veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të nderuar drejtorë dhe asamblistë komunal, të nderuar përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale.
Shumë e respektuara zonja Doris Pack ish Deputete e Parlamentit Evropian dhe mike e madhe e Kosovës.
I nderuar zotëri Ertan Xhihiq, i respektuari ish Komandant i Zonës Operative të Llapit z.Rrustem Mustafa, i respektuari gjeneral z.Naim Haziri, i respektuari gjeneral z.Kadri Kastrati, i respektuar Komandant Latif Gashi – Lata.
Të nderuar mysafir, shumë i respektuari Shkëlqesia e Tij Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Kosovë z.Petrit Malaj, i respektuari Kryetar i Komunës së Leposaviqit, të nderuar qytetarë, zonja dhe zotërinj.
Me një ndjenjë të thellë krenarie dhe respekti, jemi mbledhur sot për të shënuar një ngjarje historike dhe të veçantë për Komunën tonë, 25 vjetorin e Çlirimit të Podujevës. Ky përvjetor simbolizon jo vetëm fundin e një periudhe të errët, por edhe fillimin e një epoke të re të lirisë dhe zhvillimit për Komunën dhe qytetarët tanë.
Gjatë këtyre 25 viteve, Podujeva ka kaluar nëpër sfida të mëdha dhe ka shënuar përparime të dukshme. Çlirimi i Podujevës përbën një moment historik për qytetin e Komunën tonë, ky moment përfaqëson triumfin e drejtësisë mbi padrejtësinë dhe të lirisë mbi shtypjen.
Në këtë ditë, kujtojmë dhe nderojmë të gjithë ata që sakrifikuan jetën e tyre për lirinë e Kosovës. Kujtojmë me nderim të veçantë Heronjtë, Dëshmorët dhe Martirët të cilët me guximin dhe sakrificën e tyre na dhanë të ardhme të lirë neve dhe brezave të ardhshëm.
Në këtë ditë historike për Komunën tonë një mirënjohje të veçantë e falënderime të thella meritojnë të gjithë djemtë dhe vajzat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që tejkaluan frikën e vdekjes dhe u bashkuan në misionin për të luftuar për lirinë e atdheut tonë.
Po ashtu në këtë ditë të veçantë duhet ta përmendim, kujtojmë dhe respektojmë punën dhe kontributin e Presidentit Rugova dhe bashkëpunëtorëve të tij që hapën dyert për Kosovën në arenën ndërkombëtare duke krijuar ura miqësie me vendet perëndimore të cilat na u gjenden pranë në epokat më të vështira.
Në këtë rrugëtim drejt lirisë, të mundimshëm dhe mes shumë sfidave, u jemi mirënjohës secilit për kontributin dhe angazhimin për lirinë e Kosovës.
Ndërsa festojmë Ditën e Çlirimit, ne mendojmë edhe për punët dhe sfidat që na presin në të ardhmen, duke qenë e kaluara jonë si udhërrëfyes për të ardhmen, për idealet dhe për angazhimin e përditshëm që duhet ta kemi për të jetësuar ëndrrat dhe amanetin e atyre që shkrinë vetën për lirinë e Kosovës.
Sot, në këtë seancë solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës, kemi nderin të dekorojmë me çmimin Qytetare Nderi e Komunës së Podujevës, një mikeshë të madhe të Kosovës, znj.Doris Pack.
Si Deputete e Parlamentit Evropian në vitet e 90-ta, zonja Pack loboi me vendosmëri për çështjen e Kosovës dhe ndërkombëtarizimin e çështjes së saj. Zëri i saj i fuqishëm nuk u ndal as pas luftës, duke mbështetur fuqishëm pavarësinë dhe njohjen ndërkombëtare të Kosovës. Kontributi i saj është i pa çmim dhe mirënjohja jonë për të është e thellë, prandaj sot jemi të nderuar e shumë të respektuar që e kemi në mesin tonë në këtë datë historike për Komunën dhe qytetarët tanë.
Gjithashtu, sot do të ndajmë një mirënjohje të veçantë për z.Ertan Xhihiq, për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në sportin Llapjan, veçanërisht për futbollin e për klubin "Besiana".

Përkushtimi i zotëriut Xhihiq në promovimin e sportit dhe përgatitjen e të rinjve në këtë fushë ka sjellë jo vetëm suksese sportive, por edhe ka ndihmuar në ndërtimin e një komuniteti më të shëndoshë dhe më të bashkuar. Sukseset e asaj kohe të Klubit të Futbollit “Besiana” vazhdojnë të na bëjnë krenarë edhe në ditët e sotshme.
Prandaj zotëri Xhihiq, ju e meritoni këtë mirënjohje si shenjë nderimi për punën dhe kontributin tuaj për sportin llapjan dhe sportistët tanë.
Për fund, dëshiroj t'iu falënderoj të gjithë juve që keni ardhur për të ndarë këto momente të veçanta me ne.
Këtu prezent kemi edhe profesorin e respektuar z.Rexhep Gjergji, po ashtu Komandantin z.Muhamet Latifi që ishte komandant i mbrojtjes civile, mandej përfaqësuesit e Bashkësisë Islame në Podujevë, dhe të gjithë juve tjerëve një falënderim i veçantë që jeni pjesë e këtij eventi sot të përbashkët këtu bashkërisht në këtë mbledhje solemne.
Le të jemi gjithmonë të bashkuar në përpjekjet tona për një Podujevë më të mirë, më të fortë dhe më të zhvilluar.
Urime Dita e Çlirimit te Podujevës, Zoti e bekoftë Kosovën, Zoti e bekoftë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.
Ju Faleminderit.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, tani fjala për shefin e Grupit të LDK-së z.Valon Demolli.

**z.Valon Demolli**, theksoi, përshëndetje për të gjithë, përfaqësues të Shoqatave të dala nga lufta, gjeneral z.Kadri Kastrati, Komandant z.Rrustem Mustafa-Remi, Komandant z.Latif Gashi, i nderuari z.Samet Arifi, përshëndetje edhe për të pranishmit nga Bashkësia Islame në Podujevë, po ashtu përshëndesim edhe profesorin e nderuar njëherit edhe kryetarin e parë të Lidhjes Demokratike profesor Rexhep Gjergji.
E nderuara zonja Doris Pack, fillimisht kemi nderin dhe privilegj që jemi pjesë e një Kuvendi ku na është mundësuar që zonjën ish Deputet e Parlamentit Evropian Doris Pack ta shpallim Qytetare Nderi të Komunës së Podujevës, faleminderit zonja Pack.
Të nderuar Qytetarë të Komunës së Podujevës, 19 Qershori - Dita e Çlirimit të Podujevës, na kujton sakrificën e brezave që punuan fortë për lirinë e vendit tonë.
Sot kujtojmë të rënët që dhanë jetën e tyre, por edhe ata të gjallët që dhanë çdo gjë nga vetja.
Kjo ditë na mbushë me krenari dhe na kujton sakrificën e jashtëzakonshme për lirinë dhe dinjitetin tonë, sot përkulemi para veprës së Heronjve, Dëshmorëve dhe Martirëve të cilët me guximin dhe përkushtimin e tyre bënë të mundur që ne të jetojmë të lirë, i përkulemi veprës së Heronjve të UÇK-së, Heroit Zahir Pajaziti bashkë me Edmond Hoxhën, Hakif Zejnullahun, Ali Ajetin, Besnik Restelicën, Bahri e Fahri Fazliun, çdo përvjetor na kujton se sakrifica e tyre nuk do të harrohet kurrë dhe do të mbetet në kujtesën tonë si shembull i papërsëritshëm, gjaku i tyre është themeli mbi të cilën qëndron e fortë liria jonë.
Sot kujtojmë edhe Mësuesit tanë të cilët në kohë të vështira duke edukuar brezat dhanë një kontribut të madh për kauzën e lirisë, ata janë Heronjtë tanë të heshtur që dhanë gjithçka për një të ardhme më të mirë për Podujevën.
Në këtë ditë të shënuar, nuk mund të mos e përmendim rolin dhe kontributin e jashtëzakonshëm të Presidentit Historik Ibrahim Rugova, ai ishte njeriu që me vizionin dhe urtësinë tij i hapi dyert Kosovës në të gjithë botën. Ibrahim Rugova, i njohur si Gandi i Ballkanit ndërtoj ura miqësie dhe paqeje në një kohë kur vendi ynë kishte më shumë nevojë për to. Vizioni dhe vendosmëria e tij për një Kosovë të lirë dhe demokratike janë një trashëgimi që duhet ta ruajmë me krenari.
Ibrahim Rugova ishte dhe do të mbetet simbol i unitetit dhe rezistencës paqësore.

Në këtë ditë të shënuar le të bëjmë një zotim se do të punojmë me ndershmëri dhe përkushtim për një të ardhme më të ndritur për Podujevën. Le të kujtojmë gjithmonë se liria dhe paqja janë vlera që duhet t'i ruajmë dhe t'jua përcjellim brezave të ardhshëm.
Urime Dita e Çlirimit të Podujevës.

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, tani në emër të tri Shoqatave të dala nga lufta, dhe në emër të Zonës Operative të Llapit, fjalën e ka gjeneral Rrustem Mustafa.

## 3. Fjalë rasti e përfaqësuesit të Shoqatave të dala nga Lufta e UÇK-së

**z.Rrustem Mustafa**, ish Komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Zonën Operative të Llapit, dhe në emër të tri Shoqatave të dala nga Lufta, theksoi, i nderuari Kryetar i Komunës z.Shpejtim Bulliqi, përfaqësues të Kuvendit Komunal të Podujevës, i nderuar Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Kosovë z.Petrit Malaj, e nderuara ish Deputete e Parlamentit Europian znj.Doris Pack, i nderuar z.Ertan Xhihiq, të nderuar gjeneral të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës z.Kadri Kastrati, z.Latif Gashi, z.Naim Haziri dhe ju bashkëluftëtar tjerë.
Në fundshekullin e kaluar Ushtria Çlirimtare e Kosovës hapi rrugë për liri dhe perspektivë në vendin tonë, rajon dhe më gjerë. Me organizimin e saj mori me vete qytetarë të Republikës së Kosovës, gjithë njerëz të vendit tonë duke përfshirë edhe politika paqësore që u vu në shërbim të Luftës për liri, si në logjistikë dhe në gjithçka që mundi të ofroj me vete, mori në krahë Shtetin Shqiptar që ofroj të mira logjistike dhe trajnime të ushtarëve të UÇK-së, dhe në fund mori me vete Aleancën NATO të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe gjithë shtetet e qytetëruara në botë.
Si shenjë e këtij koalicioni të vendeve të qytetëruara në botë sot këtu prezentë kemi bashkë me neve edhe ish Deputeten e Parlamentit Europian znj.Doris Pack të cilën Kryetari i Komunës bashkërisht me Kuvendin e Komunës kanë bërë shumë mirë që e kanë dekoruar me medalje znj.Doris Pack, faleminderit zonja Pack që na ke nderuar me pjesëmarrje sot këtu.
Më vie mirë që edhe z.Ertan Xhihiq sot do të merr mirënjohje për kontributin në sportin dhe jetën në vendin tonë, por mbi të gjitha si një luftëtarë i madh në organizmin dhe gjithçka që ka mundur të jetë në shërbim të luftës dhe vendit.
Të nderuar motra dhe vëllezër, ne ju jemi mirënjohës të gjithëve në Llap dhe përtej Llapit që u vurët me gjithçka që patët në shërbim të lirisë të vendit. Nga Llapjanët tanë nuk ishte befasi sepse në mënyrë aq të organizuar po përkrahnin luftën për liri, dhe ata njerëz vinin nga persona të përgatitur siç ishin Adem Demaçi, Shaban Shala, Ali Ajeti, Afrim e Fahri Fazliu deri te Besnik Restelica dhe komandanti i UÇK Zahir Pajaziti.
Ju falënderoj që jeni bashkë me ne dhe sot e 25 vite, e që po përfundon epoka siç është promovimi i librit "Mbijetesa në Tavan", prandaj kurrë më populli ynë dhe qytetarët tanë nuk do të kenë aso periudha të hidhura që i kemi kaluar 25 vite më parë, kurse ju bashkëluftëtarë të mi ndihuni mirë sepse kishim marrë mbi vete të gjithë qytetarët e Kosovës dhe gjitha forcat më të përgatitura të botës dhe NATO-së të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
Rroftë Ushtria Çlirimtare e Kosovës, rroftë vendi ynë.

4. **Ndarja e dekoratës për znj.Doris Pack Qytetare Nderi e Komunës së Podujevës**
    - **Fjalë rasti nga znj.Doris Pack Qytetare Nderi e Komunës së Podujevës**

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, në bazë të rregullativës ligjore në fuqi dhe me iniciativën e Klubit Politik Afrim Zhitia, në propozim të Kryetarit të Komunës z.Shpejtim Bulliqi, Kuvendi i Komunës së Podujevës në seancën e mbajtur më 15.05.2023 ka marrë Vendim për shpalljen e znj.Doris Pack Qytetare Nderi e Komunës së Podujevës, si dhe emërimin e një rruge kryesore me emrin e saj.
Znj.Doris Pack ish Eurodeputete dhe anëtare shumëvjeçare e Bundestagut Gjerman, dhe parlamentit Europian Shpallet Qytetare Nderi e Komunës së Podujevës. Titulli Qytetare Nderi e Komunës së Podujevës, për znj.Doris Pack ish Eurodeputete dhe anëtare shumë vjeçare e Bundestagut Gjerman dhe Parlamentit Europian, i jepet në shenjë mirënjohje për kontributin e dhënë për lirinë dhe shpalljen e Pavarësisë së Republikës së Kosovës.
Titulli Qytetare Nderi e Komunës së Podujevës, sipas këtij Vendimi do të ndahet nga Kryetari i Komunës sot në këtë mbledhje solemne për nderë të Ditës së Çlirimit të Podujevës.
Pra ky vendim është marr në mbledhjen e Kuvendit të Komunës në vitin e kaluar më 15 maj 2023, mirëpo për shkak të pamundësisë që znj.Doris Pack të jetë prezentë në atë mbledhje, dekorata nuk është ndarë deri tani, prandaj tani sot ftojmë znj.Doris Pack që ta marrë Dekoratën e cila do t'i jepet nga Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi.
Pra urdhëroni mund të fillohet ceremonia e dhënies së dekoratës.

*Para pjesëmarrësve në këtë mbledhje, me ceremoni solemne nga Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi i dorëzohet Dekorata Qytetare Nderi e Komunës së Podujevës zonjës Doris Pack ish Eurodeputete në parlamentin e Europian në shenjë mirënjohje për kontributin e dhënë për lirinë dhe shpalljen e Pavarësisë së Republikës së Kosovës.*

Gjatë ceremonisë së dhënies së dekoratës zonjës Doris Pack, **Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi**, theksoi, të respektuar të pranishëm, nga sot znj.Doris Pack ka një shtëpi të re dhe këtë shtëpi e ka në qytetin e Podujevës sepse këtë shtëpi i'a kanë dhënë qytetarët e Podujevës në shenjë të punës, angazhimit dhe sakrificës që bërë për çështjen kombëtare, prandaj me këtë rast e ftoj zonjën Doris Pack për një fjalë rasti.

**znj.Dris Pack,** former Euro member in the European Parliament, emphasized, I thank you very much, the people of Council, of the Local Council of Podujevo, for giving me this honor. Thank you that you decided this, thank you President and Mayer, giving me this honor. I feel humbled, but I feel also proud. I think I'm not going to make a long speech, but I wanted to show you, yesterday, I have it here, but it's there, I got a key, the key of a house in Podujevo, the key of the house the family of a young man, of a family of a young man who may have a common, how to say, a sad moment in their life, in my life.
In 1997, I came from Belgrade to Prishtina, and on the way to Podujevo somebody stopped me and asked me to come to see their killed and tortured son. I cannot tell you, how, what it made to me, but therefore, I was very, I was happy that they had a chance to speak with his family, they said, with his brother and that we have together a memory which gives us a kind of family. So, I have the key of this family's house, and now, I am a honorary citizen of your city, I'm a co-citizen so to say, and I think together we have to work, that this Kosovo will have a good future, a better future, and I can assure you that I am proud, having had the chance to be on your way always with you, because you didn't have so many friends. I learned Kosovo in 1990 via people with whom I'm friend until today, one has died, two have died. It was Ibrahim Rugova, it was Adem Demaci, who is citizen, a citizen of this town, and please not to forget, it was Bujar Bukoshi , who played a very important role in Germany. So I think, I had three good friends and all the time they helped me to understand your situation. So, I think we are not where we want to be in this country. I say, we have managed it, and I think with the new commission we can make it, and we want to do everything that you became not only member of the Council of Europe, but even you will be member of Union, because this you deserve, you are a functioning democracy and I'm proud to be your honorary citizen of Podujevo and therefore of Kosovo. Thank you

<u>*Në vijim teksti i përkthyer dhe përshtatur në gjuhën Shqipe*</u>

*Ju falënderoj shumë anëtarë të Kuvendit të Komunës së Podujevës, që më keni bërë këtë nder, dhe që keni vendosur për këtë.*
*ju faleminderit Kryetar i Kuvendit dhe Kryetar i Komunës që më bëtë këtë nder. Ndjehem e respektuar, por edhe krenare. Nuk mendoj të mbaj një fjalim të gjatë, por dua t'ju tregoj se dje e kam e kam marrë një çelës, çelësin e një shtëpie në Podujevë, çelësin e shtëpisë së familjes së një të riu me të cilin kemi një moment të përbashkët, apo siç mund ta them, një moment të trishtë në jetën e tyre, dhe në jetën time.*
*Ne vitin 1997 erdha nga Beogradi në Prishtinë, dhe rrugës për në Podujevë dikush më ndaloi dhe kërkoi nga unë që të shkoj dhe të shoh djalin e tyre të vrarë dhe të torturuar. Nuk mund t'jua them si dhe si ndikoi kjo tek unë, mirëpo unë isha shumë e kënaqur që ata patën mundësinë që unë të flas me familjen e tij, ata më treguan, unë bisedova me vëllain e tij e që ne së bashku kemi një kujtim që na lidhë neve si familje, kështu që unë kam çelësin e shtëpisë së kësaj familje, dhe tani unë jam një Qytetare Nderi e Qytetit tuaj, unë jam një bashkëqytetare e juaja dhe mendoj se së bashku ne duhet të punojmë që Kosova të ketë një të ardhme të mirë, një të ardhme më të mirë, dhe unë mund t'ju sigurojë juve se jam krenare që kisha rastin të jem gjithmonë me juve në rrugëtimin tuaj sepse ju nuk kishit aq shume miq.*
*Kam njohur Kosovën në vitin 1990 përmes njerëzve me të cilët ende mbetem mike, një nga ata ka vdekur, në fakt dy nga ata kane vdekur, ishte Ibrahim Rugova , ishte Adem Demaci i cili ishte qytetar i këtij qyteti, pastaj ju lutem mos të harrojmë, ishte Bujar Bukoshi i cili luajti një rol mjaft të rëndësishëm në Gjermani, kështu që mendoj se kisha tre miq të mirë të cilët gjatë gjithë kohës më ndihmuan mua të mësoj për gjendjen tuaj dhe vendit tuaj, kështu që mendoj se nuk jemi aty ku ne dëshirojmë të jemi në këtë vend, kështu që mund të them ne e kemi menaxhuar këtë dhe mendoj që me angazhimin tonë, ne mund t'ia dalim, dhe ne dëshirojmë të bëjmë gjithçka në mënyre që ju të bëheni jo vetëm anëtare të Këshillit të Evropës, por gjithashtu të bëheni anëtar të Bashkimit Europian, sepse kjo është ajo të cilën ju e meritoni. Ju jeni një demokraci funksionale dhe jam krenare të jem qytetare nderi e Podujevës dhe në këtë mënyrë e Kosovës.*
*Ju faleminderit.*

5. **Ndarja e mirënjohjes për z.Ertan Xhihiq për kontributin e tij në sportin llapjan**
   - **Fjalë rasti nga z.Ertan Xhihiq**

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, në mëson tonë kemi edhe një sportdashës të cilin gjithë Llapjanët e njohin, i cili kontributin e vet e dha në ditët më të vështira, kur nuk kishim institucione, kur mungonin gjithçka, ai kontribuoj që futbolli në Llap të arrijë kulmin e suksesit, konkretisht me Klubin Futbollisitik “Besiana” ka arritur që t’i marrë titujt më të rëndësishëm në Ligën e Kosovës, kështu që kryetari i Komunës në shenjë mirënjohjeje për kontributin e dhënë fton z.Ertan Xhihiq që t’i ndaj Mirënjohjen.

*Para pjesëmarrësve në këtë mbledhje, me ceremoni solemne nga Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi i dorëzohet Mirënjohja z.Ertan Xhihiq për kontributin e dhënë në sportin Llapjan.*

Gjatë ceremonisë së dhënies së Mirënjohjes zotrit Ertan Xhihiq, **Kryetari i Komunës z.Shpejtim Bulliqi**, theksoi, për z.Ertan Xhihiq çfarëdo që themi tani mendoj se është e tepërt sepse tani më të gjithë e njohim. Atëherë kur futbolli jonë ishte në baltë, kur futbolli ynë ishte i okupuar, kur në fushat tona nuk lejoheshin të zhvilloheshin aktivitete sportive z.Ertan Xhihiq ka gjetur formë dhe mënyrë që të merret në këtë fushë dhe puno shumë, por jo vetëm, të nxjerrë edhe tituj të atëhershëm në Republikën e Kosovës, prandaj mendoj se kjo Mirënjohje është në shenjë të falënderimit për krejt kontributin e dhënë gjatë asaj periudhe kohore dhe besoj se është njëri prej më meritorëve që edhe përkundër atyre kushteve të rënda ka nxjerrë sportistë të mirë, ka nxjerrë klube të mira dhe ka dhenë suksese në futbollin e Llapit.
Andaj urime juve i nderuar Ertan, dhe tani fjala është për juve.
**z.Ertan Xhihiq**, theksoi, faleminderit Kryetarit të Komunës dhe të gjithë juve të pranishëm miq dhe mikesha. Nuk është vetëm mërit e imja ajo çfarë kemi kontribuuar për sportin në Llap, por është mëritë e të gjithëve e veçmas e bashkëpunëtorëve që kam pas.
Kur e kemi marrë titullin e kampionit, i ndjeri ish Presidenti Ibrahim Rugova në vitin 1995 na e ka dorëzuar kupën e kampionit ngase në një takim që kishim më parë unë së bashku me të ndjerin tash Fadil Vokrrin dhe me bashkëpunëtor tjerë ishim zotuar se do të angazhohemi shumë për të fituar titullin dhe na ishte premtuar se kupën do t’jua dorëzoj unë.
Për fitimin e titullit kampion duhet t’i falënderohemi shumë z.Rrustem Mustafës-Remit, z.Latif Gashit-Latës, të ndjerit tash më Naim Kadriut, dhe shumë e shumë të tjerëve që kemi ardhur deri te ai titull ngase vërtetë e kemi pas të vështirë sepse lojërat i kemi zhvilluar në Dumnicë në një fushë e cila ka qenë e rrethuar me vetëm një tel të metalit por që shikues kishte një numër të madh në atë kohë rreth 3000-4000 shikues e që vlen të falënderohet zotëri Shabani pronar i asaj toke që e ka lëshuar për fushë të futbollit në aty kohë qoftë për KF “Besiana” qoftë KF “Llapi”.
Unë vërtetë tani kam emocione të mëdha dhe nuk di çfarë të them, mirëpo edhe njëherë falënderoj z.Shpejtim Bulliqin dhe gjithë të tjerët për këtë Mirënjohje

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, falënderojmë edhe njëherë z.Ertan Xhihiq për kontributin e dhënë në sportin e Llapit dhe Kosovës në përgjithësi.
Para se të përfundojmë me këtë mbledhje solemne me rastin e shënimit të 25 vjetorit të Çlirimit të Podujevës, ju ftoj për pjesëmarrje në vendosjen e luleve tek memoriali i katër Dëshmorëve të Kombit në sheshin e qytetit Zahir Pajaziti për të vazhduar tek përmendoret e Adem Demaçit dhe Ali Ajetit, mandej në varrezat e Dëshmorëve në fshatin Penuh, kurse pas këtyre homazheve kemi përurimin e Stacionit të Autobusëve në Podujevë.
Edhe njëherë ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje dhe me këtë rast e përfundojmë këtë mbledhje.

**Mbledhja përfundoi në ora 10;45**

**Procesverbalin e mbajti;**
**Enis Sheholli**

| | |
|---|---|
| **Nr.Prot.01-060/04-0039753/24** | **Kryesuesi i Kuvendit** |
| **Podujevë, 19 qershor 2024** | **Hilmi Hoxha** |

# KUVENDI I KOMUNËS

**Procesverbal nga mbledhja e XLI-të (dyzet e një)-*e rregullt*, mandati VII-të, e mbajtur më 27 qershor 2024.**

Mbledhja filloi në orën 13:15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.
Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.
Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:
Nga LVV, *Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokrri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu;; Ardi Hasani; Lirika Maliqi,* kurse munguan; *Xhevdet Maloku; Haki Rudari; Bahri Blakçori.*
*(*Nga LDK *Valon Demolli,; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Ilir Koprani; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani.*
Nga PDK, *Bashkim Syla; Mimoza Abdullahu,* kurse mungoi *Endritë Murati.*
Nga AAK, *Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.*
Nga OBKD, *Gazmend Islami i cili mungoi me arsyetim shëndetësor me shkrim dërguar Kryesuesit të Kuvendit.*
Të pavarur, *Demokrat Hodolli; Adnan Zymeri.*

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;
*(Shuajb Blakçori-Drejtoria e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtoria e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Vlora Humolli Jashanica-Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Alban Zeka-Drejtoria e Inspeksionit DI; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE).*

Të pranishëm ishin edhe mediave lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

## Rendi i Ditës

**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke iu dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë në këtë mbledhje, ndër të tjera theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

1. **Procesverbale nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: *04.03.2024*, *18.04.2024***

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, kemi dy procesverbale nga mbledhjet përkatëse të Kuvendit të Komunës të cilët sigurisht i keni marrë me kohë dhe i keni lexuar, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtyre dy dokumenteve, për ndonjë plotësim – ndryshim apo vërejtje eventuale që mund të keni.

*Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime, miratohen procesverbalet sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## 2. Korniza Afatmesme Buxhetore - KAB e Komunës së Podujevës 2025-2027

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave - DBF, e paraqiti fjalën hyrëse për KAB 2025-2027, theksoi, zhvillmi ekonomik dhe shoqëror është një prej kritereve dhe synim i politikave të qeverisjes lokale dhe në funksion të arritjes së këtyre synimeve është hartuar Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027 ku janë të planifikuara investimet tre vjeçare në çdo sektor me qëllim të përmbushjes së obligimeve zhvillimore të cilat janë të përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal.

Bazuar në Qarkoren Buxhetore për Komunat 2025-2027 e lëshuar nga Ministria e Financave, Komuna e Podujevës ka këto limite buxhetore; për vitin 2025 ka një buxhet prej 33,459,115.oo€, për vitin 2026 ka një buxhet prej 35,074.000.oo€, dhe për vitin 2027 buxheti është 36,677,000.oo€. Pra në bazë të këtyre limiteve buxheti për vitin 2025 do të jetë afër 2 milion euro më i lartë se në vitin 2024 dhe do të vazhdoj të ketë rritje edhe në dy vitet tjera për afërsisht 2 milion euro në vit.

Buxheti për vitin 2025 në bazë të planifikimeve me KAB do të jetë në bazë të kësaj strukture, paga 17,793,000.oo€, mallra 4,090,000.oo€, komunale 633,000.oo€, subvencione 1,810,000.oo€, dhe për investime kapitale 9,132,421.oo€. Pra kjo rritje buxhetore që është prej 2 milion euro në vit shtrihet në të gjitha kategoritë dhe ku kemi rritje në të gjitha kategoritë e shpenzimeve siç janë paga, mallra, subvencione, kapitale e të tjera.

Në këtë dokument të KAB ashtu sikurse edhe në çdo vit tjetër vazhdon të jetë prioritet fusha e arsimit, ekonomisë, shëndetësisë, projekteve të mëdha zhvillimore, infrastrukturës urbane, kulturës rinisë dhe sportit e të tjera.

Në këtë KAB, për fushën e arsimit parashihet një rritje e buxhetit në kategorinë e mallrave si dhe rritje e buxhetit për investime kapitale. Me rritjen e buxhetit në kategorinë e mallrave në këtë sektor do të mundësohet kushte më të mira për procesin edukativ arsimor, mirëpo gjithashtu një rritje të ndjeshme ka edhe kategoria e investimeve kapitale në qoftë se krahasojmë me periudhën e kaluar e që në këto tri vitet e ardhshme parashihen investime në fushën e arsimit rreth 4,671,000.oo€. Për projekte kapitale në fushën e arsimit planifikohen këto investime; ndërtimi i shkollës së mesme ekonomike, ndërtimi i një objekti të ri shkollor në qytet, ndërtimi i shkollës në fshatin Shajkoc, ndërtimi i shkollës në fshatin Bradash, ndërtimi i aneksit të shkollës "Naum Veqilharxhi" në fshatin Llapashticë, ndërtimi i aneksit të shkollës në fshatin Tërrnavë, ndërtimi i aneksit të shkollës në fshatin Dobratin, ndërtimi i aneksit të shkollës në fshatin Dobërdol, ndërtimi i aneksit të shkollës në fshatin Lladoc, ndërtimi i tri anekseve të shkollave të mëdha në qytet (shkollat Dr Ibrahim Rugova, Enver Maloku, Xheladin Rekaliu), pastaj ndërtimi i katër sallave të edukatës fizike, investime dhe renovime në infrastrukturën arsimore. Po ashtu në fushën e arsimit janë edhe një numër i projekteve të financuara nga MASHT siç është ngritja e Çerdheve si dhe është ndërtimi i një shkolle të mesme profesionale ku besojmë se shumë shpejt do të nënshkruhet Memorandumi i Bashkëpunimit. Pra të gjitha këto investime infrastrukturore në fushën e arsimit qojnë deri te arritja e një qëllimi për mësim tërë ditor dhe mësim me një ndërrim në të gjitha shkollat e Komunës së Podujevës.

Në këtë KAB, në fushën e shëndetësisë kemi planifikuar buxhet të mjaftueshëm për mallra dhe shërbime në mënyrë që ky sektor jetik të ketë të gjitha furnizimet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Gjithashtu kemi planifikuar edhe buxhetin për renovimin e objekteve shëndetësore, për furnizim me pajisje mjekësore, kurse për ndërtim nuk kemi ndonjë planifikim por dihet që objektet shëndetësore me ndërtimin e Urgjencës vetëm se është rrumbullakësuar si infrastrukturë shëndetësore, si dhe në kategorinë e subvencioneve kemi një rritje të buxhetit nga 200,000.oo€ në 220,000.oo€ për vitin e ardhshëm.

Në fushën e ekonomisë janë planifikuar 682,152.oo€ ku nga këto 382,152.oo€ janë të planifikuara për Zonën Industriale kur dihet se projekti i Zonës Industriale ka një vlerë prej 3.8 milion euro dhe që është nënshkruar një Memorandum i Bashkëpunimit mes Komunës së Podujevës dhe Ministrisë së Industrisë ku 3 milion euro do të financoj Ministria kurse pjesa tjetër për të cilën ne kemi planifikuar me buxhet është pjesë e cila na obligon neve si Komunë për pagesë të këtij projekti që vetëm është proceduar në prokurim nga ana e Ministrisë së Industrisë. Pastaj janë të planifikuara 300,000.oo€ për ndërtimin e tregut të ri të qytetit, projekt ky i cili po ashtu është me Memorandum të Bashkëpunimit me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal e cila do të investoj pjesën tjetër të projektit.
Në fushën e kulturës dhe sportit janë planifikuar 200,000.oo€ për subvencione, dhe 550,000.oo€ për investime kapitale ku parashihet ndërtimi i pishinës gjysmë olimpike projekt ky i cili po ashtu do të jetë në bashkëfinancim mes Komunës së Podujevës dhe Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, pastaj janë planifikuar ndërtimi i terreneve sportive, investime në trashëgimin kulturore, renovimi i Teatrit të Qytetit e të tjera.
Në këtë KAB janë të planifikuara shumë projekte në fushën e infrastrukturës dhe vlen të ceket se janë planifikuar investime në çdo lokalitet për infrastrukturë rrugore, si dhe gjithashtu është një numër i projekteve më të rëndësishme siç është ndërtimi i rrugës nga rr.”Shaban Shala” deri në rr.“28 Nëntori”, ndërtimi i unazës së qytetit, ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza, ndërtimi i rr.”Bedri Bajrami”, ndërtimi i rr.”Ali Ajeti”, rregullimi i hapësirave publike, ndërtimi i trotuareve dhe shumë projekte të tjera infrastrukturore të cilat janë të planifikuara nga Drejtoria e Urbanizimit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.
Kjo KAB me këto investime të cilat janë të planifikuara besoj se i përgjigjet nevojave zhvillimore të Komunës së Podujevës si dhe është në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Podujevës andaj edhe ju ftoj që ta mbështetni këtë dokument.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, sot para vetës kemi Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës tonë për vitet 2025-2027, dokument ky i cili është një strategji e cila ka për qëllim parashikimet ekonomike dhe financiare të Komunës si dhe është i rëndësishëm dhe si dokument i cili është sjellë nga Drejtoria përkatëse parasheh investime në infrastrukturë në zonat urbane dhe ato rurale, lidhjen e arsimit me tregun gjë që është element i ri që na është sjellë në Kuvend, pastaj parasheh përkrahjen e bizneseve në mënyrë që të zvogëlohet papunësia dhe të ndikoj në zhvillimin ekonomik, zhvillimin e turizmit, zhvillimi bujqësisë e të tjera.
Ajo që është me rëndësi dhe që është diçka e re në këtë Kornizë që na është sjellë këtu është trajnimi për burimet dhe resurset njerëzore si dhe shumë e rëndësishme përdorimi i softverve të avancuar për shërbime që është një element i ri ku po kalojmë nga një fazë të investimeve vetëm bazike në një fazë më të avancuar duke bërë përdorimin e teknologjisë për zhvillim të përgjithshëm ekonomik të Komunës ton.
Se nga vijnë të hyrat nga të cilat bazohen këto buxhete dhe kjo rritje kontinuele buxhetore në vitin 2025 deri në vitin 2027 janë nga tatimi në pronë, tatimi në tokë, taksat për leje ndërtimi, taskat administrative komunale, taksat për automjete motorike, certifikatat, qiratë nga objektet dhe qiratë nga toka, participimi në shëndetësi dhe participimi në arsim.
Pra kjo që e potencuam është në “vija të trasha” sa i përket përcaktimit buxhetor dhe mendoj që secili nga ne edhe më herët ka pasë mundësi që të jap ide për t’i inkorporuar në këtë Kornizë, mirëpo ide edhe më shumë të qarta mund t’i japim edhe në planifikimet buxhetore të cilat do të jenë në vitet në vazhdim, andaj një dokument të tillë sugjeroj dhe ju kërkoj të gjithë anëtarëve të Kuvendit që ta përkrahim në mënyrë anonime me qëllim të një perspektive më të gjatë të zhvillimit të Komunës së Podujevës.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, vërtetë të fjalësh për rëndësinë e Kornizës Afatmesme Buxhetore nuk diçka që përcaktohet nga ne rëndësia e këtij dokumenti por me vetë faktin që është një dokument i cili i paraprinë përgatitjes së buxhetit për vitin e ardhshëm, andaj pa dashur të hyjë në detaje nga ajo që e potencuan parafolësit, KAB është një dokument që e ka vizionin, misionin se ku e sheh Komunën dhe ku i jep drejtim Komunës në këto 3 vite që parashihen.
Të kesh parasysh anën ku është përcaktuar vizioni dhe misioni vërtetë të lë një hapësirë që jemi në rregull dhe jemi duke ecë në drejtimin e duhur, mirëpo po sa të hysh në ndarjet gjegjësisht kodet dhe mjetet me të cilat synohet të arrihet këtu krijohen dilemat e para se nuk janë në përputhje apo në harmoni me atë që synohet si vizion dhe mision.
Po mundohem në pika të shkurtra të paraqes disa, në veçanti më ka bërë që t'i gëzohem një projekti që është për herë të parë e që dua të shfaq si anë pozitive, ndërtimin e një Shtëpie Rezidenciale për personat me nevoja të veçanta e që mendoj se vërtetë do ta ndihmonte dhe lehtësonte jetën e atyre që e kanë përditshmëri këtë kategori, ndërsa shqetësuese për mua e që besoj se edhe për qytetarët e Komunës së Podujevës, u fol më shumë edhe nga drejtori parafolës i DBF-së por edhe nga parafolësi kolegu zotëri Fetahu, avancimi në mbrojtjen e mjedisit e që sidomos u potencua një projekt i cili është i filluar vite e vite më parë me mangësitë dhe problemet e tij e që me një masë që ka arritur me implementim deri në një masë të caktuar fjala është për kolektorin e ujërave të zeza, mirëpo shqetësim i imi në këtë rast është se është paraparë kolektori dhe është punuar në drejtim të lumit Llap, lumit Kaqanolli, lumit të Bërvecës, por ka mbet anash sikur të mos ishte i Komunës së Podujevës një lum që vërtetë është një vijë e hapur e kanalizimit në veçanti në muajt e verës, pra ka mbet trajtimi gjegjësisht ndërtimi i kolektorit përgjatë lumit Dumnica, që pata rastin me kompaninë e cila bënë Dezinfektimin Derratizimin dhe Dezinsektimin që vërtetë është rënduar jeta e njerëzve që jetojnë përgjatë këtij lumi.
Sa i përket gjithë përfshirjes, po shihet që ka një gjithëpërfshirje te investimet kapitale, por ajo gjithëpërfshirje nuk bën të kuptoj se do të ketë projekte të realizuara të cilat vërtetë do të vlerësonim se a po i japin vërtetë drejtim zhvillimit. Vërtetë që KAB bazohet në Strategjinë Zhvillimore të Kosovës, bazohet në Qarkoret e lëshuara nga Ministria dhe tani jemi në fazën e përmbylljes së kësaj dhe jam në dijeni se shkaku i afateve kohore që është 30 qershori ndodhi edhe kjo që brenda ditës dhe në rregull jemi që të kemi një dokument të miratuar me qëllim të plotësimit të kushteve ligjore për buxhetin, po pa dashtë të devijoj nga tema dua që të cekë se kam parë ndarje të mjeteve në shumë lokalitete mirëpo ajo mund të jetë që të kënaqet çdo njëri prej tyre, por të paraqitësh asfaltimin e disa rrugëve në NN vendin me shuma 5,000.oo€; 7,000.oo€; 12,000.oo€ vërtetë nuk e plotëson kriterin bazë dhe nuk del serioze se aty do të jetë një projekt që do të ndikonte në cilësinë e jetës së qytetarëve.
Unë deshta të vë në spikam edhe të mirat edhe jo të mirat e këtij dokument dhe duke pasë parasysh afatet ligjore unë mendoj se ka vend edhe për votën për, edhe kundër, dhe Grupi i LDK-së në një formë me vërejtjet që do t'i shfaqin çdonjëri, mundësinë e votimit e kemi çdonjëri siç e vlerëson vetë dhe me këtë po dëshirojmë të japim një shembull të demokracisë, dhe këtu jemi.
**z.Bashkim Syla**, theksoi, në Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Podujevës për vitet 2025-2027 janë paraqitur misioni, objektivat, parashikimet, të hyrat vetanake.
Ky dokument është obligim ligjor i qeverisjes komunale dhe i paraprinë buxhetit për vitet 2025, 2026 dhe 2027, zakonisht viti 2025 në këtë rast është i përafërt me planifikimin buxhetor ndërsa për dy vitet tjera nuk mund të plotësohet ose ndryshohet, pra në këtë dokument të KAB është planifikuar buxheti i Komunës së Podujevës për vitin 2025 që është 33,459,115.oo€ ku nga grandet dhe trasferet qeveritare janë 31,472,779.oo€ ndërsa nga të hyrat vetanake janë 1,986,336.oo€.

Në faqen 26 të KAB është tabela korniza buxhetore komunale në euro ku janë dhënë të hyrat totale të Komunës siç janë grandet dhe shpenzimet tjera për vitet 2022; 2023; 2024; 2025; 2026 dhe ajo që më bëri përshtypje është që për vitet 2022 dhe 2023 nuk janë dhënë shifra të sakta të shpenzimeve totale komunale.
Sa i përket projekteve kjo KAB përfshinë projekte të mira, sidomos investimet në rrugët e qytetit të lirojnë qytetin në një formë, kurse pavarësisht kësaj te investimet kapitale kam 3 vërejtje, dhe atë, te paraqitja e projekteve nëpër Drejtori, infrastrukturë publike shembull meremetimi i rrugëve me zhavorr është në shumë 300,000.oo€ por nuk është cekë se në cilat vende do të investohet ngase është shumë bukur e madhe e mjeteve buxhetore andaj edhe do të ishte mirë të ishte më e specifikuar kjo pikë. Pastaj kemi për rindërtimin e rrugëve shumën 500,000.oo€ por që nuk është pasqyruar asnjë rrugë e cila do të rindërtohet, kurse te Drejtoria e Arsimit e cila për vitin 2025 ka buxhet 770,000.oo€ kurse nuk është paraparë asnjë shumë buxhetore për ndërtimin e Çerdhes në fshatin Gllamnik. Pra këto ishin tri vërejtjet që kam unë, por do të shohim sepse kjo KAB ka edhe projekte të mira, ka investime kështu që ne Grupi i PDK-së për çdo propozim vendim që është sjellë për të mirë të qytetarëve e kemi përkrahur dhe mbështetur duke e arsyetuar por që kundër nuk kemi dalë asnjëherë.
**znj.Arnisa Sylejmani**, theksoi,  kam një pyetje për drejtorin e DBF-së, në këtë dokument të KAB të Komunës së Podujevës për vitet 2025-2027 qysh në fillim në faqen e 2 e keni cekë se i keni kushtuar shumë rëndësi aspektit të barazisë gjinore, a mendoni se është dashtë të specifikohet në mënyrë më të qartë se qysh është menduar t'i kushtohet rëndësi të veçantë kësaj çështje.
**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, edhe unë i kam disa shqetësime të cilat dua t'i paraqes rreth këtij dokumenti, shembull tek objektivat e Komunës së Podujevës, te pika zhvillimi i kulturës rinisë dhe sportit në Komunën e Podujevës, pastaj njëra prej pikave thot përkrahja e biznesve bë mënyrë që të ulet papunësia, ngritja e Parkut Industrial, mandej subvencionimi i ndërmarrjeve të vogla, subvencionimi dhe mbështetja e punësimit të grave dhe subvencionimi i bizneseve te gratë.
Ta marrim shembull tek zhvillimi i kulturës rinisë dhe sportit, ne veç se po e shohim në Komunën e Podujevës se qysh po subvencionohen ku i jepen 15,000.oo€ një personi nga Peja që është arsimtar i gjeografisë nga Leshani i Pejës, pastaj një personi nga Suhareka i jepen 8,000.oo€ dhe të tjerë nga komunat tjera kurse atyre të Podujevës ju jepen nga 300 € e që gjysma e tyre i'u shkojnë për përgatitjen e dokumenteve, andaj kur t'i përgatitini dokumentet për ta zhvilluar sportin në Podujevë jua jepni njerëzve të Podujevës dhe mos dilni jashtë Komunës së Podujevës.
Drejtori i DBF-së nuk e përmendi po as unë nuk e kam parë në dokumente Palestrën Sportive, kurse ne jemi në dijeni se këtu në Kuvend e kemi ndarë një pronë për ndërtimin e Palestrës Sportive për të cilën ish drejtori pati premtuar se brenda 2-3 muajve fillon ndërtimi kurse ne nuk kemi parë ende asgjë në atë drejtim ashtu siç edhe në këtë KAB nuk e pash që figuron si projekt.
Po ashtu nuk e di përse nuk është paraparë ndërtimi i kolektorit përgjatë lumit Dumnica që edhe kolegu parafolës e përmendi, përgjatë së cilit përfshihen shumë fshatra, prej Dumnicës, Shtedim, Sfeçël, Siboc, Dumosh, Llugë e të tjerë, dhe është shumë e nevojshme të ndërtohet kolektori përgjatë këtij lumi andaj nuk e di përse është shmangur kjo, madje as zgjerimi i këtij lumi nuk figuron askund. E them këtë sepse unë jetoj në atë pjesë dhe mund të them se vërshimeve i'u përballojmë disi por erërave dhe kundërmimeve të kanalizimeve në atë lum nuk mund t'iu përballojmë ngase janë tepër të shfaqura sidomos gjatë verës.
Mandej kemi Pishinën Gjysmë Olimpike të cilën e përmendi drejtori i DBF-së por edhe ky si projekt ka një kohë të gjatë që përmendet dhe po ashtu në këtë Kuvend kemi votuar një parcelë për ndërtimin e saj por që pastaj ka pasë paraqitje publike ku është thënë se do t'i ndërrohet vendi këtij

projekti sepse nuk është vendi i mirë ai që është ndarë e që unë personalisht nuk e di a ka mbet aty ku është votuar apo ka lëvizë.
Po ashtu më bërë përshtypje investimi në rr.”Bedri Bajrami” sepse tani së fundmi unë nuk e di ku është rr.”Bedri Bajrami” sepse është heq ai emër i asaj rruge që ka qenë në tabelë dhe është vendosur “Doris Pack” andaj ne tani duhet ta dimë se cilin emër e mban ajo rrugë, e që drejtori i Drejtorisë kompetente besoj se e kupton se çfarë e pyeta dhe besoj se do të më shpjegon këtë.
**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, sot në kuadër të KAB dëshiroj të paraqes një propozim që ka të bëjë me një çështje shumë të rëndësishme për shoqërinë tonë që është subvencionimi i nënave lehona.
Duke marrë parasysh se nënat tona janë shtylla kryesore e familjes dhe shoqërisë tonë dhe duke marrë parasysh vështirësitë që ato kalojnë para dhe pas shtatzënisë, unë sot propozoj që në Kornizën Afatmesme Buxhetore të ndahen 200,000.oo€ për nënat lehona.
**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore paraqet parashikimin trevjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale, do të thotë KAB 2025-2027 planifikohet në bazë të buxhetit ku edhe janë përcaktuar objektivat e Komunës.
Objektivat e Komunës së Podujevës janë objektiva që përputhen edhe me objektivat e Qeverisë së Kosovës të cilat janë të shprehura në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe në programet e Qeverisë, pra siç e keni parë kjo KAB ka një gjithëpërfshirje.
Përkundër nevojave në Komunën e Podujevës kemi pasë fshatra në të kaluarën në të cilat nuk është investuar asnjë cent, një i tillë ka qenë edhe fshati Sylevicë e që tani më gëzon fakti që në këtë KAB është planifikuar asfaltimi i rrugës ku në vitin 205 janë paraparë 95,000oo€ kurse për vitin 2026 janë paraparë edhe 215,000.oo€. Pra pas shumë dekadash pritje fshati Sylevicë do të bëhet me një rrugë të re të asfaltuar.
znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, edhe ne Grupi i LDK-së e mbështesim propozimin e znj.Drita Pajaziti për subvencionim të nënave lehona, konkretisht që mjetet buxhetore të parashihen në këtë KAB.
**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, theksoi, falënderoj të gjithë parafolësit për diskutimet dhe propozimet e paraqitura lidhur me këtë dokument të KAB dhe po përpiqem të jap përgjigje për të gjitha. Lidhur me çështjen e ndarjeve buxhetore, misionit dhe vizionit që u diskutuan ne këtë e kemi bërë në bazë të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal si dhe orientimeve strategjike që ka Komuna e Podujevës që t’iu përgjigjemi me ndarjet buxhetore për përmbushjen e atyre objektivave dhe synimeve, normalisht duke pas parasysh edhe kufizimet buxhetore që ka Komuna e Podujevës.
Ndërtimi i Shtëpisë Rezidenciale vetëm ka filluar që është një bashkëfinancim me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit” dhe shpresojmë se shumë shpejt të përfundoj ai projekt.
Sa i përket kolektorit që u cek nga dy parafolës, është në procedurë të prokurimit dhe për disa arsye së shpejti fillon të ri procedohet dhe të rifilloj ndërtimi i kolektorit të ujërave të zeza që është një çështje shqetësuese për Komunën e Podujevës mirëpo përveç kolektorit është e domosdoshme edhe impianti i ujërave të zeza e që nuk është e planifikuar në KAB për arsye se do të jetë financim nga ana e Qeverisë së Kosovës përkatësisht përmes një kredie nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, kështu që do të ndërtohet edhe impianti i ujërave të zeza së bashku me komplet rrjetin fekal dhe kanalizimin e ujërave të zeza ku pastaj do të përpunohen në atë impiant.
Çështje tjetër që u diskutua ishte edhe ajo e z.Bashkim Syla rreth ndërtimit të Çerdhes në fshatin Gllamnik e që vërtetë se nuk figuron në këtë KAB por ndërtimi i Çerdhes në fshatin Gllamnik ka hyrë në planifikime dhe së shpejti do të procedohet në prokurim nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe do të ndërtohet Çerdhja në fshatin Gllamnik, mirëpo e vërteta është se nuk figurojnë në këtë KAB edhe ndërtimet e Çerdheve tjera që ne i kemi prioritet në këtë dokument të KAB, mirëpo do të ketë një numër të madh të Çerdheve që do të ndërtohen nga ana e Ministrisë andaj meqë këto do të ndërtohen nga fondet e Ministrisë dhe fondet e IPA normalisht se nuk e kemi parë të nevojshme

t'i përfshijmë në KAB por kemi liruar mjete buxhetore për projekte tjera sepse normalisht se nevojat gjithherë janë shumë të mëdha për Komunën e Podujevës sikurse që janë edhe për çdo Komunë tjetër.
Pati edhe disa çështje që u shtruan nga asambleisti z.Ekrem Rrahmani ku njëra prej tyre kishte të bënte me Palestrën Sportive për të cilën është e vërtetë se është caktuar një lokacion për ndërtimin e asaj Palestre që do të jetë financim nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit e që shpresojmë se do të filloj së shpejti, pastaj u shtrua edhe çështja e Pishinës Gjysmë Olimpike projekt ky i cili po ashtu do të jetë një bashkëfinancim me Ministrinë e cekur dhe këto mjete buxhetore të cilat normalisht janë të pamjaftueshme sepse ai projekt ka vlerën afërsisht 4 milion euro, por që pjesa tjetër do të jetë investim i MKRS.
Lidhur me rrugën "Bedri Bajrami" bëhet fjalë për rrugën nga shkolla e mesme ekonomike në drejtim të Parkut të Pishave por që KAB si dokument ka filluar të hartohet më herët dhe ka mbet ashtu por nëse vie deri te emërtimi i rrugës do të shqyrtohet kur kemi shqyrtimin e buxhetit, prandaj besoj se të gjithë e njohim për cilën rrugë po bëhet fjalë.
Pra këto ishin sqarimet dhe përgjigjet për çështjet të cilat u shtruan, ne ashtu siç e ceka edhe në fillim kemi pas këto prioritete të Komunës së Podujevës të cilat janë përfshirë në këtë KAB siç është arsimi ku kemi një rritje të madhe të buxhetit për arsim në rast se krahasojmë me periudhat e kaluara, pastaj jemi në dijeni se Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik në të kaluarën ka pas jo ekzistent faktikisht kurse tani ka një buxhet për investime kapitale 680,000.oo€, pastaj për subvencione 300,000.oo€, mandej kemi rritje të buxhetit për subvencione në fushën e bujqësisë ku tani kemi të planifikuara 750,000.oo€ për vitin 2025 si dhe kemi një rritje dhe një prioritizim duke u bazuar në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Podujevës.
Gjithashtu pati një çështje që e ngriti znj.Arnisa Sylejmani që lidhet me çështjen e barazisë gjinore dhe për buxhetimin gjinor, por që tani çdo projekt që figuron në këtë KAB fillimisht i përgjigjet të gjitha shtresave të popullsisë dhe shumica e projekteve janë që i përgjigjen në mënyrë të barabartë të dy gjinive ngase në çoftë se bëhet fjalë për ndërtimin e një rruge ajo rrugë do të jetë e përdorshme prej të gjithëve, pastaj në mënyrë më specifike është ndërtimi i trotuareve që më shumë do t'i shërbej kësaj çështje, do të thotë kemi mjete të planifikuara për ndërtimin e trotuareve, për ndriçimin publik, mirëpo edhe ndërtimi i Çerdheve që e ceka se nuk figuron në këtë KAB por që do të jetë investim nga Ministria e Arsimit.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, nga ajo që dëgjuam prej drejtori parafolës si përgjigje për pyetjet apo sugjerimet që ishin, ishte në shprehje propozimi që në këtë KAB të zënë vend si projekte jetike për qytetarët unë e përmenda kolektorin në lumin Dumnica, projekt të cilin në planifikime buxhetore apo projektbuxhet nuk e kemi pasë asnjëherë dhe nuk e di si mund të jetë procedura e prokurimit por që nëse është në procedura të prokurimit jemi në rregull atëherë, mirëpo sa di unë as nuk është paraparë me projektbuxhet të këtij viti që jemi por nuk e kam parë as në KAB si projeksione për tri vitet e ardhshme, uroj të jem unë gabim apo që nuk e kam parë.
Ne mund t'i përmendim shumë projekte qoftë impiant, kolektor e që ndoshta mund të krijojmë dilemë tek qytetarët, çështje kjo e cila është diskutuar dhe e di sepse jetojmë këtu ashtu siç e di edhe koston e një impianti e që Komuna e Podujevës pa ndihmën ndokujt dhe pa donacione e ka të vështirë ta ndërtoj një impiant që i trajton ujërat e zeza gjegjësisht ndotësirat që krijohen dhe që përshkojnë lumenjtë e Llapit.
Të gjithë qytetarët e dinë që kolektori është vetëm bartje, gyp, tubacion që bartë ujërat e zeza dhe që kan për qëllim anashkalimet e vendbanimeve që të mos rëndohen aty për aty me ujëra të zeza.
Gjithashtu diçka që më bëri shumë përshtypje i nderuar drejtor i DBF-së, kërkoj falje por ti e përdore ashtu dhe mua më tingëllojë në vesh kur e potencuat arsimin dhe buxhetin në arsim, por

që të gjithë ne që jemi këtu jemi në dijeni se grandi specifik për arsim dhe shëndetësi pak apo fare varet nga ne si Komuna sepse është grand specifik prej Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe i njëjti ndahet në bazë të formulës së tyre që kanë, ne krejt çka mund të ndikojmë aty kemi të hyrat vetanake që mund t'jua ndihmojmë ose nga të hyrat që këto dy sektor inkasojnë vet përmes participimeve të ndryshme, prandaj kjo fjalia, e kemi një buxhet tepër të madh, sugjeroj ta heqësh këtë fjalën "tepër të madh" ose bëje paksa më të vogël dhe të mbetet si një buxhet që plotëson nevojat, por jo të thuhet tepër të madh, ngase po tingëllon si diçka tepër e madhe që nuk meritojmë por që i'u kemi dhënë atyre. Pastaj u tha në fjalinë tjetër për një Drejtori tjetër ku shprehet se ka pas një buxhet gati inekzistent, mos kështu. Pra edhe njëherë e potencoj se grandi specifik për arsim dhe shëndetësi dihet qysh është.
**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, theksoi, dëshiroj vetëm edhe një sqarim sa i përket grandit specifik për arsim dhe shëndetësi e që është e vërtetë se ka një grand specifik për arsim dhe shëndetësi i cili llogaritet në bazë të formulës për të cilat Komunat nuk kanë të drejtë ligjore t zvogëlojnë atë buxhet që i përcaktuar në këta dy sektorë, mirëpo në bazë të grandit specifik për arsim investimet kapitale janë 110,000.oo€ mirëpo i kemi fut 1,700,000.oo€ për arsye se Komuna e gëzon të drejtën e propozimeve dhe Kuvendi i Komunës e gëzon të drejtën e miratimit të buxhetit i cili shtohet nga grandi i përgjithshëm, pra grandin e arsimit nuk ke të drejtë ta zvogëlosh por ke të drejtë të marrësh mjete buxhetore nga grandi i përgjithshëm dhe ta rrisësh atë. Do të thotë mbi limitin e mjeteve buxhetore që kemi si grand specifik i arsimit për investime kapitale, kemi rreth 17 herë më shumë buxhet të planifikuar për arsim sepse është prioritet, andaj të bëhet 17 herë më i lartë nuk ka dëshmi më të madhe se arsimi është shumë prioritet për Komunën e Podujevës.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar drejtor i DBF-së unë specifikisht nuk deshta të hyjë por vetëm tregova çka është grandi specifik dhe çka mund të intervenojmë ne, minimumi futja e duarve në grandin specifik nuk lejohet dhe këtë e dim edhe unë edhe ti, por ne çka mund të intervenojmë është nga mjetet buxhetore e që kemi intervenime të tilla.
Unë e kuptoj se ju sot jeni të ulur përballë neve dhe implementoni një program të subjektit tuaj politik, këtu jemi në rregull dhe shumë e kuptoj këtë, mirëpo të potencosh vazhdimisht prioritetin e arsimit dhe të shëndetësisë duke përfshirë edhe mirëqenien sociale, i kuptoj të gjitha këto, por nuk mund të thuhet, buxhet tepër të madh, pastaj të thuhet buxheti ka qenë tepër inekzistent, kjo po tregon tepër diskrepancë në këtë rast.
Deri vonë Kryetari i Komunës ka qenë udhëheqës i Drejtorisë së Arsimit, dhe unë e di se investimet kapitale në këtë Drejtori që drejtori po thotë se buxheti ka qenë tepër pak, ka qenë në kompetencë të Ministrisë dhe nivelit qendrorë, konkretisht ndërtimi i shkollave, nuk ka qenë kompetencë e Komunës fare, por tani është bërë shumë mirë që ajo kompetencë dhe mundësi është deleguar tek Komunat ngase po nisem prej një shembulli indvidual që e kam ku Komuna ka projektuar dy shkolla dhe i ka përfunduar kurse ajo e nivelit qendrorë që ka filluar në fshatin Llugë qe tri vite është dhe Zoti e din kur do të përfundoj.
**znj.Edona Shabani**, theksoi, i nderuar drejtor i DBF-së, ashtu sikurse kolegut tim edhe mua më tingëllojë në vesh përgjigja juaj në pyetjen e znj.Arnisa Sylejmani sa i përket barazisë gjinore për çka e potencove se për barazi gjinore kemi shtruar rrugë, unë asnjëherë nuk e kam ditë që barazia gjinore matet me asfalt dhe këtë e them seriozisht që asnjëherë barazi gjinore që matet me asfalt nuk kam parë. Me asfaltimin e rrugëve përfitojnë pleqtë, moshat e mesme dhe po ashtu moshat e thyera, por barazia gjinore nuk ka të bëjë me asfalt, përndryshe kur nuk keni përgjigje mund të mos japni por jo të thuhet dika e tillë. Pra kjo ishte e cila deshta t'ua them sepse nuk munda pa ju thënë.

**z.Bashkim Syla**, theksoi, unë e di që drejtori i DBF-së është shumë i përkushtuar, mirëpo për pyetjen që e parashtrova sot, të njëjtën e kam bërë në vitin 2022 dhe e kam marrë të njëjtën përgjigje, pastaj të njëjtën përgjigje për të njëjtën pyetje në vitin 2023, dhe po ashtu të njëjtën përgjigje e mora tani në vitin 2024, kështu që edhe në vitin 2025 sigurisht se do t'jua bëjë të njëjtën pyetje por mos harro dhe mos më jep përgjigjen e njëjtë, ndryshoje paksa përgjigjen nëse veç nuk bëhet ajo punë. Fjala është për ndërtimin e Çerdhes në fshatin Gllamnik.
**z.Adnan Zymeri**, theksoi, dëgjova disa prej kolegëve të cilët potencuan rëndësinë e Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe po ashtu edhe unë pajtohem se është dokumenti më i rëndësishëm në të cilën duhet të bazohet hartimi i buxhetit të një Komune. Në të njëjtën kohë nëse KAB proceduralisht hartohet mirë mandej edhe buxheti bëhet i mirë e pastaj përtej buxhetit edhe raportet e auditimit na vijnë më të mira, mirëpo në rastin që ne jemi duke diskutuar procedura se si ka ardh deri te hartimi i këtij dokumenti të KAB konsideroj se nuk është në rregull për shkak se në këtë KAB duhet ta ketë pjesën e vetë të participimit edhe Kuvendi i Komunës, por jo vetëm Drejtoria përkatëse të organizon takime ku ftohen qytetarët e që nuk kanë qenë në pjesëmarrje të kënaqshme sa i përket numrit të pjesëmarrësve e që rrjedhimit nuk mendoj se kërkesat e tyre nuk janë paraqitë në mënyrën më të drejtë të mundshme.
Po ashtu u theksua disa herë se duhet të bazohet në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal - SZHEL si dhe në dokumentet tjera të rëndësishme strategjike të Komunës, mirëpo ne e kemi një draft SZHEL të cilës i del afati në vitin 2025 ndërsa këtu në këtë KAB janë bërë planifikime për periudhën kohore 2025 – 20207.
Diçka prej elementeve tjera që kam hasë në këtë KAB është edhe duplifikimi i projekteve, shembull e kemi mirëmbajtjen e trotuareve në vlerë 50,000.oo€, në të njëjtën kohë kemi edhe subvencionimin e Ndërmarrjeve Publike e që mendoj se një pjesë e madhe e këtyre mjeteve i përkasin edhe Ndërmarrjes publike “Eko-Llapi” e cila pritet të themelohet dhe ta kryej të njëjtën punë për tçë cilën janë ndarë një pjesë e mjeteve buxhetore në vlerë 50,000.oo€.
Element tjetër i rëndësishëm e që besoj se e kam potencuar edhe në deklarimet tjera se te fusha e arsimit duhet pasur shumë kujdes dhe të bëhet në lloj studimi i fizibilitetit sa i përket çështjes së ndërtimit të shkollave për shkak të lëvizjeve të mëdha që janë duke u bërë, është shumë e rëndësishme anekset e shkollave nëpër fshatra të ndryshme që janë planifikuar për t'u ndërtuar, mirëpo konsideroj se duhet pasë kujdes në këtë drejtim.
Gjithashtu janë edhe disa elemente tjera që unë nuk i kam pas mjaftueshëm të qarta, njëra prej tyre është parashikimi në vlerë më të ultë e tatimit në pronë në vitin 2025, ku nga 705,256.oo€ sa janë vitin aktual, në 631,226.oo€ për vitin 2025 dhe për këtë nuk e di cila është arsyeja e këtij parashikimi. Element tjetër është edhe shpenzimet e larta për energji elektrike të cilat i ka Komuna ku shembull për vitin 2025 parashikohen të jenë rreth 350,000.oo€ shpenzime të energjisë elektrike për të cilat mendoj se Komuna duhet ta ketë një lloj plani se si duhet t'i reduktoj këto shpenzime dhe a ka ndonjë ide tjetër për të dalë në ndonjë rrjetë tjetër të ndriçimit.
Ka edhe disa terma tjerë siç është shembull për neve që nuk jem profesionist, qysh është rasti i furnizimit me dokumentacion mjekësor në vlerë 50,000.oo€ e që unë konkretisht nuk e kam pas të qartë këtë, pastaj edhe te investimet kapitale nëpër fshatra të caktuara siç është fshati prej nga vijë unë fshati Bajçinë janë të planifikuara 20,000.oo€ andaj nuk e di cili ka qenë kriteri i ndarjes së këtyre mjeteve buxhetore jo vetëm në fshatin e cekur por nëpër fshatrat tjera të Komunës së Podujevës, mirëpo nëse ekziston një projekt për të cilin definitivisht meriton që të aprovohet kjo KAB është projekti të cilin e përmendi edhe kolegu z.Naim Çunaku, është ndërtimi i Qendrës Rezidenciale për personat me aftësi të kufizuara.

**z.Hilmi.Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, theksoi, vetëm deshta ta lus drejtorin e DBF që propozimit të koleges znj.Drita Pajaziti t'i gjen vend diku në buxhet, të gjenden mjetet buxhetore dhe të mbështeten me një shumë buxhetore gratë lehona sepse vërtetë ka nevojë.
**znj.Drita Pajaziti**, nga vendi thekson se ka propozuar një shumë buxhetore dhe ajo të mbetet si propozim për tu votuar.
**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, vërtetë e nderuar që propozove por jemi në konsolidim të buxhetit dhe kjo nuk mund të votohet sepse tani për tani nuk i ka mjetet buxhetore por ndërkohë duhet të gjejë forma dhe mënyra që t'i siguroj ato për tu përfshirë në buxhetin final.
**z.Shpejtim Bulliqi**, **Kryetar i Komunës**, theksoi, vërtetë sot është jashtëzakonisht e rëndësishme që në rend të ditës kemi Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2025 - 2027, një plan buxhetor orientues për këtë periudhë kohore në të cilin kemi bërë përpjekje maksimale që të trajtohen gjitha ato fusha të rëndësishme të cilat janë dhe që lidhen me projekt të rëndësishme në interes të qytetarëve dhe të cilat besoj që do t'jua lehtësojnë jetën qytetarëve në përgjithësi.
I dëgjova me vëmendje edhe vërejtjet që u potencuan e që mendoj se ka vend për t'u analizuar, por ajo që mund t'ju themi është fakti që në Komunën e Podujevës jemi dëshmitar të gjithë se janë duke u realizuar një varg projektesh të rëndësishme kapitale në interes të qytetarëve dhe sigurisht që edhe në të ardhmen do të vazhdohet me projekte të tilla, me projekte të mëdha dhe unë besoj se jo ne të gjitha do të arrijmë t'i përfundojmë sepse do të mbeten edhe shumë punë dhe shumë projekte tjera në të ardhmen që do të bëhen, qoftë prej neve që jemi qoftë prej ndokujt tjetër.
Kështu që ajo që deshta t'ju informoj juve është çështja e kolektorit të ujërave të zeza, projekt i cili tani veçse është në proces, jeni në dijeni se ka pas ankesa dhe është në proces të shqyrtimit të ankesave, mjetet buxhetore ekzistojnë dhe janë të planifikuara për atë projekt dhe në momentin që do të krijohet hapësirë për të vazhduar tutje ne kemi hapësirë për fillimin e implementimit të këtij projekti
Çështja tjetër e që besoj se edhe ju e dini, është në fazën fillestare inicimi i studimit të fizibilitetit për impiantin e ujërave të zeza që është duke u bërë nga një Kompani Ndërkombëtare nga Belgjika nëse nuk gaboj, por që është një projekt i cili do të zhvillohet dhe financohet në mes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Kompanisë Regjionale të Ujësjellësit "Prishtina" që është duke u punuar në këtë projekt dhe ne si Komunë i kemi dhënë të gjitha informacionet e nevojshme për këtë Kompani projektuese dhe besoj se për një kohë jo të gjatë do ta kemi një draft të fizibilitetit.
U përmend edhe energjia elektrike që u tha se janë shpenzime të mëdha, është e vërtetë por ju sigurisht po e vëreni se për çdo ditë po kemi kërkesa të mëdha të zgjerimit të rrjetit të ndriçimit publik andaj zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik normale që rritë edhe nevojën për planifikime dhe shpenzime shtesë.
Po ashtu mund t'ju informoj se ne tani kemi bërë studimin e fizibilitetit të mundësisë së kalimit në Smart City që nënkupton ndriçim të mençur i cili sigurisht se do t'i reduktoj shpenzimet, dhe arsyeja pse ende në këtë vite ende nuk kemi investuar në zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik është fakti që kemi pritur këtë fizibilitet që të shohim se çfarë po na ofrohet, dhe mund t'ju them se fizibiliteti është pozitiv që ndikon në uljen dhe zvogëlimit të shpenzimeve në zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik dhe ndoshta disa prej këtyre trupave ndriçues që i kemi në qytet por edhe në pjesët përreth do të kemi mundësi që me të njëjtit trupa ta zgjerojmë rrjetin e ndriçimit publik edhe më tutje në pjesët më periferike të Komunës së Podujevës si dhe njëkohësisht të kemi një reduktim të shpenzimit të energjisë elektrike.
Po ashtu dëshiroj t'ju jap një lajmë të mirë se nesër do ta nënshkruajmë një Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për ndërtimin edhe të një objekti të ri shkollor Shkollë e mesme profesionale e cila do të ndërtohet në Parkun e Biznesit, që është në

vlerë 1.7 milion euro, pra nesër pasdite do të nënshkruhet mes meje dhe Ministres së MASHT dhe është informacioni më i ri që e kemi sot.
Po ashtu jemi në diskutim me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit që të bashkë financojmë dhe të fillojmë realizmin e projektit të Pishinës Gjysmë Olimpike dhe shpresoj shumë që n'këto ditë do të nënshkruhet Memorandumi për bashkëfinancimin e ndërtimit të Pishinës në fjalë, dhe njëkohësisht ju informoj se mjetet buxhetore për ndërtimin e Palestrës Sportive janë në dispozicion dhe nëse nuk gaboj shuma është rreth 1.7 milion euro sërish nga MKRS dhe sipas gjitha gjasave Palestrën Sportive do të jemi të obliguar ta orientojmë në një parcelë që e kemi prapa parkut të pishave, pra janë dy mundësi ku njëra është që nëse planifikojmë në të ardhmen që ta ndajmë pronën përkatëse të cilën e kemi shpronësuar në fshatin Sfeçël ta bëjmë një qendër sportive apo kompleks sportiv me një stadium të madh të futbollit dhe stadiume tjera ndihmëse por edhe mund t'i koncentrojmë edhe objekte tjera sportive në atë lokalitet për arsye se kemi një sipërfaqe me rreth 9 hektar në atë lokalitet e që mendoj se është një pozicion jashtëzakonisht i përshtatshëm, mirëpo ne si Komunë një kompleks të tillë nuk mund ta ndërtojmë por e vetmja mundësi është financimi nga MKRS në bashkëpunim me Federatat përkatëse sportive për të pas mundësi të krijimit ndoshta edhe shtigjeve të atletikës dhe për gjitha sportet tjera të nevojshme që mund të zhvillohen, andaj e them se ky është një projekt paksa më ambicioz dhe nuk mund të jap edhe informacione tjera përderisa nuk kemi ndonjë përgjigje pozitive prej atyre që kanë gatishmëri të investojnë, në fakt sigurisht që e keni parë se para neve si institucion z.Tahir Batatina e ka paraqitë në rrjete sociale, kështu që neve na mbetet që pas zotëri Batatinës ta japim për opinionin publik këtë informatë apo gjysmë informatë nëse mund ta quaj.
Çështja tjetër që besoj se ja vlen të diskutohet dhe ja vlen që si projekt të përkrahet, është propozimi i asambleistes znj.Drita Pajaziti rreth mundësisë së ndarjes së një shume buxhetore 200,000.oo€. Komuna e Podujevës ka rreth 1000 lindje brenda vitit, pra janë afërsisht sepse planifikim të sakt nuk mund të kemi, andaj edhe shuma buxhetore është përafërt nëse vendosim që lehonave t'ju ndajmë një shumë prej 200 €, do të thotë se shuma prej 2000,000.oo€ ta mbulon këtë subvencionim i cili besoj se është i qëndrueshëm dhe që ja vlen të hyjë në projeksione buxhetore e që unë bashkërisht me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave do ta analizojmë dhe besoj se do të gjejmë mundësi që të futet si projeksion buxhetor në mënyrë që të bëhet ndarja e mjeteve për këtë kategori.
Ajo që mund t'ju them është se punët janë duke u zhvilluar mirë dhe ashtu siç janë planifikuar, mund të ketë në ndonjë projekt aty këtu ndonjë ngecje t]ë vogël gjë që nganjëherë nuk po varet shumë nga ne sepse jemi duke punuar me këto kompani që janë. Gjithashtu besoj shumë që kjo KAB do të jap dhe do të hap edhe shumë rrugë tjera, por sigurisht presim edhe shumë investime tjera që do të vijnë nga niveli qendrorë në saje të një bashkëpunimi të mirë që kemi pothuajse me të gjitha dikasteret qeveritare.
Ju falënderoj për përkrahjen dhe besoj se bashkërisht do të kemi mundësi ta implementojmë në mënyrë graduale sipas periudhave përkatëse kohore.
**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, me gjithë respektin që kam për ty Kryesues i Kuvendit, realisht nuk është kompetencë e jotja t'i thuash drejtorit të DBF-së që t'ia gjej vendin një propozimi.
Ashtu siç jemi në dijeni KAB është sjellë në Kuvend dhe sigurisht që drejtori i DBF-së e din që do të ketë kritika, sugjerime dhe propozime, andaj kjo gjë nuk tolerohet ashtu siç u cek.
Është nënkuptuar që do të ketë propozime, ishte një propozim që e bëra unë dhe ka mundur të jenë edhe të tjera, pra të planifikohet propozimi që e paraqita unë.

**z.Hilmi Hoxha**, **Kryesues i Kuvendit**, duke i'u përgjigjur parafolëses theksoi, ju falënderoj e nderuar zonja Pajaziti mirëpo meqë DBF nuk kishte mjete të planifikuara për propozimin e juaj andaj edhe kërkova që të gjenden mjetet buxhetore dhe të përfshihen në planifikime. Pra kjo ishte arsyeja që unë e potencova unë kurse ti si duket paske keqkuptuar sepse unë e përkraha propozimin por edhe 200,000.oo€ nuk është ndonjë shumë e madhe e cila mund të paraqet ndonjë problem ngase po i bie 200 € në vit. Përndryshe e nderuar kur të bësh propozime të tilla është mirë paksa t'i analizosh e jo vetëm të jepet një shumë dhe pastaj duke mos qenë në dijeni se si do të dal. Ai ose ajo që paraqet propozime të tilla duhet t'i analizoj para se t'i paraqet në Kuvend.
**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, nuk ka çka të analizohet, kemi kategorinë e subvencioneve dhe aty mund të planifikohen.
**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, realisht ne kemi kategorinë e subvencioneve në shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Përndryshe mua personalisht mu duk shumë e vogël ajo që u paraqit.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, më shumë se 2-3 herë u përmend kolektori i ujërave të zeza dhe nuk po e kuptoj se a unë nuk po di të shprehem apo dikush nuk po ka vesh të dëgjoj. Unë isha konciz, kolektori për trajtimin e ujërave ë zeza në lumin Dumnica. Ne kemi kolektor në lumenjtë tjerë, mirëpo unë e potencova lumin Dumnica që është një prej bartësve më të mëdhenj ku kemi derdhjet më të mëdha të kanalizimeve në mënyrë të pakontrolluar, ku kemi një shtrirje të madhe të banorëve, andaj dua konciz të di për lumin Dumnica, nuk diskutova për lumenjtë tjerë.
Sa i përket intervenimit në propozimin e znj.Drita Pajaziti, i nderuar Kryesues i Kuvendit vërtetë ishte një gaf i juaji sepse nuk mundesh nga foltorja e Kryesuesit t'i thuash në rregull po e lusim drejtorin përkatës, ne nuk jemi këtu që ta lusim askënd sepse i nderuar Kryesues për të satën ju them se pronar i buxhetit të komunës është Kuvendi i Komunës dhe qytetarët, propozues është Ekzekutivi i Komunës në këtë rast. Nuk vendos drejtori për buxhetin, ne jemi ata që vendosim për buxhetin e Komunës, drejtori vetëm propozon. Prandaj në këtë rast i jap të drejtë koleges znj.Drita Pajaziti edhe pse thënë të drejtën këtë propozim më shumë e pritja nga znj.Adelinë Stublla që tani është Drejtoresh e DSHMS sepse për një mandat të tërë pati propozuar një gjë të tillë, mirëpo meqë drejtoresha e DSHMS nga vendi po potencon se tani Kryeministri i Kosovës z.Albin Kurti po i subvencionon, unë i them drejtoreshës meqë po thua se është ashtu, nguceni edhe pak Kryeministrin që edhe ato banesat sociale t'i bënë më shpejt sepse pastaj shkojnë.
**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, theksoi, vetëm një sqarim lidhur me çështjen e propozimit të znj.Drita Pajaziti, u përmend disa herë edhe nga unë por edhe nga ju Qarkorja Buxhetore e lëshuar nga Ministria e Financave, ne kemi një limit buxhetor që është përcaktuar me këtë Qarkore që është 33,459,115.oo€, ju si Kuvend dhe ne si propozues këtë limit nuk kemi të drejtë ta tejkalojmë as 1 euro e as të lëm 1 euro më pak. Do të thotë se kjo KAB është në përputhej me këtë limit buxhetor që është përcaktuar me Qarkoren Buxhetore të Ministrisë, ndërsa një propozim që mund të vie siç është ky tani në shumë 200,000.oo€ për subvencione, apo që mund të jetë një tjetër për ndonjë projekt tjetër me një shumë ta zëm 1 milion euro, ato mjete duhet të minusohen diku sepse as nuk guxon të tejkalohet buxheti e as të zvogëlohet, përndryshe edhe pse KAB është dokument strategjik prap se prap merr një vlerësueshmëri ligjore nga ana e Ministrisë së Financave e që mund të ndodh të na e kthej sërish në këtë Kuvend këtë buxhet, madje për 1 cent ndryshim.
Ne kemi një shumë 220,000.oo€ të planifikuara subvencione në DSHMS dhe në bazë të politikave që bënë kjo Drejtori ose në bazë të një vendimi që mund ta merr Kuvendi i Komunës që të subvencionohen lehonat me shumën përkatëse sepse kur të vie puna e te vendimi i Kuvendit duhet të ketë një vendim të prerë që çdo lehonë për fëmijën e lindur të subvencionohet ta zëm me 110 €, 150€ apo 200€, varësisht prej vendimit të Kuvendit dhe prej mjeteve buxhetore që janë të planifikuara ne pastaj si DBF jemi të obliguar ta ekzekutojmë atë vendim që e merr Kuvendi i

Komunës, mirëpo duhet të jetë në bazë të planifikimit dhe në bazë të limiteve buxhetore të cilat janë në KAB, përndryshe sa për propozime të gjithë mund të keni nga një propozim dhe për të gjitha e rritim buxhetin me nga 200,000.oo€ dhe do të rritej goxha shumë, mirëpo nuk mund të del përtej këtij limit që e ceka. Tani e them se o na mbetet ta votojmë këtë KAB mbi bazën e këtij dokumenti që është paraqitur dhe ato 220,000.oo€ të cilat janë të planifikuara mund të përdoren edhe për lehona, dhe kur të vie çështja e përgatitjes dhe shqyrtimit të buxhetit kjo shumë mund të rritet dhe të tërhiqen subvencione nga kategoritë e tjera. E them këtë sepse kur të vie buxheti ne do të marrim një Qarkore tjerët buxhetore prej Ministrisë së Financave ku do t'i kemi të limituara edhe kategoritë ku thuhet ta zëmë 1 milion e 800 mijë euro kemi për subvencione, dhe nuk mund të tërheqësh më nga një projekt kapital por duhet të lëvizësh përbrenda kategorisë së subvencioneve, kështu që kjo mbetet çështja ku janë 220,000.oo€ në DSHMS dhe ai propozim mund t'i takoj një vendimi jashtë KAB dhe në rast se vendosim të rriten subvencionet në DSHMS duhet ta dimë se në cilën kategori dhe në cilin projekt të zvogëlohen këto fonde.
Në qoftë se më leni mua buxhetin në diskrecion timin unë mund të paraqes krejt një buxhet tjetër, por duhet të vendos Kuvendi i Komunës.
**z.Naim Çunaku**, theksoi, sërish nuk mora një përgjigje prej drejtorit të DBF-së çka me kolektorin e ujërave të zeza përgjat lumit Dumnica që nuk parashihet as në tri vitet e ardhshme.
A jam edhe unë qytetar i këtij vendi, në fakt i gëzohem investimeve në lumenjtë tjerë siç është lumi Llap, lumi Bërvenica, por përse unë të mos e shohë një projekt të tillë edhe në lumin Dumnica, unë i kuptoj ato teknikalitete që u tha se për ta futur një projekt duhet hequr një tjetër, jam i vetëdijshme, por ta kam paravetës një dokument që planifikon edhe për tri vitet e ardhshme se si do të duket dhe si do të kundërmon lumi Dumnica sigurisht mua më shqetëson dhe dëshiroj të di përse nuk kanë zënë vend ai projekt në këtë KAB, ndërsa për mua shumë i parëndësishëm është asfaltimi i rrugëve me 10,000.oo€ e 15,000.oo€ sepse është rrumbullaksuar asfaltimi i rrugëve përveç disa nevojave individuale sepse është rrumbullaksuar qarkullimi i lirë i qytetarëve të Komunës së Podujevës, mirëpo tani është problem jetik ruajtja e ambientit dhe unë propozoj që t'i jepet prioritet ruajtjes së ambientit, në këtë rast të gjendet mundësi dhe hapësirë në projeksione sepse më shqetëson që në tri vitet e ardhshme nuk është paraparë që do të ketë asnjë investim në funksion të kundërmimit në lumin Dumnica për çka edhe kërkova.
**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, theksoi, konsideroj se përgjigja u dha sa i përket çështjes së shtruar nga parafolësi, megjithëse edhe drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit nuk është prezent këtu, e thash se është një projekt në procedura të prokurimit ku vlera e parashikuar e atij projekti është 2.2 milion euro, nuk jam qind për qind i sigurt por sa jam në dijeni parashihet komplet rrejti i kolektorëve të ujërave të zeza dhe atu është i planifikuar edhe mbledhja e ujërave të zeza në lumin Dumnica. Përveç kësaj sepse nuk mjafton, por ashtu siç e ceku edhe Kryetari i Komunës, parashihet edhe impianti i ujërave të zeza sepse ujërat që grumbullohen nëpër kolektor duhet të pastrohen diku sepse përndryshe nuk zgjidhin problem. pra ai projekt kap vlerën mbi 20 milion euro që do të financohet nga niveli qendror por nuk figuron në KAB të Podujevës, kolektorët janë në finalizim e që ju tregova se mbi 1 milion euro janë në procedurë të prokurimit.
Edhe njëherë sa i përket çështjes së propozimeve dhe votimit të kësaj KAB e sqarova njëherë po e ndjejë edhe njëherë që t'ju kërkoj të votohet kjo KAB me këto limite buxhetore që janë, 220,000.oo€ janë në DSHMS, merret vendim nga Kuvendi i Komunës, kalkulohet vlera financiare e kësaj dhe nëse ka nevojë për mjete shtesë kur të vie puna te çështja e buxhetit mbi bazën e shumës së nevojshme për subvencionimin e lehonave dhe normalisht që kur të vie çështja e buxhetit subvencionet duhet të zvogëlohen diku tjetër, pra kjo KAB ka mjete buxhetore në shumë 220,000.oo€ dhe janë të planifikuara por për çka do të përdoren mbetët që me një vendim të

Kuvendit të Komunës jashtë KAB, vie çështja e buxhetit kalkulohet financiarisht ajo shumë, për q sa ka nevojë të shtohen mjete buxhetore duhet të shtohen në pozicionin e subvencioneve në kuadër të programit të mirëqenies sociale të DSHMS.
**z.Shpejtim Bulliqi**, **Kryetar i Komunës**, theksoi, vetëm edhe një sqarim i nderuar Naim Çunaku, në atë buxhet që është planifikuar për kolektor të ujërave të zeza janë të gjitha linjat, është lumi Batllava, lumi Dumnica dhe lumi Llap.  Jeni në dijeni se afërsisht janë 15 km që janë kryer me atë kredin që ka qenë rreth 5 milion euro e që 1 km na ka kushtuar rreth 400,000.oo€, andaj duke pas parasysh çmimin tejet të lartë që është planifikuar, ne patëm ndarë shumë buxhetore që ta bëjmë vet ne si Komunë sepse kalkulimet që i kemi bërë ne ka dal që afërsisht 175,000.oo€ kushton 1 km dhe duke marrë parasysh këtë gjatësi dhe matjet që janë bërë në lumenjtë e Battlavës, Tërrnavës, dhe Dumnicës është planifikuar që kjo shumë buxhetore ka mundësi t'i mbuloj këto linja në mënyrë që ta sjellim krejt në një pikë kolektorin e ujërave të zeza.
Pra Kështu është planifikimi prej DSHPMSH dhe besoj se kështu do të vazhdoj të zhvillohet edhe pse nuk është e titulluar kështu ngase është titullar si projekt vetëm kolektori i ujërave të zeza por nuk është definuar se ku është, te lumi Llap, te lumi Dumnica apo diku tjetër, kështu që unë këtë punë e di kështu siç e potencova dhe besoj se kështu do të jetë. Pra e kemi menduar këtë çështje dhe kemi punuar në këtë drejtim, ndërsa tjetër gjë që nuk ishte fati i mirë me procedurat e prokurimit andaj besoj që në momentin që do të zhbllokohet në proceduar të prokurimit do të vazhdohet me realizmin e tij.
Çështja tjetër, nuk e kam paravetës planifikimin buxhetor dhe nuk e di sakt, por i nderuar drejtor i DBF-së nëse ka hapësirë te buxheti i subvencioneve në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik të merret një shumë e caktuar 30,000.oo€ - 50,000.oo€, pastaj një shumë prej 50,000.oo€ mund të marrësh nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe atë shumën e ndarë te DSHMS prej 220,000.oo€ të rrisësh në 320,000.oo€ në mënyrë që në të ardhmen nëse do të kemi nevojë për mjete shtesë në këtë program duhet të ulemi bashkërisht dhe të analizojmë se ku mund të merren pjete shtesë për mbulimin e kërkesave për subvencione në DSHMS, nëse jo në këtë formë atëherë ne mund të shkojmë në këtë formë që kemi mirëpo domosdo do të detyrohemi pastaj të bëjmë një rishikim të buxhetit apo tek buxheti final mund ta rrisim buxhetin te DSHMS kështu që ky problem mund të zgjidhet, andaj nuk është nevoja që të komplikohet kjo çështje në këtë fazë.
**znj.Adelinë Stublla**, drejtoresh e DSHMS, theksoi, sa i përket çështjes së ngritur nga asambleisti z.Adnan Zymeri lidhur me dokumentet mjekësore që u cek se nuk po kuptohet si term, në dokumente mjekësore hyjnë udhëzimet laboratorike, udhëzimet për referime tek specialistët, udhëzimet për referimet tek radiologu, formularët për analiza, raportet mjekësore dhe në kudër të tyre hyjnë edhe shenjat mjekësore, vërtetimet për lirimin e nxënësve nga mungesat në shkolla e të tjera të ngjashme, pra kjo është si një përmbledhje e përgjithshme.
Sa i përket asaj që e potencoj asambleisti z.Naim Çunaku rreth çështjes së banesave apo siç quhet banimi i përballueshëm , jemi duke punuar në këtë drejtim ku do të ndërtohen tri blloqe me 176 banesa në total e që si kriter do të jetë mosha 37 vjeçare e një qifti, kështu ty e as mua fatkeqësisht nuk do të na takoj.
**z.Ragip Fetahu**, theksoi, më vie mirë që ideja për përkrahjen e nënave lehona po ri aktualizohet ashtu siç gjatë kohës kur kam qenë edhe unë anëtar i Kuvendit është drejtoresha aktuale e DSHMS znj.Adelinë Stublla në vazhdimësi e ka ngritur zërin që të përkrahen nënat lehona.
Ajo që unë sugjeroj është se kjo çështje të analizohet mirë, do të thotë shuma e planifikuar për nënat lehona të planifikohet vetëm brenda 1 viti në KAB, apo planifikimi të jetë në periudhën 3 vjeçare ashtu siç është edhe KAB, çështje kjo e cila duhet të qartësohet.

Çështja tjetër është se duke pasë parasysh që KAB është planifikim ose orientim buxhetor se ku duhet të përcaktohet, të përkrahet dhe të subvencionohet, është mirë që drejtoresha e DSHMS të ketë bashkëpunim dhe koordinim me propozuesen znj.Drita Pajaziti në mënyrë që këtë propozim ta bëjnë më të qartë dhe më konkret dhe pastaj ta inkorporojnë në buxhetin e vitit 2025, andaj mendoj se kjo KAB të mbetet kështu siç apo si variant i dytë të kërkojmë një pauzë të shkurtër 15-20 minuta me qëllim të gjetjes së një zgjidhje për këto mjete të kërkuara.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, ju falënderoj z.Ragip Fetahu mirëpo propozimi i drejtorit të DBF-së ishte shumë i qartë dhe nuk mendoj se kemi nevojë për pauzë.
**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, ndoshta u përmend shumë herë çështja e kolektorit të lumit Dumnica, mirëpo ndoshta nuk është diçka keq që nuk është këtu prezent drejtori i DSHPMSH, por po e theksoj se e kam pyetur, nuk është në projekt në tri vitet e ardhshme. Është lumi Batllava, lumi Llap, por lumi Dumnica nuk është, të hënën e kam pyetur dhe përgjigja e tij ka qenë se nuk është, kurse tani kryetari pak më parë e tha që është, por nëse drejtori i DBF e din saktësisht a është apo nuk është. Me paksa shaka e them që nuk e di ndoshta veç se jam unë pjesë e asaj ane apo çka është puna për këtë çështje.
**Kryesuesi i Kuvendi**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim Kornizën afatmesme Buxhetore të Komunës së Podujevës për periudhën 2025 – 2027 sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe propozimin e znj.Drita Pajazit që i njëjti të përfshihet në dokument.

*Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 25 vota Për, nga anëtarët prezent në sallë, miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Podujevës për vitet 2025-2027*

3. **Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1798-0, ZK Podujevë**
   3.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe njëkohësisht i autorizuar për kryerjen e punëve dhe ushtrimin e funksionit të DPKGJ deri sa drejtoresha e kësaj Drejtorie të kthehet nga pushimi i lehonisë, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, lidhur me këtë propozim vendim kërkoj nga ana juaj që ta mbështetni në mënyrë që të hapen mundësit ligjore për zhvillimin e procedurave për dhënien e kësaj prone në shfrytëzim që është në interes të zhvillimit ekonomik dhe rritjes së mirëqenies sociale të qytetarëve.
Njëkohësisht për këtë pikë të rendit të ditës propozoj edhe anëtarët e komisionit përkatës, dhe atë nga ana e Ekzekutivit të Komunës propozoj drejtorët Bahri Selimi dhe Shuajb Blakçori, kurse nga sektori joqeveritar lokal / shoqëria civile kanë aplikuar 4 organizata dhe propozoj Fadil Halimin.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, pra nga Ekzekutivi i Komunës dhe nga shoqëria civile kemi propozimet e dhëna për anëtar të komisionit përkatës, kurse kërkohet edhe dy anëtar nga radhët e Kuvendit, andaj urdhëroni.
**znj.Sebastina Vokrri**, theksoi, nga radhët e Grupit të LVV-së propozojmë Florent Hasanin.
**z.Valon Demolli**, theksoi, sa i përket propozim vendimit për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1798-0, ZK Podujevë e përkrahim, kurse në emër të Grupit të LDK-së propozojmë Naim Çunakun ër anëtar në komisionin përkatës.

**z.Florent Hasani**, theksoi, unë tërhiqem nga ky komision që u propozova, dhe për anëtare në këtë komision propozoj Sebastina Vokrrin
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.
Thërras dhe kërkoj që të respektohet barazia gjinore në formimin e komisioneve.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 21 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1798-0, ZK Podujevë, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, në këtë përbërje:*
*z.Bahri Selimi, nga Ekzekutivi i Komunës*
*z.Shuajb Blakçori, nga Ekzekutivi i Komunës*
*znj.Sebastina Vokrri, nga Kuvendi i Komunës*
*z.Naim Çunaku, nga Kuvendi i Komunës*
*z.Fadil Halimi, nga sektori joqeveritar lokal*

4. **Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-2159-0, ZK Batllavë**
   4.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe njëkohësisht i autorizuar për kryerjen e punëve dhe ushtrimin e funksionit të DPKGJ deri sa drejtoresha e kësaj Drejtorie të kthehet nga pushimi i lehonisë, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, për propozim vendimet për miratime paraprake besoj se arsyetimi është i njëjtë dhe e keni materialin, mirëpo tani e tutje do të propozoj vetëm emrat nga radhët e ekzekutivit dhe sektorit jo qeveritar lokal për anëtarë në komisionin përkatës.
Nga Ekzekutivi i Komunës propozoj Vlora Humolli Jashanica dhe Bahri Selimin, kurse nga shoqëria civile Fadil Halimin.
Pra ka të drejtë që anëtar të komisioneve të jenë të njëjtit persona në më shumë se një komision.
**znj.Sebastina Vokrri**, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e mbështesim propozim vendimin përkatës sipas kësaj pike të rendit të ditës, ndërsa për anëtar në komisionin përkatës e propozojmë Florent Hasanin.
**z.Valon Demolli**, theksoi Grupi i LDK-së e përkrahë këtë propozim vendim dhe anëtare në komisionin përkatës e propozojmë Donjetë Sheqirin.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 18 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në*

*<u>shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-2159-0, ZK Batllavë</u>, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe <u>propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim</u>, në këtë përbërje:*
*znj.Vlora Humolli Jashanica, nga Ekzekutivi i Komunës*
*z.Bahri Selimi, nga Ekzekutivi i Komunës*
*z.Florent Hasani, nga Kuvendi i Komunës*
*znj.Donjetë Sheqiri, nga Kuvendi i Komunës*
*z.Fadil Halimi, nga sektori joqeveritar lokal*

5. **Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-893-0, ZK Batllavë**
   5.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe njëkohësisht i autorizuar për kryerjen e punëve dhe ushtrimin e funksionit të DPKGJ deri sa drejtoresha e kësaj Drejtorie të kthehet nga pushimi i lehonisë, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës propozohen Shuajb Blakçori dhe Lirie Hoti, ndërsa nga shoqëria civile propozoj Arta Ahmeti.
**z.Florent Hasani**, theksoi, për këtë propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-893-0, ZK Batllavë, e mbështesim dhe për anëtare në komisionin përkatës nga Grupi i LVV-ës e propozojmë Drita Pajazitin.
**z.Valon Demolli**, Grupi i LDK-së edhe këtë propozim vendim e përkrahë dhe për anëtare në komisionin përkatës propozon Edona Shabanin
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 21 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet <u>propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-893-0, ZK Batllavë</u>, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe <u>propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim</u>, në këtë përbërje:*
*z.Shuajb Blakçori, nga Ekzekutivi i Komunës*
*znj.Lirie Hoti, nga Ekzekutivi i Komunës*
*znj.Drita Pajaziti, nga Kuvendi i Komunës*
*znj.Edona Shabani, nga Kuvendi i Komunës*
*znj.Arta Ahmeti, nga sektori joqeveritar lokal*

6. **Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-425-1, ZK Zakut**
   6.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe njëkohësisht i autorizuar për kryerjen e punëve dhe ushtrimin e funksionit të DPKGJ deri sa drejtoresha e kësaj Drejtorie të kthehet nga pushimi i lehonisë, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës propozohen Alban Zeka dhe Lirie Hoti, ndërsa nga shoqëria civile propozoj Arta Ahmeti.
**z.Florent Hasani**, theksoi, për këtë propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-425-1, ZK Zakut, e mbështesim dhe për anëtare në komisionin përkatës nga Grupi i LVV-së e propozojmë Artrit Mulliqin.
**z.Valon Demolli**, Grupi i LDK-së edhe këtë propozim vendim e përkrahë dhe për anëtare në komisionin përkatës propozon znj.Tringa Sfishtën.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 20 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-425-1, ZK Zakut, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, në këtë përbërje:*
*z.Alban Zeka, nga Ekzekutivi i Komunës*
*znj.Lirie Hoti, nga Ekzekutivi i Komunës*
*z.Artrit Mulliqi, nga Kuvendi i Komunës*
*znj.Tringa Sfishta, nga Kuvendi i Komunës*
*znj.Arta Ahmeti, nga sektori joqeveritar lokal*

7. **Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-427-0, ZK Zakut**
   7.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe njëkohësisht i autorizuar për kryerjen e punëve dhe ushtrimin e funksionit të DPKGJ deri sa drejtoresha e kësaj Drejtorie të kthehet nga pushimi i lehonisë, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës propozohen Leutrim Krasniqi dhe Adelina Stublla, ndërsa nga shoqëria civile propozoj Shqipdon Rushiti.
**z.Florent Hasani**, theksoi, edhe këtë pikë të rendit të ditës e përkrahim dhe për anëtar në komisionin përkatës e propozojmë Ragip Fetahun.

**z.Valon Demolli**, theksoi, po ashtu Grupi i LDK-së këtë propozim vendim e përkrahë dhe për anëtare në komisionin përkatës propozon znj.Arnisa Sylejmani.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 20 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet <u>propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-427-0, ZK Zakut</u>, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe <u>propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim</u>, në këtë përbërje:*
*z.Leutrim Krasniqi, nga Ekzekutivi i Komunës*
*znj.Adelinë Stublla, nga Ekzekutivi i Komunës*
*z.Ragip Fetahu, nga Kuvendi i Komunës*
*znj.Arnisa Sylejmani, nga Kuvendi i Komunës*
*z.Shqipdon Rushiti, nga sektori joqeveritar lokal*

8. **Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-429-0, ZK Zakut**
   8.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe njëkohësisht i autorizuar për kryerjen e punëve dhe ushtrimin e funksionit të DPKGJ deri sa drejtoresha e kësaj Drejtorie të kthehet nga pushimi i lehonisë, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës propozohen Leutrim Krasniqi dhe Adelina Stublla, ndërsa nga shoqëria civile propozoj Shqipdon Rushiti.
**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, për këtë propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-429-0, ZK Zakut, e mbështesim dhe për anëtar në komisionin përkatës nga Grupi i LVV-së e propozojmë Kasib Bashotën.
**znj.Tringa Sfishta**, theksoi, Grupi i LDK-së këtë propozim vendim e përkrahë dhe për anëtar në komisionin përkatës propozon z.Fahri Hasanin.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 20 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet <u>propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-429-0, ZK Zakut</u>, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe <u>propozim vendimi</u>*

*për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, në këtë përbërje:*
*z.Leutrim Krasniqi, nga Ekzekutivi i Komunës*
*znj.Adelinë Stublla, nga Ekzekutivi i Komunës*
*z.Kasib Bashota, nga Kuvendi i Komunës*
*z.Fahri Hasani, nga Kuvendi i Komunës*
*z.Shqipdon Rushiti, nga sektori joqeveritar lokal*

9. **Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-860-2, ZK Revuç**
    9.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe njëkohësisht i autorizuar për kryerjen e punëve dhe ushtrimin e funksionit të DPKGJ deri sa drejtoresha e kësaj Drejtorie të kthehet nga pushimi i lehonisë, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës propozohen Avni Fetahu dhe Alban Zeka, ndërsa nga shoqëria civile propozoj Arnisa Gubetini.
**znj.Drita Pajazit**, theksoi, Grupi i LVV-së e mbështet këtë propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-860-2, ZK Zakut, për anëtar në komisionin përkatës e propozojmë asambleisten e AAK-së Mrika Thaqin.
**z.Ekrem Rrahmani**, theksoi, Grupi i LDK-së e përkrah edhe këtë propozim vendim dhe për anëtar në komisionin përkatës propozon Arjant Topanicën.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 21 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-860-2, ZK Revuç, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, në këtë përbërje:*
*z.Avni Fetahu, nga Ekzekutivi i Komunës*
*z.Alban Zeka, nga Ekzekutivi i Komunës*
*znj.Mrika Thaqi, nga Kuvendi i Komunës*
*z.Arjant Topanica, nga Kuvendi i Komunës*
*znj.Arnisa Gubetini, nga sektori joqeveritar lokal*

10. **Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-860-3, ZK Revuç**
    10.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe njëkohësisht i autorizuar për kryerjen e punëve dhe ushtrimin e funksionit të DPKGJ deri sa drejtoresha e kësaj Drejtorie të kthehet nga pushimi i lehonisë, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës propozohen Avni Fetahu dhe Alban Zeka, ndërsa nga shoqëria civile propozoj Arnisa Gubetini.
**z,Kasib Bashota**, theksoi, Grupi i LVV-së e mbështet këtë propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-860-3, ZK Zakut, për anëtar në komisionin përkatës e propozojmë Haki Rudarin.
**z.Arjant Topanica**, theksoi, Grupi i LDK-së e përkrah edhe këtë propozim vendim dhe për anëtare në komisionin përkatës propozon Arjeta Salihu Abazi.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 23 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-860-3, ZK Revuç, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, në këtë përbërje:*
*z.Avni Fetahu, nga Ekzekutivi i Komunës*
*z.Alban Zeka, nga Ekzekutivi i Komunës*
*z.Haki Rudari, nga Kuvendi i Komunës*
*znj.Arjeta Salihu Abazi, nga Kuvendi i Komunës*
*znj.Arnisa Gubetini, nga sektori joqeveritar lokal*

11. **Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1207-0, ZK Llapashticë e Epërme**
    11.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe njëkohësisht i autorizuar për kryerjen e punëve dhe ushtrimin e funksionit të DPKGJ deri sa drejtoresha e kësaj Drejtorie të kthehet nga pushimi i lehonisë, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës propozohen Shuajb Blakçori dhe Vlora Humolli Jashanica, ndërsa nga shoqëria civile propozoj Arnisa Gubetini.

**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, Grupi i LVV-së e mbështet këtë propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe për anëtar në komisionin përkatës e propozojmë Ardi Hasanin.
**z.Valon Demolli**, theksoi, Grupi i LDK-së e përkrah edhe këtë propozim vendim dhe për anëtar në komisionin përkatës propozon Ilir Kopranin.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 22 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1207-0, ZK Llapashticë e Epërme, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, në këtë përbërje:*
*z.Shuajb Blakçori, nga Ekzekutivi i Komunës*
*znj.Vlora Humolli Jashanica, nga Ekzekutivi i Komunës*
*z.Ardi Hasani, nga Kuvendi i Komunës*
*z.Ilir Koprani, nga Kuvendi i Komunës*
*znj.Arnisa Gubetini, nga sektori joqeveritar lokal*

**12. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-202-1, ZK Lupç i Poshtëm**

12.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe njëkohësisht i autorizuar për kryerjen e punëve dhe ushtrimin e funksionit të DPKGJ deri sa drejtoresha e kësaj Drejtorie të kthehet nga pushimi i lehonisë, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës propozohen Shuajb Blakçori dhe Adelina Stublla, ndërsa nga shoqëria civile propozoj Shqipdon Rushiti.
**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, Grupi i LVV-së e mbështet këtë propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe për anëtar në komisionin përkatës e propozojmë Xhevdet Malokun.
**z.Valon Demolli**, theksoi, Grupi i LDK-së e përkrah edhe këtë propozim vendim dhe për anëtar në komisionin përkatës propozon Arjant Topanicën.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 22 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-202-1, ZK Lupç i Poshtëm, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe propozim*

*<u>vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim</u>, në këtë përbërje:*
*z.Shuajb Blakçori, nga Ekzekutivi i Komunës*
*znj.Adelinë Stublla, nga Ekzekutivi i Komunës*
*z.Xhevdet Maloku, nga Kuvendi i Komunës*
*z.Arjant Topanica, nga Kuvendi i Komunës*
*z.Shqipdon Rushiti, nga sektori joqeveritar lokal*

**13. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-209-0, ZK Lupç i Poshtëm**

13.1.*Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF dhe njëkohësisht i autorizuar për kryerjen e punëve dhe ushtrimin e funksionit të DPKGJ deri sa drejtoresha e kësaj Drejtorie të kthehet nga pushimi i lehonisë, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës propozohen Shujab Blakçori dhe Alban Zeka, ndërsa nga shoqëria civile propozoj Fadil Halimin.
**z.Artrit Mulliqi**, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së e mbështet këtë propozim vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe për anëtare në komisionin përkatës e propozojmë Lirika Maliqin.
**znj.Donjetë Sheqiri,** theksoi, në emër të Grupit të LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim dhe për anëtare në komisionin përkatës propozon Edona Shabanin.
**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 22 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet <u>propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-209-0, ZK Lupç i Poshtëm</u>, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe <u>propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim</u>, në këtë përbërje:*
*z.Shuajb Blakçori, nga Ekzekutivi i Komunës*
*z.Alban Zeka, nga Ekzekutivi i Komunës*
*znj.Lirika Maliqi, nga Kuvendi i Komunës*
*znj.Edona Shabani, nga Kuvendi i Komunës*
*z.Fadil Halimi, nga sektori joqeveritar lokal*

**14. Të Ndryshme**

**z.Ragip Fetahu**, theksoi, kam një pyetje për drejtoreshën e DKRS, deri ku kanë arritur projektet e nisura drejtori paraprak i DKRS z.Pajtim Balaj sepse janë një numër i madh i projekteve të filluara nga ish drejtori dhe më nuk kemi informacione se çfarë ka ndodh me ato projekte.
**Kryesuesi i Kuvendit**, kërkon nga anëtarët e Kuvendit të cilët po e lëshojnë sallën që të kthehen në mbledhje sepse në të kundërtën nuk ka kuorum dhe jemi të obliguar që sipas Rregullores së Punës së Kuvendit ta mbyllim këtë mbledhje si shkak i kuorumit.

*(Pati kritika në drejtim të Kryesuesit të Kuvendit nga asambleistët z.Ekrem Rrahamni dhe znj.Tringa Sfishta por edhe disa të tjerët që ishin prezent se nuk është hera e parë që ndodh kjo nga Grupi i LVV-së dhe disa prej drejtorëve të Drejtorive, që në pikën Të Ndryshme e lëshojnë mbledhjen dhe mbetemi pa kuorum, andaj për këtë arsye kemi kukuar që pika Të Ndryshme të trajtohet në fillim të mbledhjes).*

**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, qëllimi është që të bëhet kuorumi dhe të vazhdohet me mbledhjen dhe të përfundoj sipas procedurave e jo të mbetet e hapur dhe të thirret sërish vazhdimi i mbledhjes vetëm me këtë pikë të rendit të ditës.
Përndryshe unë do të thërras vazhdimin e kësaj mbledhje kurdo që e shoh të arsyeshme.
Konsideroj se kjo është papërgjegjësi prej të gjithë atyre që e lëshojnë mbledhjen pa ndonjë arsye të justifikueshme, pavarësisht cilit Grup të subjektit që i takojnë, është mos diciplinë e atyre anëtarëve që veprojnë në këtë mënyrë
**z.Valon Demolli**, theksoi, i nderuar Kryesues edhe ne po e lëshojmë sallën dhe kurdo që e thërrasim vazhdimin e kësaj mbledhje këtu ku kemi mbet, kërkojmë që ta thërrisni.
**Kryesuesi i Kuvendit**, vazhdoi, atëherë në mungesë të kuorumit jemi të detyruar ta përfundojmë këtë mbledhje sepse në sallë për momentin janë vetëm 16 / 17 anëtar/e të Kuvendit, dhe nuk mund të vazhdohet me seancën pa qenë 18 e më shumë në sallë.

*Meqë nuk pati kuorum për të vazhduar mbledhjen, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se pika Të Ndryshme nuk mund të shqyrtohet kështu që ndërprenë këtë mbledhje, me kërkesën e shumicës e anëtarëve të Kuvendit që janë prezent që kjo pikë të shtyhet, përkatësisht mbledhja të thirret dhe të vazhdoi këtu ku ka mbet si pasoj e mos pasjes së kuorumit.*

**Mbledhja përfundoi në orën 15:05**

**Procesverbalin e mbajtën dhe hartuan;**
**Sabedin Namani**
**Arbrim Idrizi**

**Nr.Prot.01-060/04-41844/24**
**Podujevë,**
**27 qershor 2024**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Hilmi Hoxha**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCAVE

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores MAPL nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, ndërlidhur me nenet 62.3, 11; 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja c) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, neneve 17; 38; 60 dhe 61 të Ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nenit 64 paragrafi 4, neneve 14; 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 34 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

*Propozohet*

**VENDIM**
**PËR SHTIM TË BUXHETIT DHE KOD TË RI**

**Neni 1**

Me këtë vendim miratohet shtimi i buxhetit dhe krijimi i kodit të ri buxhetor për projektin "Furnizimi me mekanizëm bujqësor" në vlerë 41,610.00€, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.

**Neni 2**

Projekti mund të krijohet nga mjetet e participimit të qytetarëve bazuar në Marrëveshjet e Mirëkuptimit në mes Komunës dhe përfituesve të subvencionit.

**Neni 3**

Komuna e Podujevës si bartëse e projektit në vlerë të përgjithshme prej 138,700.00€, financon shumën 97,090.00€ apo 70% të vlerës së projektit të cekur, kurse shuma e përgjithshme e participimit nga ana e përfituesve është në vlerë 41,610.00€ apo 30% e vlerës së projektit.

**Neni 4**

Projekti sipas nenit 1 të këtij vendimi mbulohet me mjete financiar nga participimi prej 30% të vlerës së përgjithshme nga ana e përfituesve, ndërsa 70% të vlerës së përgjithshme nga Komuna e Podujevës, dhe i njëjti bënë pjesë në kategorinë subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – kodi i programit 47005

**Neni 5**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

**Neni 6**

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021.

**Nr.prot.** 01-400/08-0046801/24
**Podujevë, datë;** 18.07.2024.

**Drejtori**
**Fatmir Osmani**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCAVE

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores MAPL nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, ndërlidhur me nenet 62.3, 11; 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja c) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, neneve 17; 38; 60 dhe 61 të Ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nenit 64 paragrafi 4, neneve 14; 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 34 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

***Propozohet***

**VENDIM**
**PËR SHTIM TË BUXHETIT DHE KOD TË RI**

**Neni 1**

Me këtë vendim miratohet shtimi i buxhetit dhe krijimi i kodit të ri buxhetor për projektin "Furnizimi me mëshqerra" në vlerë 124,185.6€, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.

**Neni 2**

Projekti mund të krijohet nga mjetet e participimit të qytetarëve bazuar në Marrëveshjet e Mirëkuptimit në mes Komunës dhe përfituesve të subvencionit.

**Neni 3**

Komuna e Podujevës si bartëse e projektit në vlerë të përgjithshme prej 413,952.00€, financon shumën 289,766.4€ apo 70% të vlerës së projektit të cekur, kurse shuma e përgjithshme e participimit nga ana e përfituesve është në vlerë 124,185.6€ apo 30% e vlerës së projektit.

**Neni 4**

Projekti sipas nenit 1 të këtij vendimi mbulohet me mjete financiar nga participimi prej 30% të vlerës së përgjithshme nga ana e përfituesve, ndërsa 70% të vlerës së përgjithshme nga Komuna e Podujevës, dhe i njëjti bënë pjesë në kategorinë subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – kodi i programit 47005

**Neni 5**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

**Neni 6**

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021.

**Nr.prot.**04-400/08-0046804/24
**Podujevë, datë;** 18.07.2024

**Drejtori**
**Fatlum Osmani**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## DREJTORIA E BUXHETIT DHE FINANCAVE

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores MAPL nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, ndërlidhur me nenet 62.3, 11; 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja c) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, neneve 17; 38; 60 dhe 61 të Ligjit nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nenit 64 paragrafi 4, neneve 14; 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 34 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

***Propozohet***

**VENDIM**
**PËR SHTIM TË BUXHETIT DHE KOD TË RI**

**Neni 1**

Me këtë vendim miratohet shtimi i buxhetit dhe krijimi i kodit të ri buxhetor për projektin "Furnizimi me sera" në vlerë 116,852.4€, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere.

**Neni 2**

Projekti mund të krijohet nga mjetet e participimit të qytetarëve bazuar në Marrëveshjet e Mirëkuptimit në mes Komunës dhe përfituesve të subvencionit.

**Neni 3**

Komuna e Podujevës si bartëse e projektit në vlerë të përgjithshme prej 389,508.00€, financon shumën 272,655.6€ apo 70% të vlerës së projektit të cekur, kurse shuma e përgjithshme e participimit nga ana e përfituesve është në vlerë 116,852.4€ apo 30% e vlerës së projektit.

**Neni 4**

Projekti sipas nenit 1 të këtij vendimi mbulohet me mjete financiar nga participimi prej 30% të vlerës së përgjithshme nga ana e përfituesve, ndërsa 70% të vlerës së përgjithshme nga Komuna e Podujevës, dhe i njëjti bënë pjesë në kategorinë subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – kodi i programit 47005

**Neni 5**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

**Neni 6**

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021.

**Nr.prot.** 04-400/03-0046803/24
**Podujevë, datë;** 18.07.2024

**Drejtori**
**Fatlum Osmani**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja h) ndërlidhur me nenet 11; 12 paragrafët 1 dhe 2; 14 dhe 17 shkronjat c) dhe s) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 27 (me theks paragrafët 1 dhe 2) të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënin e Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, ndërlidhur me nenet 34 dhe 35 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 61 paragrafi 1.8, ndërlidhur me nenet 11; 15 paragrafët 1 dhe 2; dhe 19 paragrafët 1.3; 1.19 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i

***PROPOZOHET***

**VENDIM**
**PËR SHPALLJEN NË INTERES TË PËRGJITHSHËM PUBLIK**

**Neni 1**

**1.** Me këtë Vendim shpallen në interes të përgjithshëm publik pronat e paluajtshme të cekura si në vijim:

**1.1.** *Prona/t e paluajtshme në sipërfaqe të përgjithshme 541 $m^2$, sipas certifikatës pronësore nr. 08-942/06-0046883/24 të datës 18.07.2024 , Njësitë kadastrale nr: P-71712062-00244-2 në Zonën Kadastrale Podujevë të evidentuara si Prona shoqërore -Mekanizmi, të cilat janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit.*
*Qëllimi i shpalljes në interes të përgjithshëm publik të kësaj / këtyre pronave është për realizimin e projektit **"Ndërtimi i objektit per Banim të Përballueshëm ".***

**1.2.** *Prona/t e paluajtshme në sipërfaqe të përgjithshme 752 m2, sipas certifikatës pronësore nr 942/06-0046883/24 të datës 18.07.2024 Njësitë kadastrale nr: P-71712062-00244-3 në Zonën Kadastrale Podujevë, të evidentuara si Prona shoqërore -Mekanizmi, të cilat janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit.*
*Qëllimi i shpalljes në interes të përgjithshëm publik të kësaj / këtyre pronave është për realizimin e projektit **"Ndërtimi i objektit per Banim të Përballueshëm ".***

**Neni 2**

Autorizohet Kryetari i Komunës që konform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

**Neni 3**

Për zbatimin e procedurave përkatëse ligjore lidhur me rregullimin e dokumentacionit teknik, regjistrimin e pronës në librin kadastral si dhe çështje e veprime tjera të nevojshme obligohet Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

**Neni 5**

Pas shqyrtimit dhe miratimit, ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

**Nr.Prot.______________________**
**Podujevë, datë:_________________**

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria - Vlada - Government***

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71712062-00244-2

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **08-942/06-0046883/24** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 18.07.2024 - 14:45 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | PODUJEVË / PODUJEVO / PODUJEVË |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Podujevë / Podujevo / Podjevë |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | PODUJEVË / PODUJEVO / PODUJEVË |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type | Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type | Zona U/R G/S U/R | Sipërfaqja Površina Area (m²) | Përshkrim Opis Description | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-71712062-00244-2** | **PARCELË / PARCELA / PARCEL** | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | **541** | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur Mesto zvano Called place | Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code | Emri i rrugës Naziv ulice Street name | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|
| QYTET-Rr. ILIR KUNUSHEFCI | | | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E PODUJEVËS - REPUBLIKA KOSOVO - OPŠTINA PODUJEVO - PODUJEVË/O

**Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person**

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land | Shtëpi-Ndërtese/Kuca-Zgrada/House-Building | | 541 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | PRONA SHOQËRORE - MEKANIZIMI | KCID1711805 | PODUJEVË / PODUJEVO / PODJEVË / | | | 1/1 | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PODUJEVË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Podujevë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-71712062-00244-2 | Parcelë / Parcela / Parcel | 541 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:428

Punoi/Obradio/Created: Valon Beselica
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 18.07.2024
Koha/ Vreme/ Time: 02:57:58

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71712062-00244-3

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **08-942/06-0046883/24** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 18.07.2024 - 14:45 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | PODUJEVË / PODUJEVO / PODUJEVË |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Podujevë / Podujevo / Podjevë |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | PODUJEVË / PODUJEVO / PODUJEVË |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type | Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type | Zona U/R G/S U/R | Sipërfaqja Površina Area (m²) | Përshkrim Opis Description | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71712062-00244-3 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | 752 | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur Mesto zvano Called place | Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code | Emri i rrugës Naziv ulice Street name | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|
| QYTET-Rr. ILIR KUNUSHEFCI | | | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E PODUJEVËS / PODUJEVO

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Podujevës me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Podujevës.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

# 2 Gjetjet dhe rekomandimet[4]

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të mundshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: mungesa e zotimeve, mungesë e projektit ekzekutiv, mosraportim nga menaxherët e kontratave në e-platformën e prokurimit publik, dobësi në menaxhimin e pasurive mbi dhe nën 1,000€, vonesa në inkasmin e llogarive të arkëtueshme. Po ashtu, procesi i raportimit në komunë është përcjellë me mangësi, kjo është vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) të cilat kishin edhe gabime tjera, të cilat janë vërejtur gjatë auditimit dhe pas sugjerimeve tona janë bërë korrigjimet e mundshme. Megjithatë çështjet që ndërlidhen me pasuritë dhe klasifikimin e shpenzimeve nuk janë paraqitur saktë dhe drejtë në PVF. Gjetjet dhe rekomandime kanë për qëllim të përmirësojnë informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.
Gjithashtu duhet të theksojmë se për vitin 2023 Thesari kishte ekzekutuar përmes procedurave përmbarimore/gjygjësore vlerën prej 1,100,795€ këto pagesa për obligimet e dala nga kontrata kolektive të cilat ishin realizuar nga kategoria paga dhe mëditje (765,593€), mallra dhe shërbime (60,880€), subvencione dhe transfere (74,642€) dhe investime kapitale (199,680€). Këto shpenzime kanë të bëjë me pagesat që janë bërë për shujta, inflacion dhe kualifikim për sektorin e arsimit, prej tyre shpenzime të interesit ishin 243 669€.
Ky raport ka rezultuar me 13 rekomandime, prej tyre 5 janë rekomandime të reja, 8 të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

**Çështja B1 - Nënvlerësimi i pasurive mbi 1,000€ dhe nën 1,000€**

| | |
|---|---|
| **Gjetja** | Rregullorja MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6.1. përcakton se, "Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Po ashtu neni 6.3. përcakton se: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".<br><br>Pasurit kapitale mbi 1,000€, të raportuara në nenin 19.3.1 në Raportin Vjetor Financiar ishin nënvlerësuar për shkak se pagesat në vlerë prej 1,293,740€, nuk ishin regjistruar në SIMFK. Po ashtu pasuria jo kapitale nën 1,000€, për vitin 2023, nuk ishte regjistruar në sistemin e-pasurisë në vlerë prej 247,470€, dhe si rezultat këto pasuri ishin të nënvlerësuar.<br><br>Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta në monitorimin dhe verifikimin e regjistrave të pasurisë, ku kjo pastaj ka ndikuar që pasuritë të mos jenë regjistruar në regjistrat përkatës. |
| **Ndikimi** | Mos regjistrimi i pasurisë, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare, mund të ndikon në humbjen a po tjetërsimin e pasurisë dhe prezantimin e informatave jo të plota në pasqyrat |

financiare.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale dhe jo kapitale në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B2 - Keqklasifikim i shpenzimeve**

**Gjetja** Neni 18, paragrafi 3 i Rreguliës Financiare Nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se "shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet t'i aplikojnë.

Nga testimi i mostrave tona, kemi vërejtur keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë prej 301,385€. Nga kjo vlerë thesari kishte paguar sipas vendimit përmbarimor të gjykatës për paga jubilare dhe shujta për arsimtar nga kategori investimet kapitale 199,678€, dhe nga subvencione dhe transfere 46,707€. Po ashtu nga kategoria investime kapitale komuna kishte paguar 55,000€, që për nga natyra i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime.

Këto kishin ndodhur për shkak të planifikimit jo të mirë buxhetor dhe mungesës së mjeteve në kategoritë adekuate.

**Ndikimi** Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpien në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PFV-e.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë që, janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike adekuate.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

**Çështja A1 - Pagesa e projektit nga fondet e një projekti tjetër pa miratim nga Kuvendi Komunal**

**Gjetja**

Neni 16-Ndryshimet në shumat e ndara për projektet kapitale në kuadër të nën programeve paragrafi 11 i Ligji nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 parasheh se "Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal. Ndryshimet e bëra të parapara me këtë nen regjistrohen në SIMFK nga Ministri".

Komuna i kishte paguar 200,000€ nga fondet e projektit "Ndërtimi dhe Rindërtimi i Kanalizimit Fekal dhe Atmosferik nga Fshati Bajqinë deri në Lupq", për projektin "Zgjerimi dhe Rregullimi i Shtratit të Lumit Llap në Qytet", pa u aprovuar transferimi i mjeteve nga Kuvendi Komunal. Vlera e projektit ishte 804,871€.

Kjo ka ndodh pasi që ishte fundi i vitit dhe projekti i kanalizimit nuk ishte iniciuar me kohë, atëherë ishte vendosur nga menaxhmenti që nga fondet e këtij projekti të bëhen pagesa për projektin tjetër pa kërkuar aprovim nga Kuvendi Komunal.

**Ndikimi**

Pagesa e një projekti nga fondet e një projekti tjetër pa miratimin për transferimin e mjeteve nga Kuvendi Komunal mund të ndikoj në dështimin e projektit të cilit ju kanë marrë mjetet.

**Rekomandimi A1**

Kryetari duhet të sigurojë respektimin e procedurave për menaxhimin e fondeve, duke siguruar që çdo transferim i fondeve nga një projekt në tjetrin të miratohet paraprakisht nga Kuvendi Komunal.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A2 - Përdorimi i gabuar i kontratës publike kornizë**

**Gjetja**

Neni 54-Kontratat Kornizë respektivisht paragrafi 54.2 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se "Kontrata publike kornizë është term i përgjithshëm i marrëveshjeve në mes të autoriteteve kontraktuese si dhe operatorëve ekonomik për furnizime, shërbime, dhe punë (riparim/ mirëmbajtje), e cila i vendos termat dhe kushtet sipas të cilave kontratat ndihmëse ose bërja e urdhrave mund të kryhet përmes termave të marrëveshjes.

Komuna gabimisht kishte përdorur llojin e kontratë publike kornizë për punë për projektin kapital "Rrethojat e oborreve shkollore" në vlerë 46,800€, duke lejuar në kontratë +/-30%. Kontrata nuk do të duhej të ishte publike kornizë por për punë me çmim fiks, pasi që kontratat publike kornizë për punë sipas rregullores lejohet vetëm në rastet kur kemi të bëjë me kryerjen e punëve për riparim/mirëmbajtje.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve nga zyra e prokurimit

për t'i respektuar kërkesat ligjore që ndërlidhen me kontratën publike kornizë për punë.

**Ndikimi** Përdorimi i gabuar i llojit të kontratës publike kornizë për punë (riparim/mirëmbajtje ) mund të ndikon që komuna ta realizoj +/- 30% edhe pse natyra e punëve nuk ka të bëjë me punë për riparim/mirëmbajtje por punë që do të duhej të jetë kontratë me çmim fiks.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që zyra e prokurimit zbaton kontratën e duhur ashtu siç e parasheh rregullativa ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B3 - Regjistrimi i pasurisë në kategorinë e gabuar**

**Gjetja** Rregullorja MF-Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 11 parasheh se "Pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim. Pasuritë jo financiare kapitale që janë në fazën e investimeve në vijim nuk zhvlerësohen".

Pasuritë e regjistruara në kodin e gabuar ose jo adekuat ishin në vlerë 379,448€. Kjo lidhet me faktin që pasuritë u regjistruan si pasuri në përdorim, ndërsa ato duhet të ishin regjistruar si investime në vijim.

Kjo ka ndodh si rezultat i mos funksionimit të kontrolleve të brendshme, si dhe mungesa e monitorimit nga ana e menaxhmentit që pasuritë të regjistrohen sipas kërkesave ligjore.

**Ndikimi** Regjistrimi i pasurisë në kategorinë pasuri në përdorim e jo si pasuri investim në vijim ndikon në nënvlerësimin e pasurive komunale.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A3 - Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës Financiare**

**Gjetja** Neni 22 i Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet Kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjellë faturën për pagesë.

Nga 32 mostrat e testuar si pjesë e testimeve substanciale në kategorinë mallra dhe shërbime kemi vërejt se në 13 raste në vlerë 387,491€, nuk janë respektuar hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht është bërë pranimi i mallit dhe shërbimet/furnizimit dhe fatura pastaj është lëshuar zotimi dhe urdhërblerja.

Kjo ishte si pasojë e dështimit të kontrolleve nga zyra e financave dhe prokurimit pasi që zyrtari zotues dhe zyra e prokurimit nuk i kishin respektuar hapat për procedim të pagesave sipas rregullës financiare.

**Ndikimi** Mos respektimi i hapave për procedimin e pagesave mund të shkakton rritjen e obligimeve komunale ndaj operatorëve ekonomik.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë se financat dhe zyra e prokurimit do të ndjekin të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuar me Rregullën Financiare për shpenzimin e parave publike.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B4 - Mungesa e projekteve ekzekutuese**

**Gjetja** Paragrafi 19.17 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik ndër tjerash parasheh se "Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit".

Në tri raste komuna kishte filluar procedurat e prokurimit dhe kishte lidhë kontratë pa hartuar projekt ekzekutiv. Rastet ishin te projekti "Asfaltimi i rrugëve në qytet Lot I" me vlerë 143,954€, "Asfaltimi i rrugëve në qytet Lot III" në vlerë 117,843€, dhe "Rrethojat e oborreve të shkollave" në vlerë 46,800€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së planifikimit të duhur para fillimit të procedurave të prokurimit, duke përfshirë mungesën e hartimit të projektit ekzekutiv për projektet specifike.

**Ndikimi** Mungesa e projektit ekzekutues mund të shkaktoj vështirësi në realizimin e projekteve gjatë fazës së ekzekutimit, dhe rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin profesional, ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

**Rekomandimi B4** Kryetari të sigurojë forcimin e kontrolleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B5 - Inicimi i projekteve pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve**

**Gjetja**

Neni 36 paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/I-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë parasheh se "Para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin aktual fiskal, Organizata Buxhetore i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në Sistemin Informativ për Menaxhimin Financiar në Kosovë në përputhje me rregullat".

Në katër (4) raste komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale pa mjete të mjaftueshme të zotuara. Rastet kanë të bëjnë me projektet:

- Furnizim me material për mirëmbajtjen e objekteve komunale-vlera e zotimit ishte 20,000€, ndërsa vlera e kontratës 119,131€;
- Hartimi i projekteve- vlera e zotimit ishte 3,000€, ndërsa vlera e kontratës 140,000€;
- Rrënimi dhe largimi i objekteve-vlera e zotimit ishte 25,764€, ndërsa vlera e kontratës 35,000€; dhe
- Ekzaminimi i materialeve ndërtimore- vlera e zotimit ishte 4,000€, ndërsa vlera e parashikuar e kontratës 40,000€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit pa pasur zotim të mjaftueshëm të mjeteve.

**Ndikimi**

Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara, apo implikime buxhetore për vitin aktual si dhe të jenë ngarkesë për buxhetin e vitit vijues.

**Rekomandimi B5**

Kryetari duhet të forcojë kontrollet dhe procedurat për të siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit, të gjitha zotimet për projekte janë të vlerësuara dhe të miratuara në përputhje me fondet e disponueshme.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B6 - Vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara**

**Gjetja**

Neni 39.1 i Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësit parasheh se "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore".

Në pesë (5) raste në vlerë 253,545€, kemi vërejtur se komuna nuk i kishte kryer obligimet financiare brenda afatit prej 30 ditësh. Vonesat ishin deri në katër muaj nga data e pranimit të faturës.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.

**Ndikimi**

Vonesat në kryerjen e obligimeve mund t'i shkaktojnë kosto shtesë komunës për shkak se ajo mund të përballet me padi ku përveç vlerës së faturës duhet t'i paguaj kostot shtesë përfshirë kamatën, interesin dhe shpenzimet gjyqësore.

**Rekomandimi B6** Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunali në vitin 2023, ishte 3,825,402€, prej tyre ishin shpenzuar 3,607,195€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet për derivate, riparim dhe mirëmbajtje, furnizim me lëndë djegës, komunali etj.

**Çështja A4 - Tejkalim i sasive indikative në kontratën publike kornizë**

**Gjetja**

Paragrafi 54.10 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik përcaktojnë se "Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse AK nuk deklaron përqindjen e mospërputhjes në dosje të tenderit, atëherë kontrata përfundon me vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan të vendosur. Nëse AK deklaron përqindjen e mospërputhjes në dosje të tenderit dhe nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes se pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull".

Te kontrata publike kornizë, "Furnizim me barna dhe reagensa" e datës 07.12.2022, në vlerë 541,956€, kemi identifikuar tejkalim të sasive në 11 pozicione në vlerë 3,838€, në krahasim me sasinë e kontraktuar. Vlen të theksohet se vlera totale e kontratës nuk është tejkaluar.

Ndër tejkalimet përtej mospërputhjes së lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) janë:

Pozicioni 16 Methylergometrin amp ", sasia e realizuar ishte 1000 copë, ndërsa sasia e kontraktuar ishte 300 copë;

Pozicioni 35 Kanila 24 G", sasia e realizuar ishte 3500 copë, ndërsa sasia e kontraktuar ishte 2000 copë;

Pozicioni 46 Paraffin 10cm x10 cm, sasia e realizuar ishte 4300 copë, ndërsa sasia e kontraktuar ishte 2400 copë;

Pozicioni 48 Shpatulla druri 1x100copë sasia e realizuar ishte 800 copë, ndërsa sasia e kontraktuar ishte 200 copë;

Pozicioni 158 Mikroveta EDTA K3 200uL, sasia e realizuar ishte 3000 copë, ndërsa sasia e kontraktuar ishte 2000 copë; dhe

Pozicioni 204 Llanceta, sasia e realizuar ishte 3500 copë, ndërsa sasia e kontraktuar ishte 2000 copë.

Tejkalimi i sasive të kontraktuar ka ndodhur si rezultat i menaxhimit jo të mirë të kontratës nga menaxheri i kontratës.

**Ndikimi**

Tejkalimi i mospërputhjeve mbi limitin e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) për pozicion/artikull, është në kundërshtim me kriteret e përcaktuara për kontratat publike kornizë si dhe mund të rezultojë me pagesa përtej buxhetit të planifikuar për ato projekte dhe vështirëson realizmin e projekteve të tjera të planifikuara.

**Rekomandimi A4**

Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratës ushtrojnë kontrolle të rregullta për furnizime të çdo artikulli sipas kontratës kornizë dhe të sigurojë se nuk bëhen tejkalime të sasive të kontraktuara.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B7 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit**

**Gjetja**

Paragrafi 70.24.f. i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se "Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik".

Menaxherët e kontratave/projekteve nuk e kanë mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës se kontraktuesve.

Kjo ka ndodhur si rezultat i neglizhencës të menaxherëve të projekteve.

**Ndikimi**

Mosmbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo efektiv të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancen e kontratave.

**Rekomandimi B7**

Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vitin 2023, ishte 9,794,789€, prej tyre ishin shpenzuar 8,468,073€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet për rregullimin e infrastrukturës rrugore, ndërtimin e kanalizimeve, ndërtimin e ujësjellësit etj.

**Çështja A5 - Mossigurimi i garancionit të performancës dhe orarit të pagesave**

**Gjetja**

Neni 13-Pagesat e paradhënies i Ligjit nr. 08/I-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 nder të tjerash parashh "Për pagesën e paradhënies për projektet kapitale, kontrata duhet të përmbajë garancionin e performancës dhe orarin qartazi të përcaktuar të pagesave, e cila njëkohësisht parasheh punën që duhet kryer para se të bëhet secila pagesë".

Komuna kishte lidhë marrëveshje mirëkuptimi me Jetimat e Ballkanit për financimin e projektit "Ndërtimi i shtëpisë për qëndrim ditor për të moshuarit, kuzhinë humanitare dhe bujtinë në Komunën e Podujevës". Sipas kësaj marrëveshje komuna për vitin 2023, duhet t'i sigurojë mjetet financiare në vlerë 126,500€, apo 5% e vlerës së projektit në formë parapagimi. Për vitet 2024 dhe 2025, komuna duhet të sigurojë mjete financiare në vlerë prej 403,500€ ose nga 201,750€ për secilin vit. Shoqata ka marrë përsipër t'i sigurojë mjetet financiare në vlerë 2,000,000€. Procedurat e prokurimit do t'i udhëheq Shoqata.

Komuna për vitin 2023 kishte paguar si paradhënie 5% vlerës së projektit prej 126,500€. Megjithatë për këtë pagesë të bërë nuk ishte siguruar garancioni i performancës dhe orarin e përcaktuar për pagesat, që njëkohësisht përcakton punën që duhet kryer para se të bëhet secila pagesë.

Sipas përgjigjes nga komuna arsyeja pse nuk është bërë kjo është për shkak se ka të bëjë me një donator të besueshëm dhe nëse kërkohet sigurimi i garancionit dhe orari i pagesa nga donatori ekziston rreziku që donatori të largohet.

**Ndikimi**

Mossigurimi i garancionit të performancës për paradhënie dhe i orarit të përcaktuar të pagesave i cili parasheh punën që duhet kryer mundë të ndikoj që projekti të mos realizohet ashtu siç është paraparë.

**Rekomandimi A5**

Kryetari duhet të sigurojë se për pagesat e bëra në paradhënie të kërkoj sigurimin e garancionit të performancës dhe orarin e pagesave, që njëkohësisht parasheh punën që duhet kryer.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna në vitin 2023 ka shpalosur në RVF llogaritë e arkëtueshme në vlerë 3,721,030€.

**Çështja B8 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme**

**Gjetja**

Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005,Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.
Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Komuna nuk kishte një menaxhim efektiv në mbledhjen e Llogarive të arkëtueshme (LLA). Nga analizat tona, nuk kemi vërejtur që Komuna ka ndërmarrë ndonjë veprim konkret për vitin 2023 për të inkasuar LLA. Pjesa më e madhe e arkëtueshmeve vjen nga tatimi në pronë, në shumën e 2,627,106€, ndjekur nga qiraja e objekteve (parcelave) në shumën 1,090,988€ dhe të tjera në shumën 2,936€.

Dobësitë e identifikuara lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efikase në menaxhimin përkatësisht arkëtimin e tyre.

**Ndikimi**

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake.

**Rekomandimi B8**

Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke mos përjashtuar edhe masat juridike.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

# 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final[5] | 2023 Shpenzimet | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet |
|---|---|---|---|---|---|
| **Burimet e fondeve** | **27,406,567** | **31,594,651** | **29,739,731** | **24,913,687** | **22,218,657** |
| Grante Qeveritare - Buxheti | 25,600,074 | 28,705,948 | 27,799,690 | 22,300,431 | 20,767,918 |
| Financimi përmes huamarrjes | 0 | 0 | 0 | 180,268 | 75,565 |
| Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve | 0 | 0 | 0 | 95,756 | 0 |
| Të bartura nga viti i kaluar | 0 | 778,057 | 610,627 | 880,898 | 458,564 |
| Të hyrat vetanake | 1,806,493 | 1,806,493 | 1,214,331 | 1,214,141 | 868,016 |
| Donacionet vendore | 0 | 303,631 | 115,083 | 204,186 | 48,594 |
| Donacionet e jashtme | 0 | 522 | 0 | 38,008 | 0 |

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 4,188,084€. Kjo rritje është rezultat i Vendimeve të Qeverisë, i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak, si dhe donacioneve.

Komuna ka shpenzuar rreth 94% të buxhetit final e cila paraqet një performancë të mirë buxhetore.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2023 Shpenzimet | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet |
|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike** | **27,406,567** | **31,594,651** | **29,739,731** | **24,913,687** | **22,218,657** |
| Pagat dhe mëditjet | 13,041,474 | 16,147,349 | 16,110,409 | 13,450,099 | 12,881,047 |
| Mallrat dhe shërbimet | 3,088,899 | 3,357,402 | 3,142,048 | 2,588,859 | 2,583,473 |
| Komunalitë | 468,000 | 468,000 | 465,147 | 419,968 | 410,040 |
| Subvencionet dhe transferet | 1,600,050 | 1,827,111 | 1,554,054 | 1,272,012 | 703,733 |
| Investimet Kapitale | 9,208,144 | 9,794,789 | 8,468,073 | 7,182,751 | 5,640,364 |

Shpjegimet për ndryshimet e buxhetit në kategoritë ekonomik janë dhënë më poshtë:
Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 3,105,875€, krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje vjen nga Vendimet e Qeverisë së Kosovës në vlerë 3,090,837€ për realizimin e ligjit të ri të pagave, si dhe rritje prej 15,038€, të ndara nga qeveria për rimëkëmbjen ekonomik.
Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 268,503€. Kjo rritje vjen nga bartja e mjeteve nga kategoria investime kapitale për kategorinë mallra dhe shërbime me vendim të Kuvendit Komunal në vlerë 235,621€, rritje nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2022, për 25,680€, si dhe rritje nga donacionet për 7,202€.
Buxheti final për subvencione ishte rritur për 227,061€, nga kjo vlerë: 226,311€, ishte rritje nga donacionet e brendshme (participimet e qytetarëve) si dhe rritje prej 750€, nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2022.
Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 586,645€. Kjo rritje vjen si rezultat i bartjes së të hyrave vetjake të pa shpenzuar nga vitin 2022 për 751,627€, rritje nga donacionet për 70,639€, dhe zvogëlim i kategorisë së investimeve kapital prej 235,621€, ku me vendim të Kuvendit Komunal janë bartur në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Mjetet e shpenzuara në vitin 2023, për Rimëkëmbjen Ekonomike ishin 15,038€, ato kryesisht ishin ndarë për shtesa në shëndetësi.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023




Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2023, ishin 1,806,493€, përderisa ishin realizuar 1,740,942€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna për vitin 2023, ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 404,427€, si dhe të hyra nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës në vlerë 5,337€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2023 Pranimet | 2022 Pranimet | 2021 Pranimet |
|---|---|---|---|---|---|
| **Totali i të hyrave** | **1,806,493** | **1,806,493** | **1,740,942** | **1,472,653** | **1,427,378** |
| Të hyrat tatimore | 758,488 | 758,488 | 666,373 | 515,799 | 685,098 |
| Të hyrat jo tatimore | 1,048,005 | 1,048,005 | 1,074,569 | 951,155 | 739,571 |
| Të hyrat tjera | 0 | 0 | | 5,699 | 2,709 |

# 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022, kishte rezultuar me 14 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit i vitit 2022 ishte diskutuar në Asamblenë Komunale. Deri në fund të auditimit tonë, pesë (5) rekomandime janë zbatuar, një (1) është i mbyllur dhe tetë (8) rekomandime nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikun 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**




**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Baza për opinion | Kryetari me rastin e pagesave të bëra më marrëveshje me donatorët e jashtëm, të diskutoj me thesarin për mënyrën e pagesës për tu siguruar se janë duke u respektuar kërkesat ligjore. Më tutje, Kryetari duhet të shtoj kontrollet për të siguruar se regjistrimi i pasurisë të bëhet vetëm atëherë kur plotësohen të gjitha kërkesat e parapara ligjore. | Nuk kemi vërejtur ndonjë çështje të kësaj natyre. | I zbatuar |
| 2. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. | Në vitin 2023, kishte pasuri që nuk ishte regjistruar në klasën e duhur. | Nuk ka filluar zbatimi |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 3. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë zhvillimit të projekteve duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizim. | Komuna kishte hyr në obligime kontraktuale pa zotim të mjaftueshëm. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 4. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik. | Edhe në vitin 2023 menaxhimi i kontratave nuk bëhet përmes platformës së e-prokurimit. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 5. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të shtoj kontrollet ndaj zyrës së prokurimit dhe në rastet kur OE tërhiqen gjatë procesit të tenderimit të bëhet konfiskimi i sigurisë së tenderit. | Nuk kemi hasur çështje të kësaj natyre. | I zbatuar |
| 6. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet t'i shtoj kontrollet për të siguruar se zyra e financave nuk do ta lejoj asnjë shpenzim nëse nuk janë të arsyetuar në pajtim me kërkesat ligjore. | Për vitin 2023 nuk kemi hasur raste kur avancet për udhëtime zyrtare ishin të paarsyetuar. | I zbatuar |
| 7. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të shtoj kontrollet tek zyra e prokurimit për të siguruar se të gjitha dokumentet e kërkuar ngarkohen në platformën elektronike të prokurimit publik. | Për mostrat tona është vërejtur se dokumentet e përshtatshmërisë ishin ngarkuar në platformën e-prokurimit. | I zbatuar |
| 8. | Pasqyrat Financiare Vjetore | Kryetari duhet të sigurojë që, janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike adekuate. | Edhe në vitin 2023 komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 9. | Pasqyrat Financiare Vjetore | Kryetari duhet të sigurojë se rastin e përgatitjes së RVF Zyrtari Kryesor Financiar do të bëjë prezantimin dhe shpalosjen e duhura në lidhje buxhetin përfundimtar, lëvizjet dhe ndryshimet buxhetore të komunës. | Raporti Vjetor Financiar për vitin 2023 nuk kemi hasur gabime në këtë tabelë të PFV. | I zbatuar |
| 10. | Investimet kapitale | Kryetari të sigurojë forcimin e kontrolleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara. | Katër rate ishin hasur kur procedurat e prokurimit ishin filluar pa projekt ekzekutiv. | Nuk ka filluar zbatimi |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 11. | Çështjet e përbashkëta | Kryetari duhet të sigurojë informata të sakta dhe fonde të mjaftueshme për kategorinë e pagave dhe të adresojë këtë çështje tek Ministria e Financave, me qëllim që gjatë planifikimit të buxhetit të merret në konsiderim nëse është nevoja për buxhet shtesë për pagat jubilare. Derisa, për vonesat tjera në pagesa të shtojë kontrollet në mënyrë që procesi i realizimit të pagesave të bëhet brenda planifikimeve buxhetore dhe afateve kohore të përcaktuara. | Edhe në këtë vite ka pasur pagesa të bëra nga thesari me vendime gjyqësore, këtë e kemi prezantuar si informacion tek kapitulli gjetjet dhe rekomandimet. | Nuk është i aplikueshëm më |
| 12. | Pasuritë | Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për tu siguruar se zyrtari i pasurive do ta regjistrojë pasurinë nën 1,000€, në regjistrat kontabël të pasurive. | Komuna edhe këtë vit nuk ka regjistruar të gjitha pasuritë e në e-pasuri. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 13. | Llogaritë e arkëtueshme | Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke mos përjashtuar edhe masat juridike. | Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 14. | Obligimet e papaguara | Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe të sigurojë që të gjitha obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh. | Edhe në vitin 2003, komuna faturat nuk i kishte paguar brenda afatit të paraprë prej 30 ditësh. | Nuk ka filluar zbatimi |

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme

Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm

Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit

Florim Beqiri, Udhëheqës i ekipit

Muharrem Qyqalla, Anëtar i ekipit

Mexhit Ferati, Anëtar i ekipit

# Shtojca I: Letër konfirmimi

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Podujevës**
**Opština Podujevo -Municipality of Podujeva**

---

## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Podujevës, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Shpejtim Bulliqi

Kryetar i Komunës

Data: 23.04.2024 Podujevë

# Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[6] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet[7], duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**
***Forma e opinionit***

**Opinioni i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

**Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit**

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

**Opinioni i kualifikuar**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

**Opinion i kundërt**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

"E përhapur" është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

*Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit*

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

[2] Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

[3] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

[4] Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

[5] Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[6] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

[7] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E PODUJEVËS/OPŠTINA PODUJEVO/MUNICIPALITY OF PODUJEVA
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE

| Dorëzuar më / Dostavljeno | 12.07.2024 | |
|---|---|---|
| Njësi.org. / Org. Jed. | Nr. / Br. | Shtojcë - Prilog |
| 04-052 | 08-004 | 5436/24 |

PODUJEVË - PODUJEVO

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Podujevës**
**Opština Podujevo –Municipality of Podujeva**

| | |
|---|---|
| Datë/a: | 11.07.2024 |
| Referenc-ë: | |
| Për/ Za/ To: | Zyrën Kombëtare të Auditimit |
| CC: | Florim Beqiri, Auditor |
| Nga/ Od/ From: | Fatlum Osmani, Drejtor për Buxhet e Financa |
| Nga/ Od/ From: | Shpejtim Bulliqi, Kryetari i Komunës |
| Tema/ Subjekat/Subject: | Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve ZKA-se |

Te nderuar

Bashkangjitur gjeni planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**Për Zyrën Kombëtare të Auditimit**

**Nga z.Shpëtim Bulliqi - Kryetar i Komunës së Podujevës**

**Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve**
**të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit**

| Nr. | Komponenta e auditimit (kapitulli) | Gjetja | Rekomandimi | Veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrë | Zyrtari/ët përgjegjës | Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Çështja B1 - Nënvlerësimi i pasurive mbi 1,000€ dhe nën 1,000€** | Rregullorja MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6.1. përcakton se, "Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Po ashtu neni 6.3. përcakton se: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria". Pasurit kapitale mbi 1,000€, të raportuara në nenin 19.3.1 në Raportin Vjetor Financiar ishin nënvlerësuar për shkak se pagesat në vlerë prej 1,293,740€, nuk ishin regjistruar në SIMFK. Po ashtu | Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale dhe jo kapitale në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. | Komuna e Podujevës si organizatë buxhetore bënë regjistrimin e pasurive nën 1000 euro dhe mbi 1000 euro, mos regjistrimi i disa pasurive ka ndodhur per arsye se Ministria e Financave i ka jep qasje me vonese zyrtarit të ri te pasurisë, pasuritë do jene te gjitha të regjistruara. | Drejtoria e Financave | Regjistrimi i pasurive do rregullohet brenda vititi 2024 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pasuria jo kapitale nën 1,000€, për vitin 2023, nuk ishte regjistruar në sistemin e-pasurisë në vlerë prej 247,470€, dhe si rezultat këto pasuri ishin të nënvlerësuar. Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta në monitorimin dhe verifikimin e regjistrave të pasurisë, ku kjo pastaj ka ndikuar që pasuritë të mos jenë regjistruar në regjistrat përkatës. | | | | | |
| 2 | **Çështja B2 - Keqklasifikim i shpenzimeve** | Neni 18, paragrafi 3 i Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se "shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet t'i aplikojnë. Nga testimi i mostrave tona, kemi vërejtur keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë prej 301,385€. Nga kjo vlerë thesari kishte paguar sipas vendimit përmbarimor të gjykatës për paga jubilare dhe shujta për arsimtar nga | Kryetari duhet të sigurojë që, janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike adekuate. | Keqklasifimi i shpenzimeve ka ndodhur si rezultat i kontrates kolektive, kontrate kjo e nënshkruar vite më parë nga ana e nevilit qenderor. Vendimet gjygjesore të cilat janë marrë për këtë kontrate | Drejtoritë përkatëse dhe Drejtoria e Financave | 2024 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kategori investimet kapitale 199,678€, dhe nga subvencione dhe transfere 46,707€. Po ashtu nga kategoria investime kapitale komuna kishte paguar 55,000€, që për nga natyra i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime. Këto kishin ndodhur për shkak të planifikimit jo të mirë buxhetor dhe mungesës së mjeteve në kategoritë adekuate. | | kolektive janë ekzekutuar nga ana e Thesarit të Kosovës nga kategoritë jo adekuate qe ka rezultuar me keqklasifikim. | | | |
| 3 | **Çështja A1 - Pagesa e projektit nga fondet e një projekti tjetër pa miratim nga Kuvendi Komunal** | Neni 16-Ndryshimet në shumat e ndara për projektet kapitale në kuadër të nën programeve paragrafi 11 i Ligji nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 parasheh se "Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal. Ndryshimet e bëra të parapara me këtë nen regjistrohen në SIMFK nga | Kryetari duhet të sigurojë respektimin e procedurave për menaxhimin e fondeve, duke siguruar që çdo transferim i fondeve nga një projekt në tjetrin të miratohet paraprakisht nga Kuvendi Komunal. | Projekti i rregullimit të lumit Llap permban ne vete edhe rregullimin e kanalizimit pergjate lumit Llap, kjo është arsyja pse ky projekt është paguar nga projekti i kanalizimeve. | Drejtoria përkatëse dhe Drejtoria e Financave | 2024 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ministri". Komuna i kishte paguar 200,000€ nga fondet e projektit "Ndërtimi dhe Rindërtimi i Kanalizimit Fekal dhe Atmosferik nga Fshati Bajqinë deri në Lupq", për projektin "Zgjerimi dhe Rregullimi i Shtratit të Lumit Llap në Qytet", pa u aprovuar transferimi i mjeteve nga Kuvendi Komunal. Vlera e projektit ishte 804,871€. Kjo ka ndodh pasi që ishte fundi i vitit dhe projekti i kanalizimit nuk ishte iniciuar me kohë, atëherë ishte vendosur nga menaxhmenti që nga fondet e këtij projekti të bëhen pagesa për projektin tjetër pa kërkuar aprovim nga Kuvendi Komunal. | | | | | |
| **4** | **Çështja A2 - Përdorimi i gabuar i kontratës publike kornizë** | Neni 54-Kontratat Kornizë respektivisht paragrafi 54.2 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se "Kontrata publike kornizë është term i përgjithshëm i marrëveshjeve në mes të autoriteteve kontraktuese si dhe operatorëve ekonomik për furnizime, shërbime, dhe punë | Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që zyra e prokurimit zbaton kontratën e duhur ashtu siç e parasheh rregullativa ligjore | Renovimi i objekete arsimore është bërë me kontrata kornizë për arsye se ka pasur nevoje për shume intervenime të vogla në shumë | Menaxherët e kontratave | 2024 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | (riparim/ mirëmbajtje), e cila i vendos termat dhe kushtet sipas të cilave kontratat ndihmëse ose bërja e urdhrave mund të kryhet përmes termave të marrëveshjes. Komuna gabimisht kishte përdorur llojin e kontratë publike kornizë për punë për projektin kapital "Rrethojat e oborreve shkollore" në vlerë 46,800€, duke lejuar në kontratë +/-30%. Kontrata nuk do të duhej të ishte publike kornizë por për punë me çmim fiks, pasi që kontratat publike kornizë për punë sipas rregullores lejohet vetëm në rastet kur kemi të bëjë me kryerjen e punëve për riparim/mirëmbajtje. Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve nga zyra e prokurimit për t'i respektuar kërkesat ligjore që ndërlidhen me kontratën publike kornizë për punë. | | institucione arsimore . Gjithashtu intervenimet në infrastrukturen arsimore është i nevojshëm për gjatë gjithë vitit dhe këtë e bënë të mundur vetëm kontrata kornizë. | | | |
| 5 | **Çështja B3 - Regjistrimi i** | Rregullorja MF-Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo | Kryetari duhet të sigurojë zbatimin e | Regjistrimi i pasurisë në | Drejtoria e Financave | 2024 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **pasurisë në kategorinë e gabuar** | Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 11 parasheh se "Pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim. Pasuritë jo financiare kapitale që janë në fazën e investimeve në vijim nuk zhvlerësohen". Pasuritë e regjistruara në kodin e gabuar ose jo adekuat ishin në vlerë 379,448€. Kjo lidhet me faktin që pasuritë u regjistruan si pasuri në përdorim, ndërsa ato duhet të ishin regjistruar si investime në vijim. Kjo ka ndodh si rezultat i mos funksionimit të kontrolleve të brendshme, si dhe mungesa e monitorimit nga ana e menaxhmentit që pasuritë të regjistrohen sipas kërkesave ligjore. | drejtë të kontrolleve të brendshme lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale në pajtim me kriteret e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. | kategori të gabuar ka ndodhur gjate viteve të kaluara dhe reflekton edhe ne regjistrata e vitit 2023, kjo rregullohet vetëm pas përfudnimit të projekteve të cilat në vitet e kaluara janë regjistru në kategori të paguara | | | |
| 6 | **Çështja A3 - Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës Financiare** | Neni 22 i Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF – Shpenzimi i parave publike, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet Kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj | Kryetari duhet të sigurojë se financat dhe zyra e prokurimit do të ndjekin të gjithë hapat për procedimin e pagesave të | Pagesat jane kryer pas pranimit të mallit, pas pranimit është bërë zotimi i | Drejtoria e Financave | 2024 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Operatori Ekonomik sjellë faturën për pagesë. Nga 32 mostrat e testuar si pjesë e testimeve substanciale në kategorinë mallra dhe shërbime kemi vërejt se në 13 raste në vlerë 387,491€, nuk janë respektuar hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht është bërë pranimi i mallit dhe shërbimet/furnizimit dhe fatura pastaj është lëshuar zotimi dhe urdhërblerja. Kjo ishte si pasojë e dështimit të kontrolleve nga zyra e financave dhe prokurimit pasi që zyrtari zotues dhe zyra e prokurimit nuk i kishin respektuar hapat për procedim të pagesave sipas rregullës financiare. | përcaktuar me Rregullën Financiare për shpenzimin e parave publike. | mjeteve dhe urdherblerja ne disa raste për arsye se nuk është e mendur që të dihet saktë vlera financiare e furnizimit apo shërbimit si: furnizimi me naftë i veturave, shërbimet e fotokopjimit etj. | | | |
| 7 | **Çështja B4 - Mungesa e projekteve ekzekutuese** | Paragrafi 19.17 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik ndër tjerash parasheh se "Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të | Kryetari të sigurojë forcimin e kontrolleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të | Këto projekte për arsye të ndryshme janë realizuar vetëm me paramasë, për arsye se bëhet fjalë për shumë | Drejtoritë përkatëse dhe Zyra e Prokurimit | 2024 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit". Në tri raste komuna kishte filluar procedurat e prokurimit dhe kishte lidhë kontratë pa hartuar projekt ekzekutiv. Rastet ishin te projekti "Asfaltimi i rrugëve në qytet Lot I" me vlerë 143,954€, "Asfaltimi i rrugëve në qytet Lot III" në vlerë 117,843€, dhe "Rrethojat e oborreve të shkollave" në vlerë 46,800€. Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së planifikimit të duhur para fillimit të procedurave të prokurimit, duke përfshirë mungesën e hartimit të projektit ekzekutiv për projektet specifike | sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara. | rrucica të vogla brenda një projekti. | | | |
| **8** | **Çështja B5 - Inicimi i projekteve pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve** | Neni 36 paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/I-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Publike dhe Përgjegjësitë parasheh se "Para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim të rezultojë në ngritjen e një obligimi në vitin aktual fiskal, Organizata | Kryetari duhet të forcojë kontrollet dhe procedurat për të siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit, të gjitha zotimet për projekte janë të vlerësuara dhe të | Te projektet e cekuar qe janë lidhur kontrata pa zotimin e plotë të mjeteve është për arsye se kontratat | Drejtoria e Financave | 2024 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Buxhetore i regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në Sistemin Informativ për Menaxhimin Financiar në Kosovë në përputhje me rregullat". Në katër (4) raste komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale pa mjete të mjaftueshme të zotuara. Rastet kanë të bëjnë me projektet: • Furnizim me material për mirëmbajtjen e objekteve komunalevlera e zotimit ishte 20,000€, ndërsa vlera e kontratës 119,131€; • Hartimi i projekteve- vlera e zotimit ishte 3,000€, ndërsa vlera e kontratës 140,000€; • Rrënimi dhe largimi i objekteve-vlera e zotimit ishte 25,764€, ndërsa vlera e kontratës 35,000€; dhe • Ekzaminimi i materialeve ndërtimore- vlera e zotimit ishte 4,000€, ndërsa vlera e parashikuar e kontratës 40,000€. Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit pa pasur zotim të mjaftueshëm të mjeteve | miratuara në përputhje me fondet e disponueshme.. | nuk janë një vjeçare dhe nuk dihet sakte vlera e realizimit përgjatë vitit, andaj zotimi shtese realizohet nese ka realizushme ri të punëve. | | | |
| 9 | **Çështja B6 - Vonesa në** | Neni 39.1 i Ligjit të Menaxhimit të Financave | Kryetari duhet të përmirësojë | Në disa lënd ka pas | Drejtoria e Financave | 2024 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **kryerjen e obligimeve të papaguara** | Publike dhe Përgjegjësit parasheh se "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore". Në pesë (5) raste në vlerë 253,545€, kemi vërejtur se komuna nuk i kishte kryer obligimet financiare brenda afatit prej 30 ditësh. Vonesat ishin deri në katër muaj nga data e pranimit të faturës. Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore | menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave. | tejkalim të afatit 30 ditor per arsye ne disa ka pasur munngese te dokumentacionit | | | |
| **10** | **Çështja A4 - Tejkalim i sasive indikative në kontratën publike kornizë** | Paragrafi 54.10 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik përcaktojnë se "Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo | Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratës ushtrojnë kontrolle të rregullta për | Menxahimi i kontrave kornize bëhet në bazë të sasive në | Menaxherët e kontratave | 2024 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse AK nuk deklaron përqindjen e mospërputhjes në dosje të tenderit, atëherë kontrata përfundon me vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan të vendosur. Nëse AK deklaron përqindjen e mospërputhjes në dosje të tenderit dhe nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë | furnizime të çdo artikulli sipas kontratës kornizë dhe të sigurojë se nuk bëhen tejkalime të sasive të kontraktuara. | kontratë, tejkalimi në rastin konkrejt behet fjale per produkete me vlere shumë të ultë financiare dhe që kanë qenë të domosdosh me për funksionimi n e institucione ve shëndetësor e. | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes se pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull". Te kontrata publike kornizë, "Furnizim me barna dhe reagensa" e datës 07.12.2022, në vlerë 541,956€, kemi identifikuar tejkalim të sasive në 11 pozicione në vlerë 3,838€, në krahasim me sasinë e kontraktuar. Vlen të theksohet se vlera totale e kontratës nuk është tejkaluar. Ndër tejkalimet përtej mospërputhjes së lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) janë: Pozicioni 16 Methylergometrin amp ", sasia e realizuar ishte 1000 copë, ndërsa sasia e kontraktuar ishte 300 copë; Pozicioni 35 Kanila 24 G", sasia e realizuar ishte 3500 copë, ndërsa sasia e kontraktuar ishte 2000 copë; Pozicioni 46 Paraffin 10cm x10 cm, sasia e realizuar ishte 4300 copë, ndërsa sasia e kontraktuar ishte 2400 copë; Pozicioni 48 Shpatulla druri 1x100copë sasia e realizuar ishte 800 | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | copë, ndërsa sasia e kontraktuar ishte 200 copë; Pozicioni 158 Mikroveta EDTA K3 200uL, sasia e realizuar ishte 3000 copë, ndërsa sasia e kontraktuar ishte 2000 copë; dhe Pozicioni 204 Llanceta, sasia e realizuar ishte 3500 copë, ndërsa sasia e kontraktuar ishte 2000 copë. Tejkalimi i sasive të kontraktuar ka ndodhur si rezultat i menaxhimit jo të mirë të kontratës nga menaxheri i kontratës | | | | | |
| 11 | **Çështja B7 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit** | Paragrafi 70.24.f. i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se "Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik". Menaxherët e kontratave/projekteve nuk e kanë mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin | Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet përmes sistemit elektronik të prokurimit publik. | Kjo nuk ka ndodhur për arsye teknike ne disa raste. Gjatë vitit 2024 do të jetë i plotësuar si rekomandi m. | Menaxherët e kontratave dhe Zyra e Porkurimit | 2024 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | e performancës se kontraktuesve. Kjo ka ndodhur si rezultat i neglizhencës të menaxherëve të projekteve. | | | | | |
| **12** | **Çështja A5 - Mossigurimi i garancionit të performancës dhe orarit të pagesave** | Neni 13-Pagesat e paradhënies i Ligjit nr. 08/l-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 nder të tjerash parasheh "Për pagesën e paradhënies për projektet kapitale, kontrata duhet të përmbajë garancionin e performancës dhe orarin qartazi të përcaktuar të pagesave, e cila njëkohësisht parasheh punën që duhet kryer para se të bëhet secila pagesë". Komuna kishte lidhë marrëveshje mirëkuptimi me Jetimat e Ballkanit për financimin e projektit "Ndërtimi i shtëpisë për qëndrim ditor për të moshuarit, kuzhinë humanitare dhe bujtinë në | Kryetari duhet të sigurojë se për pagesat e bëra në paradhënie të kërkoj sigurimin e garancionit të performancës dhe orarin e pagesave, që njëkohësisht parasheh punën që duhet kryer. | | | 2024 | Projekti "Ndërtimi i shtëpisë për qëndrim ditor për të moshuarit, kuzhinë humanitare dhe bujtinë në Komunën e Podujevës" është projekt ku nga 2,530,000.00 euro, 2 milion janë donacion nga donatori, andaj nuk është e arsyshme qe ti kërkohet garancion një donatori. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Komunën e Podujevës". Sipas kësaj marrëveshje komuna për vitin 2023, duhet t'i sigurojë mjetet financiare në vlerë 126,500€, apo 5% e vlerës së projektit në formë parapagimi. Për vitet 2024 dhe 2025, komuna duhet të sigurojë mjete financiare në vlerë prej 403,500€ ose nga 201,750€ për secilin vit. Shoqata ka marrë përsipër t'i sigurojë mjetet financiare në vlerë 2,000,000€. Procedurat e prokurimit do t'i udhëheq Shoqata. Komuna për vitin 2023 kishte paguar si paradhënie 5% vlerës së projektit prej 126,500€. Megjithatë për këtë pagesë të bërë nuk ishte siguruar garancioni i performancës dhe orarin e përcaktuar për pagesat, që njëkohësisht përcakton punën që duhet kryer para se të bëhet secila pagesë. | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Sipas përgjigjes nga komuna arsyeja pse nuk është bërë kjo është për shkak se ka të bëjë me një donator të besueshëm dhe nëse kërkohet sigurimi i garancionit dhe orari i pagesa nga donatori ekziston rreziku që donatori të largohet. | | | | | |
| **13** | **Çështja B8 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme** | Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005,Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, | Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme në mënyrë të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme, duke mos përjashtuar edhe masat juridike. | Komuna e Podujevë e trashegon me vite problemin e llogarive të arktuëshme, ku kanë qenë një numër i madh i mjeteve të pa mbledhura, në vitet e fundit ka rritje të të hyrave vetanake që ka ndikuar në zvogëlimin e llogarive të | Drejtoria e Financave dhe Drejtoria e Pronës | 2024 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave. Komuna nuk kishte një menaxhim efektiv në mbledhjen e Llogarive të arkëtueshme (LLA). Nga analizat tona, nuk kemi vërejtur që Komuna ka ndërmarrë ndonjë veprim konkret për vitin 2023 për të inkasuar LLA. Pjesa më e madhe e arkëtueshmeve vjen nga tatimi në pronë, në shumën e 2,627,106€, | | arkëtushme, mirëpo ende mbetet një sfidë vlera e madhe e obligimeve ndaj komunës. | | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ndjekur nga qiraja e objekteve (parcelave) në shumën 1,090,988€ dhe të tjera në shumën 2,936€. Dobësitë e identifikuara lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efikase në menaxhimin përkatësisht arkëtimin e tyre. | | | | | | |

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

**Për; ZYRËN E KRYESUESIT TË KUVENDIT**
**z.Hilmi Hoxha Kryesues i Kuvendit**

**Çështja; Propozim Vendim**

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronjat (a), (l) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25 të Ligjit nr.08/L-017 Për Agjencinë Për Parandalimin e Korrupsionit, Vendimin nr.1476/2023 të datës 26.07,2023, Për Miratimin e Metodologjisë Për Planet e Integritetit, nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores MAPL nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 34 paragrafi 2.1 dhe 2.12 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i propozohet marrja e vendimit Për shfuqizimin e Vendimit nr. prot.01-016/01-0045377/23 të datës 03.07.2023, Për Miratimi e Planit të Integritetit 2023 – 2027 në Komunën e Podujevës.

Bashkëngjitur gjeni Propozim Vendimin në aneksin në vijim.

**Nr.prot.**01-020/01-0047146/24
**Podujevë, datë;** 19.09.2024

**Kryetari i Komunës**
**Shpejtim Bulliqi**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronjat (a) dhe (l) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25 të Ligjit nr.08/L-017 Për Agjencinë Për Parandalimin e Korrupsionit, Vendimin nr.1476/2023 të datës 26.07,2023, Për Miratimin e Metodologjisë Për Planet e Integritetit, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 34 paragrafi 2.1 dhe 2.12 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më datë ________________ miratoi këtë;

## VENDIM
## PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT N.PROT. 01-016/01-0045377/23 të datës 03.07.2023 PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT 2023-2027 NË KOMUNËN E PODUJEVËS

**Neni 1**

Shfuqizohet vendimi nr. prot.01-016/01-0045377/23, i datës 03.07.2023, Për Miratimi e Planit të Integritetit 2023 – 2027 në Komunën e Podujevës.

**Neni 2**

Shfuqizimi i vendimit sipas nenit 1 të këtij vendimi bëhet në kuptim të zbatimit të nenit nenit 25 të Ligjit nr.08/L-017 Për Agjencinë Për Parandalimin e Korrupsionit si dhe Vendimit nr.1476/2023 të datës 26.07.2023, Për Miratimin e Metodologjisë Për Planet e Integritetit, në bazë të cilave miratimi i planit të integritetit është në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive të Ekzekutivit të Komunës.

**Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021.

**Nr.prot.______________________**
**Podujevë, datë;________________**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Hilmi Hoxha**

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

# DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Në bazë të nenit 62.3, ndërlidhur me nenet 12.2 shkronja d), 17 dhe 40 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 10 paragrafi 2.1 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr.04/L-174, Udhëzimit Administrativ MMPH nr.01/2018 për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme, nenit 64 paragrafi 4, ndërlidhur me nenin 15 paragrafi 2.4; nenet 19 dhe 34 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 13 paragrafi 1.1 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, Kuvendit të Komunës, i,

***Propozon***

## VENDIM
## PËR INICIMIN E PROCEDURAVE PËR HARTIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM NË PJESËN E POSHTME TË QENDRËS 2 LINDJE - BLLOKU 1

### Neni 1

Me këtë vendim lejohet inicimi i procedurave për hartimin e **Planit Rregullues të Hollësishëm për "Pjesën e Poshtme të Qendrës 2 Lindje – Blloku 1"** në Komunën e Podujevës, sipas Raportit të Arsyeshmërisë i përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtës së Mjedisit, bashkëngjitur këtij propozim vendimi, Zona Kadastrale Podujevë, me sipërfaqe të përgjithshme 323631.125 $m^2$, sipas Hartës Zonale të Komunës.

### Neni 2

Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave urbane apo zona rurale siç është e përcaktuar me Planin Zhvillimor Komunal për periudhën 2016 - 2025 si dhe Hartën Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën 2022 - 2030.

### Neni 3

Bartës i procesit të hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm për "Pjesën e Poshtme të Qendrës 2 Lindej – Blloku 1", është Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si Autoritet përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, në koordinim dhe bashkëpunim me Drejtoritë sektoriale brenda Komunës së Podujevës.

### Neni 4

Plani Rregullues i Hollësishëm për "Pjesën e Poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1" do të mbulon periudhën të paktën 8 (tetë) vite

### Neni 5

Pas miratimit, Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 dit pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021.

**Nr.Prot.** 07-350/01-0047245/24
**Podujevë, datë: 19 korrik 2024**

**Drejtori i DPUMM**
**Leutrim Krasniqi**

**Plani Rregullues i Hollësishëm i pjesës së poshtme të Qendrës 2 Lindje – Blloku 1**

(Raporti i Arsyeshmërisë)

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit e komunës së Podujevës, propozon hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm (PRrH) për zonën "Pjesa e poshtme Q2L-B1", me qëllim të përmirësimit të kushteve jetësore dhe mirëqenies së qytetarëve të zonës përkatëse, zbatimit të HZK-së, dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm në tokës. Qendra 2 Lindje-Blloku 1, shtrihet në pjesë lindore të qytetit, veçohet me dendësi të ulët deri të mesme (105-200 b/ha) në të cilat zhvillohen funksionet ekonomike që shërbejnë gjithë territorin e komunës, por në një shkallë më të ulët.




Sipërfaqja e propozuar për Planin e Hollësishëm Rregullues - sipërfaqja pjesës së poshtme të Q2L-B1 është përafërsisht 323631.125m$^2$.

**KARAKTERISTIKAT E ZONËS**

Duhet theksuar se zona për të cilën propozohet hartimi i këtij plani, karakterizohet me zhvillim jo adekuat përgjatë 20 viteve të fundit, Zonën e përshkruan hekurudha e cila për momentin është jo funksionale , por në të ardhmen bazuar në projektet regjionale do të rifunksionalizohet dhe do trajtohet në mënyrë të detajuar me hartimin e planit rregullues për këtë hapësirë, Afërsia me Parkun e Paqes si hapësirë rekreative e qytetit të Podujevës është karakteristikë tjetër dhe mundësi për trajtimin ma të hollësishëm e kësaj zone, bazuar edhe në qasjen direkte që ka me qendrën dhe pjesët tjera të qytetit, Disa shfrytëzime tjera nga infrastruktura publike dhe sociale dhe infrastrukturës teknike, por edhe transportit mungojnë në zonë.

**Raporti i Arsyeshmërisë për Hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm (PRRH) për Zonën Qendrore 2 Lindjes, Blloku 2, Qyteti Podujevës**

**I. Hyrje**

Komuna e Podujevës ka hartuar Hartën Zonale Komunale (HZK) e cila mbulon të gjithë territorin e komunës, duke përcaktuar kushtet e përgjithshme zhvillimore dhe kushtet tjera përkatëse. Me kapacitetet të kufizuara profesionale të komunës së Podujevës, gjatë kohës së hartimit të HZK-së, me informatat e kufizuara nga të gjithë akterët e kyçur në hartimin e HZK-së, por edhe përkrahja e kufizuar nga jashtë na ka vendosë në situatën që jo vetëm në ketë zonë por edhe disa zona tjera sidomos te zona urbane, duhet Plane Rregulluese të Hollësishme , Ne e kemi konsideruar se mbulimi me përmbajtjet që janë trajtuar me HZK të komunës së Podujevës, nuk do jetë i mjaftueshëm për rregullimin hapësinorë adekuat të zonës, trajtim të infrastrukturës, lëshim të lejeve ndërtimore e veçanarisht trajtim të barabartë të gjithë pronarëve për procedurat e lë-shuarjes së lejeve ndërtimore. Për këto dhe arsyet që do i specifikojmë në vijim, është evidentuar nevoja për detajim të kushteve ndërtimore për Zonën Qendrore 2 Lindjes, Blloku 2 në funksion të trajtimit të barabartë, zbatimit të qëndrueshëm dhe funksional të zonës.

**II. Arsyeja për Hartimin e PRRH-së**

Hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Qendrore 2 Lindjes, Blloku 2 është i domosdoshëm për arsyet specifike si më poshtë:

1. **Kushtet e Detajuara Ndërtimore:**
    - Kushtet aktuale në HZK nuk janë të mjaftueshëm për të mbuluar nevojat specifike të zhvillimit në këtë zonë, kushtet në nivel zone (dy e ma shumë parcela që kanë kushte të njëjta) nuk mjaftojnë sepse nuk ka pajtueshmëri të pronarëve të parcelave në trajtim të parcelave për shkak pozitës dhe formës së parcelave.
    - Andaj hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Qendrore 2 Lindjes, Blloku 2 është i domosdoshëm, sepse bënë trajtim të hollësishëm, përfshirë riparcelimin profesional (me diskutime dhe pajtueshmëri të pronarëve), i cili do ti vendos pronarët dhe parcelat në funksion të kushteve nga HZK ,por me rregullim më të detajuar, për të siguruar një zhvillim të harmonizuar dhe të qëndrueshëm, thjesht kushtet do precizohen deri te vendosja e ndërtesës në parcelë, ashtu që të arrihet pajtueshmëri nga të gjithë pronarët ,dhe PRRH-ja do shërbej si instrument për ndërtimin e pajtueshmërisë së pronarëve të parcelave e cila do reflektoj në komoditet , racionalitet si për ndërtim ashtu edhe funksionim, dhe cilësi e jetesës, veçanërisht për korridore të gjelbëra, parkim, infrastrukturë publike dhe përmbajtje tjera.
2. **Mungesa e Vijave Rregulluese dhe Ndërtimore adekuate:**
    - Aktualisht, zona ka një sipërfaqe të zhvilluar (ndërtuar) dhe zbatimi i vijave Rregulluese dhe Ndërtimore nga NTPH dhe HZK, pa analiza specifike se cilat pjesë të zonës (pronarëve të parcelave dhe ndërtesave ) nuk planifikojnë zhvillime të reja, dhe cilat pjesë të zonës duan dhe kanë parashtrua kërkesën për leje ndërtimi vija në pik pyetje zbatimin e tyre dhe trajtimin e barabartë të zonës (duke krijuar hapësira dhe vija të

rregullta, e ndriçim adekuat) por edhe pronave, Pra mund të konstatojmë se nuk ka vijë rregulluese dhe ndërtimore adekuate të trajtuara brenda zonës (në nivel të parcelave), pasi që janë trajtuar në nivel të HZK-së (zonave), çka krijon nevojën për një plan të detajuar që do të rregullojë vijat Rregulluese dhe Ndërtimore sipas NTPH dhe HZK-së por në detaje të hollësishme ashtu që të krijojmë vijat adekuate, trajtim të barabartë të parcelave dhe pronarëve dhe zhbllokojmë ndërtimet në zonë, duke precizuar përdorimin e tokës.

3. **Forma dhe pozita e Parcelave:**

- Forma jo e rregullt e parcelave dhe pozita e tyre, në ketë zonë imponon trajtim jo të barabartë të gjithë pronarëve, dikujt duke i krijuar favore e dikujt pengesa, në ketë rast kemi probleme në zonë dhe pronarët kanë kërkuar ndihmën tonë, që lidhet me lejet ndërtimore, andaj PRRH është i vetmi instrument i cili do zgjidh ketë problem pasi që nuk kemi ligj për komasacion urban

- Andaj hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Qendrore 2 Lindjes, Blloku 2 është i domosdoshëm, pasi që format jo e rregullt e parcelave dhe pozita e tyre e kërkon një planifikim të hollësishëm për të përcaktuar në harmoni me kushtet zhvillimore, ndërtimore etj, vendosje të përmbajtjeve të hollësishme dhe instrumenteve legal në funksion të trajtimit të barabartë dhe adekuate të çdo parcele dhe pronari normal pa ndryshuar rregullat dhe aktivitetet e zhvillimit hapësinor të përcaktuara në dokumente e planifikimit hapësinor të nivelit më të lartë në fuqi si HZK e Podujevës, përfshirë Kushtet Zhvillimore, Kushtet Ndërtimore, Masat Mbrojtëse si dhe kushtet e Zonave Mbishtresore, por duke rregulluar në hollësi deri te vendosja e ndërtesave në parcela, duke siguruar edhe rregullim e zbatim të Hollësishëm të NTPH dhe HZK-së në funksion të sigurimit të hapësirave publike dhe gjelbërimit në mënyrë adekuate.
- Përfundimisht mund të themi se PRRH-ja si zhvillim dhe zgjidhje e prodhuar do të kontribuojë në: 1. Zgjidhje të konfliktit në mes pronarëve
  2.Organizimin racional të sipërfaqes së planifikuar për PRRH;
  3. Trajtim i vijave Rregulluese dhe Ndërtimore
  4. Trajtim i Formës dhe pozitës së Parcelave

4. **Trajtimi i infrastrukturës**

- Në funksion të zbutjes së e rreziqeve nga fatkeqësitë; në zonë kalon hekurudha e cila për momentin është jo funksionale ,mirëpo edhe nuk është trajtuar në mënyrë adekuate në HZK të Podujevës ,Lidhja me korridoret e Rajonale kërkon rifunksionalizimin e hekurudhës, rifunksionalizimi i saj pa trajtim të hollësishëm në zonë paraqet rrezikshmëri për qytetarët e zonës dhe hartimi i planit rregullues për këtë hapësirë është më se i nevojshëm për trajtim ,dhe definim të servituteve dhe përmbajtjeve tjera.

- Infrastruktura Rrugore brenda zonës nuk është e trajtuar me HZK andaj kemi probleme në mes pronarëve të parcelave e cila mund të zgjidhet vetëm me PRRH pasi nuk ka pajtueshmëri në mes tyre.

- Infrastruktura publike Afërsia me Parkun e Paqes si hapësirë rekreative e qytetit të Podujevës është përparësi por edhe nga ana tjetër mundësi për organizmin e kësaj zone, marrë për bazë qasjen direkte që ka me qendrën dhe pjesët tjera të qytetit,por edhe kjo përmbajtje nuk është trajtuar në mënyrë adekuate me HZK andaj kërkohet trajtim me PRRH.

III. Arsyet tjera të këtij Raporti

- Detajimi i kushteve ndërtimore për zonën në fjalë sipas U.A. MMPH - nr.01/2018 dhe Udhëzim Administrativ mmph-nr.08/2017 mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor

HZK e Podujevës ka siguruar një kornizë të përgjithshme për përdorimin e tokës dhe zhvillimin e zonës, por nuk mund të adresojë çdo detaj të nevojshëm për zhvillimin urban. PRRH plotëson këtë boshllëk duke siguruar rregullore dhe normativë specifike për ndërtimet, infrastrukturën dhe hapësirat publike.

- Zbatimi i Politikave dhe Strategjive Lokale

PRRH ndihmon në zbatimin e politikave dhe strategjive të përfshira në HZK, duke i përkthyer ato në plane konkrete dhe veprime specifike për një zonë të caktuar. Kjo përfshin detajimin e planeve për zhvillim ekonomik, social dhe mjedisor.

- Planifikimi i Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike

PRRH lejon planifikimin e detajuar të infrastrukturës teknike dhe shërbimeve publike, si rrugët, kanalizimet, furnizimi me ujë, energjia elektrike dhe hapësirat publike. Kjo siguron që infrastruktura të jetë e përshtatshme për nevojat e komunitetit dhe të zhvillimit të ardhshëm.

- Përshtatja me Kushtet Lokale

Çdo zonë ka karakteristika unike dhe kërkesa specifike që mund të mos jenë adresuar plotësisht nga HZK. PRRH mund të përshtatet më mirë me këto kushte lokale, duke adresuar çështje të veçanta të zonës, si topografia, mjedisi natyror dhe struktura ekzistuese urbane.

- Sigurimi i Cilësisë së Jetës

PRRH kontribuon në përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve, duke planifikuar në detaje hapësirat publike, gjelbërimin, objektet shoqërore dhe kulturore. Kjo ndihmon në krijimin e një mjedisi jetësor të shëndetshëm dhe tërheqës.

- Menaxhimi i Zhvillimeve dhe Ndryshimeve Urbanistike

Zonat urbane janë në ndryshim të vazhdueshëm. PRRH ndihmon në menaxhimin e këtyre ndryshimeve, duke përcaktuar standarde dhe rregulla të qarta për zhvillimin dhe ndërtimin, dhe duke parandaluar zhvillimet e pakontrolluara ose të paplanifikuara.

- Harmonizimi me Legjislacionin dhe Rregulloret

**Hartimi i një PRRH ndihmon në sigurimin që zhvillimet e ardhshme janë në përputhje me legjislacionin lokal dhe kombëtar, duke përfshirë rregulloret e ndërtimit dhe standardet e mjedisit. Kjo siguron që zhvillimi të jetë i qëndrueshëm dhe ligjërisht i pranueshëm.**

- Promovimi i Zhvillimit Ekonomik dhe Investimeve

**PRRH krijon një plan të qartë dhe të detajuar për zhvillimin urban, duke tërhequr investitorë dhe duke promovuar zhvillimin ekonomik të zonës. Kjo krijon mundësi të reja për bizneset dhe banorët.**

- Pjesëmarrja dhe Konsultimi Publik

**Procesi i hartimit të PRRH përfshin konsultime publike dhe pjesëmarrjen e komunitetit, duke siguruar që nevojat dhe shqetësimet e banorëve të jenë të adresuara në planifikim. Kjo rrit transparencën dhe pranimin e planit nga publiku.**

- Koordinimi Ndërmjet Aktorëve të Ndryshëm

**PRRH siguron koordinimin e aktiviteteve dhe interesave të aktorëve të ndryshëm, siç janë qeverisja lokale, zhvilluesit, investitorët dhe komuniteti. Ky koordinim është i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të planeve të zhvillimit.**

Përfundim

**Hartimi i një Plani Rregullues të Hollësishëm i Zona Qendrore 2 Lindjes Blloku 2 Qyteti i Podujevës është esencial për të siguruar që zhvillimi urban të jetë i qëndrueshëm, i mirëorganizuar dhe në përputhje me nevojat specifike të komunitetit dhe kushtet lokale, edhe kur ekziston një Hartë Zonale Komunale e cila përcakton kushtet e përgjithshme dhe kushtet tjera për territorin e komunës.**

**IV. Konkluzione dhe Rekomandime**

Raporti i Arsyeshmërisë për hartimin e PRRH-së për Zonën Qendrore 2 Lindjes, Blloku 2, Qyteti Podujevës, është hartuar për të shpjeguar qartë nevojën e hartimit të PRRH-së dhe për shpenzime financiarenë funksion të zgjidhjeve të lartpërmendura për këtë plan. Ky raport siguron që zhvillimi i propozuar do të ketë ndikim pozitiv në mjedis, do të krijojë një hapësirë të sigurt dhe ekonomikisht të qëndrueshme, dhe do të jetë në përputhje me dokumentet e planifikimit hapësinor ekzistuese. Rekomandohet që Kuvendi i Komunës dhe Ministria të miratojnë këtë raport dhe të inicojnë procesin e hartimit të PRRH-së.

**Informata nga HZK-ja për zonën:**

Plani Rregullues i Hollësishëm për pjesën e poshtme të Q2L-B1 propozohet të planifikohet sipas Hartës Zonale të Komunës së Podujevës (2022-2023), në të cilën për këtë zonë janë të përcaktuar shfrytëzimet të nënndara:

Shfrytëzimet e lejuara, lejuara dytësore, lejuara veçanta, përkohshme dhe të ndaluara

Shfrytëzimet e lejuara:

- Banim me funksione tjera në pajtueshmëri (ndërtesa të banimit shumë-banesor). Ky lloj i shfrytëzimit lejohet të kombinohet me shërbim tregtar/profesional, shërbim profesional financiar dhe i informacionit, shërbime bankare në përdhese të objektit.

- Infrastrukturë e transportit rrugor, ndalesat e autobusëve;

-Shërbime publike (infrastruktura e energjisë elektrike dhe termike, telekomunikacionit, ujësjellësit dhe kanalizimit, vend-depozitimet e mbeturinave);

Shfrytëzimet dytësore të lejuara në kuadër të zonës:

- shërbime të komunitetit (shërbime arsimore, shëndetësisë, fetare);

- shërbime kulturore, argëtuese dhe rekreative (parqe, gjelbërim, terrene sportive...);

- shërbime tregtare me pakicë (shërbime të ushqimit-shitore);

- shërbime të hotelierisë (restaurante, bare);

- hapësira të vogla për riparim të automjeteve dhe pajisjeve personale dhe shtëpiake e të ngjashme, autolarje;

- hapësira të vogla artizanale;

- Shërbim teknik profesional dhe shkencor shërbim financiar, komunikimit e informimit dhe i sigurimit.

Shfrytëzimet dytësore të lejuara në kuadër të njëjtit bllok: veprimtaritë dytësore dhe vartëse të zonës së banimit.

Dimensionit të parcelës për shfrytëzimet dytësore i shtohet sipërfaqja e nevojshme për vendosjen e strukturave dytësore të dhëna tek kushtet në kuadër të zonave përkatëse.

- Parkingje;

- Shërbime rekreative (gjelbërim, terrene sportive, shtigje për ecje;

- Shfrytëzimet e veçanta të lejuara në kuadër të zonës;

- shërbime tregtare me shumicë;

- Rrethoja nga rruga me të cilën rrethohet parcela ndërtimore këndore nuk guxon të jetë më e lartë se 1m', kjo për shkak të sigurimit të shikimit vizuel të udhëkryqit;
- Rrethoja e parcelave ndërtimore mes fqinjve mund të bëhet me mur të gjallë (me gjelbërim) i cili mbillet në boshtin e kufirit të parcelave ndërtimore. Në rastet ku mund të ketë edhe rrethoja të mundshme për objektet përbrenda parcelës së njëjtë ndërtimore (objektet ekonomike, kopshte, depo etj..), lartësia e rrethojës nuk guxon të kalojë lartësinë e rrethojës së jashtme;
- Hapja e dyerve në kuadër të rrethojës nuk duhet të jetë jashtë vijës rregulluese.
- Streha kërkohet të jetë jo më shumë se 1 m;
- Me qëllim të përmirësimit estetik, komuna mund të vendos taksa më të mëdha për ndërtesat e papërfunduara ose të degraduara të cilat nuk plotësojnë kushtet optimale të banimit e të cilat ndikojnë negativisht në peisazhin rural apo urban dhesigurinë e zonës përreth.

Bonuset e zonimit: mund të përdoren si stimul i propozuar nga komuna apo edhe investitori për të realizuar zbatimin e planit dhe përdoret sidomos në rastet e kompensimit, eksproprijimit të pronës

private me qëllim të ofrimit të përmbajtjeve publike, infrastrukturës teknike (p.sh. zgjerimin e rrugëve, parkingjeve, trotuareve) apo hapësirave për rekrijim dhe të gjelbëra në kuadër të zonës së banimit. Komuna mund të përdor legjislacionet në fuqi si dhe instrumente tjera për të realizuar bonuset e zonimit Ligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme, Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, lirimin nga tatimi në pronë e të ngjashme (shih nenin 39 i UA për NTPH). Në raste kur dëshmohet se as ky mekanizëm nuk mund të zbatohet për arsye objektive, atëherë Komuna mund të fillojë me zbatimin e parimit të 50% të vijës ndërtimore ekzistuese;

Jonkonformitetet: jo-konformiteti të aplikohet tek rastet e objekteve të vetmuara të banimit në toka bujqësore, të cilat do të aplikohet mënyra "ngrirja e gjendjes".

